



BULETIN

Revistë Informative
Periodike

Janar-Qershor 2016



Republika e Kosovës



Komuna e Gjiçanit

Gjiçani nderohet me

diplomë për bashkëpunim dhe partneritet european

Kongresi i Pushtetit Lokal dhe Regjional i Këshillit të Europës, ka shpërblyer Gjiçanin me diplomën për bashkëpunim ndërkomunal, ndërregjional dhe për partneritet europian. Në ceremoninë e rastit, që u zhvillua në Paris të Francës, diplomën e nderit, kryetarit të Komunës së Gjiçanit, Lutfi Haziri, ia dorëzoi presidenti i Kongresit, Jean-Claude Frecon. Kryetari Haziri e ka falënderuar me këtë rast z. Frecon për vlerësimin, duke thënë se

ky është një nder që i bëhet qytetit të Gjiçanit dhe qytetarëve të kësaj Komune. Përndryshe, kreu i Gjiçanit, Lutfi Haziri, së bashku me drejtorin e DZHE-së, Agim Zuzaku, janë duke ndjekur punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Asociacionit Europian për Zhvillim të Demokracisë Lokale (ALDA). Komuna e Gjiçanit, nga viti 2015 është anëtare me të drejta të plota në këtë organizatë.



**Haziri Në Gjiçan kemi
vendosur barazi sociale dhe
barazi në investime**



**Petrovci O sa mirë me
qenë në Gjiçan**

FAQE 15

Ne jemi model tjetër i qeverisjes

FAQE 21

Haziri: Ne ishim gjeneratë e Republikës, rinia e sotme është gjeneratë e integriteteve evropiane

FAQE 34

Konferencat e shfave të grupeve politike në Kuvend Komunal

FAQE 122

Gjiçani me donatorët nis projektet e mëdha

FAQE 132

Kronika e manifestimit "Flaka e Janarit 2016"

FAQE 154

Haziri: Gjiçani, kryeqytet kulturor i shqiptarëve në Ballkan

Botoi

KK Gjilan, Zyra për Informim

E përgatiti:

Stafi i Zyrës për Informim:

Ilmi Musliu

Ibrahim Ademi

Muhamet Pajaziti

Eroll Jonuzi - Fotoreporter

kk.rks-gov.net/gjilan

0280/321 486



Për Gjilanin

Gjilani gjendet në pjesën juglindore të Kosovës. Si njëra ndër komunat më të mëdha të Kosovës, me rreth 100 mijë banorë rezidentë, është qendër e Anamoravës dhe regjionit të lindjes, në përgjithësi, që përfshin njëmbëdhjetë komuna.

Gjilani si vendbanim është formuar rreth vitit 1750, ndërsa si qendër urbane - në vitin 1772. Si qendër urbane është zhvilluar krahas shuarjes së Novobërdës (Artanës), e cila në mesjetë ka qenë njëri nga qytetet dhe qendrat më të mëdha tregtare dhe ekonomike në Ballkan.

Pozita gjeografike që ka Gjilani, si një gjeo-komunikuese, i mundëson atij lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit.

Gjilani është larg nga Prishtina, kryeqendra e Kosovës, 46 kilometra, nga Kamenica - 27 km, nga Vitia – 22 km, nga Artana – rreth 25 kilometra. Me komunat e regjionit, në juglindje kufizohet me Preshevën (33 km) dhe Kumanovën (53 km), ndërsa në lindje – me Bujanocin (40 km).

Ndërtimi i rrugës Gjilan-Lipjan, nga drejtimi i Kishnapolës, ka shkurtuar dukshëm distancat e kësaj komune me aeroportin e Prishtinës, me rrugën e kombit si dhe me hekurudhat e Kosovës.

Gjilani do të bëhet së shpejti me autostradë. Projekti është prezantuar nga Ministria e Infrastrukturës.

Gjilani pret të lidhet së shpejti edhe me Kumanovën, nga drejtimi i Stançiqit, ku parashihet hapja e një pike doganore.

Qyteti përshkohet nga tre lumenj të vegjël, Mirusha, Banja dhe Stanishori, të cilët bashkohen dhe derdhen në Moravën e Binçës, që përbën njërin prej tre lumenjve më të mëdhenj në Kosovë.

Gjilani ka dy liqej akumulues, në Përlepnice, që shfrytëzohet për furnizimin e qytetit me ujë të pijes dhe në Livoç të Epërm, që shfrytëzohet si qendër rekreative.

Gjilani njihet edhe për ujërat termale dhe ka dy banja, në Mireshe e Uglar.

Gjilani ka kushte të mira për bujqësi dhe njihet si qytet agro-industrial. Rrethina e Gjilanit është e pasur me xehe (hekur e leucid) dhe me burime minerale (Nasalë, Pidiq, Kmetoc, Uglar, Përlepnice).

Gjilani njihet edhe si qytet i bashkatdhetarëve, meqë besohet se në botën e jashtme jetojnë mbi 35 për qind e qytetarëve të kësaj komune.

Prej 16 vitesh e kënde, Gjilani është shndërruar në atdhe të dytë edhe për të zhvendosurit nga Lugina e Preshevës. Aktualisht, llogaritet se këtu jetojnë mbi 15 mijë banorë nga kjo trevë etnike.

Prej dhjetorit të vitit 2014, në Gjilan, është hapur Zyra për Preshevë, Bujanoc e Medvegjë.

Gjilani është shpallur “Qytet i Paqes” nga Këshilli i Europës.

Qyteti i Gjilanit është dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani si dhe nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga.

Gjilani është binjakëzuar me qytetet dhe komunat Luterbah (Francë), Iper (Belgjikë), Jelderim (Turqi) dhe të tjera.

Gjilani, me kalanë e Pogragjës dhe vlerat tjera të trashëgimisë, ka bërë hapa konkret në zhvillimin e turizmit, duke falënderuar edhe sektorin privat që ka bërë investime në këtë fushë.

Fjala e kryetarit

Jemi në vitin e tretë të qeverisjes sonë, e cila karakterizohet me suksese dhe sfida. Në këtë gjashtëmujor, kemi arritur të realizojmë një sërë projektesh të rëndësishme për Komunën tonë.

Në ofrimin e shërbimeve administrative, Komuna e Gjilanit është shembull në Kosovë dhe rajon. Kemi funksionalizuar shërbimin e E-kioskave, ndërkohë po punojmë në projektin madhor “Gjilani Smart City”.

Në sektorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kemi nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit me MSHMS për ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, gjersa në bashkëpunim me UNICEF-in dhe organizata tjera ndërkombëtare, kemi vazhduar me ofrimin e vizitave mjekësore nëpër shtëpi për të gjitha familjet që nuk e kanë të lehtë qasjen në mjekësinë familjare. Në sektorin e përkujdesjes sociale, kemi përfunduar 30 shtëpi për nevojtarë dhe kemi subvencionuar në vazhdimësi një numër të konsiderueshëm të nevojtarëve për barna e mjekime si dhe kemi vazhduar me përkrahje, brenda mundësive tona, për shoqatat e ndryshme që ofrojnë përkujdesje për qytetarët me nevoja të veçanta.

Në sektorin e Arsimit, në bashkëpunim me GIZ-in, kemi arritur t'i certifikojmë 400 mësime të klasave 1-9 në fushën testimeve dhe të matematikës. Ndërkohë, nxënësit tanë kanë shkëlqyer nëpër gara rajonale, republikane e ndërkombëtare. Përkundër pamundësive financiare, ne kemi investuar në disa nga këta talent të rinj duke iu ndarë bursa akademike për shkollim të mëtutjeshëm në universitetet dhe kolegjet tona. Në aspakëtin infrastrukturor, shkolla të reja janë ndërtuar në Shurdhan, janë bërë renovime të shkollave ekzistuese, janë ndërtuar ose janë duke u ndërtuar çerdhe.

Gjilani ka bërë investime të vëllimshme edhe në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizime. Janë proceduar me sukses planet urbane për Lagjet Zabeli 1, Qendra 4 dhe Fidanishtja 2. Janë shtruar ose janë në shtrim e sipër shumica e rrugëve në fshatra (Dobërqqan, Cërrnicë, Përlepnice, Shillovë, thuajse janë asfaltuar të gjitha rrugët e fshatit) dhe po vazhdojnë në fshatrat tjera. Edhe në qytet kemi riparuar e rishtruar shumicën e rrugëve dhe trotuareve, gjersa po vazhdojmë me intensitet të shtuar ndërtimin e rrugëve me katër korsi në hyrje të Gjilanit, për të filluar ndërkohë edhe me drejtimet tjera.

Edhe bujqit janë përkrahur përmes subvencioneve nga buxheti komunal, nga qeveria dhe organizatat ndërkombëtare. Atyre u janë dhuruar pajisje e makineri bujqësore. Në Gjilan, për herë të parë ka filluar kultivimi i mjedrs, derisa ne po angazhohemi që ta kthejmë edhe kultivimin e duhanit në Gjilan, për të cilën njihet Gjilani.

Edhe në sektorin e Zhvillimit Ekonomik, ka përparime. Në këtë gjashtëmujor ka pasur një ngritje të konsiderueshme të numrit të bizneseve dhe vendeve të punës, në krahasim me gjashtëmujorin e vitit paraprak. Gjatë kësaj periudhe, janë regjistruar 260 biznese të reja dhe janë hapur mbi 440 vende pune. Në aspekt, përmes bashkëpunimit me Bankën Gjermane, Ministrinë e Financave, Gjilani ka përfutuar edhe mbi 1 milion euro nga projekti i efciences së energjisë. Komuna jonë ka përfutuar edhe nga programi BE-EURED për zhvillimin e agrobiznesit si dhe nga projekti BE-se për bashkëpunim ndërkufitar, ku 28 biznese te vogla kanë përfutuar grante nga rreth 2,000 euro.

Inkasimi i tatimit në pronë, ka shënuar rritje për 32% në krahasim me gjashtëmujorin e vitit paraprak. Edhe në sektorin e lejeve të ndërtimit, të hyrat janë rritur për 194%.

Gjilani ka shënuar suksese edhe në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit. Ne kemi qenë nikoqir të Panairit të Sportit në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës si dhe kemi realizuar me sukses manifestimin tradicional “Flaka e Janarit”. Për nevoja të rinisë, është promovuar objekti i ri të Qendrës Rinore.

Këto ishin disa nga pikat kyçe të punës sonë në këtë periudhë. Ne do të vazhdojmë me punë deri në ditën e fundit të mandatit tonë.

Lutfi Haziri
Kryetar i Komunës së Gjilanit



Gjilani shënon ditën e të përndjekurve nga Kosova Lindore

30

QERSHOR

Gjilan, Përmes një ekspozite me fotografi të shtëpive dhe vendbanimeve të braktisura, në Gjilan, është kujtuar dita e dëbimit të shqiptarëve nga vatrat e tyre në Kosovën Lindore, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga komunat Preshevë, Bujaoc e Medvegjë.

Ministri i Shëndetësisë, Imet Rrahmani, ka thënë se institucionet kosovare duhet të bëjnë më shumë për qytetarët e asaj pjese. Ai ka thënë se edhe vetë ndihet banor i asaj ane. “Edhe pse jetoj për rreth pesë dekada në Gjilan, unë ndjehem zarbicali. Ajo është vendlindja ime, e cila nga paslufta e këndej ka mbetur e zbrazët bashkë me gjashtë fshatra të tjera”, ka thënë Rrahmani. Ai ka kërkuar që qytetarët të Kosovës Lindore të gëzojnë të drejtën e pajisjes me dokumentacion të gjendjes civile dhe të trajtohen si duhet e jo një qytetar kinez të bëhet

shtetas i Kosovës më lehtë se një shqiptar i Luginës së Preshevës, i cili jeton në Kosovë për 17 vjetësh. Ndërsa Rexhep Kadriu, nënkryetar i Komunës, ka thënë se qytetarët e Kosovës Lindore trajtohen në mënyrë të barabartë me qytetarët gjilanas. Kryetari Haziri është duke u angazhuar në nivel qeveritar për krijimin e lehtësirave më të mëdha në pajisje me dokumentacion për këta qytetarë, ka thënë Kadriu. Kurse deputetja e Kuvendit të Kosovës, Lirije Kajtazi ka thënë se do të angazhohet në zgjidhjen e këtij problemi. Të pranishmit i ka përshëndetur edhe koordinatoreja e Zyrës për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, Gentiana Shabani, e cila ka thënë se ZPMB është përherë në shërbim të qytetarëve. Ndryshe, është bërë edhe shpërndarja e mirënjohjeve për kontribuesit në sferën e arsimit shqip në atë pjesë.



Qytetarët pyeten për hapjen e rrugëve

30
QERSHOR

Gjilan, Komuna e Gjilanit, përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, kanë organizuar debat me qytetarët në lidhje me hapjen e trasave të rrugëve në zonën “Livadhet e Arapit”.

Nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, drejtori i Urbanizimit, Valon Shefkriu, drejtori i Kadastrës, Sadudin Berisha si dhe zyrtarë tjerë komunalë janë përgjigjur në interesimet e qytetarëve. “Qëllimi ynë është hapja e rrugëve gjithandej territorit të komunës, përfshirë në rastin konkret zonën “Livadhet e Arapit”, ku i është dhënë mundësi banimit kolektiv”, ka thënë Shefkriu, duke shtuar se kjo është sipërfaqja më atraktive urbane e Gjilanit dhe ku më se 60 për qind e sipërfaqes është e

lirë. Nënkryetari Rexhep Kadriu tha se ka shumë kërkesa prej qytetarëve për të ndërtuar në këtë zonë. Qytetarët e kanë pasur rastin edhe në debatet e mëhershme që t’i japin mendimet e tyre, para miratimit të planit rregullues urban për këtë zonë. Duke i inkurajuar qytetarët që të jenë sa më aktivë, Kadriu ka premtuar se të gjitha pyetjet dhe shqetësimet e tyre do të merren parasysh. Ndërkaq, drejtori i Kadastrës, Sadudin Berisha, ka nënvizuar faktin se janë regjistruar të gjitha pronat private dhe komunale të “Livadhet e Arapit” dhe se e dinë saktësisht sipërfaqen që i merret çdo qytetari për ndërtimin e rrugëve. Ai tha se zyrat e Drejtorisë do të jenë të hapura edhe ditëve në vijim, për t’iu dhënë sqarime qytetarëve të interesuar lidhur me këtë zonë.

Afër 100 mijë euro investime në infrastrukturë te Muhaxhirët e Dobërqanit

30
QERSHOR

Gjilan, Rreth 100 mijë euro është duke investuar Komuna e Gjilanit në ndërtimin e infrastrukturës rrugore në fshatin Muhaxhirët e Dobërqanit. Kështu ka thënë kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, gjatë vizitës që u ka bërë disa projekteve në këtë fshat. “Te Muhaxhirët e Dobërqanit jemi në përgatitje të asfaltimit të më shumë se 2.5 kilometrave rrugë, me kosto afro 100 mijë euro”, ka thënë Haziri.



Shumë shpejt, për banorët e këtij fshati do të lehtësohet jeta, pasi që këtu po asfaltohen rrugët. “Po vazhdojmë t’i realizojmë programet tona në të gjitha fshatrat dhe lagjet e qytetit, në mënyrë që qytetarëve tanë t’ua bëjmë jetën sa më të dinjitetshme”, ka thënë Haziri. Kryetari Haziri ka shprehur zotimin se deri në fund të mandatit të tij qeverisës, nuk do të mbetet asnjë rrugë pa u asfaltuar. Në këtë fshat, Komuna e Gjilanit e ka kryer edhe ndriçimin publik, që është pjesë e programit të katërshtes së infrastrukturës.



Shpërndahen 35 centrifuga elektrike për bletarë

29
QERSHOR

Komuna e Gjilanit, respektivisht Drejtoria Komunale e Bujqësisë dhe Pylltarisë, duke vlerësuar rëndësinë e madhe të mjaltës si produkt dhe tendencën për futjen e saj si pjesë të përditshme të ushqimit në sofrën gjilanasë, ka realizuar projektin për mbështetjen e bletarëve në mekanizim elektrik, pajisje këto që lehtësojnë shumë punën e bletarëve. Përndryshe, Gjilani ka kushte të mira për zhvillimin e bletarisë.

Në kuadër të kësaj, sot janë ndarë 35 centrifuga elektrike për nxjerrjen e mjaltit, projekt i cili mundëson që brenda një kohe jashtëzakonisht të shkurtër të kryhet punë e cila me mjete të mëparshme kërkonte ditë të tëra. Shpërndarjen e këtij mekanizimi për bletarët e ka bërë

drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani dhe shefi i Kabinetit të kryetarit, Arbër Ismajli. Ramadani ka thënë se jo vetëm sektori i bletarisë, por edhe të gjithë sektoreët tjerë të bujqësisë e kanë kanë mbështetjen e fuqishme të Komunës dhe kryetarit Lutfi Haziri. “Me mbështetjen në këtë sektor, synojmë rritjen e prodhimtarisë dhe bletarinë ta bëjmë jo thjesht një aktivitet familjar, por një biznes të qëndrueshëm, ndërsa qëllimi i dytë është rritja e konsumit të mjaltës, nga trajtimi si medikament në konsumin ditor si pjesë të ushqimit”, ka pohuar Ramadani. Drejtori i bujqësisë së Gjilanit ka paralajmëruar edhe aktivitete të tjera të kësaj natyre në mbështetje ndaj bujqve.



Gjilani nis ushtrimin “Reagimi i Përbashkët 2016”

29

QERSHOR

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Gjilanit (DMSH), në bashkëpunim me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka filluar ushtrimin fushor “Reagimi i Përbashkët 2016”, i cili do të zgjas deri më 30 qershor. Kjo Drejtori, si pjesë e ushtrimit “Reagimi i Përbashkët 2016”, është duke iu përshatur skenarit të ushtrimit të hartuar nga FSK dhe Planit Kontingjent, ka thënë Ensar Kadriu, drejtor komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim.

“Kapacitetet e Drejtorisë, ku përfshihen zyrtaret dhe stafi ndihmës, i cili sipas “Planit kontingjent për përballim-in e mundshëm të refugjatëve” dhe me “Planin operativ emergjent” janë pjesë Qendrës Operative Emergjente, e cila menaxhon situatën. Të angazhuar janë edhe Policia

e Kosovës, Kryqi Kuq, SHZSH, Drejtorja e Shëndetësisë - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare”, ka deklaruar drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Ensar Kadriu. Ai ka informuar se Qendra Operative Emergjente edhe sot ka koordinuar operacionet në terren, duke ngritur post-ko-mandën e incidentit në fshatin Pogragjë, e cila ka menaxhuar simulimin me rreth 300 refugjatë, ku është bërë evidentimi, trajtimi ushqimor dhe shëndetësor, si dhe transportimi i tyre në qendrën kryesore të strehimit në palestrën e sporteve në Gjilan. Gjatë zhvillimit të operacioneve, Qendrën Operative Emergjente e kanë vizituar njësitë monitoruese të KFOR- it amerikan, gjerman dhe turk të shoqëruar nga pjesëtarët e FSK – së. Ushtrimi vazhdon edhe në ditët në vijim sipas planifikimit.



Në Cernicë, gjashtë rrugë në prag të asfaltimit

29
QERSHOR

Gjilan, Në Cernicë të Gjilanit janë duke u përgatitur për t'u asfaltuar gjashtë rrugë në fshat dhe një tjetër që e lidhë me fshatin Livoç të Ulët. I kënaqur me këto investime të Komunës është shprehur të jetë kryetari Lutfi Haziri. Ai ka thënë se fshati i heroit Ramiz Cernica meriton të ketë kujdesin e shtetit, për t'ua bërë jetën e dinjitetshme banorëve.

“Programi i katërshes së madhe të infrastrukturës, ku hyjnë rrugët, kanalizimet, ujësjellësi e ndriçimi, po vazhdon të realizohet me sukses edhe në fshatin e heroit Ramiz Cernica. Janë duke u përgatitur për t'u asfaltuar pesë rrugë brenda fshatit Cernicë dhe një tjetër që e lidhë me Livoçin e Ulët. Ndërsa, në fazën e dytë do ta asfaltojmë rrugën kryesore që çon në fshat, kanalizimin dhe ujësjellësin”, ka thënë kryetari Haziri. Nga ana e tij, Fatlum Mehmeti, kryetar i këshillit të fshatit Cernicë, ka shprehur fjalë falënderimi për Komunën, përkatësisht për kryetarin Haziri për kontributin në implementimin e këtyre projekteve, duke thënë se me projektin e rrugës që e lidhë këtë fshat me Livoçin e Ulët, i ka ofruar banorët më afër qytetit. Përveç projekteve të sipërpërmendura, Komuna e Gjilanit në bashkëfinancim me klubin e rotarianëve “Gjilani”, e ka ndërtuar kanalizimin për shkollën “Ramiz Cernica”, ndërkaq është duke punuar në zgjerimin e dy urave.



Komuna ka ndërtuar në Bresalc 13 kilometra rrjet të kanalizimit...

28
QERSHOR

Gjilan, Komuna e Gjilanit, investimet që i ka bërë në infrastrukturë publike në fshatin Bresalc, i konsideron model. Ky vlerësim ka ardhur gjatë vizitës së disa projekteve infrastrukturore në këtë fshat nga ana e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili tha se vetëm në vitin 2015 dhe sivjet, Komuna ka ndërtuar në këtë fshat 13 kilometra rrjet të kanalizimit dhe 2.5 kilometra asfaltim të rrugëve.

“Aktualisht, jemi duke e përfunduar kanalizimin atmosferik për lagjen e “Gllamës” dhe lagjen e Xhamisë. Investimet e Komunës në Bresalc janë model. Fillimisht, e kemi ndërtuar rrjetin e ujësjellësit e kanalizimeve fekale e atmosferike, e më pas kemi nisur me ndërtimin e rrugëve, në mënyrë që të mos preket më rruga pas asfaltimit. Vetëm në vitin 2015 dhe sivjet, Komuna ka ndërtu-

ar në këtë fshat 13 kilometra rrjet të kanalizimit dhe 2.5 kilometra asfaltim të rrugëve. Këto janë investime që po ua lehtësojnë jetën banorëve të kësaj ane dhe nuk do të ndalemi derisa ta përmbyllin problemin e infrastrukturës në këtë fshat dhe fshatra tjerë”, ka deklaruar me këtë rast kryetari Lutfi Haziri. Banorët e këtij fshati kanë pasur fjalë falënderimi për Komunën, për realizimin e këtyre projekteve të rëndësishme. “Këto investime të Komunës janë si buka për neve. Jemi shumë të kënaqur që kryetari Luta po i mban premtimet dhe po na e heq lloçin. Na e ka lehtësuar shumë jetën këtu dhe shpresojmë shumë që do t’i kryen edhe do punë tjera”, tha Mustafë Selimi, banor i Bresalcit. Po ashtu, me mbështetjen e organizatës shtetërore gjermane GIZ, janë rinovuar disa klasë të shkollës “Ibrahim Uruqi” në Bresalc.



Lutfi Haziri: Përfundimisht e hoqëm lloçin dhe vadat në Dobërqan

27
QERSHOR

Gjilan, Komuna e Gjilanit gjithandej territorit po i vazhdon investimet në ndërtimin e katërshes infrastrukturore, ku përshihen rrugët, trotua, kanalizimit, ujësjellësi e ndriçimi. Gjatë vizitës së punimeve në Dobërqan, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, është ndarë i kënaqur me cilësinë e punëve, duke thënë se dinamika e ndërtimit të katërshes infrastrukturore do të jetë edhe më e madhe në ditët në vazhdim.

“Përfundimisht, me investimet në infrastrukturë, në Dobërqan e hoqëm lloçin dhe vadat. Jam i shumë i kënaqur për këtë. Tashmë banorët e këtij fshati do të bëjnë

jetë të dinjitetshme. Në këtë resor po punohet me intensitet të lartë edhe në fshatra tjerë të Gjilanit dhe në lagjet e qytetit. Deri në vitin ardhshëm, ashtu si në Dobërqan edhe në tërë territorin e komunës sonë do ta heqim lloçin dhe vadat. Ky ka qenë dhe mbetet prioriteti i qeverisjes në Gjilan”, ka deklaruar kryetari Haziri. Faza e parë e punimeve në infrastrukturë, në Dobërqan, ka përfunduar vitin e kaluar, ndërsa gjatë vitit 2016 janë asfaltuar 8 rrugë me gjatësi prej mbi 1.3 kilometra, përderisa është intervenuar edhe në rregullimin e depos për sigurimin e druve në shkollën “Nazim Hikmet”.



Haziri inspekton punimet në renovimin e Teatrit

26
QERSHOR

Dita e diel nuk ka qenë ditë pushimi për kryetarin e Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri. Ai ka inspektuar punimet në renovimin e objektit të teatrit të qytetit, ndërsa theksoi se qëllimi është që stafit t'i krijohen kushte më të mira dhe të prodhohen shfaqje sa më profesionale.

“Jam i kënaqur me dinamikën punëve në renovimin e objektit të teatrit. Ky është vend i krenarisë së qytetit dhe ky ka qenë qëllimi jonë që të investojmë në mënyrë që objekti të bëhet dinjitoz dhe kushtet e punës për stafin të jenë më të mira. Tashmë qyteti i Gjilanit veç e ka marrë epitetin e kryeqendrës kulturore të shqiptarëve dhe kjo na obligon edhe më shumë që të punojmë në këtë aspekt”, ka thënë Haziri.

Po ashtu, Haziri ka përmendur edhe projektet tjera të Komunës të cilat janë realizuar për teatrit dhe në përgjithësi për kulturën, siç është zgjedhja e ansamblit të aktorëve me anë të konkursit publik, shpallja e konkursit për drejtor, miratimi i kalendarit kulturor nga ana e Bordit, si kurse edhe buxhetimi i teatrit nga ana e Komunës, derisa do të shpallet edhe pozita e drejtorit artistik të teatrit të Gjilanit. “Më bënë të lumtur fakti se pas më shumë se 20 vjetëve, kemi arritur që shfaqjet që prodhohen në këtë teatër të rrugëtojnë nëpër të gjitha shkollat e Gjilanit. Synimi ynë është që të dalim edhe jashtë Komunës dhe Republikës”, ka deklaruar kreu i Gjilanit. Përndryshe, projekti i renovimit të objektit të teatrit të qytetit kap koston e mbi 100 mijë eurove dhe po realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



Mbështeten nxënësit e suksesshëm, Dafina Abdyli e Lindrit Jahiu

26
QERSHOR

Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ka nënshkruar sot vendimin për subvencionimin e shkollimit për dy nxënësit e suksesshëm të Gjilanit, Dafina Abdyli dhe Lindrit Jahiu, të cilët kanë fituar bursa shkollimi në kolegjin “Mehmet Akif”. Sipas këtij vendimi, do të bëhet pagesa në shumën prej një mijë euro për secilin nxënës, që përfshin vendosjen në konvikt, transportin dhe ushqimin në kolegjin “Mehmet Akif” në Lipjan.

Kryetari Haziri ka nënshkruar vendimet në prezencën e dy nxënësve, për të cilët tha se janë shembulli më i mirë i punës dhe i përkushtimit. “Me punën, përkushtimin dhe sukseset e jashtëzakonshme, ju jeni shembulli më i mirë i nxënësve të Gjilanit. Vazhdoni të punoni shumë dhe të tregoni suksese në mënyrë që të gjejmë forma që t’ju mbështesim edhe në dy vitet e ardhshme”, ka thënë Haziri.



Haziri: Në Gjilan kemi vendosur barazi sociale dhe barazi në investime

24
QERSHOR

Qindra qytetarë kanë marrë pjesë në takimin e madh publik të kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri dhe bashkëpunëtorëve të tij, që është i 19-ti për dy vite e gjysmë qeverisje, përfshirë edhe debatet për buxhetin dhe debatet tjera nëpër lokalitete. Duke folur për punën e bërë gjatë këtij viti dhe dy viteve tjera, kryetari Haziri tha se qeverisjen e tij karakterizohet nga disiplina e ashpër buxhetore dhe është një qeverisje me dyer të hapura dhe duar të pastra.

Disiplina në punë ka bërë që të shumë shtete të Europës dhe SHBA të investojnë miliona në Gjilan. “Mos harroni, Kosova e i 38 komuna, ndërkaq Ballkani perëndimor i ka 3000 Komuna dhe të përzgjidhet Gjilani për investime në këtë konkurrencë, është punë e madhe”, tha Haziri. Kryesorja, sipas Hazirit, në Gjilan është vendosur barazi sociale dhe barazi në investime në qytet dhe fshatra. “Me këtë logjikë të punës, ne kemi vendosur standard të ri në Kosovë”, tha ai, duke vazhduar të flasë për investimet e mëdha, që sipas tij kanë ndodhur gjatë kohës së qeverisjes nën udhëheqjen e tij. “Në partneritet me SHBA-të, ka nisur ndërtimi i çerdhes në “Dardani”, ndërtimi i shkollës në Ponesh dhe rruga e Livoçit. Në partneritet me Qeverinë e Gjermanisë, kemi realizuar projekte shumë të rëndësishme për arsimin gjilanas, derisa me bashkëpunim me qeverinë e Turqisë, është zhvilluar sektori i bujqësisë duke i subvencionuar bujqit me të gjitha kapacitetet”, ka thënë Haziri. Në debat kanë kontribuar me pyetje dhe rekomandime: Shemsedin Elezi, Rabbit Pajaziti, Fehmi Ramabaja, Musli Matoshi, Ruzhdi Selimi, Demush Vokshi, Fadil Ibrahim, Islam Rashiti, Kushtrim Ibrahim, Zajenullah Sherifi, Qahir Halili e Rexhep Ajvazi, të cilët kanë marrë përgjigjet e të parit të Gjilanit. Ai ka përmendur edhe ndërtimin e parkut në “Dardani”, si një projekt të rëndësishëm, i cili është realizuar në part-

neritet me Komisionin European, sikurse edhe projektin për bashkëpunim ndërkufitar, përmes të cilit kanë përfituar grante 28 zejtarë, dhe dhjetëra të tjerë kanë përfituar nga trajnimet e ndryshme. Gjatë takimit të madh publik, i cili është organizuar në sallën e teatrit të qytetit, i pari i gjilanasve ka deklaruar se me investimet e qeverisë së Austrisë, të cilat kapin shumë e mbi 13.5 milionë euro, do të ndërtohet përfundimisht shtrati i lumit “Mirusha”, lumit “Stanishorka”, sikurse edhe rrjetit kryesor të kanalizimit në qytet. “Realizimi i këtij projekti besojmë shumë që fillon në verën e vonshme dhe domethënë që përfundimisht e heqim lloçin dhe vadat brenda këtij mandate qeverisës”, ka thënë Haziri. Sa i përket sektorit të arsimit, kryetari Haziri është shprehur se jemi Komuna e parë me notë mesatare më të suksesshme të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, ndërkaq ka përmendur edhe projektin shumë të rëndësishëm, atë të kompleksit të shkollave të mesme. “114 nxënës kanë sjellë vendin e parë, të dytë ose të tretë në garat kombëtare e ndërkombëtare. Ata na kanë bërë krenarë dhe meritojnë t’i përkrahim me të gjitha kapacitetet tona”, tha ai. Kryetari Haziri ka folur para qytetarëve edhe për projektin e madh të banimit social, ku deri tash janë ndërtuar 28 shtëpi për familjet në nevojë, falë kontributeve të njerëzve të vullnetit të mirë, po bëhen pagesa të qirave për 40 familje, derisa javë më parë ka nisur edhe projekti për rinovimin e 37 shtëpive sipas kërkesave të qytetarëve. Për objektivë, kryetari i Gjilanit se ka ndërtimin e çerdhes në lagjen “Arbëria, ndërtimin e çerdhes në qendër të qytetit, vazhdimin e katërshes infrastrukture, ndërtimin e hyrje-daljeve Gjilan-Prishtinë dhe Gjilan Ferizaj, fillimin e ndërtimit të “Rrugës së Kumanovës” etj. Përndryshe, takimi i sotëm publik i kryetarit të Komunës së Gjilanit është transmetuar drejtpërdrejt në radiot lokale.



Çmimi “Beqir Musliu” u bënë nder shqiptarëve kudo që jetojnë

24
QERSHOR

Shkrimtari Shaip Beqiri ka pranuar sot çmimin letrar “Beqir Musliu”, të cilin ia ka dorëzuar, në një ceremoni të veçantë, kryetari i Komunës, Lutfi Haziri. Ky çmim jepet për arritje të veçanta në letërsi. Vitin e kaluar, çmimi letrar “Beqir Musliu” iu nda Anton Nikë Berishës. Më herët, këtë çmim e kanë marrë edhe Ali Podrimja, Sabri Hamiti, Musa Ramadani, Ramadan Mehmeti, Visar Zhiti dhe të tjerë.

Kryetari Haziri, fillimisht tha se shkrimtari Shaip Beqiri ka dhënë kontribut të madh në lëmin e letërsisë dhe ka qenë miku më i ngushtë i shkrimtarit të famshëm gjilanas, Beqir Musliu. Haziri gjithashtu ka ndarë disa kujtime për njeriun e letrave shqipe, Beqir Musliun, i cili sipas tij, ishte i lidhur ngushtë me Gjilanin dhe zhvillimet kulturore, shoqërore e letrare në këtë qytet. “Beqa ishte një njeri i përkushtuar, i sinqertë dhe i lidhur me zhvillimin letrar, kulturor e shoqëror të Gjilanit. Kam pas fatin të rritem afër këtij njeriu me virtyte të larta, i cili së bashku edhe me shumë të tjerë, ishin njerëzit kryesor të

kulturës. Beqa mbetet edhe më tutje i pavlerësuar në nivelin që ne presim. Ky çmim, ky titull, Gjilanit, Kosovës dhe shqiptarëve u bënë nderë kudo që jetojnë”, ka thënë kryetari Haziri, duke potencuar mungesën e Beqës, e cila vërehet përditë e më shumë edhe pas 20 vjetësh ndarje. Ndërsa, fituesi i çmimit “Beqir Musliu”, Shaip Beqiri, ka falënderuar kryetarin për çmimin, duke thënë se ky është një nder i madh për të, meqë Beqirin e kishte mikun më të mirë të jetës. Në emër të jurisë, Nexhat Rexha, ka arsyetuar vlerësimin për ndarjen e çmimit për Shaip Beqirin. Një fjalë rasti e ka mbjatur edhe akademik Ali Aliu, i cili fituesin e çmimit letrar, e ka vlerësuar për nivelin e lartë të përkushtimit në veprat e tij, ndërsa për Beqir Musliun tha se ishte njeriu i cili sakrifikonte çdo gjë për zhvillimin dhe ecjen e artit dhe letërsisë përpara. Juria e konkursit letrar ‘Beqir Musliu’ ka punuar në përbërje: Nexhat Rexha, Albina Idriizi, Hasan Bunjaku, Ramadan Mehmeti e Sadete Tërnavë Osmani.



Haziri: Ne jemi model tjetër i qeverisjes

24

QERSHOR

Kuvendi Komunal i Gjilanit ka miratuar të premten, Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2017-2019. Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit, ka thënë se KAB-i është rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa, pas një debati me qytetarë dhe ka nënvizuar se do të ketë edhe dëgjime tjera nëpër lokalitete, për t'i përcaktuar prioritetet bashkërisht me qytetarët. Lutfi Haziri, kryetar i Gjilanit, ka thënë se KAB-i është një dokument i rëndësishëm për zhvillimin e Komunës, në tri vitet e ardhshme. Duke i inkurajuar vendimmarrësit komunalë, Haziri ka shtuar se kjo është një ditë e rëndësishme për ata që dëshirojnë të kontribuojnë për Komunën e tyre.

Ndërkaq, duke iu përgjigjur akuzave të opozitës rreth qeverisjes, që sipas tyre, ka mangësi të cilat janë konstatuar edhe nga auditori i përgjithshëm, kryetari Haziri ka thënë se bëhet fjalë për variantin fillestar të raportit, ku ne kemi të drejtë t'i paraqesim vërejtjet tona. “Ne jemi të kënaqur me raportin, në përgjithësi, ndërsa vërejtjet tona i paraqesim në rrugë ligjore”, ka thënë Haziri, duke shtuar se as vjet dhe a sivjet nuk ka pasur raste që janë proceduar në prokurori për shkelje. Duke e ftuar opozitën që të jetë kritike, por t'i përmbahet kodit moral dhe të mos i kalojë kufijtë e debatit politik, kreu i Gjilanit i ka rikujtuar ata se zgjedhjet janë në vitin tjetër dhe deri atëherë është ai që do të udhëheq Gjilanin, në bazë të mandatit që ia kanë dhënë qytetarët. “Projektet që do të realizohen deri atëherë nga qeverisja ime, Gjilanit do t'i japim një format tjetër”, ka thënë Haziri. Ai ka pranuar se ka telashe me disa operatorë ekonomikë, sepse nuk i përmbahen dinamikës së projekteve, por ka thënë se kompanitë e tilla do të futen në listën e zezë për të ardhmen dhe nuk do t'iu jepen më punë. Haziri ka dhënë përgjigje edhe rreth dyshimeve që ka ngritur

opozita për fondin e solidaritetit, duke thënë se gjithçka është transparente dhe mund të verifikohet në bankë, por ka shtuar se ata që nuk kanë kontribuar me asgjë në këtë fond, nuk kanë të drejtë të kërkojnë llogari prej të tjerëve. “Në këtë fond, njerëzit e vullnetit të mirë po kontribuojnë edhe më tutje. Sikur të mos kishin besim tek ne, nuk do të lajmëroheshin çdo ditë donatorë të rinj, falë të cilëve ne jemi duke i ndërtuar edhe 8 shtëpi”. Ai ka dhënë sqarime edhe për lumin Mirusha, që është trashëguar nga qeverisja e kaluar, për lumin Stanishorka dhe projektet tjera që kanë të bëjnë me ujërat e zeza, duke thënë se ky problem do të zgjidhet përgjithmonë, në bashkëpunim me qeverinë austriake dhe qeverinë e Kosovës. Në shtator fillojmë me hyrje-daljet në rrugët Gjilan-Prishtinë dhe Gjilan-Ferizaj, për të vazhduar me rrugët dhe infrastrukturën tjetër të nevojshme, gjatë dy viteve të ardhshme. “Deri atëherë, duhet të kenë durim dhe do t’i shihni rezultatet e kësaj qeverisje”, ka thënë Haziri, duke nënvizuar se ne jemi një model tjetër nga qeverisja e kaluar. Përndryshe, edhe seanca e sotme është karakterizuar me tensione të herë pas hershme. Riad Rashiti (PDK) ka thënë se kjo qeverisje nuk ka plan zhvillimor, ndërkohë ka bërë vërejtje për buxhetin, prokurimin, subvencionet, ndërtimet pa leje, disa probleme në arsim e shëndetësi dhe të tjera. Avdyl Aliu (LDK) ka thënë se qytetarët janë ata që kanë përcaktuar vendin e secilit dhe, dikë e kanë zgjedhur për të punuar dhe dikë e kanë lënë për të folur. Vjen koha që prapë qytetarët e vlerësojnë punën tonë, ka thënë ai. Bujar Nevzati (PDK) tha se është e vërtetë që ne kemi mandat prej qytetarëve për të folur për punët e këqija, po edhe të mira, që bëhen në Komunë, prandaj edhe nuk do të heshtim. Isa Agushi (LDK) ka thënë se kjo qeverisje, për dy vite, ka bërë më shumë seç ka bërë PDK-ja për 16 vjet qeverisje në nivel lokal dhe qendror. “Kush ecën me sy hapur i sheh këto ndryshime”, ka thënë ai. Nevzad Isufi (VV) pati vërejtje rreth mbarëvajtjes së seancave dhe kërkoi që Kuvendi Komunal të shqyrtojë punën e drejtorive komunale për periudhën 6-mujore. Ai u shpreh kritik edhe për vonesat në meremetimin e rrugëve, ndriçimin publik në disa rrugë të qytetit dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me shërbimet publike. Leonora Bunjaku (PDK) bëri vërejtje pse në këtë seancë nuk është përfshirë edhe një pikë për arsimin, kur dihet se tani ka përfunduar viti shkollor, kurse Fehmi Sylejma-

ni (VV) kërkoi që dy nxënëset e Gjilanit, të cilat do të marrin pjesë në olimpiadën botërore të matematikës në Hong Kong, të ndihmohen financiarisht. Opozita ka pasur vërejtje edhe për KAB-in, duke e cilësuar atë dokument të dëshirave. Riad Rashiti (PDK) tha se nuk janë marrë parasysh nevojat e qytetarëve. Nevzad Isufi (VV) ka thënë se dokumenti është bërë me nguti dhe pati vërejtje te mungesa e investimeve të planifikuara për arsim. “Shifrat nuk japin ndonjë optimizëm”, ka thënë ai. Edhe Fehmi Sylemani (VV) tha se nuk janë planifikuar investime në kabinete shkollore, salla të edukatës fizike, për ujësjellës e kanalizime në fshatra si dhe projekte të tjera të nevojshme, kurse Shukrije Rapuca (PDK) u shpreh e pakënaqur me subvencionet për bujqësi, duke thënë se ka ulje në krahasim me vitin e kaluar. Ndërkaq, Avdyl Aliu (LDK) e Selami Xhemajli (AAK) kanë dhënë vlerësime pozitive për KAB-in, duke e cilësuar atë një bazë të mirë për zhvillimin e Komunës në tri vitet e ardhshme. “Trendet janë pozitive, kurse neve na mbetet të punojmë dhe të realizojmë planin”, ka thënë Aliu. Paraprakisht, Zijadin Maliqi, drejtor për Buxhet, i ka paraqitur kufijtë fillestarë buxhetorë për vitin 2017 si dhe orientimet e hershme për vitet 2018 dhe 2019. Buxheti i vitit 2017 do të ketë një rritje për 6 për qind në krahasim me vitin paraprak, në vitin 2018 rritja do të jetë 2 për qind, ndërsa në vitin 2019 – një për qind. Kurse të hyrat vetanake do të rriten për 15 për qind në vitin 2017, ka thënë Maliqi. Duke prezantuar të dhënat tjera nga KAB, ai ka thënë se granti i përgjithshëm do të ketë një rritje prej 8 për qind, por është shprehur i pakënaqur me rritjen e grantit për arsim për një për qind, ku Komuna e Gjilanit ka vazhdimisht probleme për t’i mbuluar pagat. Sa i përket investimeve kapitale, Maliqi ka thënë se do të ketë një rritje prej afër 17 për qind, në krahasim me vitin 2016, kurse te subvencionet nuk parashihet rritje. Edhe investimet kapitale do të shënojnë një rritje graduale, nga 4 milionë sa janë planifikuar për vitin 2017, në rreth 5 milion, në vitin 2019. Sipas KAB-it, buxheti i vitit 2017 do të jetë 22.657.746 euro, buxheti i vitit 2018 -23.122.147 euro, kurse i vitit 2019 do të jetë 23.544.228 euro. Përgjigje në pyetjet lidhur me planifikimin sipas sektorëve, kanë dhënë drejtorët Ramiz Ramadani (Bujqësi), Nexhat Hajrullahu (Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale) e Naser Korça (Shërbime Publike).



Në Gjilan hapet Panairi i Sportit

23

QERSHOR

Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri dhe Komitetit Olimpik të Kosovës, është hapur të enjten Panairi i Sportit, ku kanë marrë pjesë 14 klube me 350 fëmijë të angazhuar shkollat sportive të Gjilanit. “Sot është një ditë e rëndësishme e shënuar për ne sepse Komiteti Olimpik është anëtar i barabartë dhe pjesëmarrës i garave olimpike. 350 fëmijë të grupmoshave të ndryshme prej çerdhes e deri në akademitë shkollore sot marrin pjesë dhe shumica e tyre kanë talent të veçantë, ekupe sportive dhe sportist individual që kanë sjellë trofe në Gjilan”, ka thënë në ceremoninë e hapjes së panairit kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri.

Haziri paralajmëroi se se pas kësaj ditë të shënuar, në Gjilan pritet që të vije edhe kampi i klubit të futbollit Juventus. “Qëllimi ynë është që ta rrisim pjesëmarrjen e të rinjve dhe të rejave që të merren me sport. Ju uroj ditën olimpike dhe besoj shumë që njëri prej jush shumë shpejt do të jetë në gara olimpike një botë dhe do të na gëzojë me suksese. Ju inkurajoj që të merrni pjesë në të gjitha akti-

vitetet sportive sepse sporti është shëndet. Pas kësaj ditë të shënuar, ju njoftoj se në Gjilan pritet që të vije edhe kampi i gjigantit italian të futbollit, Juventus, i cili do të hulumtoj talentët e rinj të futbollit”, ka theksuar kryetari Haziri. Kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, e ka falënderuar kryetarin Haziri, duke thënë e edhe sa ishte ministër ka kontribuar shumë që sporti kosovar të ndërkombëtarizohet. “E falënderoj këshillin organizativ, në vecanti kryetarin e Komunës për këtë organizim kaq të mrië kaq masoviv, i cili përputhet me planin strategjik të Komitetit Olimpik për masovizimin e sportit. Sporti ka rëndësi, jo vetëm për shoqërimin e të rinjve, por ka rëndësi të jashtëzakonshme edhe për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit. Ne jemi në vitin e Olimpiadës, ku Kosova merr pjesë me 7 sportitë me gjasë reale që të fitojmë medalje, unë shfrytëzoj rastin që t’i ftoj të gjithë fëmijët që të fillojnë të merren me sport”, ka thënë Hasani. Panairi i Sportit është organizuar nga Njësia Për Sport e Komunës së Gjilanit.



GIZ certifikon mësimdhënësit e Gjilanit

21

QERSHOR

Në Gjilan janë ndarë certifikata për mësimdhënësit e klasave 1-5, kryesisht në lëndën e matematikës si dhe lëndët tjera nga shkencat natyrore. Të gjitha shkollat i kishin mësimdhënësit e tyre në këtë trajnim, me qëllim të ndryshimit të gjendjes si dhe rritjes së cilësisë në arsim, si angazhim konkret në përmirësim të rezultateve të nxënësve të Gjilanit. Drejtori i Arsimit, Nazmi Musa, ka thënë se puna dhe përkushtimi për arsimin janë të pandërprera, ndërsa trajnimi dhe fokusi për lëndët e shkencave natyrore, janë përherë nevojë e perfeksionimit.

“Duhet të bëjmë vazhdimisht punë në këtë drejtim. Cilësia në arsim është prioritet i këtij viti. Rezultatet e nxënësve tanë përherë e më tepër po shënojnë rritje të fuqishme nëpër të gjitha matjet e bëra. Ky trajnim i mbajtur për mësimdhënësit, është domosdoshmëri, sepse kështu avancohemi me kontroll të vazhdueshëm. Falë trajnimeve të organizuara nga GIZ dhe të implementuar nga CDBE

(Zhvillimi i Kapaciteteve në Arsimin Bazë), rezultatet po shihen menjëherë në matjet e fëmijëve në garat lokale, shtetërore dhe ndërkombëtare”, ka thënë, drejtori Nazmi Musa. Ndërsa nga ana e saj përfaqësuesja e GIZ-it, Dagmar Fuchs, ka thënë se angazhimi dhe puna me arsimin në përgjithësi në Gjilan, është në nivelin e tillë që shënon vetëm rezultate të prekshme dhe gjithnjë impresionuese. “Kishim një gjendje tjetër dhe kemi një tjetër sot, sa i përket nivelit të arsimit. Kur krahasojmë pasqyrën e rezultateve që kishim më parë dhe ato që kemi pas trajnimit shohim ndryshime jashtëzakonisht impresionuese. Do të angazhohemi gjithnjë dhe do të mbetemi të lidhur ngusht me Gjilanin edhe gjatë të ardhmes”, ka thënë në fjalën e saj Fuchs. Në fund, drejtori i DKA-së ka ndarë mirënjohje zonjës Fuchs në shenjë falënderimi për kontributin që ka dhënë GIZ në organizimin e trajnimeve të mësimdhënësve si dhe përkushtimin e vazhdueshëm për ngritjen e cilësisë së arsimit.

Gjilani me donatorë shpërndajnë 200 pako ushqimore

21

QERSHOR

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e Gjilanit ka pranuar sot një donacion prej 200 pakove ushqimore nga organizata “Islamic Relief”, të cilat ua ka shpërndarë familjeve në nevojë. Komuna e Gjilanit, përmes kësaj drejtorie, do të vazhdojë t’i ndihmojë këto familje, për t’ua lehtësuar sado pak kushtet e jetës dhe për të i lënë ato të vuajnë për ushqime dhe gjera tjera elementare. Përndryshe, Komuna është përkushtuar shumë në këto dy vite të ndërtimit të shtëpive për familjet me probleme banimi.



Pas shpërndarjes së këtyre pakove, drejtori i Shëndetësisë, Nexhat Hajrullahu, e ka falënderuar organizatën e sipërpërmendur për këtë donacion, i cili si i tillë ua lehtëson jetën familjeve në nevojë. Gjatë këtij muaji, Komuna me donatorët ka shpërndarë edhe dhjetëra pako të tjera ushqimore për familjet me gjendje të rëndë sociale, derisa javën e ardhshme pritet të shpërndaj edhe pako të tjera.



S’ka kompromis me kompanitë që nuk i kryejnë punët sipas kontratës

18

QERSHOR

Çështje tejet të rëndësishme janë diskutuar sot në mbledhjen e rregullt të bordit të drejtorëve, të cilën e ka udhëhequr kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri. Në mbledhje u vlerësua lartë manifestimi pesëditor “Ditët e Lirisë së Gjilanit”, i cili ka kulmuar me ndarjen e mirënjohjeve të më të dalluarit e vitit për disa lëmi në Ditën e Çlirimit më 15 qershor.

Kryetari Haziri është informuar nga drejtorët përkatës lidhur me mbarëvajtjen e punimeve në kuadër të programit të katërshes infrastrukturore. Me këtë rast, kryetari Haziri ka kërkuar nga komisioni komunal që

të vazhdojnë të bëjnë mbikëqyrje të rreptë të punimeve në projekte, derisa ka konfirmuar se kompanitë që nuk i kryejnë punët sipas kontratës dhe afatit, do t’ju shkëputen kontratat. “S’ka më asnjë lloj tolerimi për kompanitë që nuk i kryejnë punët sipas kontratës”, ka thënë Haziri. Në mbledhjen e sotme është diskutuar edhe për testin e dytë të maturës shtetërore, i cili u vlerësua lartë për përgatitjet dhe mbarëvajtjen, pastaj për realizimin e projektit të dezinfektimit, sikur edhe për projektin e banimit social, respektivisht renovimin e shtëpive për familjet në nevojë, ndërtimin e shtëpive të reja, si dhe pagesat e qirave për këtë kategori.



Violant Sylejmani shpallet sportist i vitit në Gjilan

15
QERSHOR

Pikërisht në ditën e çlirimit, Komuna e Gjilanit, përkatësisht Njësia për Sport ka ndarë sot mirënjohje për më të dalluarit e vitit 2015/2016 në sektorin e sportit, ngjarje kjo në të cilën ka marrë pjesë kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri me bashkëpunëtorë, “Nderi i Qytetit”, boksieri Erzen Rustemi, deputetë e asambleistë, sikurse edhe sportdashës të shumtë. Mirënjohjet e sotme për më të dalluarit e vitit në sport po jepen për herë të parë më 15 qershor dhe kryetari Haziri tha se kalendari i vitit për shpalljen e më të dalluarve duhet të lidhet me Ditën e Çlirimit.

“Sot, festën e qytetit po e shënojmë edhe me këtë aktivitet të rëndësishëm në sport. Sot ne kemi emra të njohur të sportit në botë, e që janë emblematic të Gjilanit, siç është Xherdan Shaqiri e Erzen Rustemi. Por, këta dhe të tjerët, nuk kanë mundur të arrijnë suksese po të mos i kishim legendat gjilanasë që dhanë shumë për sport. Pra, gjenerata të tëra kanë punuar dhe janë angazhuar që ne sot t'i korrim sukseset kombëtare e ndërkombëtare. Jam krenar që pothuajse të gjitha kategoritë e sportit në Gjilan po sjellin rezultate të mahnitshme kudo që po marrin pjesë. Gëzuar dita e çlirimit dhe faleminderit për nderin që po

ia bëni Gjilanit.”, ka thënë Haziri, në adresimin para qindra sportistëve. Me vendim të jurisë profesionale, sportist i vitit është zgjedhur boksieri Violant Sylejmani, i cili fitoi tri medalje të arta, edhe atë në turneun ndërkombëtar në Bosnie Hercegovina, në turneun “Gongu i Artë” në Maqedoni dhe në turneun “Adem Jashari” të mbajtur në Republikën e Kosovës. Me mirënjohje janë shpërblyer edhe këta sportistë: Ira Salihu (KV “Drita”), Alban Tosumi (KF “Gjilani”), Blerta Shala (KF “Intelektualet”), Bjondina Ramabaja (KH “Drita”), Elhami Shabani (Klubi Karatesë “Drita”), Blinera Jaha (KV “Drita”), Alban Haziri (KH “Zhegra”), e Mirlinda Daku (KB “Drita”). Klubi më i dalluar është shpallur ai i voleybollit “Drita”, trajneri më i dalluar Lorik Ilazi, derisa Selami Haziri - pedagogu sportiv i vitit. Ndërkaq, tek Shpresat e Sportit për vitin 2015/2016 u nderuan me mirënjohje: Belinë Rashiti (Klubi i Karatesë “As”), Blerand Limani (Klubi i Karatesë “Dardania”), Erdonis Maliqi (Klubi i Boksit “Drita”), Ardit Mustafa (Shkolla e Fubollit “Shkëndija”) dhe Vesa Ibrahim (Klubi i Karatesë “Drita”). Mirënjohje e veçantë i është ndarë Avdil Ibishit (Handikos), ndërsa me mirënjohje post mortum janë nderuar, Ramadani Salihu – ish futbollist dhe Servet Shala ish-voleybollist.



Haziri: Ne ishëm gjeneratë e Republikës, rinia e sotme është gjeneratë e integritimeve evropiane

15
QERSHOR

Për nder të Ditës së Çlirimit të Gjilanit, sot për sektorët nga fusha e arsimit, shëndetësisë dhe rinisë, janë ndarë mirënjohje për nxënës, mësimdhënës, punëtorët shëndetësor, përfaqësuesit e rinisë, studentët etj., si formë e falënderimit për sukseset e shumta të sjellura në Gjilan dhe kujdesin e vazhdueshëm ndaj qytetarëve në përgjithësi.

Gjatë ndarjes së mirënjohjeve, kryetari Haziri, ka thënë se Dita e Çlirimit të Gjilanit, është kjo ditë të cilën të gjithë ne që ishëm dikur gjenerata e Republikës dhe formimit të shtetit e kemi pritur që ta manifestojmë me suksese dhe rrugë të qartë drejt ndërtimit dhe zhvillimit. “Të rinjtë e shumtë të Gjilanit, nga fusha e arsimit, respektivisht nxënësit dhe studentët tanë, kanë shënuar rezultate të shumta dhe sot ndjehemi krenar me sukseset e tyre në të gjitha lëmitë. Nxënësit, studentët dhe të rinjtë tanë në përgjithësi, janë ata që qytetit tonë po i sjellin rezultate të mëdha duke i hapur rrugët e tyre të konkurrencës si në aspektin republikan, poashtu edhe në atë regjional e ndërkombëtar”, ka thënë kryetari Haziri, duke falënderuar të gjithë prindërit dhe mësimdhënësit për punën dhe

angazhimin që po tregojnë vazhdimisht në mbështetjen e fëmijëve. “Edhe aspekti shëndetësor dhe kujdesi i vazhdueshëm për pacientët të cilët kërkojnë ndihmën e mjekut dhe institucioneve, është një meritë e madhe e misionit human të mantelbardhëve, që mjekët tanë kanë treguar gjatë gjithë mbamendjes sonë. Si gjeneratë e Republikës përherë kishim ideal, formimin e shtetit, ndërsa rinia sot, do të jetë gjenerata evropiane e integritimit dhe zhvillimit të vërtetë të vendit”, ka thënë kryetari Haziri. Gjatë fjalës së tij, kryetari Lutfi Haziri, ka potencuar se gjithë ky organizim i sotëm dhe sukseset një vjeçare të bëra në Gjilan, do të ishin pa kuptim sikur të mos gjuhëzohemi dhe përulemi përherë para veprës së madhe dhe sakrificës së shumë heronjëve, dëshmorëve dhe të rënëve të shumtë në rrugën e gjatë e të vështirë për liri. Me fjalën e tyre falënderimi për punën e stafit të tyre, janë paraqitur Drejtori i Arsimit, Nazmi Musa, ai Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Fejzulla Berisha, dhe përgjegjësi i Njesisë për Rini, Genc Mustafa, duke falënderuar njëkohësisht edhe kryetarin e Komunës për mbështetjen në këto arritjen e këtyre rezultateve.

Gjilani, region që dallohet me punë në Kosovë



15

QERSHOR

Në Gjilan sot është bërë ndarja e mekanizmit bujqësor për mbi 25 fermerë, falë financimit të Komisionit Evropian, partnerit “Care International” dhe bashkëpunimit me Komunën e Gjilanit, duke bërë kështu që këta fermerë të kryejnë shumë punë në pak kohë, nga ajo që deri më tani, kur hargjonin shumë kohë për të bërë pak punë.

Kryetari Lutfi Haziri i cili ishte pjesë e këtij aktiviteti, ka thënë se në këtë ditë të bardhë dhe në kujtim të çlirimit të Gjilanit, është forma më e mirë e shënimit të kësaj date të veçantë për të gjithë ne, pra me një projekt të rëndësishëm të veçantë në bujqësi. “Jemi sot në punishten, në tokën, në arën e Shpresa Shabanit në Zhegër, ku po shohim se si një grua, ka siguruar mundësi dhe kushte më të mira për familjen dhe mundësi punësimi për anëtarët e saj në tokën e tyre. Ky është shembulli më i mirë se si jetohet përmes punës, falë përkushtimit të sinqertë. Kjo është mënyra më e mirë e shënimit të ditës së çlirimit të Gjilanit. Kjo mbështetje që ka ardhur tek këta përfitues sot, nuk do të ishte e mundur pa financimin e Komisionit Evropian, si një donatorë i pa-ndalur në shumë dimensione gjithandej Komunës së Gjilanit dhe në shumë programe”, ka thënë kryetari Haziri në fjalën e tij. Haziri, poashtu ka thënë se ky është regjioni që dallohet për urtësinë, përkushtimin maksimal dhe për koncentrimin

në punë, jo vetëm në Gjilan por edhe në nivel të vendit, dhe kjo mbështetje është fuqizim për këta fermerë që të vazhdohet më tutje në zgjerim të veprimtarisë së këtyre bujqëve të vyeshëm. Nga ana e tij Christof Stock, përfaqësues i KE-së, ka thënë se projektet që sjellin vende të reja pune, dhe që mundësojnë mirëqenien më të mirë për qytetarët e një vendi janë projektet më të mira gjithnjë. “Të punohet më shumë, individualisht, për çdo ditë, pa u ndalur, sepse vetëm me punë dhe me përkushtim mund të arrihen rezultate dhe mirëqenie më e mirë për qytetarin. Ky projekt është i rëndësishëm për shumë arsye, sepse kontribuon në zhvillim ekonomik dhe zhvillim të bujqësisë, ndikon në qëndrueshmërinë e projektit, të vendeve të punës dhe në të njëjtën kohë bënë që të kemi zgjerim të veprimtarisë për çka jemi të interesuar të gjithë”, ka thënë ndër të thjerash përfaqësuesi nga zyra e Komisionit Evropian në Kosovë. Gjithashtu, edhe drejtori i Care International, Felix Eölff, në Kosovë ka thënë se pavarësisht investimit, e rëndësishme është gjithnjë sipas tij kur një projekt, apo një program vazhdon edhe pas përfundimit të mbështetjes nga donatori, që në këtë rast vetëm shihen rezultate konkrete në rrugën e mbarë të ecjes përpara. Ndryshe, gjatë këtij aktiviteti është bërë edhe shpërndarja e çertifikatave të cilësisë organike të prodhimeve në këto fusha.

Haziri: Kosova e pavarur është gjysma e ëndrrës së dëshmorëve

15
QERSHOR

Për nder të 15 qershorit – ditës së çlirimit të Gjilanit, Kuvendi Komunal ka mbajtur të mërkurën seancë solemne, ku fjalë rasti kanë mbajtur kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku-Rexhepi si dhe ish-kryeministri i Kosovës, Bajram Kosumi, tani rektor i UPGJ. Njëherësh, Haziri e Rexhepi-Bunjaku ia kanë dorëzuar çmimin “Nderi i Qytetit” boksierit Erzen Rustemi, të cilin një ditë më parë, Kuvendi Komunal e ka nderuar, së bashku me futbollistin Xherdan Shaqirin si dhe ndër-kombëtarin Jozef R. Biden, i cili ka shërbyer në Kosovë, në sektorin e sundimit të ligjit dhe ka dhënë kontribut në ndërtimin e institucioneve të Kosovës.

Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, ka thënë se 12 qershorin e kremtojmë të gjithë në Kosovë. 12 -17 qershori kanë qenë ditët më të lumtura për shumicën e atyre njerëzve që janë gjetur në qytet si dhe për luftëtarët që janë gjetur në male, në epokën e gjatë të rezistencës dhe luftës së armatosur për liri. Natyrisht, jo të gjithë ata patën fatin të kthehen në qytetin e çliruar, pasi që disa prej tyre ranë në luftë, për t'u bërë gurthemel i lirisë së vendit, ka thënë Haziri. Duke i bërë një vështrim rrugës së kaluar deri këtu, në 17 vjet liri, Haziri ka thënë se rezultatet janë të dukshme, por sigurisht se ky vend e ky shtet ka nevojë për më tepër. “Kosova e pavarur është gjysma e ëndrrës së dëshmorëve. Ne kemi për obligim që të vazhdojmë tutje rrugën e tyre”, ka thënë Haziri. Ai solli në vëmendje edhe kontributin e ndërkombëtarëve në lirinë dhe shtet-ndërtimin e Kosovës. Sivjet kemi zgjedhur të nderojmë Jozef R. Biden III, djalë tani të ndjerë të nën-presidentit të SHBA--ve, i cili ka qenë pjesë e misionit civil në Kosovë dhe ka ndihmuar në ndërtimin e institucioneve të sundimit të ligjit. Boksieri Erzen Rustemi e futbollisti Xherdan Shaqiri, janë dy emra tjerë, me suk-



sese kulminante, që ne i kemi nderuar me çmimin “Nderi i Qytetit” në këtë përvjetor. “Ne jemi popull falënderues dhe mirënjohës për ata që arrijnë suksese”, ka thënë Haziri. Ndërkaq, Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, ka thënë se 15 qershori, kjo ditë e veçantë na kthen kujtesën në të kaluarën, na kthen te kujtimi për brezat që dhanë gjithçka për lirinë e Kosovës, na kthen te kujtimi për luftën heroike të UÇK-së, na kthen te kujtimi për presidentin Ibrahim Rugovë, i cili tërë jetën e vetë ia kushtoi lirisë, pavarësisë dhe demokracisë së Kosovës dhe njëkohësisht kjo datë na shërben si ditë falënderimi për aleatët tanë, SHBA-të, NATO-n dhe gjithë popujt e botës së civilizuar, të cilët e ndihmuar luftën tonë për liri. Kësaj dite që ndan në epokë historinë e Gjilanit i paraprinë ngjarje të tjera të lavdishme, ku gjenerata të tëra derdhën djersë, lot e gjak. Ky gjak i derdhur për liri, këto vuajtje e sakrificat të mëdha këtij populli, janë porosi e qartë që ne të punojmë me përkushtim të madh për ndërtimin e një jete sa më të mirë për qytetarët tanë, ka thënë Bunjaku-Rexhepi. Gjilani i dalë nga lufta, 17 vjet më parë, sot është një qytet me ndërtime të larta, me rrugë e shkolla të reja, me infrastrukturë moderne në qytet dhe fshatra. Sivjet do të ketë edhe më shumë investime. “Ne nuk do të ndalemi duke punuar për qytetarët”, ka thënë ajo. Bajram Kosumi, ish-kryeministër dhe aktualisht rektor i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, ka thënë se dita e lirisë është festa më e shenjtë që ka një popull, sepse i bën bashkë njerëzit e lumtur dhe njerëzit e dëshpëruar. Ndërkaq, boksieri Erzen Rustemi, i cili është falënderuar për çmimin “Nderi i Qytetit”, ka thënë se kjo ditë e ktheu dinjitetin e popullit shqiptar, para të cilit unë përulem përjetësisht. “Qëllimi ynë si sportistë është që ta prezantojmë sa më denjësisht kombin tonë në botë”, ka thënë Rustemi.

Komuna e Gjilanit nderon me tituj nderi Josef Biden III, Xherdan Shaqirin e Erzen Rustemin

14
QERSHOR

Kuvendi Komunal i Gjilanit, të martën, në një seancë të jashtëzakonshme, ka miratuar vendimin për rialokimin e mjeteve për projekte kapitale, vendimin për shpalljen e Joseph R. Biden III “Qytetar Nderi” i Gjilanit, vendimin për shpalljen “Nderi i Qytetit” të boksierit Erzen Rustemi dhe futbollistit Xherdan Shaqiri, pastaj ka miratuar iniciativën për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal me Komunën e Lipjanit në fushën e infrastrukturës rrugore si dhe ka miratuar vendimin për autorizimin e kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndërkomunal me komunat fqinje, në sferën e mbrojtjes nga fatëkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera.

Opozita (PDK e VV) nuk kanë marrë pjesë në seancë, me arsyetim se pikat e parapara të rendit të ditës nuk janë të jashtëzakonshme dhe sipas tyre, nuk ka pasur nevojë për një seancë të tillë. Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, ka thënë se ne kemi pasur arsye për të ftuar këtë seancë, sepse jemi në shërbim të qytetarëve, ndërsa opozita nuk ka pasur arsye që të mos vijë. Opozita po bënë politikë, ka thënë ajo. Kuvendarët e Gjilanit kanë votuar për shpalljen e Joseph R. Biden III (djali i nën-presidentit Xho Bajden) “Qytetar Nderi” sikurse edhe të Erzen Rustemit e Xherdan Shaqirin - “Nderi i Qytetit”. Biden III (tani i ndjerë) ka shërbyer në Kosovë, në kuadër të trupave amerikane dhe Kuvendi Komunal i Gjilanit e nderoi me këtë çmim në shenjë respekti dhe mirënjohje për kontributin e rëndësishëm që ka dhënë në ndërtimin e shtetit të Kosovës. Ndërkaq, sukseset e Rustemit në boks dhe të Shaqirit në futboll, janë të njohura

për të gjithë. Këshilltarët e AAK-së, pjesë e koalicionit qeverisës, patën vërejtje te procedura, duke thënë se Kuvendit është dashur t'i ofrohet një biografi e shkurtër për të tria propozimet. Ibish Ibishi (AAK) ka thënë se nuk jemi kundër emrave të mëdhenj, por jemi kundër procedurës. Vërejtje në këtë drejtim kanë bërë edhe Bajram Hasani, këshilltar i pavarur, Sejdulla Kadriu (Vatra) e Arben Mehmeti (LDK). Valentina Bunjaku-Rexhepi, pasi ka lexuar nenin 2 të rregullores për ndarjen e titujve dhe çmimeve, ka thënë se boksieri Erzen Rustemi dhe futbollisti Xherdan Shaqiri janë emra të mëdhenj, që Gjilanit i bëjnë nder dhe ka sqaruar se biografia e tyre e plotë do të lexohet ditën kur do të bëhet dorëzimi i çmimeve. Ajo ka sqaruar se seanca e jashtëzakonshme nuk është ftuar për shkak të këtyre propozimeve, por për arsye se është dashur të miratohet vendimi për alokimin e mjeteve. Kuvendi miratoi edhe vendimin për alokimin e mjeteve. Zijadin Maliqi, drejtor për Financa ka thënë se bëhet fjalë vetëm për rialokim të shumës prej 50 mijë euro nga grantet qeveritare, për financim të aktiviteteve që kanë të bëjnë me masat e eficiencës së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal, por buxheti nuk preket. Bashkëpunimi ndërkomunal në fushën e infrastrukturës rrugore ka të bëjë me projekte të interesit të përbashkët siç është rruga Zhegoc-Verbicë e Zhegocit deri në fshatin Sllovi. Komunat do të aplikojnë bashkërisht tek Ministria e Infrastrukturës dhe donatorët tjerë të mundshëm, me qëllim të realizimit të projekteve me interes të përbashkët.

Haziri: Momenti i fundit për rregullimin e shtratit të lumit “Morava”



14

QERSHOR

14 qershor 2016 / Në Komunën e Gjilanit, organizuar nga Agjensioni për Zhvillim Rajonal - Lindje dhe në financim të zyrës së BE-së në Kosovë, u mbajt tryezë e rrumbullakët lidhur me modalitetet e financimit të projektit rajonal “Morava”, i cili projekt brenda territorit të Republikës së Kosovës, ka një gjatësi prej 50 kilometra.

Në fjalën e tij prej nikoqiri, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se lumi “Morava” nuk është vetëm rregullim i lumit por edhe shumë më tepër duke ndikuar në përmirësim të kushteve të jetës dhe sigurisë së qytetarëve. “Investimi në lumin “Morava”, pos shtratit, është investim që përfshinë në vete edhe aspektin e ambientit më të pastër, sigurisë më të madhe për qytetarët, garancionin për tokat bujqësore dhe ekonominë familjare në përgjithësi. Sot kemi një shtrat të lumit të degraduar. Gjendja e njëjtë është në shumë lumenjtë të Kosovës. Por nga ky degradim në këtë rast ne kemi problem të shumta gjatë reshjeve më të mëdha të shiut, duke u shkaktuar vërshime përgjatë gjithë pjesës kah kalon ky lum”, ka thënë kryetari Haziri. Ai ka pohuar se investimi i këtij lumi është i domosdoshëm, sepse zgjidh

një problem rajonal në gjashtë Komuna të kësaj ane. Ndërkaq, shefi i zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë, Christof Stock, ka thënë se ky është një projekt i cili është përgatitur sipas rregullave të Bashkimit Evropian. “Projekt i rregullimit të shtratit të lumit “Morava e Binçës”, prekë gjashtë Komuna të këtij regjioni. Gjendja në të cilin është ky lumë është jashtëzakonisht e rëndë. Pastrimi i tij nuk është bërë prej disa dekadash, dhe sot në të gjejmë papastërti shumë të mëdha që kërkojnë intervenim sa më të shpejtë. Ndërsa projekti që është përgatitur është në bazë të standardeve Evropiane. Sipas përlllogaritjeve fillestare ky projekt do të kushtoj nga 10.5 milionë deri në 11 milionë euro dhe në këtë fazë KE, nuk ka fond të ndarë për të investuar në këtë projekt, por duhet gjetur donator, e pse jo edhe bashkëfinancim të këtij projekti jetik për këtë pjesë të Kosovës”, ka thënë në fjalën e tij, Stock. Kurse, prezantimin detaj të projektit e ka bërë kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, i cili ka bërë përmbledhjen, detajet dhe sfidat që janë gjatë realizimit të këtij projekti. Ndryshe, në këtë takim të pranishëm ishin kryetarët e këtyre Komunave të lindjes, zëvendësministri i Ministrisë së Ambientit, dhe përfaqësues të shumtë nga niveli lokal dhe ai qendror i fushës së ujërave.



Gjilani, për 15 vjet nuk i ka pasur 26 milionë investime në infrastrukturë

13

QERSHOR

Nën organizimin e klubit të gazetarëve “Beqir Musliu”, është mbajtur sot debati me temën “Çfarë pritet të përfitojë nga projektet infrastrukture Gjilani në vitin 2016”, ku panelist ka qenë kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, përfaqësues nga shoqëria civile dhe kryetarët e këshillave të fshatrave. Haziri ka thënë se sivjet veç kanë nisur projektet e mëdha e që kapin shumë 26.5 milionë euro investime në infrastrukturë, kryesisht nëntokësore.

“Këto investime Gjilani nuk i ka pasur për 15 vjet”, ka thënë Haziri para të pranishmëve.

Duke folur për ndërtimin e hyrje-daljeve të qytetit, kreu i gjilanasve ka pohuar se kjo do të jetë një zgjidhje shumë e mirë për qytetarët, duke parandaluar edhe kolonat e mëdha në trafik, por në të njëjtën kohë, tha se po bëhen sipas standardeve të larta. “Programi i rrugës Gjilan-Bujanoc tashmë është duke u realizuar dhe do të ndërtohet deri tek “Drini”, pra me buxhet komunal. Ndërkaq, dy rrugët tjera, ajo Gjilan-Prishtinë (nga kanali e deri tek penda e Livoçit) dhe Gjilan-Livoç i Ulët-Cërnice Kllokot (prej rrethit në qytet) do të ndërtohen me buxhet të Ministrisë së Infrastrukturës dhe BERZH-i”, u shpreh Haziri. Haziri tha se gjatë viteve 2015-2016 janë realizuar projekte të mëdha infrastrukture në qytet dhe fshatra, duke përfshirë kanalizimet, ujësjellësin, ndërtimin e rrugëve të reja, hapje të rrugëve, rrugët e arave etj. “Gypi kryesor i cili vije nga penda e Përlepnicës dhe kalon nëpër qytet, është i asbestit dhe është i ndaluar që të përdoret për shkak se është konstatuar se është kancerogjen. Pjesën më të madhe

të këtij gypi e kemi ndërruar”, ka thënë Haziri. Ai tha se vetëm programi i rehabilitimit të rrjetit të ujit të pijshëm dhe ndërtimi të rrjetit sipas kërkesave të qytetarëve, kap vlerën e 3.6 milionë franga zvicerane, duke shtuar se donatorë për këtë është qeveria e Zvicrës në bashkëpunim me Komunën. Ndërkaq, sa i përket kanalizimeve, i pari i Gjilani ka theksuar se Komuna e ka siguruar buxhetin nga Qeveria e Austrisë dhe pas nënshkrimit me qeverinë e Kosovës, i cili pritet të ndodhë shumë shpejt, do të realizohet. “Veç ky program kap koston e 12 milionë euro dhe donator është qeveria e Austrisë. Me anë të këtij programi, parashihet që të përfundohet shtrati i “Mirushës”, “Stanishorkës” dhe ndërtimi i kanalizimeve në zonën urbane dhe në fshatra. Këto investime parashihen të ndodhin gjatë tri viteve të ardhshme”, ka deklaruar në debatin e të hënës, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri. Po ashtu, Haziri ka paralajmëruar se këtyre ditëve do gjelbërohet pjesa të ish-ekzekutivi, pastaj tek “Atik” xhamia, tek lapidari i Reshat Ymeri në 7 korrik, sikurse edhe tek “Stahat kulla” dhe në lagjen “Arbëria”. Kryetari Haziri theksoi se është duke punuar sa i përket hapjes së dy vendkalimeve kufitare në Dobrosin, Ranatoc dhe Stançiq. Ne debatin e sotëm ka kontribuar me pyetje, ide e rekomandime edhe Demir Krasniqi, Hekuran Aliu nga KCIS, Shaban Terziu sikurse edhe kryetarët e këshillave të fshatrave. Për fund, kryetari Haziri tha se gjatë muajit gusht, bashkë me ministrin e Infrastrukturës, Lutfi Zharkun, do ta organizojë edhe një debat në Gjilan lidhur me projektin detaj të Autostradës Gjilan-Prishtinë, sikurse edhe rrugët tjera të rëndësishme të cilat marrin buxhet të lartë, siç është ajo e Pogragjës dhe e “Rruga e Kumanovës”.



Gjilani nis programin e renovimit të 37 shtëpive për familjet në nevojë

10

QERSHOR

Komuna e Gjilanit ka nisur sot implementimin e programit të renovimit të 37 shtëpive për familjet në nevojë, nga fondi i solidaritetit dhe ai komunal. Në nisjen e këtij programi ka marrë pjesë kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili tha se mbi 180 mijë euro do të kushtoj implementimi i këtij programi.

“Sipas kërkesës dhe vlerësimit të komisionit komunal për banim social, janë 37 shtëpi që janë projektuar në fazën e renovimit. Familja e Naser Malokut, është familja e parë që ne fillojmë renovimin dhe do të vazhdojmë edhe me 36 shtëpitë tjera për familjet me gjendje të rëndë sociale, të cilat kapin vlerën e mbi 180 mijë eurove. Do të vazhdojmë ta ndihmojmë çdo familje në territorin e Komunës sonë, në mënyrë që të vendosim një barazi sociale”, u shpreh Haziri. Ai ka paralajmëruar se së shpejti, Komuna e Gjilanit do të nis edhe me ndërtimin e tetë shtëpive për familjet skamnore. “Komuna e Gjilanit do të rifillojë edhe ndërtimin e pesë shtëpive të tjera nga fondi komunal, ndërkaq edhe 3 donatorë të tjerë janë lajmëruar për të ndërtuar shtëpi për familjet në nevojë, të cilat do të përgjigjen në muajin e bekuar të Ramazanit. Ndërsa, për 40 familje jemi duke paguar qiratë. Apeloj tek njerëzit e vullnetit të mirë që sipas mundësive, të dhurojnë edhe troje, meqë Komuna nuk ka të drejt ligjore të ndaj troje”, tha kryetari Haziri. Një fjalë falënderimi për kreun e Komunës dhe donatorët pati pronari i shtëpisë që ka nisur renovimi, Naser Maloku, i cili ka shfaqur gëzimin që shumë shpejt do të jetoj dinjitetshëm në shtëpinë e tij. Në mbrëmjen humanitare “Pak nga ne, shumë për ata” të mbajtur me iniciativën e kryetarit Haziri në nëntorin e vitit 2014, janë premtuar 11 shtëpi, ndërkaq janë në fazën e finalizimit 28. “Është hera e parë që në një mbrëmje trefishohet premtimi publik. Është tejkaluar çdo lloj parashikimi ynë, falë mbështetjes së donatorëve. Jam shumë i lumtur për këtë”, ka përfunduar kryetari Haziri.

Gjithandej po bëhen investime në rregullimin e infrastrukturës



9

QERSHOR

Komisioni Komunal i themeluar nga kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, që kryesohet nga nënkryetari, Rexhep Kadriu, ka bërë sot inspektimin e punimeve që janë duke u kryer gjithandej në rregullimin e infrastrukturës publike, për të lehtësuar jetën e qytetarëve, në fshatra dhe qytet. Dinamika e punëve do të rritet gjatë muajve të ardhshëm. Sivjet në Gjilan realizohen investime mbi 26 milionë euro.

Me këtë rast Kadriu ka thënë se dinamika e punëve është duke vazhduar sipas kontratave të lidhura me kompanitë tenderuese dhe gjithnjë sipas projektit dhe kriterëve për rregullim të infrastrukturës publike. “Sot ishim në fshatin Dobërqan, fshat në të cilin janë duke u ndërtuar tetë rrugë të reja dhe sipas standardeve modern që do të ndihmojnë jashtëzakonisht shumë banorët e kësaj ane që të kenë

më të lehtë qarkullimin. Gjithashtu kemi vizituar edhe fshatin Përlepnicë, ku janë bërë të gjithë përgatitjet për fillimin e rregullimit të kanalizimit fekal, në kuadër të vazhdimit të punimeve nga shumë projekte të realizuara deri më tani. Ndërsa në fshatin Velekincë, kemi përcjellë punët që janë duke u bërë në rregullim të trotuarit, dhe krijimit të lehtësirave për nxënësit dhe banorët të cilët që nga paslufta nuk kishin një trotuar për të lëvizur si këmbësor”, ka thënë nënkryetari Kadriu. Ai gjithashtu ka potencuar se muajt në vijim, do të jenë muaj të cilët në vete për Gjilanin do të ngërthejnë edhe një dinamikë shtesë si asnjëherë më parë, në punë publike dhe infrastrukturë, qëllim ky i kryetarit të Komunës, i cili ka themeluar këtë komision për t’i shtyrë përpara këto projekte dhe për krijim të kushteve më të mira për qytetarët e Gjilanit në përgjithësi.



Nis ndërtimi i kompleksit të shkollave të mesme në Gjilan

8
QERSHOR

Komuna e Gjilanit ka nisur sot ndërtimin e kompleksit të shkollave të mesme, projekt ky i cili realizohet përmes partneritetit publiko-privat.

Në nisjen e punimeve ka marrë pjesë kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, me bashkëpunëtorët e tij dhe përfaqësuesit e kompanisë gjilanasë që e ka fituar kontratën. Kryetari Haziri tha se ndërtimi i kompleksit ndikon në ngritjen e cilësisë në arsim, ngritjen e sigurisë për nxënësit dhe ndikon në zhvillimin ekonomik lokal.

“Me këtë kompleks krijohen kushte më të mira për nxënësit dhe më e rëndësishme është se do të funksionojë

në mënyrën më të mirë trekëndëshi nxënës-mësimdhënës-prindër. Po ashtu, ky projekt ndikon edhe në zhvillimin ekonomik lokal”, ka thënë Haziri. Për më tepër, ai tha se me realizimin e këtij projekti, Komuna dëshmon se është e interesuar që të kemi zhvillim të arsimit, sikurse që do të krijohen hapësira të reja sportive, vende rekreative, garave të ndryshme, duke ndikuar në shëndetin e nxënësve dhe duke u larguar nga rrugët devijante. Kreu i Gjilanit ka kërkuar nga qeveria e Kosovës që të nis procedurat për ndërtimin e kompleksit universitar, në mënyrë që të lirohen hapësirat e shkollave të mesme.

Në “Dardani” ndërtohet çerdhja më e madhe në Gjilan



8

QERSHOR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga nënkryetari dhe drejtorët e drejtorive komunale, kanë vizituar punimet të cilat kanë nisur në ndërtimin e çerdhes moderne dhe më të madhes në Gjilan. Objekti, financim i përbashkët me qeverinë amerikane (USAID), në vlerë 400 mijë euro, pritet të jetë gati në vjeshtën e këtij viti.

Gjatë vizitës në këtë projekt, i cili, është bashkëfinancim me Qeverinë Amerikane, përmes USAID-it, Haziri ka thënë se Gjilani dhe veçanërisht kjo lagje do të ketë një projekt të madh e modern, sikur që do të ketë edhe investime të tjera në këtë hapësirë. “Kjo do të jetë çerdhe moderne dhe me të gjitha kushtet, falë edhe mbështetjes së Qeverisë Amerikane, e cila e ka zgjedhur Gjilanin për

këtë investim falë qeverisjes së mirë dhe disiplinës së ashpër buxhetore, por edhe transparencës dhe kriterëve të tjera, që qeveria e SHBA-ve dhe USAID, i ka parashtruar për Komunën. Shpresoj shumë që kjo lagje, tash pas parkut i cili është në shërbim të qytetarëve, rregullimit të çerdhes dhe terreneve sportive, do ta shfrytëzojnë racionalisht këtë hapësirë dhe të gjitha këto projekte”, ka thënë kryetari Haziri. “Sipas dinamikës së ndërtimit, në vjeshtë të këtij viti do të kryhet ky projekt dhe do të hapet për fëmijë, kurse, vlera e ndërtimit është 400 mijë euro, që financohet në raportin 50 me 50 për qind, me qeverinë Amerikane. Ndërkaq, fushat sportive do të ndërtohen në partneritet dhe bashkëfinancim me Ministrinë e Kulturës”, ka thënë Haziri.



Vihet gurëthemeli i objektit të Qendrës Rajonale të Shëndetit Publik në Gjilan

7
QERSHOR

Është vënë sot gurëthemeli i Qendrës Rajonale të Shëndetit Publik, në kuadër të spitalit rajonal të Gjilanit, projekt ky kapital i Ministrisë së Shëndetësisë dhe i mbështetur nga Qeveria. Në inaugurim ka marrë pjesë kryeministri Isa Mustafa, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ministri i Shëndetësisë, Imet Rrahmani, deputetë e përfaqësues të tjerë nga institucionet lokale dhe qendrore.

“Ne si qeveri i kemi dhënë prioritet themelor shëndetësisë e arsimit kundrejt zhvillimit ekonomik dhe këto tre sektorë lidhen shumë mes vete. Neve na nevojitet që të kemi popullatë të shëndoshë, të kujdesemi për shëndetin e qytetarëve, për avancimin e shëndetit publik. Instituti dhe Ministria ka bërë një punë të rëndësishme në këtë fushë, ne vlerësojmë lartë punën që është bërë, por po ashtu konsiderojmë që duhet të investojmë më tepër në ndërtimin e objekteve, në mënyrë që edhe punonjësit shëndetësor, por edhe shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore publike. Shpresojmë se ky objekt në vjeshtën e vitit të ardhshëm të finalizohet dhe të gjithë të kenë kushte më të mira”, ka thënë në fjalën e tij kryeministri i Republikës, Isa Mustafa. Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka falënderuar kryeministrin Mustafa dhe ministrin Rrahmani, pasi tha se shëndetësia si shtylla kryesore e qeverisjes në Gjilan, po e merr mbështetjen e plotë financiare dhe politike të tyre. “Më lejoni që ta falënderoj kryemi-

nistrin Mustafa dhe ministrin Rrahmani për mbështetjen në realizimin e këtij projekti që është i një rëndësie të veçantë dhe i cili çon drejt rrumbullakimit të infrastrukturës shëndetësore në Komunën e Gjilanit. Përballë kësaj qendre, në pronën komunale do të ndërtohet edhe objekti i ri i QKMF-së, si kujdes primar që është në përgjegjësi të Komunës, por në një lidhshmëri me nënkalim që lidhet me shërbimet në kujdesin sekondar. Nga ky oborr jepen shërbime për afro gjysmë milioni banorë. Këtë ditë të bardhë po e bëjnë edhe mantelet e bardhë këtu”, ka thënë Haziri. Ministri i Shëndetësisë, Imet Rrahmani, theksoi se Përkrahja e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, do të thotë përkrahje e një shëndetësie të mirë, përkrahje e programeve parandaluese e zbuluese të hershme të sëmundjeve, dhe promovim i jetës së shëndetshme për një popullatë të shëndetshme. Nga ana e tij, drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, Naser Ramadani, e ka falënderuar kryetarin Haziri, kryeministrin Mustafa dhe ministrin Rrahmani, të cilët kanë bërë të mundur vënien e gurëthemelit, duke shtuar se “me vetë faktin se ky projekt po realizohet sot, i cili ishte kërkuar shumë më parë të ndodhte, tregon për përkushtimin e qeverisë së Kosovës, duke e vënë në plan të parë sektorin e shëndetësisë”. Përndryshe, ndërtimi i objektit të ri i Qendrës Rajonale të Shëndetit Publik kap vlerën e afro 500 mijë euro.



Haziri pret në takim ambasadoren e Francës, Marsye Daviet

7

QERSHOR

Kryetari i Komunës së Gjiçanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot në një takim pune, Ambasadoren e Francës në Kosovë, Marsye Daviet, me të cilën kanë bashkëbiseduar për bashkëpunimin dhe nevojën e madhe për investime në Gjiçan, por edhe zhvillimin ekonomik si pjesë e përbashkët e zhvillimeve të përgjithshme.

Me këtë rast kryetari Haziri, tha se me Ambasadën e Francës në Kosovë, bashkëpunimi ka qenë jashtëzakon-

isht i mirë dhe i vazhdueshëm gjithmonë. “Bashkëpunimi me Ambasadën e Francës gjithnjë kemi bashkëpunimin shumë të mirë. Në Komunën e Gjiçanit gjithnjë e më shumë po ndodhin ndryshime të cilat janë në shërbim të qytetarëve në përgjithësi, në mbështetjen e bizneseve, arsimit, shëndetësisë dhe bujqësisë, por edhe fushave të tjera në përgjithësi. Ambasada e Francës në Kosovë, gjithnjë ka qenë pikë e fuqishme në të cilën është mbështetur Komuna e Gjiçanit”, ka thënë Haziri.

Schausberger: Lutfi Haziri e prezantoi mjaft mirë Kosovën në Bruksel



2

QERSHOR

Në Bruksel është mbajtur të mërkurën konferenca për ditën e zgjerimit të pushtetit lokal, e organizuar nga Komiteti i Regjioneve, në kuadër të Bashkimit Europian, në të cilin ka marrë pjesë një delegacion nga Kosova, i kryesuar nga kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri. Kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka prezantuar para panelistëve arritjet e qeverisjes lokale në regjion, lidhur me bashkëpunimin ndërkufitar, siç është projekti për valorizimin e zejeve tradicionale Gjilan-Çair, i cili është financuar nga Komisioni Europian dhe projekte tjera.

“Fillimisht, dua ta falënderoj Komisionin Europian për mbështetjen që i ka dhënë Kosovës në tërësi dhe Gjilanit në veçanti, e të cilat kanë rezultuar tejet të suksesshme. Për shembull, nga projekti i bashkëpunimit ndërkufitar që është realizuar së bashku me Komunën e Çairit të Maqedonisë, kanë përfituar përmes granteve 28 zeje gjilanase, duke iu ndihmuar në funksionimin e suksesshëm të veprimtarive të tyre me anë të konferencave, seminareve të përbashkëta, aktiviteteve të tjera promovuese”, ka thënë Haziri. Më tej, në fjalën e tij, Haziri ka thënë toleranca politike, ndër-etnike dhe ndër-fetare, bashkëpun-

imi ndërkufitar dhe vetëqeverisja lokale, e bënë Gjilanin qytet shembull në regjionin e Europës juglindore. Nga ana e tij, kryesuesi i Komitetit Konsultativ, Franz Schausberger, tha se bashkëpunimi i Kosovës dhe Komitetit të regjioneve, po merr një kahje të mirë, pasi që kjo e fundit është drejtuar kah Bashkimi Europian. Ai ka lavdëruar kryetarin e Gjilanit për përfaqësimin “mjaft të mirë të Kosovës në këtë konferencë”. “Mendoj që përfaqësimi i Kosovës këtu ishte mjaft i mirë. Njëri nga kryetarët e Komunave z. Haziri, na dha informata të shumta dhe ne kemi nevojë të dimë më shumë për Kosovën. Pra, është mirë të participoni. Mendoj që kryetarët e komunave të Kosovës duhet të vizitojnë vendet e tjera dhe t’u tregojnë për udhëheqjen, ngase raportimi nga mediat dhe të tjerët, nuk është gjithmonë më i miri”, ka thënë Schausberger. Përveç tjerash, në fjalën e tij, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se Kosova ka vuajtur dhe po vuan nga pasojat e euroskepticizmit, duke shtuar se Kosova duhet të përjashtohet nga tendencat e ndryshme që po i bëhen asaj dhe Ballkanit perëndimor. Ndryshe, në vjeshtën e këtij viti, ky panel pritet të vije në Gjilan për të parë nga afër punën e bërë, me ftesë të të parit të kësaj Komune, Lutfi Haziri.

Konferencat e shefave të grupeve politike në Kuvend Komunal

Isufi (VV): Kuvendi nuk mund të jetë i suksesshëm, nëse të gjitha hallkat e tij nuk funksionojnë siç duhet



6
QËRSHOR

Ciklin e konferencave të subjekteve politike që përfaqësohen në Kuvendin Komunal të Gjilanit e ka përmbyllur të hënën, Nevzat Isufi, shef i grupit të këshilltarëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Ai i është përgjigjur kërkesës së Zyrës për Informim, për të bërë një vlerësim të punës së deritashme të Kuvendit e të qeverisjes komunale. VV përfaqësohet në vendimmarrjen komunale me katër ulëse.

Isufi ka thënë se, në përgjithësi, Kuvendi ka përmbushur planin sa i përket numrit të seancave, ashtu sikur edhe në vitet paraprake, por si opozitë ka pasur vërejtje për mungesën e kryetarit të Komunës, në të shumtën e rasteve, në seancat e asamblesë komunale, gjë që, sipas tij, po reflektohet edhe te puna e drejtorive, të cilat nuk janë përgjigjur në një numër të madh të pyetjeve tona, ka thënë ai. Isufi thotë se është kryetari ai që duhet t'i detyrojë drejtorët të jenë më efikas në dhënien e përgjigjeve në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit. Shefi i grupit të këshilltarëve të VV-së, thotë se mungesa e kryetarit në seanca, po reflekton edhe në punën e Kuvendit, përkatësisht në mënyrën e kryesimit të Kuvendit, gjë që ka zgjuar edhe reagimin tonë dhe të pjesës tjetër të opozitës. “Kuvendi nuk mund të rezultojë i suksesshëm, nëse të gjitha hallkat e tij nuk luajnë mirë rolin e tyre, gjithnjë sipas ligjeve e rregulloreve”, ka thënë Isufi. Sa i përket planit vjetor të punës së Kuvendit, ai thotë se plani përmban gjithsej 35 çështje. “Është vlerësim yni se ky plan i punës, sikurse edhe planet për vitin 2014 e 2015, janë të varfër për nga përmbajtja, sepse nuk ka çështje të rëndësishme për jetën e qytetarëve të komunës”, tha Isufi. Në seancat e Kuvendit të Komunës, prej 19 çështjeve të përfshira në planin

vjetor të punës, janë shqyrtuar vetëm 14 çështje. Ai ka pasur vërejtje edhe sa i përket shqyrtimit dhe miratimit të planit të punës për vitin 2016, duke thënë se Komitetit dhe komisionet përkatëse të Kuvendit, fare nuk e kanë shqyrtuar dhe kjo praktikë e përhershme, sipas tij, është trashëguar nga e kaluara. “Ne si opozitë kemi pasur edhe vërejtje konkrete që në këtë plan nuk janë futur shumë çështje që kanë të bëjnë me administratën e përgjithshme, rininë sportin, inspeksionin, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, bujqësinë, pylltarinë, informimin, auditimin, integritet evropiane dhe të tjera”. Po ashtu, nuk është organizuar asnjë debat me qytetarë dhe shoqërinë civile. Është mendim ynë se gjithë përfshirja e qytetarëve në këtë lloj diskutimi, do të mund të nxirrte edhe çështje të tjera që nuk janë paraparë. Si opozitë kemi vërejtjet tona për shumë çështje dhe si të tilla i kemi kthyer edhe në formë të rekomandimeve për Kuvend, por pozita nuk i ka pranuar për shqyrtim 56 rekomandimet tona, me arsyetim se janë të njëjta me ato të shoqërisë civile, ka thënë Isufi. Sa i përket seancës së fundit, të cilën VV e braktisi bashkë me subjektin tjetër opozitar, Isufi ka thënë se këtë veprim nuk e bënë nën ndikimin e PDK-së, por për shkak se nuk po trajtohen në mënyrë të barabartë me anëtarët tjerë të Kuvendit. Nevzat Isufi, është shef i grupit të këshilltarëve të VV-së, që në vendimmarrjen komunale përfaqësohet me katër ulëse.

Xhemajli (AAK): Jemi grup konstruktiv në vendimmarrjen komunale



3
QËRSHOR

Puna e Kuvendit Komunal dhe Ekzekutivit, është vlerësuar pozitive edhe nga shefi i grupit të këshilltarëve të AAK-së, Selami Xhemajli. Të premtën, në një konferencë me gazetarë, të cilat po i organizon Zyra për Informim, për t'iu dhënë mundësi të gjitha grupeve politike që t'i shprehin pikëpamjet e tyre, Xhemajli ka thënë se brenda kësaj periudhe janë mbajtur pesë

seanca të rregullta, me çka Kuvendi Komunal ka përm-bushur të gjitha obligimet e veta ligjore dhe statutare.

“Ne vlerësojmë se Kuvendi Komunal ka qenë funksional në këtë periudhë, me çka ka mundësuar që të trajtohen shumë çështje me interes publik, përmes miratimit të vendimeve dhe rregulloreve, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve”, ka thënë Xhemajli. Grupi i këshilltarëve të këtij subjekti konsideron se shpeshherë është shpenzuar kohë për çështje që nuk kanë qenë në agjendën e punës. “Është vlerësim yni se Kuvendi ka harxhuar shumë kohë dhe energji për tema të cilat nuk kanë qenë në rend dite të seancave dhe kjo ka ndikuar që të ketë shmangie nga rregullorja e punës, stërzgjatje të seancave, degradim të gjuhës e deri te akuzat personale mes këshilltarëve”, ka thënë Xhemajli. Përndryshe, ky subjekt politik është treguar bashkëpunues në Kuvend dhe qeverisje. Grupi i këshilltarëve të AAK-së ka pasur bashkëpunim të mirë me ekzekutivin, në përkrahje të projekteve që janë me interes për qytetarët dhe me veprimet tona kemi ndikuar që në Kuvend të diskutohen edhe temat e propozuara nga opozita, siç ka qenë rasti i Fabrikës së miellit në Gjilan, ka thënë Xhemajli. Xhemajli tha se grupi i këshilltarëve të AAK-së, edhe në të ardhmen do të vazhdojë të jetë konstruktiv, me qëllim që Gjilani të ketë një Kuvend sa më funksional dhe që iu shërben interesave të të gjithë qytetarëve të tij. Ai ka treguar mirëkuptim edhe për disa zëra kritik ndaj koalicionit, duke thënë se në një ambient demokratik, secili ka të drejtë t’i shpreh mendimet e veta, por marrëveshjet i bëjnë strukturat e subjekteve përkatëse dhe jo individët. Ndryshe ai ka vlerësuar se në Kuvendin Komunal të Gjilanit ka transparencë të mjaftueshme, duke nënvizuar faktin se seancat transmetohen drejtpërdrejt dhe secili qytetar ka mundësi t’i ndjek të zgjedhurit e vetë. AAK përfaqësohet në Kuvend Komunal me katër anëtarë. Në qeverisje, si partner i koalicionit, udhëheq dy drejtori komunale dhe ka postin e nënkryetarit të Komunës.

Aliu: Në Kuvendin Komunal të Gjilanit, opozita është e privilegjuar sa i përket hapësirës për debat

2 QERSHOR
Cikli i konferencave të shefave të grupeve të subjekteve që përfaqësohen në Kuvendin Komunal të Gjilanit, ka vazhduar të enjten me Avdyl Aliun (LDK), i cili ka paraqitur vlerësimet e tij dhe të grupit të këshilltarëve, për punën e asamblesë komunale dhe ekzekutivit, gjatë tremujorit të parë të këtij viti. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur tri seanca të Kuvendit, ku janë miratuar 16 vendime, 5 raporte, 2 rreg-



ullore si dhe rekomandime, informata e materiale të tjera me interes për jetën e qytetarëve të Gjilanit dhe assesit të ndonjë grupi të ngushtë, ka thënë Aliu.

Punën e Kuvendit Komunal e kanë lehtësuar në masë të madhe edhe komisionet e ndryshme si dhe Komitetet, si trupa ndihmëse profesionale. Nëpër debate dhe dëgjime publike, që kanë qenë të mjaftueshme, kontributin e tyre, kush më shumë e kush më pak, e kanë dhënë edhe anëtarët e Kuvendit, ka thënë Aliu. Aliu ka theksuar se në Kuvendin Komunal të Gjilanit vazhdon të mbizotërojë fryma e mirë dhe tolerante ndërmjet të gjitha grupimeve politike, që nga fillimi i punës së kësaj përbërje. Ekziston një vullnet i mirë për t’iu dhënë hapësirë të mjaftueshme dhe të paku-fizuar në aspektin kohor të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Të gjithë kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në të gjitha proceset e punës së Kuvendit, ka thënë Aliu. Ai beson se asnjë anëtar i Kuvendit nuk e ka shpenzuar kohën në mënyrë të padobishme, duke i shërbyer një interesi të ngushtë, por duke u munduar që të bëjë një punë të mirë për interesa të qytetarëve të Gjilanit. Në Kuvend është instaluar një demokraci që nuk ka ekzistuar deri më tani. Ndodhë shpesh që një asamblisti të opozitës t’i jepet fjala deri në tri herë për të njëjtën çështje. Aliu tregohet i vetëdijshëm se mund të punohet edhe më mirë dhe më shumë. “Sigurisht se, gjithmonë ka vend për më mirë dhe më shumë se sa kemi bërë deri tani për interesat e qytetarëve të Gjilanit”, thotë ai. Ai është shprehur i kënaqur edhe sa i përket bashkëpunimit me ekzekutivin. Me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Komunë, ne si Kuvend kemi pasur një bashkëpunim të kënaqshëm me ekzekutivin dhe këtë e bëjmë për t’iu shërbyer sa më mirë interesave të qytetarëve të Gjilanit. “Ky është një standard i ri se si duhet të ketë bashkëpunim ndërmjet vendimmarrjes dhe ekzekutivit për interesa të qytetarëve”, ka thënë Aliu. Gjatë këtij tremujori, janë kryer disa punë që janë të dukshme për syrin e publikut, disa janë më pak të dukshme, por ka edhe të tjera punë që do të shihen në ditët dhe muajt e ardhshëm. “Puna e kryetarit dhe e qeverisë komunale, e cila paraqitet në Kuvend, synon të nxisë një vështrim kritik të asamblistëve, qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, për të vendosur kështu një komunikim, i cili presim të rezultojë me ngritje të performancës”, ka thënë Avdyl Aliu, shef i grupit të këshilltarëve të LDK-së. LDK ka 14 këshilltarë në Kuvend Komunal.

Kuvendi Komunal nuk është vendi ku opozita duhet të bëjë politikë



1 QERSHOR
Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal në Gjilan, ka thënë se është e detyruar që tash e tutje të zbatojë me përpikëri rregulloren e punës dhe të mos e tolerojë opozitën që të bëjë politikë në organin më të lartë të pushtetit lokal, i cili ka për detyrë t’iu shërbejë qytetarëve dhe të punojë për interesa publike. Në një konferencë ma gazetarë, Rexhepi-Bunjaku, ka thënë se Kuvendi Komunal ka mbajtur deri tani pesë seanca dhe është brenda agjendës së vetë të punës.

Duke komentuar zhvillimet në seancën e fundit, të cilën opozita (PDK e VV) e braktisi me arsyetim se nuk po i jepet hapësirë e mjaftueshme për debat, Bunjaku-Rexhepi ka thënë se këto akuza nuk qëndrojnë, por opozita po dëshiron ta keqpërdorë hapësirën dhe mikrofonin e Kuvendit për fushatë politike, gjë që nuk do ta lejojë. “Unë jam munduar të jem korrekte si me pozitën, ashtu edhe me opozitën, madje shpeshherë edhe e kam dëmtuar pozitën, për t’i dhënë sa më shumë hapësirë opozitës, siç ndodhi edhe në seancën e fundit, ku pas dy orë e më tepër debat rreth rendit të ditës, ata e lëshuan sallën”, ka thënë kryesuesja e Kuvendit Komunal, duke nënvizuar se të gjitha kërkesat e opozitës janë nxjerrë në votim. Opozita nuk ka pasur asnjë arsye ta lëshojë seancën. Ka qenë një kërkesë e këshilltarit Sahit Abazi për të diskutuar për çështjen e arsimit dhe kërkesa e tij është pranuar, por nuk ka mundur të futet e para në rend të ditës, meqë drejtori i arsimit ka pasur angazhime të tjera, pas vendimit për anulimin e testit të arritshmërisë dhe ne kemi vendosur që kjo pikë të diskutohet në fund. Kjo u mor si arsye nga

Abazi për t’u revoltuar, meqë si duket ai kishte punë të tjera dhe i bëhej vonë të priste deri atëherë. Ndërkaq, këshilltarja Fatbardha Selmani e ka kritikuar komisionin për shëndetësi për ndarjen e subvencioneve për barna dhe trajtime shëndetësore, të cilin e ka themeluar kryetari i Komunës. Madje ajo e shfrytëzoi rastin të flasë edhe për politikë, duke thënë se në zgjedhjet e ardhshme do të fitojë PDK-ja. Bunjaku-Rexhepi tha se në qeverisjen e PDK-së, familja e zonjës Selmani ka përfituar nga subvencionet e shëndetësisë. Ajo ka thënë se në qeverisjen tonë, subvencione marrin vetëm njerëzit në nevojë dhe jo ata që janë anëtarë të Kuvendit dhe që i kanë kushtet e mira ekonomike. Ajo i ka komentuar edhe disa deklaratatë të këshilltarëve të opozitës, rreth një raporti të organizatave të jashtme. “Opozita po i referohet një raporti të disa organizatave ndërkombëtare mbi kënaqshmërinë e ultë të qytetarëve të Gjilanit me qeverisjen aktuale, raport ky që unë e kam kërkuar, por nuk kam mundur ta gjejë askund”, ka thënë ajo, duke shtuar se Kuvendi Komunal i Gjilanit është kampion për transparencë dhe rregullsi. Të gjitha seancat e Kuvendit transmetohen drejtpërdrejt në rrjetet sociale dhe qytetarët kanë mundësi t’i ndjekin vetë punimet e organit vendimmarrës dhe të vlerësojnë angazhimin e secilit prej këshilltarëve. Bunjaku-Rexhepi ka folur edhe për mbështetjen që Kuvendi Komunal i dha Drejtorisë së Arsimit për të mos pranuar anulimin e testit të arritshmërisë nga MASHT-i, sepse vendimi nuk bazohet në fakte. Kuvendi Komunal nuk do të vazhdojë punën dhe as nuk do të mbajë seanca, derisa MASHT-i nuk e anulon këtë vendim. “Ne nuk do ta pranojmë këtë vendim në asnjë mënyrë, sepse kemi informata se nuk ka pasur asnjë vërejtje nga mbikëqyrësit e këtij procesi”, ka thënë Bunjaku-Rexhepi. Suksesi që kanë treguar nxënësit e Gjilanit në testin e arritshmërisë nuk duhet ta befasojë askënd, derisa dihet se edhe vitin e kaluar kanë qenë ndër më të mirët dhe ata shquhen për rezultate në garat e ndryshme. Ajo ka kërkuar nga MASHT-i që të formojë një komision dhe në bashkëpunim me DKA-në të rivlerësojë këtë vendim të ngutshëm, duke nënvizuar se kërkesa është përkrahur edhe nga opozita. Zyra për Informim do të vazhdojë me konferencat e shfave të grupeve të këshilltarëve, për t’iu dhënë mundësi të gjitha grupimeve politike në vendimmarrjen komunale që t’i paraqesin vlerësimet e tyre për punën e Kuvendit dhe të ekzekutivit komunal.



Në “Ecohigjienë” ka menaxhment, por nuk ka investime nga partneri privat

26
MAJ

Investimet në kompaninë “Ecohigjiena”, si pjesë e Partneritetit Publiko Privat mes pjesës Publike dhe asaj Private, deri më tani ka respektim të marrëveshjes vetëm afër 17 për qind, sa i përket investimeve, sikur që nuk është respektuar ulja e tarifës së TVSH-së, nga 16 në 8 për qind, pastaj ka bërë uljen e vlerës së aseteve publike të cilat ishin mbi 1.4 milion euro, në 707 mijë e 235 euro.

Me këtë rast kryesuesi i Komisionit Komunal të Aksionarëve, në kompaninë “Ecohigjiena”, Xhelal Jetishi, ka dhënë disa detaje nga raporti janar – mars i punës, por edhe saktësimin e dështimeve konkrete të cilat kanë ndodhur në bashkëpunimin publik - privat. Ai ka potencuar se partneri privat në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar në vitin 2012, ka marrë obligim që brenda tri viteve t’i investoj 1.5 milionë euro dhe atë investim nuk e ka bërë, ose përkthyer në investime, deri më tani ai ka investuar mbi 257 mijë euro, gjithnjë sipas menaxhmentit të “Ecohigjienës”. “Marrëveshja e Partneritetit Publiko Privat, nuk është zbatuar sa i përket investimeve të cilat janë marrë si obligim nga partneri privat për investim në këtë kompani. Partneri privat, sipas marrëveshjes është dashur që brenda tri viteve të bëjë investimin prej 1.5 milionë euro. Por, ajo tashmë deri në këtë fazë është vetëm 17 për qind, ose përkthyer në shifra është mbi 257 mijë euro të investuara, e të cilat ende nuk janë të konfirmuara, përkundër insistimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve”, ka thënë kryesuesi Xhelal Jetishi, duke kërkuar

transparencë të këtij aspekti. Jetishi si kryesues i aksionarit publik, ka konfirmuar se pa u njoftuar komisioni i Aksionarëve është bërë hapi tjetër, ai i zhvlerësimit të aseteve Publike në këtë kompani. “Pa asnjë informacion është bërë zhvlerësimi i aseteve publike në këtë kompani, dhe atë nga mbi 1.4 milionë euro në 707 mijë e 235 euro. Me këtë zhvlerësim nuk është njoftuar paraprakisht komisioni. Dhe, sipas kësaj, ne, kinse jemi të detyruar që si obligim t’i përmbushim edhe mbi 700 mijë euro. Por, edhe në këtë raport, ne jemi përsëri me 49 për qind, ndërsa partneri ynë është aty tek 17 për qind, në raport të avancimit”, ka thënë Jetishi. Ai ka thënë se ky partner nuk është i vetmi me të cilin mund të bashkëpunojmë, ka kompani rajonale më të cilat mund të bashkëpunojmë, është Qeveria apo edhe menaxhimin mund të bëjë edhe vet Komuna. Ndryshe, siç ka thënë Jetishi, Kompanitë që formojnë partneritet apo subjektet afariste kanë qëllim, specializimin e veprimtarisë së tyre, huazimin e shërbimeve, madje edhe teknologjinë, për të rritur sigurinë dhe uljen e shpenzimeve, futjen e metodave inovatore, futjen e mekanizmave të rinj, për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, të cilin synim sipas Jetishit e ka pjesa publike e partnerit në këtë kompani. Komisioni i Aksionarëve nuk ka asnjë vërejtje sa i përket pastërtisë, sepse ajo bëhet vazhdimisht dhe në mënyrën më të mirë të mundshme nga punëtorët e kësaj kompanie, sikur që është bërë gjithnjë edhe para këtij bashkëpunimi. Gjilani është ndër qytetet më të pastra në Kosovë.



Stacioni i Autobusëve në Gjilan ka dhënë mbi një milion shërbime për 3 muaj

25
MAJ

Në konferencën për media të mbajtur sot, janë dhënë lajme të mira dhe pozitive nga ana e kryesuesit të Komisionit Komunal të Aksionarëve i Ndërmarrjes “Stacioni i Autobusëve” në Gjilan, Avdyl Jerliu, i cili ka thënë se kanë nisur të lëvizin gjërat drejt ecjes dhe rimëkëmbjes së kësaj ndërmarrjeje.

Ai tha se në periudhën janar – mars është kompletuar Bordit e kësaj ndërmarrje dhe në këtë periudhë karshi shumë problemeve dhe sfidave të trashëguara, janë dhënë shërbime për mbi një milion qytetarë dhe ngritje të lehtë të të hyrave vetanake. “Në periudhën janar – mars 2016 janë dhënë shërbime për një numër jashtëzakonisht të madh të qytetarëve, e që numri i tyre kalon shifrën një milion”, tha Jerliu. Por, ai ka dhënë disa vërejtje për menaxhmentin lidhur me disa operatorë, të cilët kanë ngecur me pagesat e borxheve, por edhe për problemet me mos respektim të kontratës për qiramarrësit. “Menaxhmenti i Ndërmarrjes duhet të veproj më me ngulm, sepse ka disa neglizhenca të vogla, por që përktihen me më pak hyrje të financave. Në këtë drejtim ka problem me disa qiramarrës të cilët shfrytëzojnë hapësirat e ndërmarrjes,

e të cilët nuk kanë bërë pagesa sipas kontratave të shfrytëzimit të tyre. Kemi ende një numër të operatorëve privat të cilët operojnë në Gjilan e që nuk i shfrytëzojnë peronat e stacionit, por marrin e zbresin qytetarë jashtë rrethojave të ndërmarrjes. Gjithë kjo bëhet vetëm për t’i ikur një pagese për peron në vlerë prej tre euro”, ka thënë Jerliu, duke përmbledhur raportin tremujor. Kryesuesi i Aksionarëve të kësaj ndërmarrje ka potencuar edhe problemet të cilat i ka trashëguar kjo ndërmarrje, e cila deri vonë ka qenë nën menaxhimin e AKP-së, e që janë një barrë e rëndë për funksionimin e saj në të ardhmen. “Problemi më i madh, i cili e rëndon vazhdimisht ndërmarrjen janë borxhet e mëdha të trashëguara. Më e keqja është që ne deri në këtë fazë nuk kemi arritur t’i zgjidhim këto pengesa të pakapërcyeshme me të hyrat që ka deri më tani ndërmarrja. Shpresojmë shumë që në nivel të Kosovës të bëhet një zgjidhje adekuate për të gjitha ndërmarrjet”, ka thënë Jerliu. Ndryshe, në kuadër të planifikimit të ndërmarrjes parashihen edhe investime kryesisht në infrastrukturë, për avancimin e shërbimeve dhe modernizimin e Stacionit të Autobusëve në Gjilan.



Iniciativa e Hazirit për kultivimin e duhanit, i bënë bashkë institucionet, shoqërinë civile dhe prodhuesit

26
MAJ

Iniciativa e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, për kulturën e duhanit i ka bërë bashkë sot në Gjilan Komisionin për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët në bashkëpunim me organizatën KDI dhe MDA, kanë organizuar tryezën e diskutimit lidhur me “akcizën në produktet e duhanit dhe revitalizimin e industrisë së duhanit në Republikën e Kosovës”, ku morën pjesë edhe shumë fermerë të interesuar për kultivimin e bimës së duhanit.

Kryesuesi i Komisionit për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Bardhyl Meta, ka falënderuar kryetarin Haziri, për të cilin tha se është ideator i kësaj tryeze me qëllim që të riaktivizohet kjo fushë, t’i kthehet nami i industrisë së duhanit, që dikur ishte shumë rentabile si për kultivuesit, industrinë e duhanit dhe vendin në përgjithësi. Ndërsa, kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, theksoi

se ideja e inicimit të kësaj çështjeje ka nisur qysh në vitin e kaluar, pasi tha se familjet në Gjilan e kanë siguruar mirëqenien nga kjo veprimtari. “Ka një vit që është iniciuar procesi, në fazën e parë në tavolinë, që t’i kthehem punës tonë, secili në regjionin e tij, ndërsa sa i përket regjionit të Gjilanit, dua të them se çdo familje prej çdo fshati, vendbanimi dhe lagje të qytetit, është marrë me kultivimin e duhanit, pavarësisht gjendjes ekonomike që e kanë pasur, duke filluar nga bujqit, arsimtarët, profesorët dhe të gjitha profilet”, ka thënë Haziri. Haziri ka përmendur nevojën e domosdoshme të miratimit të ligjit dhe nevojës së përfshirjes në subvencionim të bimës së duhanit, ndërkaq theksoi se kryeministri Mustafa ia ka shprehur gatishmërinë dhe mbështetjen për këtë program. “Lajmi i mirë është vullneti i mirë i deputetëve, grupit punues, gatishmëria e kryeministrit dhe vetë qeverisë dhe pronarit të ri të “Premium Tobacco Group”, bënë që trekëndëshi

të funksionoj në një koordinim, i cili, çon drejt fillimit të adaptimit të legjislacionit, apo ligjit të domosdoshëm, lehtësimeve dhe parashikimeve që duhani si bimë të vendoset në listën e prioriteteve dhe duhet të subvencionohet nga qeveria. Kosova, në këtë fazë të zhvillimit të kulturës së duhanit, nuk mund ta parashohë asnjë lloj akcize”, ka deklaruar Haziri. Haziri tha se dita e sotme, është me e lumtura që prej marrjes së mandatit të kryetarit, duke thënë se ky program i jep mundësinë familjeve gjilanase edhe të punojnë, por edhe të kenë përfitime të shumta. “Komuna e Gjilanit, në planifikimin buxhetor në vjeshtë, do të parashoh subvencione drejtpërdrejt për familjet që janë të interesuara të fillojnë me kultivimin e kulturës së duhanit, në mënyrë që ta rikthejmë kulturën e gjelbër të tokave të Gjilanit dhe Anamoravës. Është ambient që krijon mundësi shumë, duke pasur parasysh kapacitetet e kompanisë për t’i blerë dhe plasuar në treg, janë qartazi indikacione që na bëjnë që të përgatitemi. Tashmë me teknologjinë e re, fermerët e kanë shumë më të lehtë kultivimin e bimës së duhanit”, ka shtuar Haziri. Përkrahje me të gjitha kapacitetet për kultivimin e kulturës së duhanit, ka shprehur sot Jehona Shyti, shefe e kabinetit të ministrit të Bujqësisë. Memli Krasniqi. “Jam këtu për të përcjellë mesazhin e ministrit Krasniqi, i cili është mbështetës i fuqishëm i kësaj iniciative, që së bashku me institucionet relevante, duke filluar me Kuvendin e Kosovës, Ministrinë e Financave, Komunën e Gjilanit dhe me shoqërinë civile e fermerët, që të përfshihemi bashkërisht që të mbështesim një program i cili do të bëjë rivitalizimin e sektorit të prodhimit të duhanit. Ne, që nga

fillimi, kemi qenë kundër akcizës në fletat e duhanit dhe besojmë se do ta kemi përkrahjen e Kuvendit të Kosovës për këtë çështje”, ka thënë Shyti. Nga ana e tij, Gazmend Abrashi, pronar i fabrikës së duhanit në Gjilan “Premium Tabacco Group”, tha se pas privatizimit, kompania e tij ka investuar mbi 7 milionë euro, derisa ka të punësuar mbi 100 persona. Ai ka konfirmuar se fabrika e tij është e gatshme t’i blejë të gjitha prodhimet e fermerëve, pasi tha se kapaciteti i grumbullimit është 6 mijë tonë, derisa ai i paketimit është 3 mijë për një vit. Artan Murati nga KDI, tha se nga pikëpamja e shoqërisë civile, do ta mbështesin secilën nismë të mbarë për zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit, ndërkaq Bardhyl Musa nga MDA, ka prezantuar studimin, i cili përfshinë një historik të ish-fabrikës së duhanit në Gjilan ndër vite, sikurse edhe një krahasim të legjislacionit të akcizës së duhanit me disa shtete të rajonit. Musa tha se nga studimi i MDA-së i përkrahur nga KDI, ka dalë se mbi 10 mijë fermerë vetëm në Gjilan e kanë kultivuar duhanin para viteve 90-ta, të cilët e kanë siguruar mirëqenien e tyre. Në debat kanë dhënë kontributet dhe rekomandimet e tyre edhe përfaqësues nga shoqëria civile, sikurse edhe ish-kultivuesit e duhanit, të cilët treguan përvojat dhe përfitimet e tyre që i kanë pasur para viteve 90-ta. Për fund, kryesuesi i Komisionit për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Bardhyl Meta, tha se puna që do ta bëjnë në vijim është që ta prekin çdo pjesë, qoftë ajo e infrastrukturës ligjore, qoftë e politikave fiskale dhe aspektet tjera të rëndësishme.



Mijëra vullnetarë i bashkohen aksionit “Ta pastrojmë Gjilanin”

24
MAJ

Në Komunën e Gjilanit sot ka filluar aksioni “Ta pastrojmë Gjilanin”, në kuadër të aksionit “Ta pastrojmë Kosovën”, dhe është duke u punuar në eliminimin e shtatë deponive të egra të identifikuara deri më tani. Udhëheqës i aksionit ishte kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga stafi i tij dhe i rrethuar edhe nga nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, përfaqësues të FSK-së, Policisë, OJQ-ve, qytetarë të shumtë.

Me këtë rast, kryetari Haziri, ka thënë se ky aksion “Ta pastrojmë Gjilanin”, po realizohet në kuadër të aksionit “Ta pastrojmë Kosovën” dhe do të bëhet eliminimi i shtatë deponive të egra të identifikuara në lagje dhe fshatra të ndryshme derisa ka apeluar tek të gjithë qytetarët që të kujdesen çdo ditë për ambientin. “Aksioni “Ta pastrojmë Gjilanin”, ka nisur në kuadër të aksionit “Ta pastrojmë Kosovën”, në 24 majin, si datë e shënuar tashmë prej vitesh, që i kushtohet veçanërisht pastërtisë së hapë-

sirave publike. Sot do të pastrohet në fshatin Shillovë e Muhaxherëve, pastaj Livoçi i Ulët, fshati Velekincë, Livoçi i Epërm, lagja “Zabeli”, “Arbëria”, Dardania” dhe disa deponi të vogla në Gjilan, po ashtu do të bëhet edhe pastrami i gjithë qendrës së qytetit. Jemi të mobilizuar si institucione që sot bashkërisht, me mijëra aktivist – vullnetarë, të largojmë disa qindra tonelata mbeturina nga qyteti ynë”, ka thënë Haziri derisa grumbullonte mbeturinat e hedhura vend e pa vend. Ai ka potencuar se Gjilani shënon këtë datë për çdo ditë kalendarike dhe në shikim të pare, Gjilani tashmë është një qytet që ka nivel të lartë të pastërtisë përmes përkushtimit me punë të përditshme, mirëpo, ka ende punë që të kemi një ambient çfarë të gjithë bashkërisht e dëshirojmë. “Apeloj që të angazhohemi secili nga pozita e vet dhe mundësia që ka që përditë të punojmë në pastërti, sikur që gjithnjë të hedhim mbeturinat në vendet e caktuara”, tha ai për fund.



Për tre muaj, mbi 74 mijë vizita në shëndetësinë primare

24
MAJ

Bazuar në planin e punës dhe detyrat ligjore, në shëndetësinë primare përditë e më shumë po përmirësohen kushtet në infrastrukturën shëndetësore, ngritje të cilësisë së shërbimeve dhe monitorim të gjendjes së shëndetit të qytetarëve të Gjilanit në përgjithësi. Për tre muaj janë kryer mbi 74 mijë vizita, ka thënë Fejzulla Berisha, drejtor i QKMF-së, në një konferencë me gazetarë.

Ai ka prezantuar angazhimet, sfidat, sukseset dhe synimet, të cilat i ka elaboruar në detaje, derisa ka folur punën tremujore që është kryer në kujdesin primar shëndetësor. “Për tre muaj, kishim 74 mijë e 523 vizita të pacientëve në shëndetësinë primare. Prej tyre, dominojnë vizitat në mjekësinë familjare, mbi 47 mijë, pastaj prijnë injeksionet me mbi 28 mijë, për të vazhduar me vizitat në Emergjencë që numri i tyre është mbi 10 mijë dhe në sektorë të tjerë si vizita stomatologjike, infuzione, kujdes shtëpiak për pacientë, pastaj trajtime psikologjike diabet etj. Falë projektit të filluar së zbatuari nga bashkëpunimi i Komunës së Gjilanit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe “Caritas Kosova”, është bërë pranimi i një numri të caktuar të punëtorëve shëndetësor, që normalisht janë dhënë më shumë shërbime shëndetësore, ngritje të cilësisë dhe kujdesit shtesë për familjet në nevojë me përfshirjen e gjithë hapësirës, rurale dhe urbane”, potencoi drejtori Berisha. Ai ka falënderuar me këtë rast të gjitha institucionet lokale dhe qendrore si dhe donatorët për mbështetjen për mbështetjen e vazhdueshme si dhe stafin e shëndetit primar, për angazhimin e përhershëm në dhënien e shërbimeve shëndetësore për pacientët. Krahas gjithë këtyre punëve, Berisha ka potencuar vazhdimin e projektit për

kontrollimet sistematike për nxënësit e shkollave fillore, me qëllim të vlerësimit të gjendjes shëndetësore. “Çak i kontrollimeve sistematike janë nxënësit e klasave të para, të pesta dhe të nënta. Në ekipin e shëndetit primar, në këto kontrolle, janë ekipet nga mjekësia familjare dhe stomatologjike. Kështu do të vazhdohet edhe në vitet e ardhshme dhe në bazë të rezultateve do të bëhen edhe orientimi i politikave shëndetësore në kujdesin primar shëndetësor”, ka thënë në prezantimin e këtij projekti, drejtori Berisha. Ai ka thënë se së bashku me mbështetjen e kryetarit Haziri, Ministrisë së Shëndetësisë dhe UNICEF-it, pretendojmë të fillohet edhe projekti tjetër ai për vizitat shtëpiake me theks të përkujdesjes së nënave dhe fëmijëve. Ndërsa në sektorin e investimeve në infrastrukturë dhe furnizim nga lista esenciale, drejtori Berisha ka paraqitur një pjesë të investimeve që janë bërë për këto dy vjet. “Për dy vjet, kemi arritur të investojmë dhe përmirësojmë infrastrukturën në 90 për qind të objekteve shëndetësore, duke bërë kështu renovimin e QKMF-së, QMF-së në lagjen “Dardania”, “Arbëria”, “Ramiz Cërnica”, “28 Nëntori”, “Dheu i Bardhë”, si dhe QMF-të dhe ambulancat në fshatin Malishevë, Uglar, Pograditë, Mireshe, Livoçi Ulët, ndërsa gjatë ditës së sotme ka nisur edhe renovimi i asaj në fshatin Përlepnice, të cilës do ti shtohet edhe një aneks që tu përgjigjet kërkesave të banorëve të këtij fshati”, potencoi ai në këtë rast. Drejtori i QKMF-së në Gjilan tha se sa i përket furnizimit me barëra nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë, Gjilani qëndron më mirë se asnjëherë më parë. “Sot kemi furnizim të kënaqshëm dhe lirisht mund të themi se kemi një furnizim të rregullt dhe të kënaqshëm që në përqindje arrin deri në 80 për qind”, ka potencuar drejtori Berisha.



Shurdhani bëhet me shkollë të re

20
MAJ

Pikërisht në Ditën e Shkollës, është inauguruar sot objekti i ri i shkollës fillore “Bajram Curri” në Shurdhan të Gjilanit, investim ky nga Komisioni European, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga institucionet komunale e qendrore. Në ceremoninë e inaugurimit, në emër të kryetarit Lutfi Haziri, drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Nazmi Musa, ka falënderuar Komisionin European për këtë mbështetje, tha se tash e tutje cilësia e arsimit do të jetë shumë më e lartë.

“Ju uroj këtë ditë të shenjtë të përrimit të këtij tempulli të shenjtë për fëmijët tanë. DKA ka bërë si objektivë kryesore ngritjen e cilësisë në arsim për nxënësit për të trasuar rrugën e tyre të ardhshme me profesione të ndryshme.

Por, të gjitha këto nuk mund të arrihen siç duhet pa infrastrukturën e nevojshme. Tash e tutje, cilësia e arsimit në këtë shkollë do të jetë shumë më e lartë”, ka thënë Musa. Ndërkaq, drejtori i shkollës fillore “Bajram Curri”, Qemajl Ramadani, inaugurimin e shkollës së re e ka vlerësuar si ditë historike për Karadakun e Gjilanit. “Kjo është një ditë historike e cila do të shkruhet me shkronja të arta, jo vetëm në faqen më të re të historisë së shkollës sonë, por edhe të Karadakut”, ka thënë Ramadani. Në fund, nxënësit e kësaj shkolle kanë shfaqur një program të pasur kulturor-artistik. Përndryshe, ndërtimi i objektit modern të shkollës fillore “Bajram Curri” në Shurdhan ka kushtuar mbi 400 mijë euro, ndërkaq tokën e ka ndarë Komuna e Gjilanit.



Gjilani, shembull i mirë i angazhimit për integritet

20
MAJ

Me mbështetjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, nën organizimin Zyrës për Integritet Evropian dhe Qendrës Kosovare për Diplomaci, sot është mbajtur në Gjilan konferenca “Roli i MSA-së dhe liberalizimi i vizave në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës”, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të ndryshëm të institucioneve qeverisëse në nivelin lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues nga niveli akademik i Universitetit “Kadri Zeka”, përfaqësues të Policisë së Kosovës etj., të cilët këtë hap e kanë konsideruar mundësi të madhe për shtetin e Kosovës drejtë integritetit dhe zhvillimit.

Me këtë rast, në emër të kryetarit të Komunës së Gjilanit hapjen e kësaj konference e ka bërë këshilltari i kryetarit për investime të jashtme, Faton Bislimi, i cili ka potencuar se Gjilani është model dhe shembull i mirë në të gjitha aktivitetet se si duhet të orientohej angazhimi drejt integritetit. “Organizime të tilla, konferenca të këtij niveli dhe debate të ndryshme janë ndihmuese dhe të domosdoshme në këtë proces por edhe në të ardhmen e integritetit të mëtutjeshme. Gjilani është dhe po merret shembull i mirë në shumë aspekte si në atë të bashkëpunimit dhe tolerancës në mes të komuniteteve të ndryshme etnike që jetojnë në Gjilan, tolerancës fetare, nivelin e lartë të sigurisë publike, arsimit bazik dhe atij universitar, e deri edhe tek angazhimi maksimal për zhvillim dhe integritet të plotë në BE. MSA, dhe liberalizimi i vizave është një derë e madhe e cila qytetarit të Kosovës, pos lëvizjes së lirë, do t’i siguroj edhe zhvillim ekonomik, hapje të tregut me botën, rritje të cilësisë në të gjitha fushat e zhvillimit dhe kështu në vitet e ardhshme shteti i Kosovës do të ketë të njëjtin nivel të ecjes përpara në aspektin politik, ekonomik por edhe aspekte të tjera, sikur

edhe vendet tjera të rajonit dhe më gjerë”, ka potencuar ai në fjalën e tij. Ndërsa Burim Elezi, zyrtar për Integritet Evropian, ka thënë se për dy vjet me radhë “Java e Evropës” po organizohet në Gjilan, falë mbështetjes së fuqishme të kryetarit Haziri. “Për këto dy vjet me radhë, falë mbështetjes së kryetarit të Komunës çdo herë është organizuar Java e Evropës, gjithnjë me pretendimin e përgatitjeve më të mëdha për integritet në BE. MSA dhe liberalizimi i vizave është një rrugë e fuqishme që do t’i hapë rrugën e vërtetë të gjithë qytetarëve të Kosovës që të jenë vërtetë në Evropë në të gjitha fushat, duke nisur nga aspekti politik, ekonomik, shoqëror dhe kulturor”, potencoi Elezi. Kurse Dukagjin Leka, prorektor në Universitetin “Kadri Zeka”, ka thënë se përfitimi i shtetit të Kosovës me MSA-në dhe liberalizimin e vizave është i shumanshëm, por me theks të veçantë, ai ka potencuar ndihmën që do ta marrë Kosova në aspektin politik, duke qenë e barabartë me vendet e rajonit në rrugën e integritetit, pastaj në aspektin juridik, duke përgatitur infrastrukturën ligjore në kuadër të kriterëve të kërkuara nga BE. Ndërsa, profesori universitar, Flamur Hyseni, ka thënë se gjendja e Kosovës në aspektin e mirëqenies do të stabilizohet gjatë të ardhmes përmes mundësive më të mëdha edhe pse është një rrugë e gjatë, sipas tij, me shumë sfida dhe përfitime të mëdha politike dhe ekonomike. Ndërsa dekani i shkencave kompjuterike, Xhevdet Thaçi, ka thënë se shteti i Kosovës i krijuar zyrtarisht në vitin 2008, ka bërë lëvizje jashtëzakonisht të mëdha dhe me hapa të shpejtë. Gjithashtu, në shoqërinë tone, sipas tij, pas liberalizimit do të ndodhë edhe kultivimi i kulturës evropiane këtu, duke përfshirë dominimin e formalitetit nga informaliteti, etj. Në këtë konferencë kanë kontribuar edhe drejtori i shëndetësisë, Nexhat Hajrullahu, profesori Ismet Azizi dhe të tjerë.

Bunjaku-Rexhepi: Gjilani qendër e kulturës falë përkushtimit të qeverisjes Haziri

20
MAJ

Nën organizimin e shkollës “Musa Zajmi” nga Gjilani, është mbajtur sot Festivali i katërt i Dramës në gjuhën angleze, në të cilin kanë marrë pjesë edhe nxënësit e shkollës fillore “Mazllum Këpuska” nga Komuna e Gjakovës dhe e shkollës fillore “Nënë Tereza” nga Komuna Rrëshen nga Shqipëria.

Me këtë rast, në emër të kryetarit të Komunës së Gjilanit, të pranishmit në këtë shfaqje i ka përshëndetur kryesuesja e Kuvendit të Komunës, Valentina Bunjaku-Rexhepi, e cila ka thënë se Gjilani po dëshmohet edhe nga nxënësit se është kryeqendër e kulturës. “Se Gjilani është kryeqendër e kulturës, kjo tashmë është dëshmuar disa herë, përmes organizimeve të shumta

kulturore, e konkretisht shfaqjeve teatrale. Sot jemi ata që do të përcjellim dramën e përgatitur në gjuhën angleze nga nxënësit e tri shkollave, Gjilanit, Gjakova dhe Shqipëria. Kryetari Haziri me përkushtimin e veçantë që ka ndaj prioritetit të parë të qeverisjes – arsimin, po dëshmohet edhe me rezultate konkrete. Sot këta nxënës kanë treguar për shpirtin e tyre artistik dhe entuziazmin e madh që të dëshmohen me punë e suksese të arritura në mësim”, ka thënë ajo, ndër të tjerash. Ndryshe, në Gjilan kohë pas kohe me paraqitje të ndryshme, nxënësit e shkollave të ndryshme, disa herë kanë treguar se themelet bazë të punës dhe përkushtimit, i kanë të palëkundura, drejtë sukseseve si brenda ashtu edhe jashtë vendit në disa fusha.

Haziri priti kryetarin e shoqatës “Miq të Amerikës”, Agim Rexhepi

19
MAJ

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot në takim kryetarin e shoqatës “Miq të Amerikës”, Agim Rexhepi. Ai e ka informuar kryetarin Haziri për aktivitetet e kësaj shoqate, ndërkaj janë dakorduar që më 11 shtator 2016, në Gjilan të mbahet manifestimi qendror me rastin e 15-vjetorit të sulmeve terroriste në kullat binjake. Manifestimi do të mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës.



Nga ana e tij, kryetari Haziri e ka falënderuar z. Rexhepi për vizitën, ndërkaj ka shprehur gatishmërinë që ta nënshkruaj edhe memorandumit e mirëkuptimit gjatë javëve në vijim me këtë shoqatë, përkritazi me shënimin e 15-vjetorit të sulmeve në kullat binjake.



Gjilani shënon 17 vjetorin e rënies së dëshmorit Abdullah Tahiri

19
MAJ

Me Homazhe në kompleksin e varrezave të dëshmorëve, në Gjilan dhe me nderim para përmendores në fshatin Malishevë, është shënuar sot Dita e Shkollës fillore “Abdullah Tahiri” në Malishevë, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues të shumtë të qeverisjes lokale, të kryesuar nga kryesuesja Bunjaku-Rexhepi, nënkryetari Rexhep Kadriu, drejtori i Arsimit Nazmi Musa, deputet të Parlamentit të Kosovës nga Gjilani dhe qytetarë të shumtë.

Me këtë rast kryesuesja e Kuvendit të Komunës, Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se heronjtë janë themeli i shtetit të Kosovës, dhe janë ata të cilët sot na bëjnë të jemi krenar dhe më të vendosur për zhvillimin e vendit. “Heronjtë janë themeli dhe meritoret kryesor të lirisë së Kosovës. Ne jemi ata të cilët duhet dhe do të përulemi përherë para veprës së heronjve, dëshmorëve dhe të rënëve në luftën për liri. Ata dhanë jetën që ne të frymojmë lirshëm me interes të zhvillimit të vendit. Veçanërisht përkushtimi i kësaj shkolle duhet të jetë në pretendimet e një shkolle model dhe të zhvilluar, sepse Abdullah dhe shumë dëshmorë të lirisë ranë që ne të gjallët sot të jetojmë dhe kemi të hapura të gjitha rrugët krahas shteteve më demokratike”, ka thënë ndër të tjerash Bunjaku-Rexhepi. Ajo më tej ka potencuar se u takon nxënësve dhe mësimitdhënësve që kjo shkollë të jetë iden-

titet i lartë i Malishevës, Gjilanit dhe Kosovës. Ndërsa drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Nazmi Musa, në shënimin e kësaj dite ka thënë se kjo datë është një nderim që të gjithë ne i bëjmë veprës e dëshmorit të kësaj ane. “Sot nderojmë dëshmorin “Abdullah Tahiri”, nderojmë veprën e tij për lirinë dhe ndërtim të vendit. Ne sot krenohemi me sukseset e shkollës dhe ecjen drejtë synimeve të arsimit në Kosovë. Abdullahu ka dhënë jetën që ne sot të jetojmë të lirë, të zhvillohemi dhe të jemi pjesë e proceseve në ndërtimin e vendit. Duhet të punojmë edhe më shumë që ideali i të rënëve për liri të jetë shtet në praktikë. Jemi të përkushtuar që krahas punës sonë të nderojmë edhe të rënë për liri”, ka thënë ndër të tjerash drejtori Musa. Ndërsa, drejtori i shkollës fillore “Abdullah Tahiri” Rashit Sahiti, ka thënë se 19 maji është ditë e rëndësishme sepse shënon rënien e heroit tonë, i cili ka rënë për të mos vdekur kurrë. “Dita e shkollës sonë është ditë e krenarisë sepse mbanë emrin e dëshmorit Abdullah Tahiri. Po zhvillohemi përditë e më shumë në aspektin e infrastrukturës shkollore por edhe në aspektin e suksesve të nxënësve dhe shkollës në përgjithësi”, ka thënë ai ndër të tjerash. Ndryshe, shënimi i Ditës së Shkollës “Abdullah Tahiri”, është përcjellur edhe më një program të pasur kulturor-artistik, të përgatitur nga nxënësit e kësaj shkolle.

Bashkatdhetarët nga Zvicra, donacion për meremetimin e shtëpisë muze të Zija Shemsiut



18
MAJ

Një grup bashkatdhetarësh nga Gjilani që jetojnë dhe veprojnë në Bern të Zvicrës, kanë grumbulluar një donacion prej 2610 frangash zvicerane për renovimin e shtëpisë muze të heroit Zija Shemsiu. Gjatë ditës, kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ka pritur në takim prijësin e kësaj iniciative, Nazmi Hazirin, të cilin e ka falënderuar për kontributin e tyre për meremetimin e shtëpisë muze për këtë kolos të kombit.

“Ju shpreh falënderimin dhe mirënjohjen time për kontributin tuaj dhe të bashkatdhetarëve nga Gjilani që kanë mbledhur këto mjete për meremetimin e shtëpisë muze të Zija Shemsiut, i cili u kryengrit dhe bëri që jehona e madhe e rezistencës së tij, jo vetëm në Gjilan e Anamoravë, por në

mbarë Kosovën, të merret si shembull i veprimtarit të madh i cili kryengritjen e çon deri në fund”, ka thënë me këtë rast kryetari Haziri. Nga ana e tij, prijësi i kësaj iniciative, Nazmi Haziri, pasi falënderoi kryetarin Haziri për pritjen, tha se kjo është më e pakta që mund ta bëjnë ata, karshi kontributit të jashtëzakonshëm për lirinë e shqiptarëve të heroit Zija Shemsiu. Kreu i Gjilanit menjëherë ka formuar një komisionin në përbërje, Rexhep Kadriu, Nazmi Haziri dhe Shaban Shemsiu, të cilët do ta mbikëqyrin deri në finalizim meremetimin e shtëpisë së heroit nga Përlepnica e Gjilanit. Ndryshe, pos Nazmi Hazirit, iniciatorë të këtij aksioni janë edhe Refik Mehmeti, Arif Osmani, Kadrush Tali, Mark Prenkaj dhe Hajdar Sadrija.

Kqiku: Ky është viti më i suksesshëm i Gjilanit sa i përket investimeve



19
MAJ

“Ky është viti më i suksesshëm në Gjilan që nga paslufta, meqë po ndodhin investime milionëshe, kryesisht në ndërtim të infrastrukturës”, ka thënë drejtori i Departamentit të Prokurimit në Gjilan, Salih Kqiku, në një konferencë për media. Duke paraqitur të arriturat dhe sfidat e 3-mujorit të punës, Kqiku ka thënë se të gjitha aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar bazuar në planifikimin final të prokurimit, duke respektuar hapat sipas udhëzuesit operativ për prokurim publik.

“Në periudhën janar-mars 2016 janë udhëhequr 30 aktivitete të prokurimit, të cilat edhe janë publikuar në web faqe të KRPP-së dhe të Komunës, edhe atë 19 janë me procedurë të hapur, 6 ftesa për kuotim, me vlera minimale 3, ankande publike 1 dhe një konkurs projektimi”, ka thënë Kqiku. Ai ka përmendur se për tri aktivitete e prokurimit (“Ndërtimi i Çerdhes në lagjen “Dardania”, “Furnizim me IT për të gjitha njësitë shpenzuese në regjionin e Gjilanit” dhe “Ndërtimi i shtëpive për raste sociale”) nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit janë kthyer përgjigje në favor të autoritetit kontraktues, ndërsa ka shtuar se rasti i aktivitetit të prokurimit “Sinjalizimi vertikal dhe horizontal” është në shqyrtim. Kqiku tha se është bërë edhe menaxhimi financiar i projekteve të realizuara në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastruktursë, dhe Ministrinë e Pushtetit Lokal, duke përgatitur raportet mbi gjendjen dhe rrjedhjen e projekteve, përfshirë anën financiare dhe anën ekzekutive të projekteve. “Gjatë kësaj periudhe, pasi kemi kryer aktivitetet e prokurimit, po implementohen projektet infrastrukturore në qytet dhe gati të gjitha fshatrat e Komunës se

Gjilanit si në: Bresalc, Cernicë, Dobërqqan, Muhaxhirët e Doberqqanit, Përlepnicë, Shilovë, trotuari në Velekincë etj. Ndërsa, gjatë këtij muaji është shpallur asfaltimi rrugëve në Capar, Malishevë e Epërme, Malishevë e Ulët, Pogradjë, lagja Arbëria, lagja e Vishnjeve, Përlepnicë, Velekincë dhe disa rrugë të qytetit”, është shprehur Kqiku. Në adresimin para gazetarëve, drejtori i Prokurimit në Gjilan përmendi se po vazhdon ndërtimi i rrugës me katër krosi Gjilan-Bujanoc, derisa ka konfirmuar se Ministria e Infrastruktursë ka shpallur tenderin për ndërtimin e hyrje-daljes Gjilan-Prishtinë dhe Gjilan-Kllokot. “Këto investime që po ndodhin në Gjilan, janë rezultat i punës dhe vizionit të kryetarit Haziri, të cilin e falënderoj shumë për mbështetjen e madhe që na ka dhënë”, përfundoi Kqiku.

Zuzaku: Afro 200 biznese i kemi mbështetur për tre muaj



18
MAJ

“Mbështetja e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, me aktivitete të cilat kanë ndikuar në rritje të zhvillimit ekonomik lokal në Gjilan, po arrihet përmes përkrahjes në drejtim të bizneseve të vogla dhe të mesme, duke i përgatitur që të jenë konkurrent në përfitimin e granteve, programeve dhe projekteve të ndryshme të cilat vijnë në Kosovë përmes partnerëve të shumtë që ka Gjilani me organizata të ndryshme qeveritare të shteteve mike.

Kështu është shprehur në një konferencë për media, drejtori i Zhvillimit Ekonomik në Gjilan, Agim Zuzaku, i cili tha se Gjilani tashmë është identifikuar si mbështetës i fuqishëm i bizneseve të vogla dhe të mesme, duke qenë emërues i përbashkët për zhvillim ekonomik lokal duke mbështetur afro 200 biznese për tre muaj të këtij viti.

Zuzaku me këtë rast ka përmendur disa nga projektet kryesore që kanë të bëjnë me grante për bizneset e vogla dhe të mesme e të cilat praktikisht janë gjenerator për zhvillimin bizneseve. “Bizneset e vogla dhe ato të mesme me mbështetje përmes granteve, apo programeve të ndryshme e stabilizojnë veten dhe menjëherë krijojnë mundësi punësimi. Kështu me organizatën gjermane “Help”, në bashkëfinancim edhe nga Qeveria Gjermane, Qeveria e Kosovës dhe Komuna e Gjilanit, implementohet “Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të mikro-bizneseve në Kosovë”. Planifikohet të shpërndahen rreth 40 grante, duke ofruar pajisje në vlerë prej 2 mijë euro, shumë kjo e cila përfshinë edhe investimin nga përfituesit prej 15 për qind”, ka thënë drejtori ai. Zuzaku e ka vlerësuar tejet të rëndësishëm edhe mbështetjen e BE-së përmes projektit “Valorizimi i tregtisë tradicionale dhe potenciali socio – ekonomik”, duke bërë që me grantet prej 2 mijë euro, duke përfituar 28 zeztarë, gjë që ka dhënë një stabilitet të këtyre zejeve për Gjilanin. Drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Agim Zuzaku, ka potencuar edhe zhvillimin e agrobiznesit përmes mbështetjes dhe përkrahjes së madhe të organizatës CARE dhe ATRC, duke bërë kështu që të bizneset nga fusha e tillë të takohen dhe të krijojnë ura lidhëse mes vete, për zhvillim të qëndrueshëm edhe ndërkomunal. “Përmes Organizatës CARE dhe ATRC, kemi arritur që t’i mbledhim në një takim të përbashkët bizneset agrare të regjionit të Gjilanit, me qëllim të lidhjeve të reja për zhvillim. Në kuadër të këtij projekti janë angazhuar 100 praktikantë me pagesë për 3 muaj në sektorin privat, duke ju dhënë një mundësi e madhe të rinjve për t’u aftësuar për punë, mirëpo përfituese në këtë rast ishin edhe bizneset me numër të punëtorëve për nevojat zhvillimit të biznesit”, pohoi ai.

Inkubatori i biznesit është në shërbim të vërtetë të bizneseve

Drejtori i DZHE-së së Gjilanit tha se me aprovimin e kryetarit të Komunës së Gjilanit, do të bëhet renovimi i objektit të inkubatorit të biznesit dhe krijimit të kushteve më të mira për bizneset e reja të cilat fitojnë të drejtën për përfitim të shfrytëzimit të zyrave. Zuzaku, po ashtu, ka thënë se Drejtoria për Zhvillim Ekonomik është duke bashkëpunuar ngushtë edhe me Organizatën Qeveritare Gjermane Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – GIZ, në Hartimin e Planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave, dhe pas përfundimit të pilot projektit të parë do të vazhdojmë me pilot projektin e dytë atë të përfshirjes së të gjitha shkollave të Komunës së Gjilanit në menaxhimin e mbeturinave dhe ndarjen e

tyre. Ndërsa, nga ana tjetër në këtë fazë ka vazhduar projekti për eficientësi e energjisë në ndërtesat publike, përmes KfW-së (Bankën Gjermane për Zhvillim). Edhe në Qendrën për Regjistrimin e Bizneseve (QRB) në Gjilan gjatë periudhës janar – mars 2016, i pari i DZHE-së në Gjilan tha se ka rritje për 48 për qind të numrit të bizneseve të reja të regjistruara dhe 6 biznese më pak të shuara se sa në periudhën e njëjtë e vitit 2015. Zuzaku, po ashtu, ka thënë se edhe sektori i inspeksionit gjatë periudhës janar – mars 2016 ka inspektuar bizneset që nuk janë të regjistruara, po ashtu ka njoftuar komunitetin e biznesit për rregulloret komunale (orari i punës) dhe (taksa komunale). “Gjithashtu tani janë duke marrë pjesë në aksionin për deklaracionet e mallit për bizneset të cilat kanë mall pa deklaracion”, tha ai. Hapat e ardhshëm të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik janë angazhimi i konsulencës për implementimin e projektit, përfshirë analizimin e projekteve të identifikuar si dhe identifikimin e projekteve shtesë që do të përfshihen në program, trajnimin e stafit të komunave për operimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe monitorimin e implementimit të punëve ndërtimore në objekte. Në fund, drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Agim Zuzaku, ka apeluar tek bizneset që ta shfrytëzojnë “Skemën e granteve për zhvillimin e sektorit privat”, program i financuar nga BE, përmes Asociacionit të Agjencive për Zhvillim Rajonal, sepse afati për aplikim është 25 maj 2016, dhe qëllimi është mbështetja e bizneseve të qëndrueshme për gjenerim të vendeve të punës.



Korça: Për herë të parë Gjilani nis me mirëmbajtjen verore të rrugëve në prill

17
MAJ

Aktivitetet e shumta, projektet e ndryshme dhe gatishmëria 24 orë në shërbim të qytetarëve, janë vetëm disa nga nënvizimet e drejtorit të Shërbimeve Publike, Naser Korça, në konferencën për

media, ku ai paraqiti punën e periudhës janar-mars 2016, karshi edhe shumë projekteve kapitale dhe zhvillimore në Komunën e Gjilanit. Korça tha se mirëmbajtja dimërore e rrugëve është realizuar në gjithë territorin e Gjilanit, pa vonesa, përfshirë edhe fshatrat, sikurse edhe pastrimi dhe mirëmbajtja e shesheve, parqeve dhe trotuareve.

“Kjo periudhë e vitit përherë është e ndjeshme me reshjet që ndodhin në këtë kohë. Falë intervenimit tonë në pastrimin e lumenjve dhe investimin e Komunës edhe në rrjetin e kanalizimit, këtë vit kemi rënie të dukshme të problemeve sa i përket kësaj natyre. Është bërë pastrimi i lumenjve, hapja e kanaleve, zhblllokimi i tyre në disa zona, këtë vit nuk kemi fare problem në këto pjesë sepse puna e bërë me kujdes dhe përkushtim ka bërë të mundur që problemet e vërshimeve në këtë pjesë t’i mbeten vetëm të kaluarës”, ka thënë drejtori Naser Korça. Ai ka potencuar se pastrimi i lumenjve është vazhduar edhe këtë vit, krahas edhe mirëmbajtjes dhe intervenimit na parqe dhe hapësira të gjelbëruara, mbjellje të luleve, kujdesit të veçantë të hapësirave të tjera publike në pjesë të ndryshme të qytetit etj. Drejtori i Shërbimeve Publike ka theksuar se për herë të parë pas shumë vitesh, këtë vit në Gjilan mirëmbajtja verore ka nisur me kohë dhe shumë shpejt do të bëhet mbyllja e gropave dhe rregullimi i tërësishëm rrugës Gjilan – Pogradë dhe rrugëve të tjera. “Rruga e degraduar jashtëzakonisht shumë në drejtim të fshatit Pogradë do të asfaltohet tërësisht, sepse gjendja në të cilën është ajo tani ka kërkuar intervenim të tillë”, ka pohuar Korça. Ai ka përmendur një sërë projektesh të cilat janë në realizim e sipër. “Projektet të cilat janë në realizim e sipër është projekti i hyrje-daljes së rrugës në drejtim të Bujanocit, rrugës në fshatin Shillovë, rrugës në fshatin Mireshe i Vogël, Bresalc, Livoç i Epërm, Cërnicë, pastaj rregullimi i kanalizimit në çerdhen “Ardhmëria I”, investimeve në shkollën “Selami Hallaqi”, ka precizuar drejtori i Shërbimeve Publike. Gjithashtu, drejtori Korça ka bërë të ditur edhe gatishmërinë që ka kjo Drejtori, respektivisht inspektorët e saj, në ilegalitetit të operimit të taksistëve në këtë qytet. “Përfundimisht nuk ka lehtësim për informalitetin, sepse rendi dhe ligji është i njëjtë për të gjithë dhe obligim për të gjithë”, tha ai. Ndryshe, gjatë këtyre ditëve është bërë edhe pastrimi i deponive të egra që janë krijuar prej vitesh në lagjen “Avdullah Presheva”.



Gagica: Gjilani, model edhe për rajonin për shërbimet në administratë

13
MAJ

Rritja e efikasitetit të shërbimeve, ulja e shpenzimeve, eliminimi i tollove para sporteve, përkushtimi për hapa të tjerë në digjitalizim të shërbimeve, por edhe përgatitja për implementimin e projektit tjetër në Gjilan, atë të “Gjilan Smart City”, ose ‘Gjilani i mençur’, ishin ato që u prezantuan në konferencën me gazetarë nga drejtori i Administratës së Përgjithshme në Gjilan, Nazim Gagica.

Gagica me këtë rast ka thënë se ky tremujor paraqet përmbylljen dhe përmbylljen e të gjitha kriterëve të parapara nga MAPL, për krijim të një administrate moderne. “Gjatë periudhës janar – mars 2016, në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, është arritur që të bëhet përmbyllja dhe përmbyllja e të gjitha kriterëve të parapara nga MAPL, për krijimin e një administrate moderne dhe një rritje të dukshme të cilësisë së shërbimeve përmes avantazheve të teknologjisë informative. Projekti dhe kriteri i fundit i arritur ishte ai për E-kiosqet, që ka nisur dhënien e shërbimeve gjatë muajit janar 2016, që është ndër projektet më avancuese në sektorin e Gjendjes Civile të Komunës së Gjilanit. Thjeshtë në resorin e Administratës Publike, ndryshimet që janë bërë për 2 vjet, nuk kanë ndodhur gjatë gjithë periudhës së pasluftës”, ka thënë Gagica në fjalën e tij. “Komunat e Kosovës, e kanë model Gjilanin sa i përket modernizimit të administratës dhe shërbimeve në Gjilan. Por, kjo nuk mbetet me kaq. Ne kemi pranuar kërkesa edhe nga komuna të ndryshme të cilat janë të interesuara për teknologjinë e përdorur në E-kiosqet dhe funksionimin e tyre. Njëra prej tyre është Komuna e Shkupit e cila kërkon specifikacionet se si punohet dhe si të arrihet në këtë shkallë. Pra Gjilani është model edhe për shtetet e rajonit”, ka spikatur ai gjatë elaborimit të punës tremujore të kësaj Drejtorie. Gjithashtu, ai ka prezantuar edhe projektin tjetër për sektorin tjetër, atë të “Gjilan Smart City”, ose ‘Gjilani

i mençur’, që parasheh digjitalizimin dhe sistemin online të Qendrës për Shërbim të Qytetarëve, e cila do të mundësojë që qytetari të komunikoj drejtpërdrejtë me zyrtarin për informacione të ndryshme në të gjithë resorët e Komunës së Gjilanit. Drejtori i Administratës Gagica, ka thënë se falë angazhimit maksimal të stafit të kësaj Drejtorie, falë programit “Apliko Online” dhe projektit të E-kiosqeve, është arritur që brenda një dite të jepen mbi 950 dokumente të Gjendjes Civile. Ai theksoi se në aspektin e shpenzimeve brenda përgjegjësisë së këtij dikasteri të qeverisjes komunale, është arritur edhe ulja e shpenzimeve përditë e më shumë edhe në sektorin e autoparkut. “Tashmë krahasimet nuk i bëjmë me të kaluarën, por, krahasime jashtëzakonisht të mëdha sot kemi edhe në autoparkun, apo shfrytëzimin e veturave zyrtare të Komunës së Gjilanit. Kështu, nëse krahasohet periudha e njëjtë me vitin e kaluar, del që këtë vit kemi 2936 kilometra më pak, në krahasim me vitin paraprak dhe periudhën e njëjtë kohore, që gjithashtu prek edhe në ulje të shpenzimeve në derivate dhe financa”, ka pohuar, ndër të tjerash në këtë konferencë për media, drejtori i drejtorisë së Administratës Publike në Gjilan, Nazim Gagica.



Kadriu: Në Gjilan ka rënie të rasteve të zjarreve

12 MAJ Tremujori i parë i këtij viti karakterizohet me aktivitete të ngjeshura dhe angazhim të vazhdueshëm në dy fushat kryesore të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Gjilan - parandalim dhe përballje në terren me gjendjen e krijuar nga të reshurat e shumta, ka thënë në një konferencë me gazetarë, drejtori i kësaj Drejtorie, Ensar Kadriu. Shërbimi i Zjarrfikësve ka nevojë për rritje të numrit të zjarrfikësve.

Kadriu tha se falë mbështetjes së kryetarit Haziri dhe bashkëpunimit me policinë, FSK-në dhe “Hidromorava”, kanë arritur që të jenë në gjendje gatishmërie për t’u dalë në ndihmë qytetarëve.

“Falë bashkëpunimit shumë të mirë që kemi me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, me Policinë e Kosovës, me Forcën e Sigurisë së Kosovës, me KRU “Hidromorava”, por edhe me institucione të tjera lokale jemi vazhdimisht në gjendje gatishmërie. Problemet më të mëdha në këtë kohë janë ato të reshjeve të mëdha të shiut, mirëpo këtë vit falë pastrimit të lumenjve gjatë vitit të kaluar, këto probleme ishin shumë më të vogla dhe presim që këtë vit ato të jenë gjithnjë në rënie kur kemi parasysh planifikimin për intervenim edhe në lumenjtë tjerë në qytet dhe fshatra”, ka thënë drejtori Kadriu. Po ashtu, drejtori i Mbrojtjes dhe Shpëtimit, ka vënë theksin edhe në uljen e rasteve të zjarrit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, por ka theksuar se ka ende numër të vogël të stafit të zjarrfikësve. “Elemente pozitive karshi rënies së problemeve në vërshime, në këtë periudhë kemi edhe numrin më të vogël të zjarreve, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Problem dhe brengë jo vetëm e Drejtorisë sonë, por edhe e qeverisjes komunale, është ende numri i vogël i zjarrfikësve dhe pamundësia ligjore për ta shtuar numrin, karshi territorit dhe popullsisë që është në zonën e intervenimit të zjarrfikësve të Gjilanit. Vazhdimisht jemi duke kërkuar nga niveli qeveritar, që ta lejoj rritjen e numrit të zjarrfikësve, sepse në periudhë të ndryshme ka nevojë për staf shtesë. Sot kemi 33 zjarrfikës, ndërsa numri i tyre përpjesëtohet me hapësirën që mbulojmë, dhe me numrin e popullsisë brenda kësaj hapësire, do të duhej se paku të jenë 60 zjarrfikës”, ka potencuar Kadriu, gjatë kësaj paraqitje para gazetarëve. Por, ai ka thënë se edhe me këtë staf që është për momentin, puna dhe intervenimi, gjithnjë janë bërë në kohën më të shpejtë të mundshme dhe me profesionalizëm të lartë. Objektivi i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, për muajt në vijim, janë aktivitetet me nxënësit e shkollave lidhur me përballjen e pasojave nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore, vlerësimi i vazhdueshëm i mundësive të rrezeve, organizimi i trajnimeve me këshillat e fshatrave, përgatitja e ushtrimit fushor me FSK-në për të vlerësuar gatishmërinë tonë për ‘aktivizimin e planit kontingjent për përballim të fluksit të mundshëm të refugjatëve’, ngritjen e kapaciteteve për parandalim të zjarreve fushore gjatë muajve të verës etj. Drejtori Ensar Kadriu, ka apeluar tek të gjithë qytetarët e Komunës së Gjilanit që ta kenë kujdesin e shtuar gjatë muajve të verës, në mënyrë që të merren masat adekuate për parandalim të përhapjes së zjarreve. Ndryshe kjo Drejtori, tashmë ka hartuar Planin e Reagimit Emergjent, i cili, është miratuar edhe nga Kuvendi i Komunës, plan ky i cili do ta rris efikasitetin e punës në masë të madhe.



Hajrullahu: Së shpejti nis ndërtimi i objektit të ri të QKMF-së

11
MAJ

Në një konferencë me gazetarë, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gjilan, Nexhat Hajrullahu, i cili shoqërohej nga dy drejtorët e tjerë, ai i QKMF-së, Fejzullah Berisha dhe Mursel Zymberi nga QPS-ja, në mënyrë telegrafike ka prezantuar zhvillimet në tremujorin e parë të punës në këtë sektor, duke përmbledhur të arriturat dhe sfidat që kanë për çdo ditë pune.

Në konferencë u tha se shërbimet shëndetësore, asistencë sociale, përkujdesja e mirëqenies në përgjithësi si dhe aktiviteti i solidaritetit për familjet pa kulm mbi kokë, janë pjesë e përditshme e punëve të kësaj Drejtorie, karshi edhe shumë projekteve dhe përgjegjësi të tjera që ka kjo fushë në qeverisjen komunale të Gjilanit, deri edhe tek përgatitjet që kanë të bëjnë me fillimin e ndërtimit të objektit të ri dhe modern të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Me këtë rast drejtori Hajrullahu, ka thënë se shërbimet shëndetësore dhe ato sociale janë duke u ofruar maksimalisht nga resori i shëndetësisë në qeverisjen komunale. “Pos vllgut të madh të punëve në resor të ndryshëm brenda kësaj Drejtorie, ne mbështesim me subvencione edhe HANDIKOS-in, shoqatën e shurdh memecëve, Shoqatën e të Verbërve, shoqatën ‘Anamorava’, OJQ “Pema”, Strehimoren “Liria”, pastaj familjet e strehuara të cilave Komuna u paguan qiranë mujore, por gjithashtu në raste të veçanta subvencionohen edhe raste të tjera në kategorinë e barërave, mjekimit dhe asistencës tjetër”, ka thënë Hajrullahu. Drejtori Hajrullahu, po ashtu, bëri të ditur se në periudhën janar-mars 2016, nga buxheti i DSHMS-së, janë ndarë subvencione në vlerë prej 42 mijë e 868 euro, ndërsa nga fondi i veçantë janë paguar qiratë mujore për familjet pa kulm mbi kokë, në vlerë prej 29 mijë e 300 euro. Ndërsa në shëndetësinë primare shërbimet shëndetësore vazhdojnë të jepen për çdo ditë dhe sipas drejtori të QKMF-së, Fejzulla Berisha,

vetëm në tremujorin e parë ka pasur gjithsej 74 mijë e 523 vizita, prej të cilave 10 mijë e 154 prej tyre ose 13.62 për qind kanë qenë referime. “Falë projektit të përbashkët me Caritas-in dhe me Ministrinë e Shëndetësisë, kemi arritur që të mbulojmë terrenin e Komunës së Gjilanit në shkallë maksimale, duke bërë që edhe shërbimet të përmirësohen shumëfish më shumë. Po ashtu shumë shpejtë presim që të nis edhe ndërtimi i objektit të ri dhe modern të QKMF-së, projekt që është në fazën e para-kualifikimit”, tha Berisha. “Kurse sa i përket furnizimi me barëra nga lista esenciale, asnjëherë nuk ka qenë më mirë se sa në këtë vit dhe presim që kështu të vazhdohet edhe më tutje, në një bashkëpunim shumë të mirë me Ministrinë e Shëndetësisë, sepse kjo është një mbështetje e madhe për pacientët të cilët vizitojnë shëndetësinë primare”, është shprehur Berisha. Drejtori Berisha, po ashtu, ka përmendur edhe projektin tjetër me shumë rëndësi, atë të kontroleve sistematike në nxënësve nëpër shkolla, si dhe organizimet e trajnimeve të ndryshme në fushën e shëndetësisë, duke vënë theksin edhe në angazhimet që janë duke u bërë në vizitat shtëpiake me theks për përkujdesje për nënat dhe fëmijët. Ndërsa në sektorin e Qendrës për Punë Sociale, informatën e ka dhënë drejtori, Mursel Zymberi, i cili ka thënë se ende problemet sociale, respektivisht gjendja ekonomike dhe sociale në Kosovë, është problematikë e madhe sikur që edhe Gjilani përballët me këtë kategori. “Numri i familjeve të cilat janë përfitues të skemës sociale në Gjilan është 1100 familje, por ka edhe një numër tjetër mjaft të madh që është në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, megjithëse ka mbështetje të madhe në forma të ndryshme nga ana e Komunës së Gjilanit dhe donatorëve të tjerë. Po ashtu. kemi edhe rastet tjera që kërkojnë energji dhe përkushtim shumë të madh siç janë rastet e dhunës në familje, konflikti me ligjin nga adoleshentët, të moshuarit në nevojë, familjet me sjellje asociale, këshillime martesore, martesë e të miturve, persona me aftësi të kufizuara fizike etj”, ka përmbledhur në paraqitjen e tij para gazetarëve, drejtori i QPS-së Mursel Zymberi.

Maliqi: Në këtë tremujor, 40 për qind të hyra më të mëdha se vitin e kaluar

10
MAJ

Të hyrat financiare në nivel të Komunës së Gjilanit, janë impresionuese karshi krahasimit me periudhën e njëjtë të tremujorit të parë të vitit 2015, ose përkthyer në shifra, 40% të hyra më shumë se sa periudha e njëjtë e vitit 2015, kështu ka thënë në një konferencë për media, drejtori i Drejtorisë Komunale për Bujxhet dhe Financa, Zijadin Maliqi.



Maliqi, në këtë komunikim me publikun, ka thënë se karshi detyrave që ka kjo Drejtori, si: përgatitjen e rrjedhës së parasë dhe dorëzimin e saj në Ministrinë e Financave, përgatitjen e pasqyrave financiare dhe barazimin me Departamentin e Thesarit, përgatitjen e bartjes së mjeteve financiare nga viti paraparak përmes aprovimit të Kuvendit të Komunës, kjo Drejtori dhe stafi i saj i kanë kushtuar rëndësi të veçantë edhe inkasimit dhe rritjes së të hyrave vetanake, duke bërë që këtë vit të kemi rritje të të hyrave, pothuajse në të gjitha kategoritë buxhetore. Drejtori Maliqi, ka apeluar tek të gjithë qytetarët e Gjilanit, që të bëjnë pagesën e tatimit në pronë, sepse këto mjete i kthehen qytetarit me investime në infrastrukturën publike. “Tatimi në pronë është e hyra kryesore e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, e cila e hyrë mbetet 100% në Komunë, duke iu kthyer qytetarëve me investime në infrastrukturë. Në këtë tremujor, në kuadër të tatimit në pronë, janë shpërndarë 31 mijë e 298 fatura, dhe janë pranuar deri më tani vetëm 160 ankesa, që një pjesë e tyre tashmë është shqyrtuar. Të hyrat në këtë kategori çdo muaj sa vijnë e shtohen më shumë. Në periudhën janar – mars 2016, janë inkasuar nga tatimi në pronë 306 mijë e 865 euro, ose 22.10% më shumë se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar”, ka thënë në fjalën e tij Drejtori i Financave, Maliqi. Po ashtu, drejtori Maliqi ka rikujtuar të gjithë borxhlinjtë se 2 shtatori po ofrohet, datë kur ligjit për faljen e borxheve i skadon afati dhe se faturat kthehen në gjendjen e mëparshme me të gjitha kamatat dhe ndëshkimet. Ai po ashtu ka përmendur faktin se bizneset kanë konfirmuar përgjigjen ndaj Komunës me pagesën e tatimit në pronë, para datës së cekur dhe kështu nga mbi 7 milionë euro sa janë borxhe në këtë kategori, 2/3 falen, ose mbi 5 milionë euro, ndërsa, mbeten për inkasim mbi 2 milionë euro, duke përfshirë bizneset dhe ekonomitë familjare.

Ramadani: Për tre muaj, 500 fermerë përfituan nga mbështetja e Komunës



6
MAJ

Drejtorja e Bujqësisë dhe Pylltarisë së Komunës së Gjilanit, ka shënuar suksese të cilat direkt prekin në krijimin e kushteve më të mira të fermerëve gjilanas, përmes projekteve të ndryshme investive në kultura të ndryshme bujqësore, dhe sipas përlogaritjeve të stafit të kësaj drejtorie, janë punësuar nga 100 – 120 punëtor në pronat e tyre me këtë mbështetje të dhënë.

Me këtë rast drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, në një konferencë me gazetarë, ka thënë se objektivat e punës së planifikuar për këtë periudhë janë arritur plotësisht dhe përfituesit më të mëdhenj janë fermerët e vyeshtë të Gjilanit, që numri i tyre për këtë tremujor është mbi 503, me mbi 100 mijë euro investime. “Planifikimi i punës vjetore të kësaj drejtorie është arritur plotësisht deri në këtë fazë dhe falë mbështetjes së kryetarit të Komunës së Gjilanit dhe donatorëve e partnerëve tanë dhe të bujqësisë së Gjilanit”, ka thënë Ramadani. Ai tha se gjatë ditës së djeshme është realizuar projekti i bashkëpunimit me agjencionin turk TIKa, nga i cili projekt kanë përfutur 40 bujq me mekanizim bujqësor në një vlerë financiare prej 30 mijë euro, gjithashtu, janë realizuar edhe disa projekte me shumë rëndësi për zhvillimin agrar. “Me donatorin dhe partnerin tonë të TIKa, kemi arritur që bujqve të Gjilanit t’u sjellim donacionin nga i cili kanë përfituar 40 fermerë me mekanizim bujqësor. Gjithashtu, kemi publikuar listën e përfituesve për konstruksione të serrave, ku përfitues kemi 20 fermerë në një vlerë prej 23 mijë e 400 euro”, ka thënë ai. Drejtori Ramadani ka thënë se gjatë muajit shkurt, fermerët janë njoftuar për skemën e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR dhe nga zyrat e kësaj Drejtorie, kanë marrë asistencë për konkurrim në këto grante. “Kemi ofruar asistencë për aplikimin dhe informimin e fermerëve për subvencionet

që ka ndarë MBPZHR, por gjithashtu kemi ndihmuar ata edhe për plotësimin e aplikacioneve edhe për mini-grante që ndanë organizata HELP”, ka thënë drejtori i Bujqësisë në Gjilan. Në konferencën e sotme, drejtori Ramadani ka përmendur edhe projektin e subvencionimit të mjedrës, i cili është i pari në historinë e Gjilanit të pasluftës. “Pas shqyrtimit të aplikacioneve të fermerëve, kemi përzgjedhur 39 përfitues me sipërfaqe prej 10 hektarë. Implementimi i fazës së parë të këtij projekti ka filluar javë më parë. Faza e dytë do të realizohet në vjeshtë dhe vlera e këtij investimi është 60 mijë euro. Vlerësojmë se me këtë investim sigurohen minimum 100 deri 120 vende të reja të punës”, ka thënë drejtori Ramadani. Po ashtu, i pari i bujqësisë në Gjilan tha se 406 fermerë kanë përfituar subvencionet për mbjellje pranverore, në shumë 13.800 euro, e ku përfshihen 320 hektarë. Përpos këtyre projekteve, në proces të implementimit është edhe projekti i centrifugave elektrike për nxjerrjen e mjaltit, pajisja e blegtorëve me makina mjelëse lëvizëse dhe shtrimi i rrugëve të arave. Ndërkaq, në sektorin e pylltarisë, Ramadani është shprehur se është punuar me intensitet dhe vigjilencë. “Gjatë kësaj periudhe kemi ngritur 85 fletëparaqitje, prej të cilave, 68 për kundërvajtje, 10 janë dërguar në gjykatë dhe shtatë për transport. Në koordinim me Drejtorinë Rajonale të Pylltarisë, kemi planifikuar që të bëjmë rrallimin e 20 hektarëve, dhjetë në majën e gjelbër dhe dhjetë hektarë në pjesën e Karadakut”, përfundoi drejtori i Bujqësisë në Gjilan, Ramiz Ramadani.



Berisha: Asnjë uzurpim i pronës publike në periudhën janar – mars 2016

5 MAJ Në një konferencë për media, drejtori i Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës, Sadudin Berisha, ka prezantuar raportin e punës për periudhën janar-mars 2016, ku ai ka potencuar suksese të ndryshme në të gjithë sektorët e kësaj Drejtorie.

Lidhur me uzurpimet e pronës publike, drejtori Berisha ka thënë se kjo periudhë, falë komunikimit të mirë me qytetarët dhe vetëdijesimit të tyre, ka kaluar pa asnjë uzurpim të vetëm të pronës publike. “Periudha tre-mujore, ka kaluar pa asnjë uzurpim të pronës publike. Është duke u kuptuar tashmë se prona publike asnjëherë nuk përvetësohet, por ajo mbetet publike në shërbim të të gjithë qytetarëve. Në vitin 2015 kishim gjashtë uzurpime, prej tyre një është ekzekutuar dhe pesë të tjera janë në proces gjyqësor”, ka thënë drejtori Berisha. Ai ka thënë se para vitit 2015 kishim rreth 90 raste të uzurpimeve, ku një pjesë e vogël e tyre janë për kthim të pronave, ndërsa një pjesë janë vetëm me dënime financiare nga gjykata, për të shtuar se në këtë periudhë është bërë punë e madhe gjithandej dhe njëkohësisht edhe janë kthyer përgjigje të shumta si dhe janë dhënë shërbime-produkte të ndryshme nga kjo Drejtori. “Në këtë periudhë kemi punuar në përcaktimin e kufijve përgjatë lumit në fshatin Livoç i Ulët, pastaj kufijve për rrugën në fshatin Llashticë, caktimi i pikave për shpronësimet në lumin ‘Mirusha’ dhe aktivitete të shumta e të ndryshme ditore në këtë sektor të matjeve. Po ashtu, janë caktuar matje për lokacionin e ndërtimit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, lokacionit për ndërtimin e Shtëpisë së Pleqve dhe propozim zgjidhje të ndryshme të pronës publike dhe asaj private”, tha ai. “Në këtë vit për këtë periudhë kohore kemi 1 mijë lëndë më shumë se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Kemi tejkalim të të hyrave për më shumë se 100% nga planifikimi vjetor për këtë periudhë”, pohoi ai para gazetarëve. Në lagjen Zabeli i “Sahit Agës”, është bërë për herë të parë identifikimi i pronës publike dhe nuk ka uzurpime klasike. “Për herë të parë bëhet identifikimi i pronës publike në këtë lagje dhe është, po ashtu, fat i madh që në këtë lokacion nuk kemi uzurpime klasike. Gjithashtu, stafi i Drejtorisë është duke punuar vazhdimisht në rregullimin e çështjeve pronësore-juridike në lagjen “Dardania” dhe nuk e kemi asnjë ankesë nga qytetarët për matjet dhe përcaktimin e gjendjes faktike dhe asaj juridike në këtë pjesë, megjithëse ka lëvizje plus apo minus në metrat katrore, sepse në vitet e 70-ta, matjet nuk kanë qenë të asaj që kemi sot për sa i përket saktësisë dhe teknologjisë”, ka thënë drejtori i Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës, Sadudin Berisha.

Musa: Gjilani, model për arsim cilësor në nivel Republike

4
MAJ

Investimet e pandërprera në infrastrukturë shkollore, cilësinë në rritje në arsim, disiplina nëpër shkolla, sukseset e nxënësve nëpër gara të ndryshme, janë elementet e fuqishme që kanë përcjellë arsimin e Gjilanit për periudhën janar – mars 2016, ka potencuar në konferencën me gazetarë, drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Nazmi Musa.

Lidhur me rritjen e cilësisë në arsim, drejtori Musa, ka thënë se kjo është arritur falë një analize të kujdesshme që është bërë në fillim të këtij viti shkollor dhe me hapat e ndërmarrë bashkërisht janë shënuar rezultate konkrete. Ai shtoi se Gjilani tashmë është model dhe pikë referente të një arsimit cilësor në nivel vendi dhe këtë vlerësim po e japin ekspertët vendor dhe organizatat e fuqishme ndërkombëtare. “Me mbështetjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në fillim të këtij viti shkollor kemi bërë analiza të detajuara që në cilësinë e arsimit të kemi performim sa më të mirë. Së bashku me GIZ-in, kemi organizuar trajnime, të cilat në fillim të vitit 2016 kanë dhënë rezultatet e para në ngritje të cilësisë. Sot të gjithë mësimdhënësit e shkollave tona kanë përgatitjen adekuate për punën që e bëjnë në shkolla dhe detyra që kanë po dëshmuar me suksese”, tha drejtori Musa. Ai,

gjithashtu, ka potencuar suksesin e nxënësve në gara të ndryshme si ato komunale shtetërore apo edhe ndërkombëtare, duke potencuar faktin që nxënësit e Gjilanit janë pothuajse në çdo garë ata që ndajnë me moshatarët e tyre, tri vendet e para. Edhe me investimet në infrastrukturën shkollore Gjilani është në rrugë të mbarë sepse po punohet gjithandej në krijim të kushteve më të mira për nxënësit, e që numri i tyre është mbi 18 mijë. “Këto ditë në infrastrukturën shkollore presim përfundimin e shkollës së re “Bajram Curri” në fshatin Shurdhan. Gjithashtu, është duke vazhduar ndërtimi i dy sallave sportive të edukatës fizike në shkollën “Abaz Ajeti” në qytet dhe shkollës “Liria” në fshatin Pogragjë. Ndërtimi i çerdhes në lagjen “Dardania” është në tenderim dhe presim përfundimin e procedurave tenderuese në mënyrë që të nisin punimet më pas edhe atje. Me mbarimin e vitit shkollor, do të filloj edhe projekti tjetër me rëndësi ai për ndërtimin e kompleksit të shkollave të mesme”, ka thënë drejtori Musa. Musa ka informuar se së bashku me Bankën Gjermane për Zhvillim do të bëhet renovimi i shkollës në fshatin Përlepnice, Bresalc dhe Livoç të Ulët. Drejtori i Arsimit, Nazmi Musa, ka falënderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen e madhe Ministrinë e Arsimit, USAID-in, Kolegjet Private, GIZ-in, Caritasin Zvicëran, Save the Children, Drejtorinë e Arsimit të Bursës, Policinë e Kosovës dhe të gjithë akterët e tjerë të shumtë që janë të angazhuar për arsimin dhe në ngritjen, suksesin, cilësinë, disiplinën në arsimin e Gjilanit.



Gjilani, qyteti i Abetares

Komuna e Gjilanit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të Republikës së Kosovës, ka shënuar “Festën Abetares”, me një program të pasur kulturor-artistik, të përgatitur nga fatosat e shkollave nga Gjilani, Presheva dhe qyteti i Bajram Currit nga Shqipëria. Ministri i Arsimit, Arsim Bajrami, tha se rruga që e ka ndjekur abetarja, ka e qenë rrugë plot sakrifica gati dy shekujsh, duke shtuar se përmes abetares dhe shkollës, kemi arritur ta ruajmë shpresën e kombit tonë për një të ardhme të sigurt. “Jemi të vetëdijshëm për rëndësinë që ka sot jo vetëm abetarja, por në përgjithësi edukimi cilësor”, tha Bajrami, duke shtuar se sot, në të njëjtën kohë, po e festojmë edhe pesë vjetorin e abetares së përbashkët, që është një e arritur shumë e madhe. Kryetari Lutfi Haziri e falënderoi ministrin Bajrami për mbështetjen e madhe që i ka dhënë Gjilanit, sikurse edhe drejtorin e DKA-së, Nazmi Musa, duke thënë se së bashku me drejtorët e shkollave, po bënë një angazhim të pasqor, për të pasur një arsim

sa më cilësor dhe një qytet të abetares çfarë është sot. “Më bënë nder të veçantë që MASHT ia ka dhënë këtë vit Gjilanit epitelin “Qyteti i Abetares”, sikur që na ka bërë nder dhe prania e fëmijëve nga Presheva dhe Bajram Curri i Shqipërisë, që së bashku me fëmijët e Republikës së Kosovës, të festojmë një festë të përbashkët, ABC-në dhe përmbylljen me sukses të mësimit të Abetares”, tha Haziri. Ai ka njoftuar se Gjilani është në një konkurrencë të hapur të marrjes së statusit “Qytet i Mençur”, si Komuna e parë e cila ka aplikuar nga Republikën e Kosovës. “Ju njoftoj se ne jemi në një konkurrencë të hapur që të marrjes së statusit “Qytet i Mençur” në nivel Republike”. Kanë përshëndetur edhe Hajrie Hoxha, përfaqësuese nga qyteti i Bajram Currit dhe Besa Sahiti, përfaqësuese nga Lugina e Preshevës, të cilat janë shprehur të nderuara që marrin pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme për arsimin shqip.

Shefkiu: Për tre muaj, të hyra rekorde nga lejet e ndërtimit

3
MAJ

Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka shënuar rezultate të mëdha në punën e vet, por edhe të hyra rekorde, më të lartat që nga paslufta e deri më tani, ose 309% më shumë se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Për legalizim të ndërtimeve, një proces ky që po zhvillohet në të gjitha komunat e Kosovës, janë paraqitur gjithsej 7413 aplikacione të qytetarëve.

Kështu ka thënë drejtori i Urbanizmit, Valon Shefkiu, në konferencën për media, duke thënë se angazhimi dhe puna në këtë Drejtori është e vazhdueshme dhe me rezultate rekorde që nga paslufta e deri më sot. “Në drejtorinë e Urbanizmit punohet me përkushtim të vazhdueshëm. Kërkesat e qytetarëve nuk kanë afatin 30 ditë për shqyrtim, por ato shqyrtohen brenda ditës apo brenda javës. Kur ne kemi ardhur në këtë Drejtori, kemi gjetur lëndë të cilat prisnin prej vitesh”, ka thënë gjatë prezantimit, Shefkiu. Në sektorin e planifikimit, Shefkiu ka thënë se kanë kryer aktivitete të rëndësishme në këtë tremujor të parë, duke përfshirë 5 parcelime, 10 informata, 13 propozim zgjidhje dhe gjithashtu një pjesë e mbetur në proces. Gjithashtu ai ka thënë se në këtë periudhë kohore janë ndërmarrë edhe aktivitete si në përfundimin e projekteve të zonave mikro-urbane dhe propozim zgjidhje të zonave-mikro urbane, që janë në proces. Drejtori i Urbanizmit të Gjilanit, ka thënë se sektori i lejeve ka shënuar rezultate konkrete të ndërmarrja gjatë kësaj periudhe. “Vetëm për periudhën janar – mars 2016, janë realizuar të hyra rekorde nga lejet ndërtimore. Janë gjithsej 246 mijë 439 euro, ose 309% më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, dhe kjo është arritur falë angazhimit dhe përkushtimit të stafit në urbanizëm që të jepjen shërbime dhe të mos pengohen e zvarriten qytetarët të cilët duan të investojnë në Gjilan. Gjithçka është duke u bërë sipas ligjit dhe në përputhje me ligjin. Ndërsa, ata të cilët gjejnë vërejtje i ftoj që të ofrohen në Drejtori dhe



të marrin informatat e sakta e jo të flasin nga ‘llafet’ e rrugëve”, ka thënë, ndër të tjerash, drejtori Shefkiu. Ai ka shtuar se falë angazhimit të inspektorëve të ndërtimit, është arritur që të monitorohen ndërtimet dhe të futen në proces ligjor edhe ata ndërtues të cilët kanë nisur ndërtimet pa leje ndërtimore, duke shënuar kështu suksese të veçanta edhe në këtë fushë. Ai ka apeluar që të punohet sipas planeve urbane dhe në harmoni me ligjin. “Lejet ndërtimore lëshohen në Drejtorinë e Urbanizmit, e jo në Zyrën e Kryetarit siç ka ndodhur më herët”, tha Shefkiu, gjatë adresimit para gazetarëve. Në aspektin e legalizimit të ndërtimeve, Shefkiu ka pohuar se procesi për legalizimin e ndërtimeve ka nisur sikur në të gjitha Komunat e Kosovës, dhe në këtë drejtori janë paraqitur gjithsej 7413 aplikacione të qytetarëve. “Ndërsa më vonë nga stafi i drejtorisë janë evidentuar edhe 24713 objekte, që në total në regjistrin e ndërtimeve janë 32126 objekte, në tërë territorin e Komunës së Gjilanit. 6256 aplikacione janë për objektet në zonën urbane, 1157 janë në zonën rurale, ndërsa evidentimet e stafit janë 9100 në zonën urbane dhe 15613 në zonën rurale”, ka përfunduar drejtori i Urbanizmit të Gjilanit, Valon Shefkiu.



Nxënës nga Gjilani shkojnë në Gjermani për shkollim profesional

14
MAJ

Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga drejtori për Zhvillim Ekonomik, Agim Zuzaku, po qëndrojnë në vizitë zyrtare në Gjermani. Haziri, gjatë vizitës në Republikën Bajernit, ka konkretizuar marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të Komunës së Gjilanit, kompanisë “Wurm” dhe “Bav-Kos” për dërgimin e 15 nxënësve të shkollës së mesme teknike “Mehmet Isai” në shkollim profesional prej 42 muajve në Gjermani.

Ky memorandum është bërë falë angazhimit të z. Erdoan Idrizi, një gjilanas i cili ka arritur sukses të jashtëzakon-

shëm në projektimin dhe ndërtimin e sistemeve alternative ripërtëritëse të kaldajave për prodhimin e energjisë dhe ngrohjes përmes biomasës, e cila prodhon energji alternative. Vlen të theksohet se ky projekt, një pjesë të prodhimit e finalizon në Gjilan. Ky është projekti më i madh ekologjik, i cili, prodhon energji nga biomasa, si mbeturinat e pyjeve, ashklave të drurit, peletit dhe lëndëve të tjera. Gjithashtu, është prezantuar edhe projekti më i ri, i cili, bënë trajtimin e llumit të ujërave të zeza, duke prodhuar, po ashtu, energji alternative dhe ngrohje dhe duke iu përmbytur të gjitha standardeve për mos emetimin e gazrave në ambient.

Haziri në Paris: Një Gjilan i dytë është krijuar në Europë



13
MAJ

Asociacionit European për Zhvillim të Demokracisë Lokale (ALDA), ka organizuar sot në Paris të Francës një tryezë me temën “Marrëdhëniet ndërmjet Francës dhe Ballkanit - rast i veçantë Kosova”, ku në mesin e panelistëve ka qenë kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri. Në tryezën, e cila ka zgjuar interesim të madh të të pranishmëve, kryetari Haziri tha se partneriteti i Kosovës, përkatësisht Gjilanit me Francën, daton që nga viti 1995, kur nën organizim të Asociacionit “Kosova e Ansambël” të cilin e udhëhoqi me sukses veprimtari Ilir Mustafa dhe lëvizjes MAN u bë e mundur që të kemi vizita e takime të ndërsjella mes përfaqësuesve të Kosovës dhe shtetit francez.

Haziri tha se ky Asociacion dhe lëvizja MAN, përmes konferencave dhe artikujve të rëndësishëm, sensibilizuan opinionin publik, politik dhe institucionet ndërkombëtare mbi krizën në Kosovë, përfshirë edhe Parlamentin European dhe Këshillin e Europës. Ai e ka vlerësuar tejet të rëndësishme hapjen e zyrës së ALDA-s në Gjilan në vitin 2004, derisa ka falënderuar Ilir Mustafa, Jean-Iv Carlen, Stev Duchan, Roger Winterhauer e shumë të tjerë, që i

kanë dhënë kuptim kësaj marrëveshje dhe formës unike të bashkëpunimit në nivel lokal dhe regjional. “Partneriteti Gjilan-Lutterbah-Strasbourg, veprimi i jashtëzakonshëm i lëvizjes MAN dhe shoqatës “Kosova Ansambël”, me mbështetje dhe solidaritet që kanë treguar për Gjilanin në periudha të ndryshme, siç është shkëmbimi i nxënësve, profesorëve, mjekëve, pastaj mbështetja e madhe edhe për të zhvendosurit dhe refugjatët, mbështetja për kauzën që ka ardhur nga regjioni i Strasburgut për Gjilanin, e bënë unik formën e bashkëpunimit në mes të Gjilanit dhe Luterbahut, pikërisht në 20-vjetorin e themelimit të këtij bashkëpunimi 1996-2016”, ka thënë Haziri. Kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri ka përmendur faktin në Europë është Gjilani i dytë me përfaqësim të mbi 30 për qind të qytetarëve të saj, në shtete të ndryshme të BE-së. “Në Europë kemi prezent Gjilanin e dytë. Në shtete të ndryshme të BE-së, ne kemi mbi 30 për qind të popullsisë sonë. Ky komunitet që ka migruar para 40 vjetëve e më shumë, sot janë të integruar në jetën shoqërore, institucionale, arsimore, shëndetësore, politike, ekonomike”, ka potencuar kryetari Haziri në tryezën e organizuar nga ALDA.

Gjilani, pjesëmarrës në konferencën “Strong Cities Network Global Summit”



12
MAJ

Pas anëtarësimit të plotë në Rrjetin ndërkombëtar të Qyteteve me seli në Londër, Komuna e Gjilani po merr pjesë për herë të parë në konferencën “Strong Cities Network Global Summit”, e cila po mbahet në Antalia të Turqisë. Valentina Bunjaku Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, e cila po e përfaqëson Gjilanin në këtë konferencë, ka thënë se synimi është që përmes praktikuesve lokal, të parandalohet përhapja e ekstremizmit të dhunshëm.

“Strong Cities Network Global Summit” synon që përmes praktikuesve lokal, të parandaloj përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm, të nxis dhe të frymëzoj qasjet në veprimtaritë e ndryshme në luftimin ndaj dhunës dhe

për të respektuar të drejtat themelore të qytetarëve. Jam nderuar që jam pjesë e kësaj konference”, është shprehur me këtë rast kryesuesja e Kuvendit Komunal të Gjilanit, Valentina Bunjaku Rexhepi. Në këtë ngjarje globale po merr pjesë edhe komandanti policisë në Gjilan, majori Remzi Azemi, sikurse edhe kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri dhe përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme. Punimet e kësaj konference filuan me fjalën përshëndetëse të Sekretarit amerikan të Shtetit, John Kerry, derisa në të po marrin pjesë mbi 100 kryetarë qytetesh dhe komunash nga e gjithë bota, për të diskutuar rreth rolit të qyteteve dhe komunave në përballje me ekstremizmin e dhunshëm.

Prezantohet plani rregullues “Fidanishtja 2”

13
MAJ

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUMM) e ka hapur dëgjimin publik për planin rregullues të lagjes “Fidanishte 2”, pas prezantimit të draftit nga kompania projektuese “INSI” e Prishtinës, për t’iu dhënë mundësi qytetarëve që gjatë tri-dhjetë ditëve të ardhshme t’i paraqesin kërkesat dhe sugjerimet e tyre në këtë dokument të planifikimit hapësinor, në mënyrë që ai të jetë sa më i pranueshëm. Qytetarët duhet t’i shfrytëzojnë javët e ardhshme për t’i bërë vërejtjet e tyre, para se plani të shkojë për miratim në Kuvend Komunal, sepse ndryshime nuk mund të bëhen para pesë viteve.

Rexhep Kadriu, nënkryetar i Komunës, i cili ka marrë pjesë në prezantimin e draftit, ka thënë se planet rregulluese janë të nevojshme për planifikimin e ndërtimit të infrastrukturës dhe dhënien e lejeve ndërtimore dhe i ka inkurajuar pronarët, të cilët preken drejtpërdrejt nga ky

plan, që t’i paraqesin vërejtjet e tyre. “Komuna e Gjilanit, gjithmonë i ka marrë parasysh kërkesat e qytetarëve dhe është mundur që ato t’i përfshijë në planet rregulluese dhe zhvillimore të qytetit”, ka thënë Kadriu, duke shtuar se pjesëmarrja e qytetarëve në këtë proces e ndihmon Komunën që të bëjë plane sa më të mira. Fadil Sherifi, shef i Sektorit të Planifikimit Hapësinor në DUMM, ka thënë se Komuna e ka për obligim t’i bëjë planet rregulluese dhe zhvillimore, të cilat mund të rishikohen pas 5 përkatësisht 8 vitesh. Zona urbane shtrihet në një sipërfaqe prej 2002 hektarësh dhe pjesa më e madhe e saj, rreth 80 për qind, është e mbuluar me plane rregulluese, ndërkohë që do të vazhdohet me pjesën tjetër. Në pikat kryesore, planin rregullues e ka prezantuar Ismajl Baftijari, ndërsa detajet tjera i kanë paraqitur ekspertët e fusheve përkatëse, Valon Gërmizaj, Shaban Neziri, Lulëzim Kryeziu, Arben Arifi dhe të tjerë.

Gjilani merr mirënjohje për bashkëpunim në fushën e trashëgimisë kulturore

12
MAJ

Në bashkëfinancim të organizatës nga Suedia, ‘Trashëgimia Kulturore pa Kufij’, (CHwB), së bashku me Ministrinë e Kulturës, Komunën e Gjilanit dhe Qendrën për Trashëgimi Kulturore, është arritur të përmirësohet infrastruktura, renovimi dhe restaurimi i objekteve me rëndësi, në fushën e trashëgimisë kulturore në Gjilan.

Kështu sot gjatë ditës është bërë pritja nga shefi i kabinetit të kryetarit të Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, për përfaqësuesit e CHwB-së, të cilët kanë dhënë një mirënjohje për Komunën e Gjilanit, për kujdesin e treguar në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore të Gjilanit dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm duke qenë edhe pjesë e bashkëfinancimit të projektit. Ndryshe, në mbështetje të forumit lokal të themeluar në Komunën e Gjilanit, përmes këtij programi është hartuar Plan i Lokal i Trashëgimisë Kulturore për Komunën e Gjilanit, ku janë identifikuar resurset e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që do të shërbenin si bazë e zhvillimit ekonomik dhe social. Në Gjilan, përmes



këtij bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi është arritur të ndërtohet ura që lidhet me kalanë në fshatin Pogragjë, në një vlerë prej rreth 75 mijë euro, investimi në muze me rreth 10 mijë euro, pastaj intervenimi në kullën e Kadri Vehbi Zeqirit, në fshatin Zhegër, renovimit të odës së Fevzi Hoxhës në fshatin Cërrnicë, odës së Zekirja Abdullahut në Gjilan dhe restaurime e renovime në disa objekte të tjera nën mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Lutfi Haziri zgjidhet anëtar i Bordit të ALDA-s me seli në Strasburg-Bruksel



12
MAJ

Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit, është zgjedhur para pak çastesh anëtar i Bordit prej 12-anëtarëve të Asociacionit European për Zhvillim të Demokracisë Lokale (ALDA), me seli në Strasburg-Bruksel. Pas votimit të fshehtë, i cili u mbajt në Paris të Francës dhe në një konkurrencë të fortë, kreu i Gjilanit arriti që të futet në mesin e 12 anëtarëve të këtij Bordi me mandat 4-vjeçar, i cili do të jetë përfaqësues në mbarë Europën.

Kryetari Haziri ka falënderuar anëtarët e ALDA-s për besimin, ndërkaj ka theksuar se përmes partneriteteve me anëtarët e Asociacionit European për Zhvillim të

Demokracisë Lokale, do të ketë mundësi shumë të mira të përfitimit të projekteve të rëndësishme për Gjilanin, Kosovën dhe regjionin. Komuna e Gjilanit, nga viti 2015 është anëtare me të drejta të plota në këtë organizatë të fuqishme, e cila është unike e kësaj natyre që përfaqëson pushtetin lokal, shoqatat, organizatat, akademitë dhe asociacionet që merren me pushtetin lokal në Europë, por mbulon aktivitete në mbarë botën. Ndryshe, gjatë ditës, Kongresi i Pushtetit Lokal dhe Regjional i Këshillit të Europës, ka veçuar dhe shpërblyer Gjilanin me diplomën për bashkëpunim ndër-komunal, ndër-regjional dhe për partneritet europian.



Qytetarët tregojnë interesim për rregulloret komunale

10
MAJ

Rregullorja komunale për menaxhimin e mbeturinave, bashkë me planin e veprimit për vitet 2016-2020 si dhe rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, i janë nënshtruar të martën një dëgjimi publik, ku qytetarët dhe shoqëria civile kanë paraqitur vërejtjet dhe sugjerimet e tyre, para se se këto dy akte komunale të procedohen për miratim në Kuvend Komunal.

Hevzi Matoshi, shef i Zyrës Ligjore, ka thënë se për herë të parë, menaxhimi i mbeturinave kalon në kompetencë të komunave dhe më tutje ka bërë një prezantim të pikave kryesore të projekt-rregullore. Naser Korça, drejtor i Shërbimeve Publike, tha se komisioni ka punuar një kohë të gjatë në hartimin e planit dhe të rregullores për menaxhimin e mbeturinave, ku kontribut të madh ka dhënë sidomos GIZ-i gjerman. Pjesë e këtij plani do të jetë edhe vetëdijësimi i qytetarëve përmes fushatave të ndryshme. Fadil Osmani, anëtar i grupit të punës për hartimin e planit për menaxhimin e mbeturinave, ka theksuar se Gjilani është komunë që inkurajon kulturën e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm, përmes standardeve më të larta të menaxhimit të mbeturinave dhe që krijon partneritet të suksesshëm me rininë, familjet dhe bizneset, me qëllim reduktimi, përkatësisht riciklimi të

mbeturinave. Sipas tij, ky plan i ka 90 veprime konkrete, që parashihet të realizohen deri në vitin 2020. Synim yni është arritja e standardeve evropiane edhe në këtë sektor, ka thënë ai. Siç u tha në debat, edhe 28 fshatra në komunën e Gjilanit, nuk janë të përfshira ende në shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Ndërkaq sa i përket rregullores për këshillat lokale, Hevzi Matoshi ka thënë se bëhet fjalë për një përmirësim të disa dispozitave të rregullores ekzistuese, që ka të bëjë kryesisht me përfaqësimin gjinor dhe të tjera. Avdyll Aliu, kryetar i komisionit për themelimin e këshillave lokale, ka thënë se deri më tani ky proces është kryer në 80 për qind të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Përmes kësaj rregulloreje korrigjohet përfaqësimi gjinor, nga 30 për qind, sa ka qenë deri tani, në 40 për qind, ndërkaq sa i përket pagesës së anëtarëve, duhet të pritët që çështja e kompensimit të rregullohet në nivel qendror. Shahadije Rexhepi nga shoqata “Agro-eko” tha se përmirësimi i përfaqësimit gjinor në Këshilla lokale është kërkuar nga prej tyre. Përmes pyetjeve, vërejtjeve e sugjerimeve të ndryshme, kontributet e tyre, qoftë për njëjërën apo rregulloren tjetër, i kanë dhënë edhe Xhelil Sahiti, Shaban Terziu, Gerhard Dummer (Ecohigjiëna), Muhadin Haziri, Avdyll Aliu, Fadil Gashi, Shahadije Rexhepi, Shemse-din Elezi dhe të tjerë.



Haziri falënderon GAP-in për raport real dhe të drejtë të monitorimit

10
MAJ

Instituti GAP, në bashkëpunim me organizatën INPO, ka organizuar sot debat në Gjiilan me temën “Zbatimi i ligjeve nga komunat”. Me këtë rast, Bekim Salihu, përfaqësues i GAP-it, ka bërë prezantimin e hulumtimit të kësaj organizate, i cili është realizuar në 31 komuna, për nivelin e zbatimit të ligjeve, procesin e koordinimit në mes të nivelit qendror dhe lokal dhe problemet praktike.

Në monitorimin për Gjiilanin, GAP vlerëson faktin se Gjiilani është në fazën e hartimit të programeve komunale për mbrojtjen e ujërave, ka të evidentuar listën e bimëve, ka plan për eficiencën e energjisë, sikurse që ka themeluar qendrën vullnetare për zjarrëfikje dhe shpëtim. Sipas raportit, kjo Komuna ka miratuar Planin Zhvillimor Komunal, ka sistemin e alarmimit në rast të rreziqeve, derisa thuhet se nuk ka inspektor të mjedisit, por ekzistojnë zyrtarët për ambient. Kreu i Gjiilanit, Lutfi Haziri, i cili ishte pjesëmarrës në këtë debat, e ka falënderuar organizatën GAP për monitorimin, duke e vlerësuar raportin si të drejtë dhe real. “Falënderoj GAP-in për pasqyrim të drejtë dhe real të monitorimit përmes këtij raporti. Natyrisht, ka nevojë për përmirësime të vogla, por kryesisht është

raport i real, i cili na ndihmon shumë në përmirësimin e qeverisjes. Ne mund të themi që si regjion i Anamoravës jemi krenarë për funksionalizim, koordinim dhe bashkëpunim ndërkomunal, pavarësisht dallimeve politike e etnike”, tha Haziri. Ai shtoi se Komuna nuk ka kapacitete njerëzore t’i ushtroj detyrat me kompetencë sepse nuk lejohet punësim shtesë sipas nevojave. “Është një problem esencial që Komuna nuk ka kapacitete njerëzore t’i ushtroj detyrat me kompetencë sepse nuk lejohet punësim shtesë sipas nevojave tona. Për shembull, ne nuk kemi inspektor të mjedisit, por kemi zyrtar për ambient, i cili duhet të përkthehet edhe si inspektor në pamundësi për ta punësuar dikë tjetër. Pra, kemi të bëjmë me kapacitete të vogla”, shtoi Haziri. “Kemi raste kur për një detyrë klasike, që me ligj i takon ta kryej qeverisë, ndërkohë që kjo e fundit ia delegon Komunës për ta ushtruar. Këtu është problem sepse delegojnë detyra, por nuk delegojnë as buxhet, e as staf dhe ka edhe shumë problematika të tjera”, tha Haziri, gjatë fjalës së tij. Përfaqësuesi i GAP-it, Bekim Salihu, theksoi se nga ky debat mund të nxirret konkluzioni se është e domosdoshme që të kemi ligje të mira, për të pasur shërbime të mira.



Haziri: Gjilanin e kemi kthyer në kantier pune

10
MAJ

Nën udhëheqjen e kryetarit Lutfi Haziri, është mbajtur sot bordi i drejtorëve në Gjilan, i cili është transmetuar drejtpërdrejt në radiot lokale. Gjatë këtij takimi, janë diskutuar disa pika të rendit të punës lidhur me Planin Zhvillimor Komunal, përgatitjen e planit të ri për PPP, transportin urban, ku për këtë fundit u tha se duhet të bëhet një rivlerësim i studimit të fizibilitetit.

Në takimin e sotëm është diskutuar, po ashtu, edhe për banimin social, ku u bë publike se gjatë muajve në vijim do të ndërtohen edhe 9 shtëpi për familjet në nevojë, derisa u konfirmua se javën e ardhshme pritet të nënshkruhet kontrata me operatorin e ri për renovimin e 40 shtëpive, ndërkaq që po bëhet pagesa e qirave për 37 familje. Kryetari Haziri ka shprehur zotimin se ditët në vijim pritet të nis projekti i ndërtimit të çerdhes në “Dardani”, projekt ky i bashkëfinancuar nga USAID. “Çerdhja e dytë që do të operohet është “Ardhmëria 1” në qendër dhe çerdhja e tretë në lagjen “Arbëria”, të cilat do ndërtohen nga ana e Komunës. Do t’i gjejmë modalitetet e ndërtimit të këtyre çerdheve”, tha ai. Ndërkaq, në takimin e bordit, u tha se mirëmbajtja e rrugëve në qytet po shkon sipas dinamikës së paraparë, ndërsa në fund të majit pritet të nisë ndërtimi i rrugës Gjilan-Pogragjë. Sa i përket lumit “Mirusha”, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka bërë publike se tashmë është shkëputur marrëveshja me operatorin aktual, ku do të bëhet prerja, derisa theksoi punimet do të përfundohen nga qeveria e Austrisë, e cila do ta zgjedh operatorin e ri, sikurse që do të nis edhe ndërtimi i shtratit të lumit “Stanishorka” dhe rregullimi i kanalizimeve në qytet dhe fshatra. Përveç kësaj, Haziri tha se po vazhdon me sukses të bëhet renovimi i objektit të teatrit, derisa në proces të projektimit është palestra në Zhegër dhe renovimi i stadiumit, projekte këto në bashkëfinancim me Ministrinë e Kulturës prej mbi 1 milion euro. Po ashtu, kryetari Haziri tha se Gjilanin e kanë rikthyer në kantier punues, duke qenë njëra nga tri komunat me ndërtim masiv. “E rëndësishme në këtë fazë është zhvillimi i ndërtimit. Ne kemi kthyer Gjilanin në kantier punues. Është njëra nga tri komunat, ku ndërtimi është duke u bërë në mënyrë masive, pasi e kemi inkurajuar sektorin privat. Në asnjë vend Komuna nuk ka marrë pjesë, as nuk ka ndarë tokë, e as nuk ka hyrë në konkurrim me sektorin privat”, tha Haziri. Gjithashtu, në mbledhjen e sotme është diskutuar edhe për subvencionet në bujqësi e shëndetësi, për rindërtimin e varrezave të martirëve në Llashticë, rikonstruktimi i varrezave të qytetit, ndërtimin e parkut për rekreacion të “Banja” në “Dardani” dhe për revidimin e projekteve të vjetra.

Gjilani shënon Ditën e Europës



9
MAJ

Pikërisht në Ditën e Europës, Komuna e Gjilanit, përkatësisht Zyra për Integritime Evropiane, në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Diplomaci, kanë organizuar sot debat me temën “Sfidat dhe mundësitë e liberalizimit të vizave”, me panelistët, Burim Elezi – përfaqësues i Zyrës për Integritime Evropiane, Njomza Emini – kryetare e Komisionit Parlamentar për Integritime, Flamur Hyseni – profesor universitar dhe Selim Daku – drejtor ekzekutiv i KCD-së.

Hapjen e debatit, në të cilin morën kryesisht studentë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, e i cili, po mbahet në kuadër të “Javës së Evropës”, e ka bërë zyrtari komunal për integritime evropiane, Burim Elezi, i cili tha se debati i sotëm korrespondon me ngjarjen e rëndësishme të Komisionit European për rekomandim të liberalizimit të vizave për Kosovën. “Për kosovarët, BE nuk është më as luks dhe as ëndërr e largët, pasi kemi miratimin e MSA-së dhe kemi marrëdhënie kontraktuale mes Kosovës dhe BE-së. Ndërkaq, ditë më pare, KE miratoi rekomandimin për liberalizim të vizave për Kosovën dhe besojmë se është çështje muajsh kur do të udhëtojmë pa viza në zonën Shengen. Tashmë jemi më afër Evropës. Kosova po hedh hapa përpara, e vendosur për të kthyer në realitet atë që dikur ishte e paprekshme”, ka thënë Elezi. Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Integritime Evropiane, deputetja Njomza Emini, pasi falënderoi kryetarin Lutfi Haziri për organizim të këtij debati të rëndësishëm, tha se tashmë pas marrjes së rekomandimit për vizat, institucioneve kosovare i mbetet të punoj shumë në sensi-

bilizimin e opinionit me fushata të ndryshme në shkolla, pasi tha se liberalizimi nuk nënkupton punësim në shtetet e BE-së. “Po ashtu, sfida mbetet edhe reformimi i administratës, arsimit, shëndetësisë e sektorëve tjerë”, tha ajo. Flamur Hyseni, profesor universitar, ka folur në dimensionin juridik, duke thënë se Kosova shumë më herët i ka plotësuar kriteret për të pasur lëvizje të lirë të qytetarëve të saj. “BE është vonë në këtë aspekt sepse Kosova i ka plotësuar që moti kriteret për ta pasur liberalizimin. Po ashtu, Kosova teknikisht e ka përmbyllë procesin e riadhesimit në mënyrë të shkëlqyeshme. Nga liberalizimi më së shumti përfitojnë studentët dhe sfida mbetet se a do të mund t’i kthej Kosova, për shembull, studentët e mjekësisë, të cilët i përfundojnë studimet jashtë dhe të sistemojnë nëpër qendra të mjekësisë familjare”, tha Hyseni. Selim Daku, drejtor i Qendrës Kosovare për Diplomaci, theksoi se tashmë Kosova i ka dy sfida sa i përket vizave: ratifikimi në Parlamentin European dhe në Këshillin e Europës. Gazetari dhe publicisti, Muhamet Halili, theksoi se tema që duhet të flitet është se a ka Kosova mekanizëm ta parandalojë ikjen masive, pasi pohoi se “gëzimi i kosovarëve për vizat është që të shkojnë jashtë vendit dhe ta sigurojnë mirëqenien, e jo vizita familjare”. Gjatë debatit, pati pyetje e diskutime tejet interesante nga ana e studentëve, të cilët morën përgjigjet e panelistëve. Në fund, kryetarja e Komisionit Parlamentar për Integritime Evropiane në Kuvendin e Kosovës, Njomza Emni, shprehur zotimin të gjitha rekomandimet që kanë dalë nga debati i sotëm, do t’i paraqes në mbledhjen e radhës të këtij Komisioni, i cili mbahet të martën.



Familja Fejzullahu në Malishevë bëhet me shtëpi të re

7
MAJ

Avdirrahim Fejzullahu nga Malisheva e Ulët Gjilanit nuk ka mundur të thotë asnjë fjalë pos “Faleminderit” nga lotët e gëzimit, pasi banorët e këtij fshati dhe bashkatdhetarët ia ndërtuan shtëpinë e re, pas iniciativës së kryetarit Lutfi Haziri në mbrëmjen humanitare “Pak nga ne, shumë për ata”. Avdirrahimi deri tani ka jetuar në një shtëpi me gjendje të mjerueshme të banimit, por sot i ka ndryshuar jeta, ngase së bashku me familjen e tij do të bëjë jetë të dinjtetshme.

Çelësat e shtëpisë së re ia dorëzoi atij, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri dhe përfaqësuesi i Këshillit Organizativ të fshatit, Agron Tahiri. “E falënderoj Këshillin Organizativ, përkatësisht qytetarët e Malishevës dhe bashkatdhetarët, për kontributin e tyre në ndërtimin e shtëpisë së familjes së Avdirrahimit, të cilin e uroj ta

mbush me gëzim e lumturi. Tashmë kjo është shtëpia e 27-të që njerëzit e vullnetit të mirë e ndërtuan, pas iniciativës në mbrëmjen humanitare “Pak nga ne, shumë për ata”, ka thënë pas inaugurimit të shtëpisë, kryetari Haziri. Kreu i Gjilanit tha se brenda vitit, numri i shtëpive të ndërtuara pas iniciativës së tij në nëntorin e vitit 2014, do të shkojë në 35. “Në Malishevë janë duke u ndërtuar edhe dy shtëpi falë kontributit të Këshillit Organizativ, ndërsa në Zhegër dhe Lladovë jemi duke u ndërtuar edhe gjashtë shtëpi tjera me fondin e përbashkët të qytetarëve. Deri në fund të vitit, numri i shtëpive të ndërtuara do të shkojë në 35. Gjithashtu, 37 shtëpi do të rinovohen atë brenda 90 ditësh dhe 40 familjeve në nevojë po ua paguajmë qiratë”, u shpreh Haziri. Ai tha se Fondi i solidaritetit ende nuk është prekur, falë angazhimit të njerëzve të vullnetit të mirë të Gjilanit, Anamoravës dhe mbarë Kosovës.



Në kadastrë synim janë e-shërbimet

6
MAJ

Në Komunën e Gjilanit sot është bërë përrurimi i zyrave të kësaj drejtorie, të rinovuar dhe ridizajnuar në mbështetje të Komunës së Gjilanit, Agjencionit Kadastral dhe donatorit kryesor, Bankës Botërore. Për herë të parë, pas 70 vitesh, kjo drejtori vendoset në shtëpinë më të mirë të mundshme, ku garantohet transparencë maksimale në punë. Kadastra është e vendosur në ish-objektin e gjykatës, që tani shfrytëzohet nga Komuna.

Nga të pranishmit u dha mesazhi se pas këtij hapi pretendim dhe prioritet kryesor pos tjerash mbetet edhe fillimi i programit të e-shërbimeve. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri ka thënë se kjo është rilindje e Kadastrës së Gjilanit pas lëvizjeve të shumta e të ndryshme nëpër objekte me kushte minimale apo tepër të rënda të punës deri më tani. “Është projekt kapital ky i cili sot po përrurohet në Gjilan. Për të gjithë ata që do të kërkojnë shërbime të përditshme nga kjo drejtori, kanë mundësinë që t’i marrin shumë shpejtë ato. Është rilindje e Kadastrës në Komunën tonë, sepse në kushtet që është punuar deri në kohën e fundit, ishin jashtëzakonisht të rënda. Këtu tashmë është i mundur edhe arkivimi por edhe arkiva e veçantë për ruajtjen e dokumentacioneve. Do t’i jem shumë mirënjohës drejtorit Berisha, nëse kjo drejtori nga Gjilani do të jetë në grupin e parë, me programin për e-shërbime”, ka thënë kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri. E nga këndi i tij, Murat Meha, kryeshef i

Agjencionit Kadastral të Kosovës, ka thënë se edhe sot është konfirmuar tradita e këtij sektori me vlera të larta. “Mbështetja e Agjencionit Kadastral, bashkëpunimi shumë i ngushtë me kryetarin e Komunës së Gjilanit dhe projekti i donatorit – Bankës Botërore, u rikonfirmua edhe njëherë se këtu është tradita e lartë e këtij sektori të Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës në Gjilan. Nuk do të ndalemi me kaq por do të vazhdojmë edhe më tutje për e-shërbimet në këtë drejtori, që mbetet edhe moto e jona për këtë vit. Do të vazhdohet edhe më tutje në sistemin e adresave e kështu me radhë”, tha Meha gjatë këtij aktiviteti. Ditë e veçantë për Drejtorinë e Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës, kështu është shprehur drejtori i kësaj Drejtorie, Sadudin Berisha, sepse për herë të parë sipas tij pas 70 vitesh, kjo drejtori vendoset në shtëpinë më të mirë të mundshme dhe në kohën e duhur. “Meritë për këtë janë kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, Agjensioni Kadastral i Kosovës, respektivisht kryeshefi, Murat Meha dhe donatori - Banka Botërore. Me këto kushte që kemi tani, shtohet edhe përkushtimi i stafit të këtij sektori jashtëzakonisht të rëndësishëm. Këtu kemi shënime dhe dokumentacione që vlera e tyre asnjëherë nuk mund të llogaritet. Këto kushte krijojnë siguri, përkushtim, azhurnim më të shpejtë të lëndëve dhe profesionalizëm edhe më të madh, duke pretenduar zhvillim dhe avancim më të madh”, ka thënë në fjalën e tij drejtori Sadudin Berisha.

UNDP mirënjohje Gjilanit për luftim të korrupsionit



5
MAJ

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë (UNDP), i ka ndarë mirënjohje Komunës së Gjilanit për partneritetin 3-vjeçar në luftim të korrupsionit. Mirënjohjen ia ka ndarë kryetari të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, koordinatori i UNDP-së për Kosovë, Andrew Russell. Komuna e Gjilanit e ka Planin për Integritet, sikurse që ka miratuar në Kuvend edhe planin strategjik për trajtimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Kryetari Haziri e ka falënderuar z. Russell për këtë vlerësim, duke thënë se që nga marrja e mandatit të kryetarit

po qeverisë me Gjilanin me duar të pastra dhe dyer të hapura për qytetarët. Haziri theksoi se për të parandaluar korrupsionin e mundshëm ka dhënë në dispozicion 2 mijë euro për çdo qytetar që e lajmëron këtë dukuri dhe ai mbetet anonim. Haziri tha se me këta hapa që i ka ndërmarrë ai në parandalimin e korrupsionit të mundshëm, investitorët e huaj do të mund të investojnë në Gjilan pa dilema. Ndryshe, Komuna e Gjilanit, në mbështetje të UNDP-së, e ka hartuar Planin për Integritet, sikurse që e ka miratuar në Kuvend edhe planin strategjik për trajtimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Në Gjilan hapet zyra e Sekretariatit të Përbashkët Teknik për Bashkëpunim Ndërkufitar

5
MAJ

Në Gjilan sot është bërë inaugurimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik, në bashkëpunim dhe mbështetje të Zyrës së Bashkimit Evropian, sipas bashkëpunimit që kanë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në Kosovë dhe Ministria e Vetëqeverisjes në Maqedoni. Kjo zyrë është një hapësirë e re, e përshtatur për të përmbushur kërkesat në rritje dhe pritjet e reja të periudhës së Programit IPA II (2014-2020).

Sekretariati i Përbashkët Teknik, do të jap informacione dhe mbështetje teknike për partnerët e mundshëm dhe të kontraktuar të projektit, për të mbështetur zbatimin e thirrjeve për propozime dhe të lehtësojë monitorimin dhe administrimin e projekteve ndër-kufitare. Një zyrë e tillë do të jetë edhe në Kumanovë që do të luaj një rol të njëjtë me këtë të Gjilanit. Ndërsa në emër të zyrës së Bashkimit Evropian, në Kosovë ka folur, Libor Chlad, zëvendës drejtor për kooperim në zyrën e BE-së në Kosovë, ka thënë se programi për bashkëpunim ndërkufitar do të zbatohet në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit IPA II, i cili mbështet bashkëpunimin ndërkufitar me qëllim të nxitjes së marrëdhënieve të mira fqinjësore, nxitjen e integritetit të shteteve dhe promovimin e zhvillimit socio-ekonomik. “Objektivi i përgjithshëm i programit është të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, atë social dhe territorial të zonës së programit duke nxitur integritetin, zhvillimin e përbashkët dhe përdorimin e potencialeve dhe mundësive për të bërë zonën ndërkufitare tërheqëse për të jetuar dhe punuar. Gjatë këtyre viteve, 2014-2020 do të lansohen dy thirrje për propozime në kuadër të këtij programi, paraprakisht në qershor 2016 dhe në tetor të vitit 2018. Fondet në dispozicion për periudhën 2014-2020 janë 8.4 milionë euro. Ne presim dhe shpresojmë që projektet e



financuara përmes skemës së granteve BNK që do të realizohen në periudhën 2016- 2020 do të stimulojnë rritjen e përgjithshme ekonomike në zonat kufitare nëpërmjet partneritetit efektiv dhe fitimprurës mes qeverisë qendrore dhe asaj lokale por edhe të komuniteteve lokale”, ka thënë ai ndër të tjerash. Besim Kamberaj, udhëheqës i Departamentit për zhvillim rajonal në kuadër të MAPL, ka thënë se kjo zyrë është mundësi e mirë për të gjitha Komunat që janë pjesë e programit. “Është një mundësi shumë e mirë për këto Komuna që janë pjesë e programit Kosovë- Maqedoni, për organizatat jo-qeveritare dhe përfituesit e tjerë potencial. Është mundësi shumë e mirë e zhvillimit, pasi tashmë jemi duke hyrë në fazën e IPA 2, dhe mundësi të mëdha që të përfitojnë numër i madh përmes projekteve të ndryshme”, ka thënë ai ndër të tjerash. Ndërsa nga ana e tij, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i ka dhënë mbështetje kësaj zyre, duke pohuar se Gjilani është qytet mikpritës dhe pionier i bashkëpunimit ndërkombëtar. “Jemi mikpritës dhe pionier të bashkëpunimit ndërkufitar me qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik lokal. Jemi këtu jo vetëm në këtë kuadër të bashkëpunimit Gjilan-Çair, por edhe si iniciues të mikro-regjionit Gjilan-Kumanovë-Preshevë. Po punojmë që ta zgjerojmë bashkëpunimin ndërkufitarë mes këtij regjioni ku tashmë kemi konfirmimin e 17 komunave për bashkëpunim. E rëndësishme është që barrierat në kufi të largohen, kështu së paku këtë vit do të përfundojë pikëkalimi në Stançiq dhe barrierat do të bien gradualisht. Uroj që Zyra të operoj me sukses dhe të nxjerr fitues të mirë, që do të shërbejnë për mbështetje të komunave dhe ndikim në zhvillim”, ka thënë kryetari Haziri. Ndryshe, zyra gjendet në në Gjilan, konkretisht përballë zyrave të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.



Shpërndahet mekanizëm për 40 fermerë

5
MAJ

Komuna e Gjilanit, në mbështetje të Agjencionit shtetëror turk TIKa, ka shpërndarë sot mekanizëm bujqësor për 40 fermerë të Gjilanit, në vlerë prej mbi 30 mijë euro. Në shpërndarjen e mekanizmit ka marrë pjesë kryetari Lutfi Haziri, drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani dhe koordinatori i TIKa-së në Kosovë, Ejup Javuz Umutlu. Gjatë javëve të ardhshme, Drejtoria e Bujqësisë pritet të shpërndajë edhe subvencione tjera për bujqit e këtushëm.

“Sot po përfitojnë 40 fermerë, ndërkaq planifikojmë që nga buxheti i Komunës edhe 100 fermerë të tjerë të trajtohen, në mënyrë që të krijohet një mundësi maksimale e shfrytëzimit të tokës dhe stabilitet në punë. Uroj që bujqit të kenë rezultatet më të mira, thjeshtë pronat e tyre t’i shndërrojnë në vende të punës. E falënderoj kryetarin për mbështetjen maksimale, sikur edhe agjencionin TIKa”, tha në fjalën e tij drejtori i bujqësisë, Ramiz Ramadani. Kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, pasi ka falënderuar agjencionin TIKa për mbështetjen, theksoi se bujqësia në Gjilan vazhdon të jetë prioritet i qeverisjes.

“Përmes Ejup Umutlu, e falënderoj qeverinë e Turqisë për mbështetjen e vazhdueshme për Gjilanin në bujqësi,

arsim e siguri. Jemi krenarë me këtë partneritet. Bujqësia, siç ua kam thënë në vjeshtë, është prioritet i qeverisjes. Pa e punuar tokën tonë, askush nuk mund të ndihet i pavarur. Zoti na e ka falë tokën e mirë dhe bërëqeti fitohet nëse punohet”, tha Haziri. “Do të mundohemi që familja bujqësore të mos ketë shpenzime sepse Komuna po ua ofron mekanizmin, pastaj farën, plehun dhe më vonë edhe subvencionimin e naftës. Do t’ju mbështesim sivjet edhe me mekanizim tjetër. Ne jemi zonë tipike bujqësore dhe është gjynah që të mos punohet toka që na e ka falë Zoti. Bujqit janë heronjtë e Gjilanit dhe janë ata që po e mbajnë këtë vend. Unë jam krenar për mundin dhe për punën tuaj”, ka shtuar kryetari Haziri. Koordinatori i TIKa-së në Kosovë, Ejup Javuz Umutlu, ka thënë se Turqia është në dijeni që Kosova ka potencial bujqësor, duke shfaqur shpresën se ky nuk do të jetë donacioni i fundit. “Ky nuk është projekti i parë që e kemi realizuar në sektorin e bujqësisë dhe shpresoj që nuk do të jetë i fundit. Siç tha kryetari, Kosova ka një tokë të bërëqetshme dhe ne jemi në dijeni për këtë, prandaj edhe në të ardhmen do të jemi pranë bujqve, për të shtrirë dorën tonë të mbështetjes për zhvillimin e bujqësisë. Vëllazëria mes dy popujve na motivon që ta shtrijmë dorën e mbështetjes në të gjithë sektorët, me mundësitë tona buxhetore”, tha Umutlu.



Haziri: Rruga dhe amaneti i Zija Shemsiut na thërret në qëllimin final

5
MAJ

Institucionet komunale të Gjilanit, në krye me Lutfi Hazirin, kanë vënë sot kurora lulesh tek lapidari i Zija Shemsiut, në Përlepnicë, në nderim të 31-vjetorit të rënies së dëshmorit të jehonës së madhe për rezistencë. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, tha se Zijahu na mësoi të mos e pranojmë robërinë e padrejtësinë. Ai u cilësua si shembull i veprimtarit, i cili kryengritjen e çoi deri në fund.

“Kryengritja e Zija Shemsiut së bashku me bashkëluftëtarët e tij, ka bërë që jehona e madhe e rezistencës së tij, jo

vetëm në Gjilan e Anamoravë, por në mbarë Kosovën, të merret si shembull i veprimtarit të madh i cili kryengritjen e çon deri në fund. Ai na mësoi të rezistojmë dhe të mos e pranojmë robërinë e padrejtësinë. Gjatë veprimtarisë së Zija Shemsiut, unë kam qenë i ri, por për veprimtarinë e tij unë kam mësuar nga babai e xhaxhai im”, tha Haziri. Ai shtoi se veprimtaria e tij atdhetare i ka bërë të gjitha gjeneratat që të rreshtohen në atë rezistencë të madhe të popullit për të drejtën për të jetuar të lirë. “Rruga dhe amaneti i Zija Shemsiut na thërret në qëllimin final - që të jetojmë të bashkuar, të lirë dhe të barabartë”, shtoi kryetari Haziri.



Haziri premton bursa për studentë, veçanërisht për femrat në rrezik për shkollim

4
MAJ

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim përfaqësuesit e Parlamentit Studentor të Universitetit Publik “Kadri Zeka”, të cilëve u ka premtuar mbështetje në kërkesat e tyre. Haziri ka shfaqur zotimin e tij për ndarjen e bursave për studentët, veçanërisht për femrat të cilat e kanë në rrezik shkollimin për shkaqe financiare. Studentët e kanë mirëpritur takimin me kryetarin Haziri.

Në takimin me përfaqësuesit e Parlamentit Studentor të Universitetit Publik “Kadri Zeka”, Kryetari i Parlamentit Studentor, Mehmet Zylfiu, ia ka prezantuar kryetarit Haziri disa kërkesa të studentëve, kryesisht

për mbështetjen përmes bursave dhe realizimit të punës praktike në institucionet komunale. Kryetari Haziri ka shfaqur zotimin e tij për ndarjen e bursave për studentët, veçanërisht për femrat të cilat e kanë në rrezik shkollimin për shkaqe financiare. Haziri tha se e gëzon fakti që klubi i rotarianëve “Gjilani” ka në dispozicion një fond për bursa, ku paratë janë grumbulluar nga një mbrëmje humanitare, ndërkaj theksoi se së shpejti do të bëhet publik fondi i Komunës i paraparë për bursa. Takimi me kryetarin Haziri është vlerësuar tejet produktiv nga ana e Parlamentit Studentor, të cilët e falënderuan për mbështetjen ndaj tyre, duke ua bërë më të lehtë studimet.



Mesazhe për unifikim të klasës politike në manifestimin “Ditët e Agimit”

3
MAJ

Moti me shi nuk i ndali mijëra qytetarë nga e mbarë Kosova që të marrin pjesë në manifestimin kulturor tradicional “Ditët e Agimit”, në Zhegër të Gjilanit, i cili u organizua nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri. Në emër të kryetarit Haziri, të pranishmëve iu është drejtuar nënkryetari Rexhep Kadriu, i cili tha se ne jemi krenarë si Anamoravë që e patëm prijësin dhe heroin, i cili në luftën çlirimtare, bëri aktin më të lartë duke hequr kufirin midis shqiptarëve.

“Ashtu siç ishte fantazia e tij e pakufishme për artin, për shprehjen e ndjenjave shpirtërore, ashtu do të jetë i pakufishëm kuptimi për lirinë, jo vetëm si ide e frymëzim, por zbatim në praktikë dhe krijimin e lirisë”, tha Kadriu. Në emër të bashkëluftëtarëve ka folur komandanti i Brigadës 138 “Agim Ramadani”, Rustem Berisha, i cili

e përcolli porosinë e Agimit se “Kur pushkët bashkohen, edhe krismën e kanë më të fuqishme”, duke nënkuptuar unifikimin e faktorit politik. Ndërkaq, vëllai i dëshmorit, Agim Ramadani, Bekimi, tha se Agimi nuk ishte vetëm vëllai i tij, por i të gjithë shqiptarëve, për të kërkuar nga klasa politike që, siç tha, të tërhiqen nga lakmia personale dhe të mendojnë për të gjithë qytetarët. Përndryshe, manifestimi tradicional kulturor “Ditët e Agimit” është mbajtur për tri ditë me radhë, duke filluar me aktivitetin e turneut të futbollit, flakadanët në përkujtim të 114 dëshmorëve të Koshares, ora e madhe letrare “Muza e Agimit”, dita e shkollës “Agim Ramadani” e Krosi i Lirisë, për të kulmuar me manifestimin qendror “I kujtojmë Agimit”, i cili u mbajt në 53-vjetorin e lindjes. Manifestimi qendror është përmbyllë me një program të pasur kulturo-artistik, ku kanë defiluar emra të njohur të estradës.



Vihet gurthemeli i bustit të heroit Reshat Ymeri

1
MAJ

Në 48-vjetorin e ditëlindjes së heroit kombëtar, Reshat Ymeri, Komuna e Gjilanit ka vënë gurthemelin e bustit të tij, në lagjen ku ka lindur.

Në këtë ceremoni, nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, ka thënë se premtimi i kryetarit Lutfi Haziri po shkon në vend me vendosjen e këtij busti që i bënë nder Gjilanit e Anamoravës. Në këtë lagje të qytetit, pritet të ndërtohet edhe “Sheshi i Ilegales”.

“Sot po e vëmë gurthemelin e bustit të heroit të kombit, Reshat Ymeri, ku do të bëhet edhe një park i mirë, në të cilin, mund të pushojnë njerëzit. Pra, premtimi i kryetarit Haziri për këtë projekt po shkon në vend. Përkushtimi i qeverisjes komunale është që të nderojmë heronjtë e

dëshmorët e Gjilanit dhe të kujdesemi për familjet e tyre”, ka thënë Kadriu. Ai paralajmëroi se shumë shpejt do të fillohet edhe me ndërtimin e “Sheshit të Ilegales” tek rru- ga “Abdulla Presheva”. Ish-komandanti i zonës opera- tive të Karadakut, Ahmet Isufi, e vlerësoi lartë vënien e gurthemelit të heroit Reshat Ymeri. “Unë s’kam shumë fjalë sepse vet vepra e Reshatit na ka mësuar se si duhet të jemi të përkushtuar për atdhe. E përgëzoj për punën që e ka bërë Komuna e Gjilanit. Është rast i veçantë sepse gjithmonë e mbajmë kujtimin për të”, tha Isufi. Në emër të familjes, ka folur vëllai i heroit Reshat Ymeri, Rashi- ti, i cili e ka falënderuar kryetarin Haziri për realizimin e këtij projekti të rëndësishëm, duke thënë se kjo e ka nderuar gjakun e heroit dhe familjen e tij.



Në Gjilan promovohet frigoriferi për ruajtjen e pemëve të imëta

29
PRILL

Në fshatin Shillovë, është bërë përrurimi i frigoriferit, i cili ka rol të rëndësishëm në ruajtjen e pemëve të imëta dhe vishnjave që kultivohen në rajonin e Anamoravës. Ndërmarrja “Calabria” e ka privatizuar frigoriferin në vitin 2014, ndërsa rehabilitimi i tërësishëm i objektit është bërë në vitin 2015. Me këtë rast, kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ka thënë se përcaktimi i Komunës së Gjilanit, që fokusin kryesor të investimeve ta mbajë kah bujqësia, po jep rezultate konkrete dhe është garancion për bujqit.

“Calabria”, ka privatizuar me sukses fabrikën në Shillovë-Gjilan, në vitin 2014, ndërsa rehabilitimi i tërësishëm i objektit është bërë në vitin 2015. Me këtë rast kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se përcaktimi i Komunës së Gjilanit, që fokusin kryesor të investimeve ta mbajë kah bujqësia, po jep rezultate dhe garancion në praktikë për bujqit. “Mbështetja në bujqësi është mbështetje në zhvillim ekonomik. Komuna e Gjilanit për këto vite ka rritur investimet dhe subvencionet për bujqësinë, duke stimuluar punimin e tokës dhe rritjen e prodhimeve bujqësore. Kjo fabrikë tash e tutje

është një garancion për prodhuesit, sepse grumbullimi, tashmë është i sigurt dhe rritja e mirëqenies në familje vjen nga punësimi dhe gjenerimi i të ardhurave. Tani e tutje kërkohet prodhim dhe urojmë që ky vit të jetë i bereqetshëm për tokën e Gjilanit dhe këtij regjioni”, tha ndër të tjerash kryetari Haziri. Ndërsa, Ministri i Bujqësisë, Memli Krasniqi, ka bërë të ditur se mbështetja e ministrisë do të jetë përherë e më e madhe për prodhimin e pemëve të imëta dhe bujqësinë në përgjithësi. “Këtë vit falë edhe mbështetjes dhe angazhimit të organizatave të fuqishme ndërkombëtare, siç është USAID, ne kemi fokusuar mjete më shumë drejtë bujqësisë dhe saktësisht pemëve të imëta. Po punojmë së bashku edhe me nivelin lokal të qeverisjes dhe me fermerët që prodhimi nga toka e Kosovës të jetë përherë e më i madh, jo vetëm për konsum të brendshëm, por edhe për eksport të produkteve tona. Kjo fabrikë është një mundësi shumë e madhe për fermerët e këtij regjioni, sepse është afër dhe në të njëjtën kohë është garantues i ruajtjes së prodhimeve”, ka thënë Krasniqi, duke apeluar që të punohet sa më shumë toka, ngase zhvillimi dhe punësimi ndodhë pikërisht

në bujqësi. Drejtori i Misionit të USAID-it në Kosovë, James Hope, ka thënë se kjo fabrikë ndikon në punësim, rritje të shitjes, eksport, prodhim dhe punim të tokës njëkohësisht. “Kjo fabrikë është një mundësi e madhe dhe e mirë për këtë regjion. Është mundësi e mirë për fermerët, sepse nga këtu sigurohet punësimi, rritja e shitjes së prodhimeve, eksporti, nxitja e punimit të tokës dhe prodhimit të pemëve të imëta. Rritja e zhvillimit ekonomik agrar ka bazë në dy faktorë, atë të investimit të teknologji bujqësore dhe mbështetje të fermerëve të vegjël. Falë përkushtimit të Ministrisë dhe Komunave, ky sektor ka një rrugë të suksesshme edhe pse të vështirë, por me rezultate të dukshme gjithandej”, ka thënë ndër të tjerash ai. Ndërsa nga ana e tij Xhelal Selimi, pronar i fabrikës “Calabria”, ka thënë se fabrika për ngrirjen e pemëve do të lidhë kontrata me fermerët që ata të dorëzojnë këtu

prodhimet dhe kështu e kanë të sigurt shitjen e mallit të prodhuar. “Planifikimet e fabrikës janë që të krijojmë lidhje zyrtare me fermerët, në mënyrë që ata të kenë të sigurt tregun dhe destinimin e produkteve të prodhuara. Kapacitetet për grumbullim janë të mëdha, por mbetet angazhimi i bujqve që të bëjnë prodhimin dhe zgjerimin e parcelave me pemë të imëta dhe vishnje. Gjatë sezonit edhe numri i punëtorëve do të jetë më i madh fabrikë dhe indirekt shumë më i madh përmes fermerëve”, ka thënë në fjalën e tij pronari Selimi. Ndryshe, dhomat e ngrirjes kanë kapacitet për ruajtjen e 3000 ton metrikë të produkteve të ngrira në temperaturë deri në minus 25 gradë celsius. Kapacitetet e ngrirjes janë deri në 8.5 ton metrikë në orë. Kjo fabrikë bënë të ditur se ka kapacitete të grumbullimit të gjithë prodhimit të këtyre kulturave për regjionin e Gjilanit.



Në Gjilan, debat për parandalimin e pjesëmarrjes së të rinjve në grupe ekstremiste

28
PRILL

Organizuar nga “Partners Kosova – Qendra për Menaxhimin e Konfliktëve” nga Prishtina, sot është mbajtur debat, në të cilin ishin pjesëmarrës drejtori i arsimit, përfaqësues të Policisë së Kosovës, Bashkësisë Islame, përfaqësues nga qendra për parandalim

të terrorizmit në Policinë e Kosovës, drejtorët dhe nxënësit e disa shkollave dhe pjesëmarrës të tjerë, lidhur me përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të rinjve gjilanas, në grupe të cilat janë me qëllim të përfshirjes në ekstremizmin e dhunshëm dhe në luftëra të ndryshme në shtetet e lindjes.

Me këtë rast drejtori i arsimit Nazmi Musa, ka thënë se falë angazhimeve të përbashkëta të të gjitha institucionet në nivelin lokal, për më shumë se gjashtë muaj nuk kemi të rinj që kanë shkuar në atë drejtim dhe për më shumë se dy vjet nuk kemi rast të vrasjeve si pasojë e akteve kriminale në Gjilan. “Falë angazhimit të përbashkët të të gjitha institucioneve, sot ne kemi një Komunë ndër më të sigurtën në nivel vendi. Lusim të gjithë qytetarët, stafin në arsim dhe nëpër shkollë, që të punojnë më shumë në bartjen e mesazhit tek të gjithë nxënësit dhe qytetarët që pjesëmarrja në luftërat e shteteve të lindjes, është luftë e përfitimit të grupeve kriminale dhe terroriste. Angazhimi në parandalim mund të bëhet vetëm atëherë, kur të gjithë përfshihemi në mbrojtje të shtetit, kombit dhe religjionit njëkohësisht”, ka thënë Musa duke potencuar nevojën e organizimit të debateve brenda shkollave. Në këtë debat, kryetari i Bashkësisë Islame në Gjilan, Naim Aliu, ka thënë për fat të keq islami është shfrytëzuar negativisht nga individ të caktuar, jashtë BI-së, duke nxitur të rinjtë për pjesëmarrje në luftërat e shteteve të lindjes. “Për fat të keq islami është shfrytëzuar negativisht nga individ të caktuar, jashtë BI-së, duke nxitur të rinjtë për pjesëmarrje

në luftërat e shteteve të lindjes. Është koha e angazhimit maksimal të të gjithë neve bashkërisht, me të gjitha institucionet, që të fokusohemi dhe harxhojmë kohë të gjatë në parandalim të shtrirjes së kësaj fryme negative në rininë tonë. Fjala hyjnore në Kur-an thotë: ‘Ai i cili mbytet një njeri, është njëjtë sikur të gjithë njerëzit në botë ti ketë mbytur dhe ai i cili shpëton një njeri, është sikur ta ketë shpëtuar gjithë njerëzimin’. Prandaj, të punojmë sipas asaj që vërtetë thuhet në librin e shenjtë dhe nuk do të kemi asnjë problem në këtë drejtim, duke mos shtrembëruar asgjë”, ka thënë Aliu ndër të tjerash. Kurse, komandanti i stacionit policor në Gjilan, Remzi Azemi, ka thënë se Policia e Kosovës është duke punuar në vazhdimësi, në zbulimin e hershëm, sepse shumë lehtë me angazhim të përbashkët mund ta mbajmë këtu një të ri, i cili, ka nisur të ketë kontakte me rekrutues, por shumë e vështirë është kthimi i tij dhe rehabilitimi në shoqëri dhe në jetë në përgjithësi nëse një person i bashkëngjitet grupeve terroriste. Ndryshe, Gjilani njihet tradicionalisht për tolerancë të lartë fetare, ku nuk mbahet në mend që ndonjëherë të ketë pas konflikt ndërjetar mes religjioneve në këtë Komunë.

Organizata “Fortesa” lavdëron qeverisjen në Gjilan



28
PRILL

Organizata joqeveritare “Fortesa” ka dhënë vlerësim pozitiv për qeverisjen në Gjilan, përkatësisht ka lavdëruar punën e Kuvendit Komunal, efikasitetin e Zyrës për Informim në publikimin e akteve në dy gjuhët zyrtare dhe azhurnimin në përgjithësi të ueb faqes zyrtare. Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Gjilanit, Valentina Bunjaku Rexhepi, e cila ka marrë pjesë në këtë debat të shoqërisë civile, thënë se Gjilani është qyteti më i sigurt në Republikën e Kosovës,

Po ashtu, organizata “Fortesa” ka dhënë vlerësimin se vërehet dukshëm një bashkëpunim i mirë mes ekzekutivit dhe legjislativit, ndërkaq u vlerësua edhe vullneti i kryetarit Lutfi Haziri që prioritet t’u jepet femrave sa i përket punësimit. Këto vlerësime janë dhënë nga dre-

jtoresha e OJQ “Fortesa”, Sanije Jahiri, në tryezën e mbajtur në Prizren, ku u lavdërua edhe toleranca ndëretnike dhe ndërjetare që mbretëron në Gjilan. Në debat ka marrë pjesë edhe kryesuesja e Kuvendit Komunal të Gjilanit, Valentina Bunjaku Rexhepi, e cila ka falënderuar organizatën “Fortesa” për këtë vlerësim, ndërkaq ka thënë se Gjilani është qyteti më i sigurt në Republikën e Kosovës, pasi brenda më shumë se dy vjetëve nuk ka pasur asnjë vrasje. Në debat është diskutuar edhe për komisionin për emërtimin e rrugëve, ku janë propozuar emra të femrave për t’i emërtuar. Punëtorja është organizuar nga ojQ “Fortesa” me mbështetje të fondacionit “Friedrich Ebert”, derisa në të kanë marre pjesë edhe përfaqësues të komunave tjera.

Gjilani ndan 50 bursa për nxënësit e shkëlqyeshëm të Agrobiznesit

27
PRILL

Kuvendi Komunal i Gjilanit, nën udhëheqjen e Valentina Bunjaku Rexhepi, ka miratuar sot raportin financiar janar-mars 2016, propozim vendimin për qasjen e revidimit të planit zhvillimor komunal “Gjilani 2015+”, propozim vendimin për qasjen e revidimit të planit rregullues urban të hollësishëm “Qendra-z-1”, sikurse edhe propozim vendimin për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të rrugës qarkore sipas PRRU “Fidanishte” – Gjilan.

Seanca e sotme u karakterizua me transmetimin e drejtpërdrejt përmes kanalit zyrtar në Youtube, projekt ky i realizuar nga Zyra për Informim me mbështetje të kryetarit Haziri. Kryesuesja Bunjaku Rexhepi ka përgëzuar Zyrën për Informim për realizimin e këtij projekti, të parin në histori të institucioneve kosovare të kësaj natyre, duke thënë se ndihet mirë që transparenca e Komunës së Gjilanit po avancohen edhe më shumë. Projektin e përshëndetën edhe asambleistët tjerë, si Isa Agushi (LDK), Bujar Nevzati (PDK) e Fehmi Sylejmani (VV), të cilët theksuan se gjithmonë do t’i përkrahin projektet e mira. Kuvendi miratoi raportin financiar janar-mars 2016, të cilin e ka prezantuar drejtori për Buxhet dhe Financa, Zijadin Maliqi, i cili tha se buxheti për këtë vit është 22 milionë euro, derisa për periudhën tre-mujore është shpenzuar 21 për qind e këtij buxheti në të mirë të qytetarëve të Gjilanit. Pozita, Avdyl Aliu – shef i grupit të LDK, Nevzad Rushiti (LDK) e Mevlyde Zejnullahu (AAK), kanë përkrahur raportin duke e vlerësuar si shumë profesional, përderisa opozita, Riad Rashiti (PDK) e kanë kundërshtuar, duke thënë se ka zvogëlim të shpenzimeve kapitale, përderisa kërkuar sqarime lidhur me fondin e solidaritetit. Drejtori i Buxhetit, Zijadin Maliqi, tha se në këtë fond, nga njerëzit e vullnetit të mirë janë mbledhur 112 mijë euro, pas iniciativës së kryetarit Haziri në gala mbrëmjen humanitare, përderisa pjesa tjetër, që po kritikon opozita, janë të buxhetit komunal. Raporti u miratua me 19 vota për dhe 10 kundër. Pika më nxehtë, e cila është futur në rendin e ditës me kërkesë të opozitës, përkatësisht Bujar Nevzadit (PDK), ka qenë ajo lidhur me rrënimin e fabrikës së bukës “Kualiteti”. Riad Rashiti (PDK) tha se qasja e gabuar pushtetit të tanishëm

me investitorët e solli në këtë gjendje fabrikën, derisa asambleistët e pozitës, Avdyl Aliu, Isa Agushi, Nevzad Rushiti e Ibish Ibishi (AAK), iu kundërpërgjigjën duke thënë se privatizimi ka ndodhur në kohën e qeverisjes së PDK-së, duke e pyetur se pse nuk kanë reaguuar në vitin 2008. Nevzad Isufi, shef i grupit të VV-së, tha se Komuna e Gjilanit është dashur ta shpallë zonë të veçantë për ta ruajtur, siç tha, rrënimin e “Kualitetit”, ndërkaq asambleisti i NISMA-s Bajram Hasani, pohoi se privatizimi ka ndodhur në kohën e qeverisjes së PDK-së, duke shtuar se nuk ka asnjë shkelje në këtë rast dhe se pronari e ka pasur të obliguar që për dy vjet ta ruaj fushëveprimtarinë e prodhimit të bukës dhe më pas mund ta ndërrojë atë. Gjatë debatit, shefi i grupit të PDK-së, Sahit Abazi, ka kërkuar që të bëhet një komision të përbërë prej të gjitha partive, për siç tha, parandalimin e rrënit të fabrikës së bukës dhe pas hedhjes në votim, nuk kanë kaluar rekomandimet e tyre, pasi 19 votuan kundër, përderisa vetëm 9 për. Pas kësaj, asambleistët e PDK-së braktisën seancën. Kuvendi Komunal i Gjilanit ka miratuar edhe propozim vendimin për qasjen e revidimit të planit zhvillimor komunal “Gjilani 2015+”, propozim vendimin për qasjen e revidimit të planit rregullues urban të hollësishëm “Qendra-z-1”, sikurse edhe propozim vendimin për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të rrugës qarkore sipas PRRU “Fidanishte” – Gjilan, të cilat i kanë prezantuar Valon Shefkriu, drejtor i Urbanizmit dhe Sadudin Berisha, drejtor për Kadastër. Ndërkohë, një informatë të rëndësishme e ka dhënë drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, i cili tha se Komuna i ka ndarë 50 bursa për nxënësit e shkëlqyeshëm të shkollës së agrobiznesit “Arbëria”. “Për 25 nxënësit që vijnë nga zonat rurale janë ndarë nga 40 euro, derisa për 25 të tjerët nga qyteti nga 30 euro, ndërsa shuma totale është 17 mijë e 500 euro”, tha Ramadani. Në këtë mbledhje, kryesuesja Valentina Bunjaku Rexhepi i ndau mirënjohjen në emër të kryetarit Haziri, Kemajl Shahin, për kontributin e tij në promovimin e të drejtave të komuniteteve si kryesues i Komitetit për Komunitete. Ndërkaq, asambleisti nga radhët e PDK-së, Izmi Zeka, ka bërë publike se tërhiqet nga kjo pozitë, duke lëshuar rend për një asambleist tjetër të kësaj partie.



Bunjaku-Rexhepi: Raporti i OJQ “Anamorava” i pasaktë dhe jo real

25
PRILL

Organizata joqeveritare “Anamorava” në Gjilan, ka paraqitur sot raportin e monitorimit të Komunës për vitin 2015, ku përfaqësuesi i saj, Isa Shefkiu, tha se në shumicën e sektorëve të ekzekutivit dhe legjislativit ka vërejtje, e kritika, të cilat sipas tij, janë të domosdoshme për t’u përmirësuar.

Por, me këtë konstatim nuk është pajtuar kryesuesja e Kuvendit Komunal të Gjilanit, Valentina Bunjaku Rexhepi, e cila vlerësoi se raporti i OJQ “Anamorava” i pasaktë, jo i drejt dhe nuk paraqet gjendjen reale. “Ky raport është jo i saktë, jo i drejt, jo profesional dhe nuk paraqet gjendjen reale të punës së Kuvendit dhe trupave ndihmës të tij gjatë vitit 2015. Raporti ka shumë gabime teknike e gjuhësore dhe kjo na e bënë shumë të vështirë çka në të vërtetë ka dashur të thotë monitoruesi”, tha Bunjaku Rexhepi. Ajo tha se në shumicën e pikave të paraqitura, raporti ka kritika të pavend, ndërkaq ka shfaqur shpresën se në raportin e radhës të mos përsëriten

ato. Shefi i grupit të këshilltarëve të LDK-së në Kuvend, Avdyli Aliu, këtë raport e ka vlerësuar si kohë e harxhuar dhe letër e harxhuar, pasi sipas tij, nuk është në përputhje me realitetin. “Ka mangësi elementare. Është huq numri i asambleistëve, pastaj numri i anëtarëve të LDK-së dhe shumë e shumë huqe të tjera”, u shpreh Aliu. Ndërkaq, opozita pati fjalë të mira për raportin. Riad Rashiti nga radhët e PDK-së, e ka mbështetur raportin, duke e vlerësuar si real, ndërkaq ka theksuar se “fatkeqësisht këtu kemi dy konstatime, raporti i “Anamoravës” që është me plot kritika, vërejtje e lëshime për Komunën në përgjithësi, ndërkaq kryesuesja po flet krejt bardh”. Shefi i këshilltarëve të lëvizjes Vetëvendosjes, Nevzad Isufi, ka deklaruar se pajtohen me shumicën e gjetjeve të raporti, të cilat sipas tij, kanë qenë vërejtje të vazhdueshme edhe të subjektit që ai i takon. Në debat, vlerësimet e tyre i kanë dhënë edhe anëtarë tjerë të partive politike, sikurse edhe nga shoqëria civile.



Haziri: Kemi krijuar ambient të mirë për qytetarët duke e gjelbëruar Gjilanin

22
PRILL

Me një sërë aktivitete, Komuna e Gjilanit ka shënuar sot Ditën Ndërkombëtare të Tokës. I pari që mbolli lule ka qenë kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, i cili tha se gjatë tërë ditës do të mbillen shumë lule dhe shumë fidane, sikurse edhe që do të bëhet pastrimi i mbeturinave gjithandej territorit të komunës.

“Në kuadër të shënimit të Ditës së Tokës, Gjilani në organizim të përbashkët me organizatat e fëmijëve, të rinjve, shkollave fillore dhe organizatën “Gjilani

Riciklon”, po mbjellim lule, gjelbërim, pastrim, e largim të mbeturinave dhe shumë aktivitete tjera. Besoj shumë që Gjilani po zgjerohet në kuptimin e gjelbërimit, kemi mbjellë shumë më shumë fidane e lule për krijimin e ambientit më të mirë për qytetarët”, tha Haziri. Kreu i Gjilanit e ka falënderuar bashkatdhetarin nga Zvicra, i cili ka dhënë donacion 57 palë veshje punë për punëtorët e “Ecohigjienës” të cilët punojnë në terren dhe 3 karroca për personat me nevoja të veçanta.

Gjilani subvencionon 20 serra bujqësore



21
PRILL

Komuna e Gjilanit, respektivisht, Drejtoria e Bujqësisë, sot ka promovuar projektin e tretë në bujqësi për këtë vit, atë për serra komerciale dhe gjysmë komerciale, duke bërë kështu që këto familje të krijojnë edhe vende të reja pune në pronat e tyre.

Me këtë rast kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, gjatë vizitës në fshatin Llashticë, ka thënë se ky është fshati më punëtor në këtë anë, me përkushtim të vazhdueshëm në bujqësi. Edhe më tutje kryetari tha se bujqësia mbetet prioritet me rëndësi të veçantë, si sektori që më së shumti mund të krijojë vende të reja pune. “Lashtica është fshati më bujqësor, më i organizuar dhe më punëtor në lëmin e bujqësisë në Komunën e Gjilanit. Sot kanë përfituar me serra pesë fermer nga Llashtica nga gjithsej 20 në gjithë Komunën. Do të vazhdojmë me projekte dhe mbështetje tjetër, si në mekanizim bujqësor por edhe në fusha të tjera dhe kultura të ndryshme. Kryefamiljarët që punojnë duke organizuar familjet e tyre dhe përmes punës sigurojnë të ardhura për familje, do ta kenë mbështetjen e Komunës, duke u angazhuar që kosto e investimit për këto familje të jetë zero, në mënyrë që më pas fitimi të jetë më i madh për ta. Bereqeti në këto familje nuk do të mungoj, sepse angazhimi dhe puna asnjëherë nuk shkojnë huq”, ka thënë kryetari Haziri. Ai ka potencuar se jo vetëm ky vit, por edhe viti i ardhshëm do të jenë prioriteti kryesorë, në subvencionim, përmes të gjitha mjeteve të mundshme që i ka në buxhet të Komunës dhe mjeteve tjera që do të vijnë nga donatorët, sepse siç ka thënë Haziri ky është sektori që jep zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal Komunës dhe vendit tonë. “Pa një familje të qëndrueshme ekonomike, nuk ka asses mundësi që të kemi një Komunë të qëndrueshme. Nëse familja pavarësohet financiarisht me punën e vet, atëherë ne mund të ndihemi të lumtur sa i përket fushës së bujqësisë. Haziri ka apeluar tek të gjithë fermerët të cilët kanë mundësi ta punojnë tokën, që të marrin shembull këto

familje, të cilat janë punëdhënës të vetvetes në tokën e tyre dhe në prodhimin e tyre”, ka thënë kryetari Haziri. Ndërsa, drejtori i Bujqësisë dhe Pylltarisë në Gjilan, Ramiz Ramadani, ka falënderuar kryetarin Haziri për mbështetjen financiare të projekteve bujqësore, të cilat ndikojnë në rritje të prodhimit dhe krijimin e vendeve të punës. “Falënderoj kryetarin Haziri, që me përkushtim dhe mbështetje të tij sot kemi këtë projekt të realizuar në fshatin Llashticë, që mundëson në një hapësirë të vogël të tokës të bëhet punë e madhe, rendimente shumfish më të mëdha, shfrytëzim maksimal të kohës së prodhimit dhe normalisht edhe përfitime shumë më të mëdha se në ambient të hapur. Angazhimi dhe mbështetja nga i pari i Komunës, mundësoi që ne sot të kemi projektin e tretë në lëmin e bujqësisë, pas projektit të mjedrës dhe mbjelljeve pranverore, duke informuar se gjatë tërë vitit do të kemi projekte që janë mbështetje për bujqit dhe bujqësinë në përgjithësi. Nga ky projekt janë përfitues 20 fermer me 20 serra, ku prej tyre 10 serra janë të dedikuara për aspektin komercial-treg dhe 10 të tjera janë për nevojat familjare. Dhjetë serra janë mbuluar hapësirën nga 300 m² dhe dhjetë të tjera nga 150 m²”, ka thënë Ramadani në fjalën e tij. “Ne do të vazhdojmë me projektet tjera dhe sektorin e bujqësisë mëtojmë ta shndërrojmë në institucion punësimi”, ka thënë drejtori Ramadani. Ndryshe, njëri nga përfituesit, Xhelal Musliu nga fshati Llashticë, ka thënë se kjo mbështetje është vend i sigurt i punës për ta. “Deri më tani kemi punuar në kushte shumë larg më të vështira, sepse kishim serra të improvizuara që nuk mund të prodhohej produkte aq sa do të prodhohen në këtë serrë, e cila është më standardet më të larta të ndërtimit dhe plotëson kushtet që rendimentet të jenë premtuese”, ka pohuar ai ndër të tjerash, duke falënderuar Komunën e Gjilanit për këtë mbështetje të madhe për familjen e tij por edhe për bujqësinë në përgjithësi. Projekti për këto serra kap shifrën mbi 23 mijë euro dhe janë ndërtuar 20 serra të investuar nga Komuna e Gjilanit.



Bunjaku-Rexhepi: Ibrahim Uruqi ka lënë gjurmë në historinë tonë kombëtare

21
PRILL

Komuna e Gjilanit ka shënuar sot 17-vjetorin e rënies së dëshmorit të kombit, Ibrahim Uruqi dhe njëkohësisht ditën e shkollës së fshatit Bresalc. Fillimisht, kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku Rexhepi së bashku me këshilltarët komunalë ka bërë homazhe para lapidarit të dëshmorit, e më pas është shënuar dita e shkollës së Bresalcit, e cila e mban emrin e këtij kolosi.

Në emër të kryetarit Haziri, të pranishmit i ka përshëndetur kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku Rexhepi, e cila theksoi se dita e shkollës së Bresalcit është njëra nga ngjarjet më të shënuara në kujtesën e kombit, duke shtuar se është ditë kur shënohet themelimi i këtij tempulli të diturisë me emrin e dëshmorit Ibrahim Uruqi. “Bashkë me emrin e shkollës “Ibrahim Uruqi”, kujtojmë edhe sakrificën kombëtare për mbajtjen e shkollës dhe djersën

e dhënë nga populli, sikurse edhe mundin dhe gjakun për të ardhur deri te kjo ditë për të festuar. Prandaj, nderi deri në përjetësi ju takon të gjithë atyre brezave që sakrifkuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës”, u shpreh Bunjaku Rexhepi. Ajo tha se shkolla dhe fshati i Ibrahim Uruqit, gjatë këtij viti do të ketë fatin t’i gëzohet një varg projektesh nga ana e Komunës së Gjilanit, që kanë të bëjnë me infrastrukturën shkollore dhe fshatit në përgjithësi. Një fjalë rasti pati edhe kryetari i OVL të UÇK-së në Gjilan, Ahmet Daku, theksoi se ndihen krenar që përkujtohet ditëlindja e bashkëluftëtarit dhe dëshmorit, Ibrahim Uruqi. Drejtori i shkollës, Gafurr Sylja, pasi falënderoi të pranishmit për prezencën, tha se kjo e nderon edhe familjen, por edhe shkollën me emrin “Ibrahim Uruqi”. Në fund, shënimi i kësaj ngjarje është përmbyllë me një program të pasur kulturor-artistik nga nxënësit e shkollës fillore “Ibrahim Uruqi” të fshatit Bresalc.

Përmbyllet me sukses projekti për bashkëpunim ndërkufitar Gjilan-Çair

20
PRILL

Është përmbyllur sot në Gjilan projekti 18 muor për bashkëpunim ndërkufitar “Valorizimi i zejeve tradicionale Çair-Gjilan”, i financuar nga Komisioni European, i cili është realizuar në bashkëpunim me organizatën “Agro-Eko”.

Në ceremoninë e përmbylljes ka marrë pjesë kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, kryetari i Këshillit të Komunës së Çairit, Zahir Bekteshi, përfaqësuesi nga zyra e BE-së në Kosovë, Dardan Sadriu, zëvendësministri i MAPL-së, Bajram Gecaj dhe zejtarët gjilanas, përfitues të granteve. Në fjalën e tij, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, pasi falënderoi Komisionin European për mbështetjen, theksoi se bashkëpunimi me Çairin ka sjellë përvoja të reja, identifikim të zejeve, si dhe grante për t'i ndihmuar në zhvillimin e veprimtarisë së tyre. “E falënderoj shumë Komisionin European për mbështetjen në këtë projekt dhe dy projektet tjera, si donatori më i madh i Gjilanit gjatë këtyre dy viteve. Po paralajmëroj se ky nuk është bashkëpunimi i fundit me një komunë nga shteti fqinjë. Ne kemi bërë identifikimin e projekteve të përbashkëta me 17 komuna të regjionit lindje dhe pritet të hyjmë në projekte ambicioze”, tha Haziri. Ai ka falënderuar edhe qeverinë e Kosovës për mbështetjen në projekte, ndërsa theksoi se Komuna edhe në të ardhmen do të vazhdojë t'i mbështesë zejtarët e Gjilanit. Ai paralajmëroi se në muajin e ardhshëm, në Gjilan pritet të hyjë donatori më i madh, Qeveria e

Austrisë, në investimet për përmirësimin e infrastrukturës, më saktësisht investimet në rregullimin e rrjetit të kanalizimit, shtratit të lumit “Stanishorka” dhe përfundimin e shtratit të lumit “Mirusha”. Ndërkaq, Zahir Bekteshi, kryetar i Këshillit të Komunës së Çairit, tha se me Gjilanin i bashkoi zëjtaria, duke potencuar se këta të fundit me ndarjen e granteve janë avancuar, duke siguruar mirëqenien për familjet e tyre. Dardan Sadriu, përfaqësues nga Zyra ndërlidhëse e BE-së në Kosovë, pasi ka falënderuar kryetari Haziri dhe ekipin për implementimin e projektit, pohoi se me anë të këtij projekti të bashkëpunimit ndërkufitar, kanë arritur që të japin kontribut në zhvillimin e ekonomik social, e sidomos për zejtarët me anë të ndarjes së granteve. Zëvendësministri i MAPL-së, Bajram Gecaj, në emër të qeverisë së Kosovës ka përgëzuar Komunën e Gjilanit për përmbylljen me sukses të këtij projekti, duke shtuar se MAPL do të vazhdojë të jap kontributin në mënyrë që të thithen edhe donacione tjera për Komunën e Gjilanit. Fjalë rasti kanë pasur edhe disa nga zejtarët përfitues të granteve nga Komuna e Gjilanit, të cilët kanë shprehur falënderim për kryetarin Haziri dhe KE-së për mbështetjen e rëndësishme në zhvillimin e veprimtarisë së tyre. Përndryshe, përmes projektit për bashkëpunim ndërkufitar, janë mbajtur trajnime për zejtarët, sikurse edhe janë ndihmuar me anë të skemës së granteve. Pas përfundimit të ceremonisë, është bërë përruruar edhe renovimi i objektit të ish-ekzekutivit.



Takim i madh publik në fshatin Zhegër

18
PRILL

Nën organizimin e Grupit të Përbashkët Punues, në mbështetje nga USAID-i dhe Komuna e Gjilanit, është mbajtur debati publik në fshatin Zhegër për të marrë nga afër kërkesat, nevojat dhe problemet e qytetarëve që kanë sa i përket infrastrukturës publike, por edhe prioritetet sa i përket angazhimeve në të ardhmen në këtë pjesë.

Ky debat me numër të madh të pjesëmarrësve ishte në një formë edhe konfirmim për mbështetjen për GPP dhe qytetarëve nga organet komunale, në realizimin e objektivave të GPP, për fuqizim të rolit të qytetarit në vendimarrje dhe të transparencës së organeve komunale ndaj qytetarëve. Në këtë takim të pranishëm ishin nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, kryesuesja e Kuvendit Bunjaku-Rexhepi, drejtorët e drejtorive komunale si dhe shefi i grupit të këshilltarëve të LDK-së në Kuvendin Komunal. Njëzëri, është dhënë mbështetje e fuqishme në projektet parësore për fshatin Zhegër si dhe është konfirmuar bashkëpunimi dhe angazhimi i mëtejshëm në investimin e projekteve të infrastrukturës publike që janë kërkesa kryesore e banorëve, përkundër që ata hapur falënderonin Komunën e Gjilanit për investimet e deritanishme atje. Kështu tani e tutje kërkesat e qytetarëve do të diskutohen hapur, gjithnjë në shërbim të rritjes së investimeve në infrastrukturë, por gjithashtu u kërkua që të vazhdohet me punë në bazë të kriterëve dhe nevojat prioritare të shumicës së qytetarëve të kësaj ane. Ndryshe me takime të tilla u tha se do të vazhdohet edhe në vendbanime të tjera dhe gjithnjë me qëllim që të konsultohet numër sa më i madh i qytetarëve nga qeverisja komunale.



Shënohet 17 vjetori i Betejës së Zhegocit

15
PRILL

Organizuar nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, sot në malësinë e Zhegocit janë mbledhur në nderim dhe respekt për dëshmorët përfaqësues nga Komuna e Gjilanit, deputetë, veteranë të luftës, përfaqësues të FSK-së, përfaqësues nga policia, si dhe aktivistë e veprimtarë të çështjes kombëtare.

Në emër të kryetarit Haziri të pranishmit i ka përshëndetur nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, i cili Betejën e Zhegocit e ka radhitur në mesin e betejave më të lavdishme të UÇK-së. “Zhegocit dhe kjo malësi, janë çelësi dhe qendra e luftës së UÇK-së në këtë regjion. Ishte ura lidhëse mes sonës së Karadakut, Nerodimes dhe Llapit. Këtu në këtë hapësirë është dëshmuar hapur dhe qartë se si luftohet me krenari dhe guxim deri në flajm. Është vendi nga i cili janë hedhur themelet e fuqishme dhe të palëkundura të lirisë së Kosovës”, ka thënë nënkryetari Kadriu. Ndërsa, ish komandanti i ZOK Ahmet Isufi, ka thënë se familjet e dëshmorëve me krenari së bashku me të gjithë të tjerët duhet të kujtojnë bijtë dhe bijat e tyre që ranë për të mos vdekur asnjëherë. “Familjet e dësh-

morëve duhet të jenë krenar për sakrificën e djemve dhe vajzave të tyre që ranë për të mirën e përgjithshme dhe me gjakun e tyre u bënë garantuesit e themeleve të shtetit dhe lirisë së Kosovës”, tha ai ndër të tjerash, duke spikatur amanetin e tyre për zhvillim dhe ndërtim të vendit. E kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, Valentina Bunjaku-Rexhepi, në fjalën e saj gjatë nderimit të veprës së lavdishme të sakrificës, të vëllait dhe motrës së familjes Gashi, në fshatin Tërboc, ka thënë se femra ishte përkrah meshkujve edhe në momentet më të rënda dhe më të vështira, por siç ka thënë ajo, asnjëherë nuk u ndal angazhimi deri në çlirimin e vendit, dhe kështu është treguar vizioni, guximi dhe vendosmëria e femrës Kosovare. Ndryshe, sot manifestimi është hapur me homazhe në varrezat e dëshmorëve në Gjilan, për të vazhduar me zbulimin e pllakës së shtëpisë bazë të UÇK-së në Zonën Operative të Karadakut në fshatin Tërboc, për të kulmuar më pas me manifestimin qendror në qendër të fshatit Zhegoc, aty ku edhe ranë shumë dëshmorë si: Pajazit Ahmeti, Alban Ajeti, Hanumshahe Abdullahu, Tefik Zymberi, Sahit Baftiu, Shahin Baftiu, Kastriot Baftiu, Nijazi Osmani dhe të tjerë si dhe shumë civilë.



Gjilani inauguron parkun e modelit european

14
PRILL

Është inauguruar sot parku modern në lagjen “Dardania” të Gjilanit, i cili është bashkëfinancim mes Komunës dhe Komisionit European në kuadër të programit “Kosova e Bukur II”. Në ceremoninë e inaugurimit ka marrë pjesë kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, përfaqësuesi i lartë i zyrës së BE-së në Kosovë, Samuel Zhbogar, kryeministri Isa Mustafa dhe qytetarë të shumtë.

“Jemi këtu për të dëshmuar një moment të përparimit, të bukurisë. Jam shumë i lumtur që po e inaugurojmë projektin e përbashkët të Bashkimit European dhe Komunës së Gjilanit, dy javë pas arritjes së marrëveshjes së stabilizim-asocimit. E kemi rregulluar këtë park të bukur në Gjilan, që njëkohësisht ka krijuar edhe vende të reja pune. 92 vendet e punës janë krijuar nëpërmes realizimit të këtij projekti, ndërsa 72 prej tyre kanë qenë të papunë për një kohë të gjatë”, ka deklaruar përfaqësuesi i lartë i BE-së në Kosovë, Samuel Zhbogar. Kryeministri i Republikës, Isa Mustafa, ka deklaruar se ky park është një dëshmi e shfrytëzimit të qëlluar të fondeve nga BE, të një projekti të përbashkët me komunën dhe me mbështetje edhe të Ministrisë së Punës. “Parku “Dardania” ka një emër të bukur, që shpreh edhe trashëgiminë

kulturore, por edhe një bukuri të veçantë për Gjilanin dhe Kosovën. Ky park është një dëshmi e shfrytëzimit të qëlluar të fondeve nga BE, të një projekti të përbashkët me Komunën dhe me mbështetje edhe të Ministrisë së Punës në të mirë të qytetarëve. Këtë park do ta shfrytëzojnë qytetarët e të gjitha moshave. Dua ta falënderoj z. Zhbogar për mbështetjen dhe kryetarin Haziri për punën e shkëlqyer që po e bënë”, tha kryeministri Mustafa. Ai theksoi që qeveria do ta vazhdojë ta përkrah Gjilanin edhe në ndërtimin e infrastrukturës rinore, sportive dhe ambientale. Nga ana e tij, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka falënderuar Komisionin European për mbështetjen në ndërtimin e këtij parku për nevojat e qytetarëve të “Dardanisë”. “Këtu ka pasur ide më herët që të ndërtohen qendra tregtare e banesa këtu, por në takimin publik që e kemi mbajtur me qytetarët e “Dardanisë”, ata kanë kërkuar ndërtimin e parkut. Dhe ne i kemi dëgjuar dhe kemi mbështetur një kërkesë të këtyre qytetarëve të kësaj lagjeje”, ka thënë para të pranishmëve kreu i Gjilanit. Ai, gjithashtu, ka falënderuar kryeministrin Mustafa për mbështetjen e vazhdueshme në programe, duke thënë se Gjilani ka nevojë edhe për më shumë mbështetje, meqë siç tha, Gjilani ka mbetur prapa në mungesë të investimeve të mëhershme. Haziri ka paralajmëruar që Komuna po në lagjen “Dardania” do ta ndërtojë çerdhen e fëmijëve dhe këndin e lojërave prej 3-6 vjeç. Parku i inauguruar në lagjen “Dardania” brenda hapësirës së tij ka një të amfiteatër, fushë sportive, shëtitore, ulëse, sikurse edhe tavolina të shahut, ndërkaq ka të rregulluar gjelbërimin dhe ndriçimin sipas standardeve europiane.



Isa Mustafa e Lutfi Haziri konfirmojnë mbështetjen për rininë në Gjilan

14
PRILL

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa dhe kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, kanë vizituar sot shtëpinë e rinisë në Gjilan dhe janë zotuar për një mbështetje të fuqishme për këtë sektor, përmes financave nga dy nivele të qeverisjes, atij qendror dhe lokal.

Me këtë rast kryeministri Mustafa ka thënë se qeveria e Kosovës këtë vit do të përfundoj ndërtimin e shumë objekteve të qendrave rinore dhe qendrave sportive, sikur që ka ndodhur me qendrën për rini në Gjilan. “Si qeveri jemi të interesuar që të investojmë për rininë edhe në objekte që dedikohen si qendra kulturore dhe rinore, por edhe në qendra sportive. Kanë mbetur mjaftë shumë objekte sportive, dhe këtë vit mund t’i përfundojmë dhe jemi të interesuar që përfundimisht edhe me futbollin të anëtarësohemi në organizata ndërkombëtare si në UEFA dhe FIFA. Do të bëjmë përpjekje që këtë ta përmbyllim gjatë muajit maj dhe do të jetë

një sukses i madh veçmas për rininë dhe kërkesat tuaja për sportin”, ka thënë në fjalën e tij kryeministri Mustafa, duke potencuar se inventarizimin e objektit do ta bëjë Komuna e Gjilanit, sipas kërkesave dhe nevojave të rinisë gjilanase. Ndërsa, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se ndërtimi i shtëpisë së rinisë, është investimi më i madh në infrastrukturën e kulturës dhe rinisë në përgjithësi nga buxheti i qeverisë. “Shtëpia e rinisë sot është e përfunduar në aspektin e ndërtimit dhe tashmë jemi duke punuar në renovimin e objektit të Teatrit të Qytetit. Në të njëjtën kohë është duke u punuar në përzgjedhjen e projektit të Stadiumit të Qytetit, që është duke u bërë gati për garat ndërkombëtare. Në këtë objekt të rinisë do të vendoset KVRL, organizatat e studentëve, organizatat e shkollave të mesme dhe OJQ që merren me problemet e rinisë. Po punojmë që rinisë të pavarësohet në aspektin e menaxhimit, por duke subvencionuar me buxhet komunal”, ka thënë kryetari Haziri. Haziri ka thënë se këtë vit janë 1.2 milionë euro mbështetje për rininë, kulturën dhe sportin në Gjilan nga buxheti i Komunës dhe ai i qeverisë së Kosovës. Ndryshe, kryeministri Mustafa dhe kryetari Haziri me bashkëpunëtorë, kanë vizituar edhe fabrikën për prodhimin e radiatorëve “Enrad” në Gjilan, nga ku kanë motivuar investitorin që të vazhdojë kështu me këtë praktikë të mirë dhe të fuqishme në prodhime, e posaçërisht prodhime vendore që janë të kualitetit të lartë dhe konkurrent të fuqishëm në tregun Evropian dhe më gjerë.

Haziri falënderon Zhbogarin për mbështetjen për Gjilanin

14
PRILL

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur sot përfaqësuesin e lartë të zyrës së Bashkimit Europian në Kosovë, Samuel Zhbogar.

Kryetari Haziri e ka falënderuar z. Zhbogar për vizitën, sikurse edhe për investimet meqë Komisioni Europian është donator më i madh në Gjilan në projekte të ndryshme, përfshirë atë të ndërtimit të parkut në “Dar-



dani” përmes “Kosova e Bukur”, pastaj ndërtimin e shkollës në fshatin Shurdhan, projektin e bashkëpunimit ndërkufitar, e ndërtimin e bibliotekës. Haziri tha, po ashtu, se Komisioni Europian ka dhënë kontribut të madh edhe ndaj bizneseve, duke mbështetur sektorin privat me anë të granteve. Gjithashtu, në takim është folur edhe për tema politike në interes të zhvillimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.



Gjilani subvencionon me farë misri 406 fermerë

13
PRILL

Komuna e Gjilanit ka ndarë sot subvencione të farës së misrit për 406 fermerë, duke arritur të mbulohen 320 hektarë. Farën e misrit ua kanë ndarë sot fermerëve të Gjilanit kreu i Komunës, Lutfi Haziri së bashku me drejtorin e Bujqësisë, Ramiz Ramadani.

“Ju 406 bujqit përfitues të sotëm, të cilët nuk po lëni asnjë pëllëmbë toke pa e punuar, duhet të jeni shembull sepse bujqësia është baza e zhvillimit në çdo familje. Gjithmonë, pavarësia në familje ka qenë punimi i tokës. Tash që jemi në stinë të misrit, uroj që të ketë bereqet pas mjedrës që e kemi filluar javën e kaluar. Do të vazhdojmë ta rrisim mbështetjen për bujqit”, është shprehur kryetari Haziri, pasi bëri shpërndarjen e farës së misrit. Ndërsa, drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, pasi e ka falënderuar kryetarin Haziri për mbështetjen e madhe në

këtë sektor, tha se fara e misrit që është shpërndarë sot është mjaft kualitative. “Ky është subvencion iu dedikohet kategorisë së fermerëve të cilët nuk arrijnë t’i plotësojnë kriteret për subvencione të Ministrisë së Bujqësisë. Kemi ndarë subvencion për 406 fermerë ose 320 hektarë kemi arritur t’i mbulojmë, ndërsa vlera e projektit është rreth 15 mijë euro. Është farë hibride kualitative dhe është njëri nga projektet që e prek shtresën që është më se e nevojshme. E falënderoj kryetarin për mbështetjen që po e bënë për të gjithë fermerët”, ka thënë Ramadani. Nga ana e tyre, bujqit Mefail Ramushi nga Llashtica dhe Naser Aliu nga Nasala, e kanë falënderuar kryetarin Haziri për mbështetjen e sotme, të cilën e kanë vlerësuar tejet të rëndësishme për sigurimin e mirëqenies për familjet e tyre. Përndryshe, në ditët në vazhdim Komuna e Gjilanit do të bëjë subvencionimin e serrave, centrifugave për bletarët, sikurse edhe me mekanizim bujqësor.



Lutfi Haziri: Llashtica është Reçaku i Anamoravës

13
PRILL

Fshati Llashticë i Gjilanit ka përkujtuar sot 26 martirët e vrarë nga forcat serbe 17 vite më parë, në mesin e të cilëve kishte edhe foshnje 3 javësh. Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri me bashkëpunëtorë, pasi ka bërë homazhe tek varret e të rënëve, ka thënë se masakra e Llashticës është dhe Reçaku i Anamoravës.

“Prilli shënon dhimbjen më të madhe të masakrës së Llashticës, e që është Reçaku i Anamoravës. Në këtë masakër nuk u kursye askush, as Luli 11 vjeç. Përmes Llashticës, ne kujtojmë edhe masakrën e Llovcës, Lladovës, Zhegrës dhe të gjithë të rënët e prillit, majit e qershorit. Gjaku i tyre është gjaku i lirisë, por gjaku që bënë dritë e që nuk shuhet kurrë është gjaku i fëmijëve.

Pafuqinë që të luftojnë me ata që kanë qenë në front, ata u hakmorën në fëmijë, pleq e plaka. Sot ne e kujtojmë me gjuhëzim dhe lus familjet që të bëhen të fortë”, ka thënë Haziri. Ndërkaq, drejtori i shkollës fillore “Esat Berisha”, Nehat Shabani, ka evakuuar kujtime edhe për nxënësin e kësaj shkolle Lulzim Musliu, i cili ishte vetëm 11-vjeç kur u vra nga forcat serbe. “Si 11-vjeçar, tek Lulzimi vërehej një ngrohtësi dhe një dashuri për shkollën. Ai ishte nxënës i shkëlqyeshëm. Populli ynë ka kaluar shumë vuajtje, mundime e luftëra, por kjo e fundit e vitit 1999 ishte nga më barbarët pasi që nuk u kursyen as fëmijët”, tha Shabani. Në këtë tubim janë lexuar poezi të përgatitura nga nxënësit e shkollës “Esat Berisha”, me tematikë patriotike dhe në kujtim të të rënëve.



Gjilani fiton projekt 200 mijë euro për rregullimin e varrezave

12
PRILL

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është njoftuar zyrtarisht nga zyra e UNDP-së në Kosovë se Komuna e Gjilanit është përzgjedhë si përfituese e projektit “Ngritja e Besimit përmes Mbrojtjes Kulturore në Kosovë” që financohet nga Komisioni Europian.

Gjilani ka konkurruar në këtë program me projektin për rregullimin e varrezave të qytetit dhe për të ka pasë përkrahjen e të gjitha komuniteteve fetare të Gjilanit. “Ne po vazhdojmë ta bëjmë Gjilanin qendër rajonale dhe përmes qeverisjes së

mire dhe efektive po shtojmë përkrahjen ndërkombëtare për komunën tonë” ka thënë kryetari Haziri. “Projekti i rregullimit të varrezave të qytetit ka karakter edhe kulturor edhe të trashëgimisë për ne, prandaj i jemi mirënjohës UNDP-së dhe Komisionit Europian për përkrahjen e tyre”, ka shtuar kryetari Haziri. Projekti kap shifrën mbi 200 mijë euro dhe financohet nga programi “Ngritja e besimit përmes mbrojtjes kulturore në Kosovë”. Komuna e Gjilanit dhe UNDP do të fillojnë përgatitjet për realizimin e këtij projekti në javët në vijim.



Në Gjilan fillon kultivimi i mjedrës

6
PRILL

Komuna e Gjilanit ka nisur sot zyrtarisht mbjelljen e fidaneve të mjedrës së subvencionuar për 39 bujq, që kap vlerën e 60 mijë eurove, e që realizohet në bashkëpunim me kompaninë “Fresh Fruti”. Në këtë ngjarje, e cila ka nisur në plantacionin e fermerit Fazli Fazliut në Përlepnicë, ka marrë pjesë nënkryetari

i Komunës, Rexhep Kadriu, drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani dhe struktura tjera komunale.

“Me mbështetjen e fuqishme të kryetarit Haziri, Komuna e Gjilanit, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë po fillon sot projektin e mbjelljes së mjedrës për 39 përfitues. Dua të them se

Komuna do të jetë gjithmonë mbështetëse e bujqve, të cilët e duan punën dhe duan të tregojnë rezultate”, ka thënë me këtë rast nënkryetari Kadriu. Ndërkaq, drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë në Gjilan, Ramiz Ramadani, ka thënë se Komuna ka subvencionuar për herë të parë mjedren meqë është mjaft fitimprurëse, duke e konsideruar si ‘ari i kuq’. “Sot është lajmi më i mirë dhe projekti më atraktiv, meqë mjedra konsiderohet ‘arit i kuq’. Është prodhimtari vërtetë e perspektivës së lartë dhe ne kemi qenë shumë këmbëngulës që të fillojmë me këtë projekt, i cili realizohet në dy faza, në pranverë dhe në vjeshtë. Sot kanë përfituar 39 fermerë, ose 10 hektarë të mbjella me fidane. Interesimi i qytetarëve ka qenë jashtëzakonisht i madh dhe ne e kemi bërë përzgjedhjen me kriteret mjaft të ashpra. Intenca është që këta fermerë të jenë model për fermerët tjerë”, është shprehur Ramadani. E rëndësishme, sipas Ramadani, është se shitja e prodhimit është e garantuar. “Partneriteti i Komunës së kompanisë “Fresh

Fruti” garanton shitjen e prodhimit, e që është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe besoj që edhe pse është kulturë e re, gjithçka do të shkojë mirë, ngase partneri ynë USAID e ka të angazhuar një ekspert për këtë lëmi, ndërsa Drejtoria e Bujqësisë ka dy. Duhet thënë se vëmendje të veçantë i është kushtuar kryesisht fshatrave kodrinore-malore, sikurse edhe disa fshatrave tjerë, të cilat janë përdorë si model. Kjo kulturë, kudo që është kultivuar, ka dhënë rezultate të mëdha”, ka shtuar drejtori i Bujqësisë së Gjilanit. Sherafedin Gashi, pronar i kompanisë “Fresh Fruti”, ka dhënë zotimin se kompania e tij do ta bëjë grumbullimin e mjedrës nga fermerët e Gjilanit, duke ua garantuar shitjen, e cila në vitin e kaluar ka shkruar deri në 2 euro për kilogram, varësisht nga tregu. Përndryshe, participimi i fermerëve është vetëm në sistem të ujitjes, derisa pjesa tjetër është e Komunës së Gjilanit dhe partnerit strategjik “Fresh Fruti”.

Avancimi politik i gruas në Gjilan, meritë e kryetarit Haziri

4

PRILL

Në seminarin e organizuar nga organizata nacionale “Lobi për barazi gjinore” në Shqipëri, kanë marrë pjesë gratë përfaqësuese të 26 Komunave të Kosovës. Nga Gjilani kanë marrë pjesë kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuesja e Grupit Joformal të Gruas, Rina Ahmeti si dhe drejtoresha e OJQ “Psikoterapeutët në Veprim” Sevdie Musliu. Gjilani shquhet në respektimin e të drejtave gjinore. Meritat për këtë, Bunjaku-Rexhepi i ka adresuar te kryetari i Komunës, Haziri.

Ky seminar kishte temë diskutimi “Kriteret të cilat duhet të plotësohen që Kosova, të anëtarësohet në BE”, ku të gjitha përfaqësueset nga Komunitet e Kosovës kanë dhënë kontribut të çmuar me diskutimet e tyre gjatë këtij debati si dhe të arriturat në përmirësimin e pozitës së gruas në vendimmarrje. Me këtë rast ndër të tjerash kryesues-

ja e Kuvendit Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se të arriturat në Komunën e Gjilanit në këtë drejtim janë evidente në barazinë gjinore. “Në Komunën e Gjilanit arriturat janë evidente në fushën e barazisë gjinore si dhe përfshirjen e mbi 500 zonjave gjilanasë në rrjetin lobues, çka ka ngjallur interesimin e jashtëzakonshëm të përfaqësuesve të Komunave të Kosovës”, ka thënë ndër të tjerash Bunjaku-Rexhepi. Ajo këto merita në avancimin e femrës, ia dedikoi angazhimit dhe mbështetjes së madhe të kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili sipas saj çdo herë prinë në përkrahje të nismave të mira që janë në interes të qytetarëve. Ndryshe, organizatorët e Lobit për Barazi Gjinore, takimin e radhës vendosën që ta mbajnë në Gjilan, pasi që Komuna e Gjilanit, u vlerësua më e suksesshme në këtë arritje, krahasuar me Komunitet tjera të Kosovës.



Lladova kujton 2 prillin e rënies së dëshmorëve

2
PRILL

Në 17-vjetorin e rënies, me një tubim madhështor, janë përkujtuar dëshmorët në fshatin Lladovë, që ishin pjesë përbërëse e kontributit të madh të lirisë së Kosovës. Njëra nga familjet e kë-tushme, ajo Ajeti, edhe sot, 17 vjet më vonë nuk e ka gje-tur trupin e familjarit të vetë. “Vepra e tyre i bënë të pa-vdekshëm dëshmorët”, ka thënë nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, në tubimin e Lladovës.

Ky aktivitet ka nisur me homazhe tek përmendorja e dëshmorëve në hyrje të këtij fshati, e më pas ka vazh-duar tubimi përkujtimor në shkollën e fshatit. Me këtë rast nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, ka thënë se lirisë së Kosovës është falë një kontributi shumë të madh që kanë dhënë dëshmorët e Grykës së Karadakut dhe Anamoravës në përgjithësi, e në veçanti dëshmorët e rënë nga Lladova. “Sot e 17 vjet më parë e gjithë Kosova por edhe fshati Lladovë përjetoj tragjedi të madhe duke humbur më të dashurit tuaj, nga një reg-jim dhe forca të armatosura serbe. Në Lladovë u vranë, u masakruan dhe u torturuan në mënyrën më jonjerëzore këta banorë vetëm pse ishin shqiptarë. Dëshmorët në përgjithësi, por edhe dëshmorët e Lladovës, ranë për të mos vdekur kurrë. Ata për ne kanë vetëm ditëlindje. Edhe sot e asaj dite ankthi në familjen Ajeti vazhdon, sepse trupi i familjarit të tyre ende nuk dihet se kah u dërgua”,

ka thënë nënkryetari Kadriu. Ai ka thënë se përkujtimi për dëshmorët, përlulja për ta, kujtimi i veprave të tyre, do të jetë përherë minimumi i asaj që bëjmë ne sot, në krahasim me veprën e tyre dhe sakrificën që bënë ata për lirinë dhe rrugëtimin e Kosovës. Ndërsa, Shefket Latifi, përgjegjës i shkollës në këtë fshat por edhe në emër të këshillit organizativ, ka thënë se “dëshmorët janë ata që me gjoksin hapur dolën para okupatorit për t’i bërë me dije se Lladova është rezistuese ndaj çdo okupatori dhe se angazhimi i përhershëm i tyre ishte për liri. Frika për këta dëshmorë nuk ka ekzistuar. Gjaku i tyre është jeta jonë dhe garancia e lirisë së Kosovës”, ka thënë Latifi, duke spikatur ndihmën e madhe të dhënë nga SHBA-të dhe NATO, për UÇK-në. Po ashtu, në emër të Shoqatës “2 prilli”, që vepron në Zvicër, të pranishmit i ka për-shëndetur edhe Besnik Ajeti-Benz, i cili ka falënderuar ata që kanë nderuar këtë tubim, duke thënë se kontributi dhe sakrifica e dëshmorëve të luftës, veteranëve të UÇK-së dhe invalidëve, janë ato që neve na mundësojnë sot të jetojmë e zhvillohemi të lirë. “Falënderim i përhershëm për dëshmorët dhe të rënë në luftë për liri, por edhe për të gjithë të gjallët të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëza-konshëm në lirinë e vendit”, ka thënë ai ndër të tjera. Më pas para të pranishmëve të shumtë është shfaqur një pro-gram i pasur kulturo-artistik.



Ndahen 100 pako ushqimore për familjet me gjendje të rëndë sociale

31
MARS

Bashkësia Islame në Gjilan, së bashku me Komunën e Gjilanit, kanë bërë shpërndarjen e 100 pakove ushqimore për familjet të cilat jetojnë në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, në mënyrë që edhe këto familje, për një kohë, të mos kenë mungesë të gjerave elementare për jetë. Për fat të keq, rastet që kanë nevojë për ndihma, ende janë të mëdha. Qytetarët që kanë mundësi të ndihmojnë, duhet të solidarizohen me njerëzit në nevojë.

Kryetari i sapa zgjedhur i Bashkësisë Islame, Naim Aliu dhe drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Nexhat Hajrullahu, në mënyrë simbolike kanë bërë sot shpërndarjen e këtyre pakove ushqimore. Me këtë rast kryetari Aliu ka thënë se kjo është një ndihmë dhe

mbështetje e vogël karshi kërkesave shumë të mëdha të familjeve në nevojë në Gjilan. “Kjo është një mbështetje e përkohshme për familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale. Bashkësia Islame periodikisht ka ndarë pako të tilla ushqimore dhe kështu falë edhe angazhimit të përbashkët në BIK, në Gjilan, kjo është bërë e mundur herë pas here. Apelojmë edhe tek të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë, të cilët kanë mundësi, që të solidarizohen me familje të tilla”, ka thënë ai ndër të tjerash. Kurse drejtori Nexhat Hajrullahu, ka falënderuar Bashkësinë Islame për mbështetjen me këto pako ushqimore, duke potencuar se është një mbështetje e mirë për këto familje edhe përkundër që raste të tilla fatkeqësisht kemi ende shumë në Gjilan.

Kuvendarët e Gjilanit miratuan raportin financiar janar-dhjetor 2015

31
MARS

Kuvendi Komunal i Gjilanit, të enjten, në mbledhjen e radhës, të cilën e ka kryesuar Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka miratuar raportin financiar janar-dhjetor 2015, disa ndryshime në rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, ndarjen e subvencioneve për tri shoqata dhe katër klube sportive në vlerë prej 96.500 euro si dhe ka diskutuar për manifestimin tradicional “Flaka e Janarit” 2016.

Kuvendi, me kërkesën e kryesueses, ka votuar për përfshirjen nga seanca të këshilltarit serb Srgjan Mitrovic, në pritje për zëvendësimin e tij, meqë është emëruar në krye të strukturave paralele. Sa i përket raportit financiar, Zijadin Maliqi, drejtor për Buxhet, ka thënë se versioni i shkruar i përmban hollësisht të gjitha të dhënat mbi të hyrat dhe shpenzimet, por është shprehur i gatshëm të japë edhe sqarime shtesë në interesimet e anëtarëve të Kuvendit. Maliqi ka thënë se Gjilani është ndër komunat më të mira në Kosovë sa i përket të hyrave, me 94 për qind realizim të planit. Për shkak të paralajmërimit për faljen e borxheve, ka pasur një ngecje të përkohshme të tatimit në pronë, derisa ka filluar zbatimin e ligjit, ka thënë Maliqi. Pozita (LDK e AAK) i kanë dhënë përkrahje të plotë raportit, ndërsa opozita (PDK e VV) janë shprehur të pakënaqura me raportin dhe nuk e kanë votuar atë. Avdyl Aliu (LDK) ka thënë se raporti paraqet gjendjen financiare të Komunës në mënyrë shumë reale, sikurse edhe Selami Xhemajli (AAK), i cili ka vlerësuar se raporti përmban të dhëna të mjaftueshme dhe për më tepër, ka thënë ai, drejtori Zijadin Maliqi është i gatshëm të japë sqarime plotësuese në të gjitha interesimet. Riad Rashiti (PDK) ka thënë se raportit financiar i mungon pjesa analitike. Nuk ka informacione për shpenzimet e grantit qeveritar, as për donacionet dhe të tjera. Rashiti, i cili i bëri një analizë të hollësishme raportit, tha se të hyrat vetanake kanë shënuar rënie. Krenare Latifi (VV), ka thënë se ka dallime të planifikimi fillestar dhe ai përfundimtar i të hyrave. Te disa kategori ka ngecje në realizimin e të hyrave, kurse te disa sosh, ka tejkalim të shpenzimeve, ka thënë ajo. Në debatin për raportin financiar kanë marrë pjesë edhe Nevzad Isufi (VV), Shukrije Rapuca (PDK), Ismet Hajdini (AKR), Isa Agushi (LDK) dhe të tjerë. Sqarime plotësuese kanë dhënë drejtori Zijadin Maliqi si dhe drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, për çështjet që kishin të bënin me sektorin e tij. Kuvendi ka miratuar edhe ndryshimet dhe plotësimet në rregulloren për tarifa komunale, ku përfshihen edhe tarifat për shfrytëzimin e tri qendrave të reja rekreative-sportive. Fehmi Sylejmani (VV) ka kërkuar që në rregulloren të parashihen edhe tarifa alternative për shfrytëzuesit e këtyre hapësirave sportive-rekreative si dhe disa të tjera, të ulen. Debat ka nxitur edhe informata për



manifestimin “Flaka e Janarit 2016”. Bujar Nevzati (PDK) tha se nuk ka vërejtje të shumta të shpenzuara, por tha se mungon një raport analitik mbi shpenzimet. Avdyl Aliu (LDK) tha se shpenzimet janë reduktuar përgjysmë në krahasim me qeverisjen e kaluar. Shpresa Kurteshi (LDK) tha se informata është shqyrtuar në Komitetin e Kulturës, por nëse ka nevojë, një raport më i gjerë mund të silllet në seancat e ardhshme të Kuvendit, ka thënë ajo, duke shtuar se këtu nuk ka asgjë për të fshehur. Nevzad Isufi (VV) ka thënë se është e pa kuptueshme që një manifestim me 25 vjet traditë, nuk e ka ende një rregullore. Kuvendi ka miratuar edhe shtatë kërkesa për subvencionimin e klubeve dhe shoqatave, në vlerë prej 96.500 euro. Duke i ftuar anëtarët e Kuvendit që t'i përkrahin këto kërkesa, Malazog Hoxha, përgjegjës për sport, ka thënë se të gjithë në mburremi me këto klube sportive, kur ato arrijnë suksese të mira dhe ka rikujtuar se në Gjilan organizohet spektakli më i madh i futbollit në rajon. Kësisoj, sipas këtij vendimi, KF “Drita” do të subvencionohet me 33 mijë euro, KF “Gjilani” – me 30 mijë, KV “Drita” (femrat) me 10 mijë, Klubi i basketbollit “Drita” (M) – 8 mijë, kurse Shoqata e të Verbërve – me 5.500, Qendra e Gruas “Liria” – me 5 mijë, Këshilli i Veprimtari Rinor Lokal – me 5 mijë. Nevzad Isufi (VV) pati vërejtje të raporti i Qendrës “Liria” për vitin e kaluar, duke thënë se shpenzimet nuk janë arsyetuar si duhet dhe kërkoi auditim të gjendjes atje, para se të vendoset për ndarjen e mjeteve tjera. Kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku-Rexhepi ka thënë se do të formohet një komision, i cili do monitorojë në të ardhmen punën e këtyre shoqatave. Përndryshe në pjesën e debatit, Sahit Abazi (PDK) kërkoi që në këtë seancë të diskutohet edhe për gjendjen e Teatrit dhe financimin e Këshillave lokalë, siç jemi marrë vesh në Komitetin për Politikë dhe Financa, tha ai. Kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku-Rexhepi ka thënë se është e vërtetë që në KPF kemi diskutuar për Tetarin dhe Këshillat lokalë, por nuk jemi marrë vesh që t'i fusim në rend dite të Kuvendit Komunal.



Haziri merr konfirmimin për pranimin e Gjilanit në Strong Cities Network në Londër

29
MARS

Në vazhden e punës intensive për ta bërë Gjilanin qendër të rëndësishme të zhvillimit jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pranuar sot konfirmimin zyrtar nga Dan Hooton, drejtor ekzekutiv i Strong Cities Network (SCN), për pranimin e Komunës së Gjilanit si anëtare e plotë e këtij rrjeti ndërkombëtar të qyteteve, me seli në Londër. SCN është themeluar në vitin 2015 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

“Gjilani ka qenë dhe mbetet simbol i demokracisë dhe tolerancës në Kosovë, por edhe në rajon. Ne jemi të gatshëm që të punojmë edhe më tutje në zhvillimin e qendrueshëm të Komunës sonë përmes bashkëpunimit me qytete tjera nga Evropa dhe metropolet botërore,” ka thënë kryetari Haziri. “Me anëtarësimin tonë në SCN, neve na është dhënë mundësia të jemi pjesëmarrës me

rëndësi në këtë rrjet”, ka shtuar Haziri. Kurse, në letrën konfirmuese për pranimin e Gjilanit si anëtar fuqiplotë në SCN, drejtori ekzekutiv, Dan Hooton, ai ka falënderuar Gjilanin dhe kryetarin Haziri për gatishmërinë që të jenë pjesë e SCN, duke e ftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në Samitin e Parë të SCN-në që do të mbahet më 11 dhe 12 maj 2016, në Antalya të Turqisë. Strong Cities Network (SCN) është themeluar në shtator 2015 me aprovim të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe me përkrahje të fuqishme nga Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara. Anëtarët e parë të rrjetit u bënë qytetet më kryesore botërore si New York City, Parisi, Montreali, Londra, Roma, etj. Qëllimi kryesor i SCN është krijimi i mundësive për bashkëpunim sa më të qendrueshëm në mes qyteteve sidomos në aspektin e punës kundër ekstremizmit dhe ndërtimit të komuniteteve sa më kohezive ndërkombëtarisht.



Bëhen nderime tek lapidari i dëshmorit Agim Rashiti

28
MARS

Në nderim të rënies së dëshmorit Agim Rashiti, sot janë mbledhur për të bërë homazhe pranë lapidarit të tij udhëheqës të institucioneve lokale e qendrore, mjekë, sportistë e familjarë. Me këtë rast, kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, Valentina Bunjaku – Rexhepi, e shoqëruar edhe nga ministri i Shëndetësisë, nënkryetari i Komunës dhe drejtorë të drejtorive komunale, ka thënë se homazhet për dëshmorët janë më e pakta që mund të bëjmë ne për ta.

“Kjo është më e pakta që ne mund të bëjmë për dëshmorët dhe familjet e tyre. Nga këto takime ne përherë dalim edhe më të përkushtuar që të vazhdojmë me punë në zhvillim, ndërsa familja dhe kolegët duhet të bëhen të fortë për njeriun e tyre që kishin me vlera të larta shoqërore dhe kombëtare”, ka thënë ajo ndër të tjer-

ash. Kurse nga ana e tij nënkryetari Rexhep Kadriu ka thënë se vetëm atëherë kur gjendemi para lapidarëve e kuptojmë se sa e dhembshme dhe me sa sakrifica është arritur liria. “Vetëm në rastet kur jemi para dëshmorëve, heronjve dhe martirëve, e kuptojmë vërtetë mungesën e madhe që ata kanë lënë në mesin tonë. Njëkohësisht kuptojmë edhe realitetin e sakrificës së madhe që ata bërë për lirinë e Kosovës. Liria vërtetë është shumë e shtrenjtë, ajo ka marrë me vete shumë djem e vajza për Kosovën e lirë”, ka thënë ai ndër të tjerash. Kurse në emër të familjes të pranishmit i ka përshëndetur, Nevzad Rushiti, i cili ka falënderuar të gjithë që edhe pas 27 vjetëve, siç ka thënë ai, nuk është harruar Agimi dhe veprimtaria e tij për Kosovën. Me vizita në këtë familje ka përfunduar edhe shënimi i kësaj dite.



Kadriu: Ruajtja e ambientit dhe pastërtisë publike është obligim i përbashkët

25
MARS

Grupet e ekologëve nëpër shkollat fillore dhe të mesme të Gjilanit, sot kanë mbajtur një aktivitet simbolik, në kuadër të promovimit të ruajtjes së ambientit, pastërtisë dhe zgjerimit të hapësirave të gjelbra. Me këtë rast, nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, me drejtorët komunalë ka qenë pjesë e këtij aktiviteti dhe njëkohësisht ka apeluar te qytetarët që të ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e ambientit dhe vendit ku jetojmë.

“Gjilani ka një park, që është pasuri e madhe në qendër të qytetit. Apeloj që të edukojmë fëmijët që nga mosha

e hershme e tyre, pastaj tutje, për ruajtjen dhe zhvillimin e hapësirave të gjelbra, ngase sa më shumë që kemi gjelbërim dhe drurë, aq më i mirë do të jetë shëndeti dhe gjendja jonë shëndetësore. Urojmë që bashkërisht të kemi angazhime dhe punë të përditshme në ruajtjen dhe mbrojtjen e natyrës, sepse ajo në të vërtetë është mbrojtja dhe ajri ynë”, ka thënë ai ndër të tjerash. Kadriu dhe drejtorët kanë qenë pjesë e fotove të cilat promovonin mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e tij. Apel i përbashkët ishte që gjithçka që është e mundur të riciklohet, të bëhet menjëherë dhe bashkërisht me të gjithë qytetarët të ndikohet në ndalimin e hedhjes së mbeturinave vend e pa vend.



Haziri: Do të iniciojmë amandamentimin e ligjit për shtetësi në Kosovë

23
MARS

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, sot ka pritur në një takim pune deputetin e Parlamentit të Serbisë, Shaip Kamberi, i cili është edhe udhëheqës i subjektit politik Partisë për Veprim Demokratik në Bujanoc, me të cilin kanë biseduar për mundësinë e bashkëpunimit në fushën e zhvillimit lokal ekonomik, por edhe në fushën e bujqësisë.

Ata gjatë bisedës kanë rrahur edhe çështjen e problematikës së shtetësisë së shqiptarëve nga kjo anë në Kosovë, sikur që është debatuar edhe për çështjen e dokumentacionit të vendbanimeve për shqiptarët e asaj ane të cilat tashmë në një pjesë mjaftë të madhe është pasivizuar vendbanimi për një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të asaj ane atje. Me këtë rast kryetari Haziri, ka thënë se misioni dhe vizioni politik i Luginës së Preshevës është i qartë tash e 26 vjet më parë, duke spikatur bashkëpunimin në fushën e ekonomisë mes dy Komunave shqiptare. “Biseduam me veprimtarin e dalluar të çështjes kombëtare për mundësinë e bashkëpunimit shtesë në sektorin e zhvillimit ekonomik – lokal mes dy komunave shqiptare nga dy anët e kufirit. Tradita e bashkëpunimit mes bizneseve të Gjilanit dhe Bujanocit ka qenë e përhershme dhe e vazhdueshme. Bizneset nga dy anët e kufirit janë ato që kanë dhënë impute jo vetëm në këto dy Komuna por në gjithë vendin”, ka thënë në fjalën e tij kryetari Haziri. Ai më tej ka potencuar iniciativën që do të merret gjatë të ardhmes pikërisht nga

zyra e kryetarit të Gjilanit, për amandamentim të ligjit për shtetësi në Republikën e Kosovës, në mënyrë që të krijohen lehtësira më të mëdha, që qytetarët e asaj ane të kenë të drejtën e shtetësisë edhe në Kosovë, ngase Kushtetuta e vendit e njeh dyshtetësinë. Ndërsa, nga ana e tij deputeti Kamberi, ka thënë se ky takim është në vazhden e takimeve tashmë tradicionale për t’i dhënë një shtytje më të madhe bashkëpunimit ekonomik dhe përvojave të bashkëpunimit ekonomik të dy Komunave. “Meqenëse bizneset në Komunën e Bujanocit përditë e më shumë po rrezikohen nga politika diskriminuese e Serbisë është i domosdoshëm bashkëpunimi rajonal. Për këtë na duhet të përdoren metodat e bashkëpunimit ekonomik në nivelin lokal dhe rajonal. Mundësitë më të mëdha të bashkëpunimit janë në fushën ekonomike, por edhe në rrafshin e bashkëpunimit në fushën e bujqësisë, konkretisht të prodhimit të duhanit, kur kemi parasysh mundësinë e aktivizimit të Fabrikës së Duhanit në Gjilan”, tha ai në fjalën e tij. Kurse lidhur me shlyerjen e adresave të banimit tek një pjesë e madhe e qytetarëve të Medvegjës dhe Bujanocit, ai ka thënë se “deri më tani askush nuk është shlyer nga adresat e vendbanimit, por, përkohësisht iu është pasivizuar adresa e vendbanimit një numri të qytetarëve, ndërsa Komuna e Bujanocit nëse vazhdohet kështu, rrezikon që gjashtë vendbanime të zbrazen zyrtarisht, mirëpo me ndërhyrjen e Prishtinës dhe Tiranës zyrtare mund të bëjmë ndryshime në të mirë të qytetarëve.

Kërkesat e fëmijëve për kryetarin: mbështetja e aksionit të solidaritetit dhe rregullimi i trotuarit

23
MARS

Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ka pritur sot një grup të fëmijëve, të cilët kishin dy kërkesa: njëra kishte të bënte me mbështetjen e Komunës në aktivitetin e tyre bamirës e solidar për familjet në nevojë, duke u siguruar atyre një tendë për shitjen e gjërave ushqimore në qytet, më datë 24 mars, kurse kërkesa tjetër ishte për rregullimin e trotuarit në rrugën “Esat Berisha”.

Në këtë takim fëmijët kanë kërkuar nga kryetari Haziri, sigurimin e një tende, në mënyrë që gjatë ditës së nesërme me datën 24 mars ata të bëjnë shitjen e produk-

teve të ndryshme ushqimore dhe fitimi nga ky aktivitet do të shkojë për familjet që janë me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale. Kërkesa tjetër ishte për rregullimin e trotuarit për këmbësorët në rrugën “Esat Berisha”. Me këtë rast kryetari Haziri gjatë këtij takimi ka thënë se do të mbështeten nga Komuna e Gjilanit, edhe ajo e solidarizimit me familjet skamnore por edhe kërkesa për trotuar gjithashtu, ngase sipas kryetarit Hazirit që të dy këto kërkesa kanë qëllim mirëqenien dhe sigurinë e qytetarëve. Ndryshe, ky ishte takim në kuadër të takimit të kryetarit me qytetarët e Gjilanit.

Haziri është takuar me Grupin Punues për Komunikim të gjerë dhe vendimmarrje të përbashkët

21
MARS

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri është takuar sot me Grupin e Përbashkët Punues, të cilët janë të angazhuar në përmirësimin e komunikimit mes shumicës dhe pakicës, e që është nismë e cila mbështetet nga USAID, respektivisht programi, Avancojmë Kosovën së Bashku.

Me këtë rast kryetari Haziri, ka ofruar bashkëpunim dhe mbështetje për këtë grup punues, duke garantuar mbështetjen e pa rezervë në intensifikim të punës dhe përmirësim të komunikimit ndëretnik por edhe ndërshoqëror në Gjilan. Në çdo moment jam afër kërkesave tua, në mënyrë që komunikimi mes shumicës dhe pakicës, por edhe komuniteteve pakicë me shumicën të jetë në nivel më të lartë dhe gjithnjë me trende pozitive. Ndërsa, Grupi i Përbashkët Punues, ka punuar planin vjetor të punës dhe i ka dorëzuar kryetarit një kopje në të cilin janë të përfshira aktivitetet e saj, të cilat kanë për synim rritjen e përfshirjes së qytetarëve të Gjilanit në proceset e vendimmarrjes, hartimin e përbashkët të buxhetit dhe po ashtu mënyrën se si ta ndihmojë komunën në monitorimin e projekteve të miratuara në buxhetin komunal.



Ndryshe, USAID respektivisht programi Avancojmë Kosovën së Bashku në bashkëpunim me RTC Consulting, janë duke zbatuar një sërë aktivitete që kanë për qëllim përmirësimin e komunikimit horizontal në mes të shumicës dhe komuniteteve jo-shumicë dhe pushtetit lokal dhe komuniteteve jo-shumicë dhe po ashtu rritjen e efikasitetit dhe kapaciteteve të administratave komunale të synuara për t’iu përgjigjur nevojave të të gjithë qytetarëve të tyre në 12 komuna që punon AKT.



Gjilani, marrëveshje me Brusën për praktikë profesionale për mësimdhënës dhe nxënës të teknikës

16
MARS

Drejtori i Arsimit në Komunën e Gjilanit, Nazmi Musa dhe drejtori i Arsimit në Brusë, Veli Salihaja, kanë nënshkruar dje marrëveshjen për praktikën dy mujore në Brusë të Turqisë, për ngritjen profesionale të mësimdhënësve dhe nxënësve nga shkolla teknike të Gjilanit.

Këtë e mundësoi shoqata “Kosova-Shkup” në krye me veprimtarin e madh nga Brusa e Turqisë, Rexhep Gyndiz, derisa kontribut për këtë marrëveshje të rëndësishme ka dhënë edhe biznesmeni nga Turqia me prejardhje nga Gjilani, Faredin Gylener. Gyner ofroi mjete materiale dhe strehim dhe akomodim dymujor për të gjithë nxënësit që

janë përfutues dhe të përzgjedhur të vijojnë kursin. Drejtori i DKA-së Nazmi Musa, i cili po qëndron në vizitë zyrtare në Turqi, ka falënderuar drejtorin Salihaja dhe biznesmenin Faredin Gylener për këtë mbështetje tejet të rëndësishme për Turqinë, për ngritjen profesionale të mësimdhënësve dhe nxënësve të Gjilanit. Zyrtarët nga Komuna e Brusës u shprehën të kënaqur me mundësinë e bashkëpunimit me Komunën e Gjilanit, duke shpresuar ky është vetëm fillimi i një bashkëpunimi afatgjatë. Nga ana e tij, Rexhep Gyndiz, kryetar i shoqatës “Kosova-Shkup”, i cili ishte ura lidhëse në mes dy Komunave, ka falënderuar edhe biznesmenin Faredin Gylener, i cili, nuk ka kursyer mjetet për bashkëkombësit e tij të origjinës.



Komuna me donatorët ndërtojnë shtëpi për Naser Hazirin në Zhegër

14
MARS

Është vënë sot gurthemeli i shtëpisë së Naser Hazirit në Zhegër të Gjilanit, e 27-ta me radhë që po ndërtohet përmes fondit të solidaritetit, pas mbrëmjes humanitare “Pak nga ne, shumë për ata”, të organizuar me iniciativë të kryetarit Haziri. Brenda tri ditësh do të fillojë ndërtimi edhe i tri shtëpive të reja për nevojtarë, ndërkohë do të vazhdohet me rinovimin e 35 shtëpive, ka thënë Haziri.

Në vënien e gurthemelit ka marrë pjesë kryetari Lutfi Haziri me bashkëpunëtorë dhe donatori Hysen Hyseni, pronar i “Ceni Company”. “E falënderoj donatorin Hyseni Hyseni, i cili pa hezitim i është përgjigjur thirrjes sime për t’u dalë në ndihmë familjeve në nevojë. Sot është vënë gurthemeli i shtëpisë së 27-të, në kuadër të programit për zgjidhjen e problemit të banimit social. Besoj

shumë që në afat rekord do të përfundohet nga donatori “Ceni Company” dhe familja e Naser Hazirit do të bëjë jetë dinjitoze. Ky është qëllimi ynë që të gjitha familjeve t’ua zgjidhim problemin e banimit”, ka thënë pas vënies së gurthemelit, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri. Nga ana e tij, donatori Hysen Hyseni ka përgëzuar kryetarin Haziri për iniciativën kaq të suksesshme për t’u dalë në ndihmë familjeve në nevojë, duke shtuar sapo e ka dëgjuar apelin, i është përgjigjur menjëherë sepse, siç tha “nuk ka ndjenjë më të mirë se sa t’i sigurosh një familje kulm mbi kohë nga të ardhurat e biznesit tënd”. Kryetari Haziri ka bërë të ditur se brenda 10 ditësh do të fillojë ndërtimi edhe i 3 shtëpive të reja për familjet në nevojë, derisa është shprehur se Komuna është duke bërë pagesën e qirasë për 40 familje, ndërkaj do të vazhdohet edhe me rinovimin e 35 shtëpive, sipas kërkesave të qytetarëve.



Mbi 300 atletë nga Kosova dhe rajoni në “Vrapimi i Qytetit – Gjilani 2016”

13
MARS

Në përkujtim të Pranverës Studentore të vitit 1981, nën përkujdesjen e kryetarit Lutfi Haziri, Njësia për Sport e Komunës së Gjilanit, ka organizuar Manifestimin Sportiv Ndërkombëtar në Atletikë “Vrapimi i Qytetit Gjilani 2016” me pjesëmarrje të mbi 300 atletëve më të mirë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Mali i Zi. I pari në kategorinë e seniorëve doli Suad Kryeziu nga Rogana, ndërkaq në kategorinë e senioreve, Luljeta Shala nga Llapi.

Në emër të kryetarit Haziri, garën e ka shpallë të hapur udhëheqësi i Njesisë për Sport, Malazog Hoxha, i cili ka vlerësuar se ky vrapim është mënyra më e mirë se si do të duhej të kujtohet vepra e studentëve të vitit 1981, të cilat ishin model i rezistencës ndaj regjimit të egër. Ndërkaq, kryetari i Federatës së Atletikës së Kosovës, Halil Sylejmani, ka deklaruar se me organizimin e kësaj ngjarje tradicionale sportive, për të 14-tën herë me radhë, Komuna e Gjilanit po dëshmon se respekton rezistencën e studentëve ndaj pushtuesit, por në njëjtën kohë edhe i

motivon dhe i vlerëson atletët. Vrapimi është zhvilluar në shtegun e gjatë 11 mijë e 300 metra për seniorë dhe seniore, për juniorë dhe juniore 4300, për pionierë dhe pioniere 2000 metra, kurse për veteranët 4300, derisa për personat me nevoja të veçanta, 800 metra. I pari nga ky shteg në kategorinë e seniorëve doli Suad Kryeziu nga Rogana, ndërkaq në kategorinë e senioreve, Luljeta Shala nga Llapi. Në kategorinë e juniorëve pozitën e parë e fitoi Berkan Emini nga Shkupi, derisa Fiolla Geci nga Rogana doli e para si juniore. Dario Ivanovski nga Shkupi u shpall fitues në kategorinë e pionierëve, ndërkohë vendi i parë për kategorinë e pionierëve i takoi Gentiana Pecit nga Mitrovica. Ndërkaq, në kategorinë e veteranëve çmimin e parë e mori Xhavit Tahiri nga Mitrovica, përderisa Avdi Ibishi në kategorinë e personave me nevoja të veçanta. Në fund, në mënyrë solemne ia dorëzuan kupat fituesve, udhëheqësi i Njesisë për Sport në Gjilan, Malazog Hoxha dhe kryetari i Federatës së Atletikës, Halil Sylejmani.



Përrurohet objekti modern i Shtëpisë së Rinisë në Gjilan

10
MARS

Është përruar sot objekti i ri, modern i Shtëpisë së Rinisë në Gjilan, i cili është realizuar me financim të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe është realizuar në bashkëpunim me Komunën e Gjilanit, e cila e ka ndarë tokën. Ministri Kujtim Shala ka premtuar edhe investime tjera në Gjilan, në sektorët që mbulon MKRS-ja.

Në një ceremoni të veçantë, prerjen e shiritit e kanë bërë kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri dhe zëvendëskryeministri dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Shala, derisa ka marrë pjesë edhe nënkryetari Rexhep Kadriu, udhëheqësi i Njesisë për Rini, Genc Mustafa dhe përfaqësues të organizatave tjera. “Jam i nderuar që në prezencë të zëvendëskryeministrit Shala të inaugurojmë objektin e ri të “Shtëpisë së Rinisë” të qytetit të Gjilanit, i cili është njëri nga objektet kapitale me interes të organizimit të rinisë gjilanasë, funksionimin e KVRL-së, Qendra Rinore si organizatë më e vjetër dhe organizatat tjera të

rinisë. Sot kjo datë do të jetë e shënuar dhe ju, rinia, duhet të kujdeseni ta ruani objektin sepse është pronë e juaja, sepse i plotëson të gjitha kushtet për punë, ka thënë Haziri. Ministri i Kulturës, Kujtim Shala, ka përgëzuar rininë gjilanasë për këtë rezultat, duke shtuar se ky është njëri nga investimet e mëdha të qeverisë në Komunën e Gjilanit, por jo i fundit. “Ne do të vazhdojmë edhe sivjet me investime në fushat tjera, në sport, trashëgiminë kulturore, në institucionet e kulturës etj. Si investim, ku do të jetë shumë i rëndësishëm, sepse siç tha kryetari, nga sot e tutje do të jetë i juaji. Uroj që ta përdorni ashtu si ju doni, në funksion të interesave tuaja, pa asnjë ngjyrim politik, por të lidhur kryesisht me preokupimet që keni ju si të rinj. Besoj që do të jetë një qendër e rëndësishme, jo vetëm e takimit të të rinjve të Gjilanit, por edhe e punës, në dobinë tuaj dhe të qytetit të Gjilanit”, është shprehur zëvendëskryeministri Shala. Ndryshe, realizimi i këtij objekti ka kushtuar 230 mijë euro.

Haziri: Rinia është dekoncentruar nga varësia e Komunës

10
MARS

Organizuar nga organizata “Fole N’Fole”, në bashkëpunim dhe mbështetje të organizatës “PEN”, respektivisht rrjeti i edukatorëve bashkëmoshatar, sot është organizuar debat i rinisë me kryetarin, “Bisedo me kryetarin tënd”, ku të rinjtë kanë bashkëbiseduar për problem të ndryshme kryesisht nga fusha e rinisë dhe aktiviteteve rinore por edhe vendimmarrjen dhe përfshirjen e të rinjve në proceset politike.

Me këtë rast kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se numrin më të madh i popullatës në vend është moshë 16 – 26 vjet, që tregon për potencialin e madh që kemi këtu. “Ky debat është për rininë, përfshirjen tuaj në proceset politike lokale, vendimmarrje, apo edhe procese të tjera me rëndësi për jetën e qytetarëve e veçanërisht për jetën e moshatarëve tuaj. Njësia për Rini së bashku edhe me KVRL-në, janë duke punuar çdo ditë në politikat rinore dhe përmirësimin e kushteve më të mira. Gjithashtu po punojmë edhe në përfshirjen e organizatave studentore dhe organizatave të shkollave të mesme në jetën rinore dhe aktivitetet e përbashkëta të rinisë. Tashmë rinia është dekoncentruar nga varësia dhe kontrolli i drejtpërdrejtë, po ashtu sot është përruruar edhe shtëpia për rini dhe kështu do të vazhdohet krahas buxhetit prej 75 mijë eurove që menaxhohet nga Njësia për Rini dhe mundësia e subvencionimit të aktiviteteve rinore është po ashtu”, ka thënë ndër të tjerash kryetari Haziri. Ai më tej ka bërë të ditur se Komuna e Gjilanit subvencionon edhe OJQ të tjera, mirëpo duhet të bindet institucioni me projekt të përgatitur mirë, sikur që edhe është e obliguar mbyllja e subvencionit nga OJQ përfituese përsëri me raport të detajuar financiar. Ndërsa të rinjtë janë interesuar kryesisht për punësimin, fuqizimin e rinisë, ndërmarrësin, buxhetin, financimin e aktiviteteve të ndryshme rinore, psikologët nëpër shkolla dhe interes tjetër për shkollimin dhe transportin urban si një nevojë për rininë sipas tyre.

Haziri: Gratë janë simboli i dashurisë, ikona e saj dhe sakrifica për më të mirën

8
MARS

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ka uruar gratë dhe nënat gjilanase, duke rikujtuar rolin e pazëvendësueshëm të femrës në ndërtimin dhe zhvillimin e shoqërisë sonë, të institucioneve tona, të shtetit tonë. Njëherësh, Haziri i ka inkurajuar gratë që të vazhdojnë të jenë zë e fuqishëm në shoqëri.

“Të nderuara vajza dhe gra, nëna dhe motra, shfrytëzoj rastin që si kryetar i Komunës së Gjilanit t’ju uroj 8 Marsin, Ditën Ndërkombëtare të Gruas dhe t’ju them se ju jeni simboli i dashurisë, ikona e saj dhe sakrifica për më të mirën. Në këtë ditë të shënuar për të gjithë ne, rikujtojmë rolin e pazëvendësueshëm të gruas në ndërtimin dhe zhvillimin shoqërisë sonë, të institucioneve tona, të shtetit tonë. Sot, gruaja gjilanase gëzon pozita të larta vendimmarrëse sepse pa fuqizimin e rolit të gruas në vendimmarrje nuk mund të kemi shoqëri demokratike. Andaj, inkurajoj të gjitha femrat që të mos ndalojnë në rrugën e tyre për të zënë vendin e tyre të merituar në shoqëri. Gëzuar!”, thuhet në mesazhin e urimit të kryetarit Haziri.



Bunjaku-Rexhepi: Rezultatet e grave shihen kudo në jetën shoqërore

8
MARS

Organizuar nga Komuna e Gjilanit, sot është shënuar simbolikisht 8 Marsi, Dita Ndërkombëtare e Gruas, ku pjesëmarrës ishte një numër i konsiderueshëm i grave gjilanasë. Me këtë rast para grave të pranishme, kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka uruar atyre festën dhe pohoi se kjo është ditë e veçantë, por edhe shumë e rëndësishme, sepse përditë e më shumë rezultatet e grave shihen kudo në jetën shoqërore, institucionale por fuqishëm edhe në zhvillimin ekonomik.

“Kjo ditë është shumë e veçantë për të gjitha gratë. Duhet të jemi të fuqishme që të drejtat tona t’i meritojmë me punë dhe angazhim të përditshëm. 8 Marsi është çdo ditë dhe në këtë drejtim duhet të angazhohemi secila prej

nesh. Uroj që vitet e ardhshme të mos festohet, por të protestohet për të drejta të barabarta. Gruaja gjilanasë ka dijeninë që të bëjë punët e shtëpisë, ka sukses në udhëheqje të shoqatave, të institucioneve dhe gjitha punët e tjera i kryen me përgjegjësi të lartë dhe sinqeritet. Ndje-hem krenare që gratë e Gjilani munden dhe dinë të plasojnë vlerat, punët dhe angazhimet e tyre konkrete në jetën shoqërore”, ka thënë ajo duke i uruar të gjitha gratë edhe në emër të kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri. Po ashtu gratë e pranishme në këtë takim, kishin rastin që nga afër të shohin ekspozitën me fotografi të përgatitur nga Myzaferre Kqiku, që pasqyrohej gruaja në aktivitete të ndryshme, karshi burrave, sikur që edhe të jenë pjesë e koktejit të përgatitur nga receta të ndryshme të kuzhinës gjilanasë që janë produkte të punës së grave.



Haziri: Universiteti “Kadri Zeka” do të jetë konkurrues edhe me universitetet ndërkombëtare

8
MARS

Në një ceremoni të veçantë, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan ka shënuar 3-vjetorin e themelimit. Pos përfaqësuesve të Universitetit, në këtë ngjarje ka marrë pjesë edhe kryetari Lutfi Haziri, ministra, deputetë e përfaqësues të tjerë të institucioneve. UPGJ ka katër fakultete, me rreth 5 mijë studentë. Në qershor të këtij viti diplomojnë studentët e parë në Universitetin “Kadri Zeka”.

Rекторi Bajram Kosumi, ka thënë se studentët dhe cilësia e studimit në UKZ është i vetmi motiv, i vetmi qëllim dhe e vetmja arsye pse jemi këtu, duke shtuar se universiteti është dera e një shoqërie. Ai tha se trekëndëshi i krijuar Universiteti, qeveria komunale dhe qeveria qendrore dhe bizneset, paraqet skemën e partnerëve dhe hisedarëve kryesor në Universitetin “Kadri Zeka”. Ndërkaq, kryetari i komunës së Gjiilanit, Lutfi Haziri, tha se është i nderuar që deri tani ka bashkëpunuar me 3 rektorë të këtij universiteti në programet e përbashkëta në interes të zhvillimit të shkollimit superior. “3-vjetori i Universitetit “Kadri Zeka” është numër i vogël, por jashtëzakonisht simbolik për rritjen e këtij institucioni të dijes. Si kryetar i Gjiilanit kam qenë i nderuar që kam punuar me 3 rektorë, për çka i falënderoj për bashkëpunimin dhe për programet

e përbashkëta për interes të zhvillimit të shkollimit superior, jo vetëm për Gjiilan, por edhe për Anamoravë në përgjithësi. Ky Universitet mbulon së paku gjysmë milionë banorë në juglindje të Kosovës që përfshinë edhe shqiptarët e Kosovës Lindore, Kumanova, Karadaku i Shkupit dhe gjithë ai territor që është i lidhur ngushtë me Gjiilanin. Arsimi mund të mbetet kërthiza e zhvillimit të regjionit tonë”, u shpreh Haziri. I pari i Gjiilanit ka paralajmëruar se në qershor pritet të nis ndërtimi i kompleksit të shkollave të mesme, duke shtuar se është i domosdoshëm edhe vendimi për të filluar planifikimin për ndërtimin e kampusit universitar. “Programet e UKZ janë interes i studentëve, i familjeve dhe është i hapur për të gjithë pavarësisht nga vijnë dhe jam i bindur që do të jetë konkurrues edhe me Universitetet ndërkombëtare të regjionit. Në qershor do të fillojmë ndërtimin e kampusit të shkollave të mesme dhe objekti i universitetit është në territorin e shkollave të mesme. Prandaj, është i domosdoshëm vendimi për të filluar planifikimin për ndërtimin e kampusit universitar, që është shumë i domosdoshëm. Suksese”, ka deklaruar kryetari Haziri. Universiteti “Kadri Zeka” ka katër fakultete, shtatë programe studimi me rreth 5 mijë studentë, derisa në qershor të këtij viti diplomojnë studentët e parë.



Haziri e Zharku, marrëveshje 3.7 milionë euro për investime në infrastrukturë

8
MARS

Marrëveshje tejet të rëndësishme për t'ua përmirësuar cilësinë e jetesës qytetarëve, ka nënshkruar sot kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri me ministrin Infrastrukturës, Lutfi Zharku. Sipas kësaj marrëveshje, Ministria e Infrastrukturës do të financojë në Gjilan projekte infrastrukturore në zonën urbane dhe rurale, në shumën prej 3.7 milionë euro.

Kryetari Haziri ka falënderuar ministrin Zharku për mbështetjen, ndërkaq ka shtuar se gradualisht po përm-

bushet zotimi për heqjen e lloçit dhe të vadave. Ministri i Infrastrukturës, Lutfi Zharku, ka shprehur zotimin dikasteri i tij do të ketë kujdes të veçantë për Gjilanin në investimet në infrastrukturë edhe në të ardhmen, meqë në të kaluarën ka qenë qytet i anashkaluar në investime. Përndryshe, kreu i Gjilanit ka nënshkruar disa marrëveshje milionëshe gjatë fundvitit të kaluar dhe sivjet, të cilat do të përdoren kryesisht për ndërtim të infrastrukturës.

Valentina Bunjaku-Rexhepi: Barazia gjinore duhet të përmirësohet akoma



7
MARS

Për nder të 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Komiteti për Barazi Gjinore (KBGJ) në Gjiilan ka organizuar një takim solemn, ku gratë kanë kërkuar të përmirësohet përfaqësimi gjinor në vendimmarrje, në të dyja nivelet e pushtetit. “Ne kemi shumë punë për të bërë sa i përket barazisë gjinore, duke filluar nga familja e tutje”, ka thënë Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal. Në takim kanë marrë pjesë edhe deputetet Lirie Kajtazi e Labinotë Demi.

Gjylshen Berisha, kryesuese e KBGJ, ka thënë se këtë ditë do ta shfrytëzojmë jo për të festuar, por për të reflektuar mbi të arriturat dhe sfidat e gruas kosovare në këto 16 vjet dhe për të kërkuar avancim të të drejtave të gruas. Duke nënvizuar rolin e femrës në shoqëri, Berisha ka thënë se gratë tona të guximshme përpiqen çdo ditë që me kontributin e tyre në fushat ku janë të angazhuara, ta bëjnë këtë vend më të mirë për të gjithë qytetarët. “Shoqëria kosovare ka nevojë për talentin, përvojën dhe leadershipin e grave”, ka thënë Berisha. Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, tha se gratë nuk duhet të kënaqen me kuotën e garantuar

dhe kërkojnë nga femrat që të angazhohen më shumë për të përmirësuar përfaqësimin në politikë dhe vendimmarrje. “Ne kemi shumë punë për të bërë sa i përket barazisë gjinore, duke filluar nga familja e tutje”, ka thënë Bunjaku-Rexhepi, duke nënvizuar si probleme të gruas edhe trashëgiminë, punësimin dhe çështje të tjera. Sa i përket emërimit të rrugëve, një proces ky në zhvillim e sipër, kryesuesja e Kuvendit Komunal i ka inkurajuar gratë që t’i dërgojnë propozimet e tyre te komisionet, por që nuk duhet të jenë emra të personave të gjallë. Deputetet Lirie Kajtazi e Labinotë Demi-Murtezi, kanë thënë se Kosova nuk qëndron keq sa i përket legjislacionit, i cili rregullon barazinë gjinore dhe të drejtat e gruas, por sfida mbetet zbatimi i ligjit. Kurse Sabit Rustemi, ish-deputet i Parlamentit të Kosovës, njëri nga hartuesit e ligjit për barazi gjinore, ka thënë se në këtë drejtim, Gjilani qëndron më mirë se komunat tjera, por ai pati vërejtje sa i përket përfaqësimit të femrës në pushtetin ekzekutiv, ku nuk është asnjë. Mesazhet e tyre për këtë ditë, i kanë dhënë edhe Drita Maliqi, ish-deputete, Drita Klaiqi, ish-zyrtare për barazi gjinore, Shukrije Rapuca, këshilltare komunale, Sadete Tërnavë (OSBE) dhe të tjera.



Haziri: Mësuesit tanë na mësuan udhën e rëndë të shkronjave shqipe

7
MARS

Nën organizimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit, sot në Gjilan është shënuar 7 Marsi, Dita e Mësuesit, duke mbledhur numër të madh të mësimitdhënësve të shkollave të Gjilanit. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka kujtuar mësuesin e parë dhe kontributin e jashtëzakonshëm që brezi të jetë sot këtu ku është. Rugëtimi i shkollës shqipe fillon para 129 vitesh.

“Lavdi e përjetshme për të gjithë ata mësues që sot nuk janë në mesin tonë. Ata kanë dhënë shumë, kanë sakrifikuar dhe atë jo vetëm për arsimin e Kosovës. Mësuesit tanë janë ata që na mësuan udhën e rëndë të shkronjave dhe kështu të gjithë ne bashkërisht hymë në rrugën e gjatë të mësim nxënies. Kuadrot që dalin nga ju mësimitdhënës sot janë jo vetëm kuadro të Kosovës por edhe më gjerë në gjithë botën, sepse sot bota është shumë e vogël dhe falë talentit të rinisë ne sot jemi gjithkund nëpër botë në rrafshin e konkurrencës mes të rinjve dhe duke marrë mirënjohje dhe medalje të shumta”, ka thënë kryetari Haziri në fjalën e tij. “Janë dy vendime kryesore në jetën e njeriut, i pari që ka të bëjë me profesionin që zgjedhim dhe i dyti me martesën që kemi, në rastin se këto dy ven-

dime janë të suksesshme, sigurisht që edhe rezultatet nuk mungojnë, por udhëzuesit e drejtpërdrejtë në përzgjedhjen e vendimit më të mirë janë mësuesi dhe nëna”, tha kreu i Gjilanit. Ndërsa, drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Nazmi Musa, ka uruar të gjithëve 7 Marsin, duke potencuar se u bënë 129 vjet nga hapja e parë e mësonjëtores së parë shqipe dhe është rrugë shumë e gjatë që është bërë deri më tani në edukimin e brezave të tërë të arsimit ndër vitesh. “7 Marsi është ditë e bekuar e historisë shqipe. Bashkë me ditën e mësuesit, ne po përkujtojmë edhe Epopenë e Lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër forcave të okupatorit serb. Robëria nën sundime të ndryshme romake, otomane, sllave etj, nuk na lanë të shohim dritë duke u përcjellë me robëri, vaujtje dhe luftëra të përgjakshme. Në këtë datë historike ne po ashtu sot kujtojmë edhe investimet e mëdha që janë bërë për këto dy vjet në fushën e gjerë të arsimit, falë edhe mbështetjes së madhe të kryetarit Haziri, por edhe miqve të shumtë-organizatave të shumtë qeveritare si USAID, GIZ, UNDP, TiKA e shumë organizata të tjera”. Gjithashtu, ky takim është përcjellë edhe me pika të ndryshme kulturore-artistike të përgatitura nga nxënësit e shkollave të komunës së Gjilanit



Haziri nderoi mirënjohje mësuesin Hetem Arifi për kontributin e jashtëzakonshëm në shumë fusha

7
MARS

Pikërisht më 7 Mars, në Ditën e Mësuesit, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nderuar me mirënjohje veteranin e arsimit, poetin dhe publicistin Hetem Arifi, për kontributin e tij të jashtëzakonshëm për çështjen kombëtare, përfshirë edukimin e shumë brezave, kontributin në manifestimin “Flaka e Janarit” gjatë viteve të rënda për shqiptarët, si kurse edhe për lëmin e letërsisë dhe kulturës.

Kryetari Haziri tha me këtë rast se Hetem Arifi është mësues shembull për të gjithë në se si duhet të punohet për të mirën e atdheut. “Arsimtar, kjo mirënjohje është me pakta që mund të bëjmë ne, karshi kontributit tuaj të jashtëzakonshëm në arsim, publicistikë e letërsi, sikurse edhe në manifestimin “Flaka e Janarit” në një kohë të

pakohë. Vepra juaj në shërbim të atdheut neve na bënë krenar. Ju uroj shëndet dhe gjitha të mirat”, u shpreh kryetari Haziri. Nga ana e tij, mësuesi dhe ish-i burgosuri politik, Hetem Arifi, ka falënderuar kryetarin Haziri për këtë mirënjohje, duke thënë se kjo është shumë e veçantë dhe e çmueshme për të. Në shenjë respekti, Arifi i dhuroi kryetarit Haziri librin e tij “Mësuesi nëpër kohë”. Përndryshe, me rastin e 7 Marsit, kryetari Haziri ka ndarë edhe gjashtë mirënjohje (pas vdekjes) për Nuhi Ismajlin, Kadri Rashitin, Feriz Nazifin, Baftjar Elezin, Magribe Kamberin dhe Xhylije Ramizin, për kontributin e dhënë në arsimimin dhe edukimin e gjeneratave të nxënësve të institucioneve edukative dhe arsimore të komunës së Gjilanit.



GIZ: Nazmi Musa, drejtori më i suksesshëm i arsimit në Republikën e Kosovës

4
MARS

Organizata e qeverisë gjermane GIZ ka shpërblyer sot me mirënjohje drejtorin e Arsimit në Gjilan, Nazmi Musa, duke e vlerësuar atë si më të suksesshmin në Republikën e Kosovës. Kjo mirënjohje, drejtorit Musa iu dha me rastin e ndarjes së 23 shpërblimeve për planet më të mira zhvillimore të shkollave të Gjilanit, ku janë bërë ndryshime të mëdha pozitive në menaxhim dhe cilësi.

Me këtë rast, përfaqësuesja e organizatës GIZ, Dagmar Fuchs, ka thënë se angazhimi dhe puna që ka bërë GIZ me Komunën e Gjilanit, e në veçanti me fushën e arsimit është kohë e veçantë punës për të, por edhe përvojë e mirë e vet organizatës, sepse sipas vlerësimit të GIZ, bashkëpunimi u bë me drejtorin që është më i suksesshmi në Kosovë. “Gjilani është një Komunë shumë e fortë e Republikës së Kosovës. Falë udhëheqjes shumë të mirë, kjo përherë e më shumë del në pah. Një përkushtim i tillë

vërehet edhe në sektorin e arsimit. Mund të them se drejtori Nazmi Musa, është shembull nga të gjithë drejtorët e arsimit në Kosovë, që është i përkushtuar për arritje të cilësisë në arsim dhe është punë e madhe e angazhimit që ai bënë në këtë fushë për këtë periudhë kohore. Janë bërë ndryshime të mëdha në udhëheqje dhe cilësi në këtë Drejtori dhe në përgjithësi në shkollat e Gjilanit”, ka thënë Fuchs, duke inkurajuar që të vazhdohet edhe më tutje me këtë dinamikë, sepse sipas saj Musa është i ri në zemër dhe me energji të madhe në udhëheqje dhe profesion. Ndërsa, Nazmi Musa, ka potencuar se ishte një kënaqësi e madhe që të jetë i angazhuar në bashkëpunimin me organizatën GIZ, duke potencuar se koha e bashkëpunimit ishte kohë e përfitimit të përvojave të mëdha lidhur me arsimin, falë edhe mbështetjes së madhe që i është dhënë sipas tij, nga kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, për sektorin e arsimit dhe ngritjes së cilësisë në arsimin e Gjilanit.

Gjilani dhe GIZ shpërblejnë 23 shkolla për hartimin planeve zhvillimore

4
MARS

Drejtoria e Arsimit në Gjilan në bashkëpunim me organizatën gjermane GIZ, ka shpërblyer sot me 23 shkolla të arsimit fillor të mesëm i ulët me mjete didaktike, për planet zhvillimore të shkollave. Në ngjarje ka marrë pjesë kreu i Komunës, Lutfi Haziri, drejtori i DKA-së, Nazmi Musa, përfaqësuesja e GIZ-it, Dagmar Fuchs si dhe drejtorë shkollash të Gjilanit.

“Jam i nderuar që jam pjesë e këtij takimi të veçantë, i cili bëhet me partnerin më të madh dhe kredibil që në sektorin e arsimit e mbështet Komunën e Gjilanit, pra organizata GIZ. Po e konfirmoj edhe njëherë që shtylla e arsimit mbetet prioriteti kryesor në Komunën e Gjilanit, për shkak se arsimi është baza kryesore e funksionimit të shtetit. Qëllimi dhe misioni i të gjithë neve është edukimi i gjeneratave me kushtet më të mira, me kurrikula më të standardizuara dhe me njohuri që duhet t’i nxënë fëmijët tanë. Po ashtu, do të vazhdojmë me investimet në këtë vit. Ne kemi nënshkruar marrëveshje edhe me bankën gjermane KfW për rehabilitimin total të infrastrukturës së disa shkollave. I përgëzoj këto 23 shkolla që janë shpërblyer sot sepse pa plan zhvillimor nuk ka sukses dhe stabilitet”, tha në fjalën e rastit kryetari Lutfi Haziri. Drejtori i DKA-së, Nazmi Musa, tha se me

ndihmën e zonjës Dagmar, kemi arritur në një shkallë të lartë të përgatitjes së mësimitdhënësve për metodologjinë e mësimitdhënies dhe, përveç tjerash, edhe në hartimin e planeve zhvillimore të shkollave. “E falënderoj zonjën Dagmar, e cila për Komunën tonë ka bërë emër të theksuar dhe të paharruar në kontributin e saj që po e jep në ngritjen e arsimit kosovar e në veçanti për komunën e Gjilanit. Me ndihmën e saj, kemi arritur në një shkallë të lartë të përgatitjes së mësimitdhënësve për metodologjinë e mësimitdhënies dhe, përveç tjerash, edhe në hartimin e planeve zhvillimore të shkollave. Me këtë rast, e falënderoj edhe kryetarin Haziri, i cili gjithëherë bënë përpjekje për krijimin e kushteve më të mira për ngritjen e arsimit gjilanas”, tha Musa. Ndërkaq, nga ana e saj, përfaqësuesja e GIZ-it, Dagmar Fuchs, tha se me kënaqësi ka dhënë kontributin e saj në Gjilan, duke përgëzuar drejtorin e arsimit për bashkëpunimin. Plani më i mirë nga 23 planet e shkollave të arsimit fillor të mesëm është zgjedhur ai i shkollës “Musa Zajmi”. Përndryshe, sot në Gjilan ka qëndruar edhe menaxheri i GIZ-it në Kosovë, Kai Hofmann, në takim pune me kryetarin Haziri, Komisionin e Aksionarëve të kompanisë “Ecohigjiena”. GIZ në Gjilan është në programe të shërbimeve publike dhe shërbimeve tjera për qytetarët.



Mbahet dëgjimi i tretë publik për “Fidanishte 2”

4
MARS

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në përkrahje profesionale të Institutit “INSI” nga Prishtina, ka mbajtur takimin e tretë publik me qytetarë, për zonën urbanistike, e cila është e përfshirë në Planin Rregullues të Hollësishëm “Fidanishte 2”, me temën “konceptet e zgjidhjes urbanistike - prezantimi i skenarëve”. Interesimi ka qenë i madh dhe shumica e pjesëmarrësve janë pajtuar me zgjidhjen.

Drejtori i kësaj drejtorie, Valon Shefkiu, ka thënë se shumica e pjesëmarrësve në këtë takim janë pajtuar me konceptin e zgjidhjes urbanistike të Planit Rregullues “Fidanishte 2”.

“Interesimi i pjesëmarrësve në takim ishte më tepër individual për parcelat private të tyre. Gjatë këtij takimi u ngritën shqetësimet nga pronarët e parcelave kadastrale të cilat preken nga destinimi i sipërfaqeve të gjelbra e sidomos përgjatë lumit “Stanishorka”. Pastaj, infrastrukturën rrugore, ku është kërkuar më tepër që të rregullohet profili i rrugëve, e sidomos akset e tyre të jenë në kufi të parcelave kadastrale”, ka thënë në informacionin e tij drejtori Shefkiu. Ai theksoi se interesim pati edhe për rregullimin e rrjetit elektrik, nga ai ajror në atë me kablo nëntokësore. Vlen të theksohet se në këtë dëgjim publik të tretë për këtë zonë, kanë qenë të pranishëm afro 100 qytetarë..

Haziri: Borxhet e trashëguara kanë qenë një gur i rëndë në qafën tonë gjatë këtyre dy viteve

1
MARS

Kuvendi Komunal i Gjilanit, në mbledhjen e radhës, të kryesuar nga Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka miratuar raportin e punës së kryetarit të Komunës, për vitin 2015, sikurse edhe vendimin për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2014 e 2015, në vitin fiskal 2016, vendimin për garancion të qëndrueshmërisë operative dhe financiare për Ndërmarrjen në themelim “Tregu” në Gjilan, vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të Shoqatës “Hendikos” dhe Qendrës për kujdesin ditor “Pema” në Gjilan.

Po ashtu, Kuvendi miratoi vendimin për revidimin e një pjesë të Planit Urban “Kodra e Thatë”, vendimin për revidimin e një pjesë të Planit Zhvillimor Urban “Qyteti i Gjilanit”, vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shtëpisë për të moshuarit si dhe vendimin për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private, për nevoja të shkollës fillore në lagjen “Dheu i Bardhë 2”. Kuvendarët e Gjilanit kanë miratuar edhe planin e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) si dhe planin për transparencë të Zyrës së Informimit, kurse i kanë rishikuar vendimin për ndryshimin e projektit të lumit Mirusha dhe rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, sipas sugjerimit të MAPL-së. Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, në raportin e tij të punës për vitin 2015, ka bërë një përmbledhje të aktiviteteve kryesore, duke nënvizuar progresin e gjithmbarshëm, disiplinën fiskale, subvencionet e shtuara, të hyrat komunale të rritura. Në vitin 2015 kemi arritur një progres të kënaqshëm, duke i përmbushur kërkesat e qytetarëve të komunës në masë të madhe, si dhe duke qenë në vazhdimësi të gatshëm që të punojmë për të arritura të mëtejshme, ka thënë Haziri. Duke folur për vështirësitë dhe sfidat, Haziri ka thënë se borxhet e vjetra kanë qenë një gur i rëndë në qafën tonë gjatë dy viteve të kaluara. (Më gjerësisht, shih: Haziri raporton në Kuvend për punën një vjeçare). Raporti ka marrë përkrahje të plotë nga partnerët e koalicionit qeverisës, ndërkaq është kritikuar nga opozita. Avdyl Aliu (LDK) ka thënë se planifikimi, besimi dhe transparenca, janë cilësi e kësaj qeverisjeje. Riad Rashiti (PDK), i cili ishte më i ashpri në fjalën e tij ndaj koalicionit LDK-AAK, ka thënë se në raport nuk janë përmendur fare problemet, ndërsa

dështimet janë quajtur progres. Selami Xhemajli (AAK) tha se raporti është i mirë. Kjo qeverisje ka treguar kulturë të mirë në menaxhimin e parasë publike, duke hequr dorë nga shpenzimet e luksit dhe këto mjete i ka orientuar në investime. Navzad Isufi (VV) tha se raporti është përgjithësues dhe shtoi se grupi i këshilltarëve të këtij subjekti mendon se ka mangësi te puna e kësaj qeverisjeje. Duke iu dhënë përgjigje akuzave të opozitës (PDK), Lutfi Haziri ka thënë se nuk është mirë që dështimet e juaja, t’i hidhni tek unë, duke ia rikujtuar shpenzimet e mëdha, borxhet që kanë lënë, projektet e papërfunduara dhe të tjera. “Sikur të kishit qenë aq të mirë sa thoni ju, atëherë nuk do t’i kishit humbur zgjedhjet”, ka thënë Haziri, duke shtuar se pushteti fitohet me besim dhe jo me shpifje e baltosje të tjetrit. “Ne kemi prishur shumë plane të qeverisjes së kaluar”, ka thënë Haziri. Ai ka mohuar që ndonjëherë të ketë qenë subjekt i ndonjë hetimi, siç tha Rashiti. “Deklaroj publikisht se Lutfi Haziri nuk është subjekt i asnjë hetimi, nuk ka qenë në këto 16 vite dhe as nuk do të jetë ndonjëherë”. Kryetari Haziri ka thënë se në këtë administratë nuk ka favorizime dhe e ka ftuar opozitën të punojnë së bashku për të zënë hapin e zhvillimit me rajonet tjera, sepse Gjilani ka ngecur shumë parapa. Vlerësimet e tyre për raportin e kryetarit të Komunës, i kanë shprehur edhe Nevzad Rushiti (LDK) e Isa Agushi (LDK), të cilët kanë thënë se opozita po sheh vetëm zi, ndërsa kanë nënvizuar se Gjilani, kurrë në historinë e vetë nuk i ka pasur 26 milionë euro investime për një vit. Bujar Nevzati (PDK) ka thënë se raporti nuk përmend asnjë të metë, duke shtuar se dështime ka në arsim, te ndërtimet e larta dhe të tjera. Fehmi Sylejmani (VV) analizoi gjendjen në arsim, administratë dhe sektorë të tjerë, duke konkluduar se në këto fusha ka pasur probleme, por ato nuk janë pasqyruar mjaftueshëm. Në debatin për raportin e punës së kryetarit, kush me vërejtje, kush me lëvdata, janë përfshirë edhe këshilltarët tjerë, Shukrije Rapuca (PDK), Ibish Ibishi (AAK), Fatbardha Selmani (PDK), Arjete Rexhepi (VV), Krenare Latifi (VV), Sahit Abazi (PDK) dhe të tjerë. Abazi ka kërkuar që në ndonjëherë nga seancat e ardhshme të diskutohet për papunësinë, që është një problem serioz, duke nënvizuar se në Gjilan janë 19 mijë të papunë të evidentuar, por me siguri se ky numër është më i madh. Sa i përket vendimit për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara, Zijadin Maliqi, drejtor financiar, ka sqaruar se bëhet fjalë për në shumë prej një milion e katër mijë euro, mjete këto që

kryesisht kanë ardhur në fund të dhjetorit dhe janar, pas mbylljes së vitit fiskal, nga gjobat në trafik, gjobat nga gjykatat dhe Agjensioni Pyjor i Kosovës. Sadudin Berisha, drejtor për Kadastër dhe Fadil Sherifi, shef i Sektorit të Planifikimit në Urbanizëm, kanë dhënë sqarime për të çështjet që kishin të bënin me revidimin e planeve dhe këmbimin pronësor. Mundësia për revidim të një pjesë të planit në zonën “Kodra e Thatë”, ku planifikohet ndërtimi i QKMF-së, ekziston, meqë kanë kaluar pesë vjet nga koha kur plani është miratuar. QKMF-së do t’i ndahen 30 ari, kurse pjesa tjetër mbetet për banim kolektiv dhe hapësira rekreative. Një pronë tjetër komunale, me sipërfaqe prej një hektari, është kërkuar në “Zabel..” për nevoja të ndërtimit të një shtëpie të pleqve. Donacioni për këtë projekt, është siguruar nga qeveria holandeze. Ambienti në këtë zonë është i përshtatshëm për një objekt të këtij destinimi. Kurse në lagjen “Dheu i Bardhë 2”, kërkesa ka të bëjë me shkëmbim të një prone komunale me një pronë private, me sipërfaqe prej 314 m/2, për nevoja të ndërtimit të një shkolle fillore atje. Kërkesën për garancion të qëndrueshmërisë operative dhe financiare për Ndërmarrjen në themelim “Tregu” në Gjilan, e ka arsyetuar Agim Zuzaku, drejtor i Zhvillimit Ekonomik, kurse kërkesat për ndarjen e subvencioneve për Shoqa-

tën “Hendikos” dhe Qendrën e kujdesit ditor “Pema” në Gjilan, Nexhat Hajrullahu, drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Po ashtu Kuvendi ka miratuar edhe planin e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, që e ka prezantuar Ensar Kadriu, drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim si dhe planin për transparencë, të cilin e ka arsyetuar Ibrahim Ademi nga Zyra për Informim. Kuvendi Komunal është detyruar që për herë të dytë të marrë vendim për largim nga seanca të këshilltarit serb Srgjan Mitroviq, i cili është emëruar në krye të strukturave paralele. Fillimisht, sqarime për pjesëmarrjen e tij në seancë, kërkoj Fehmi Sylejmani (VV), ndërkaq Sahit Abazi (PDK) kërkoj që kjo çështje të shqyrtohet në një takim të shefave të grupeve të këshilltarëve, para se të vazhdohet me seancë. Pas këtij takimi, Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, e komunikoi vendimin për largim nga seanca të këshilltarit Srgjan Mitroviq, i cili bazohet në rregulloren e punës dhe kërkoj nga organet kompetente që të fillojnë procedurat për zëvendësimin e tij me një kandidat tjetër nga i njëjti subjekt. Njëherësh, Kuvendi Komunal ka falënderuar për punë korrekte punëtorin e sekretarisë, Sali Hasani, i cili shkon në pension dhe kjo ishte seanca e fundit, ku mori pjesë në cilësinë e procesmbajtësit.

Haziri raporton në Kuvend për punën njëvjeçare

29

SHKURT

Në mbledhjen e sotme të Kuvendit Komunal të Gjilanit, kryetari i Lutfi Haziri ka prezantuar para asambleistëve raportin e punës janar-dhjetor 2015, ku ai ka pasqyruar të arriturat e kësaj periudhe si dhe planet për vitin vijues, kur pritet të realizohen investimet më të mëdha pas vitit 1999.

Në harmoni me kompetencat e Kryetarit të Komunës së Gjilanit, dhe me qëllim të ngritjes dhe fuqizimit të transparencës në komunë, sot ofroj para jush këtë Raport Pune me qëllim të dhënies së informatave sa ma të detajuara, lidhur me punën e ekzekutivit të Komunës. Ky raport vjetor, përfshinë aktivitetet e të gjitha drejtorive dhe të zyrave. Në vitin 2015, të dhënat të cilat janë pasqyruar në këtë raport tregojnë se kemi arritur një progres të kënaqshëm, duke i përmbushur kërkesat e qytetarëve të komunës në masë të madhe, si dhe duke qenë në vazhdimësi të gatshëm që bashkërisht të punojmë për të arritura të mëtutjeshme në punën gjithëpërfshirëse të komunës sonë. Angazhimi i ekzekutivit të komunës gjatë

vitit të kaluar, kryesisht është fokusuar në realizimin e detyrave tona sa i përket interesit komunal në shërbim për qytetarët, duke i pasur parasysh prioritetet e tyre dhe tonat. Ne e përmbyllëm një vit fiskal, me disiplinë të ashpër buxhetore, me shpenzime minimale, sepse kemi arrit që t’i reduktojmë shpenzimet edhe më tepër se në vitin 2014. Kemi kursyer mjetet buxhetore, e të cilat mandej i kemi orientuar në subvencione për Kulturë, për Rini dhe Sport, pastaj në investime publike qoftë të infrastrukturës rrugore, të asaj nëntokësore si kanalizime dhe rrejtje të tjera të ujësjellësit, apo investime të tjera publike. Këtë vit ne presim rezultate edhe më të mira, sidomos nga të hyrat e tatimit në pronë. Komuna e Gjilanit është komunë e cila vazhdon të jetë e përgjegjshme karshi pagesave të tatimit në pronë. Për këtë, u jemi thellësisht mirënjohës banorëve tanë. Si rezultat, ne kemi përmbyllur vitin 2015 me pak të mbetura nga ky vit janë afër 600 mijë €, e të cilat menjëherë do të futen në veprim në ditët në vijim për të çuar përpara planin tonë të zhvillimit të Komunës. Investime të vazh-



dueshme në partneritet strategjik dhe besëmirë me qeverinë tonë dhe donatorët e jashtëm si Zvicra, Austria, SHBA-të. Ndihej të lumtur që kemi disa kategori të investimeve në Gjilan, dhe ndër më të rëndësishmet është ajo e donatorëve. Gjilani ka arrit që të bashkëpunojë dhe të marrë donacione nga çdo qeveri që është prezent në Kosovë apo është në buxhetim me financa në Kosovë. Investitori i më madh në Gjilan aktualisht është Qeveria e Zvicrës, e cila pritet ta rehabilitojë rrjetin e ujësjellësit për të gjitha fshatrat dhe implemetues është ndërmarrja “Hidromorava.” Programi është bërë nga Komuna në bashkëpunim me Qeverinë Zvicerane. Partneri i dytë i madh është Komisioni Evropian me të cilin donator i kemi tri projekte: Projektin në lagjen “Dardania”, projekti me të cilin ne jemi në vazhdimësi dhe të cilin ne e kemi deblokuar është Biblioteka dhe projekti i tretë, është stadiumi i vogël, por ka edhe projekte tjera të vogla të cilat do t’i realizojmë me KE-në. Po ashtu në Gjilan prezente me investime është edhe Qeveria Amerikane me të cilën në Dardani do të ndërtojmë Çerdrën e Fëmijëve, mandej Qeveria Turke në Shkollën “Abaz Ajeti” do ta ndërtojë Çerdrën tjetër për fëmijë dhe shumë programe të tjera që janë në interes të Gjilanit. Siç po shihet, ne përparësi i kemi dhënë arsimit dhe infrastrukturës. Në Shëndetësinë Primare kemi arrit që ta rehabilitojmë pjesën më të madhe të infrastrukturës dhe në këtë degë të shëndetësisë, në bashkëpunim edhe me KARITAS-in, kemi punësuar një numër të mjekëve të

rinj dhe të teknikëve të medicinës, dhe ky program do të ndihmojë që me kuadër të kualifikuar, do të mbulojnë edhe punktet më rurale të Komunës, si në Vërbicë të Zhegocit dhe Shurdhan. Kështu, po afrojmë shërbime shëndetësore sa më afër qytetarit tonë. Mirëpo i kemi edhe 17 programe e që janë të trashëguara që nga viti 2009, por që ne po punojmë në mënyrë që këtë vit t’i përfundojmë. Vlera e investimeve për këto punë të mbetura është afër 600 mijë €. Mirëpo deri në këtë fazë ne duhet ta bëjmë prerjen e punëve për të parë se çka ka ndodhur me ato projekte. Një numër i projekteve ka qenë edhe objekt i hetimeve dhe shpresoj shumë që tash ka ardhur koha që të fillojmë të punojmë në disa rrugë që kanë filluar dhe kanë mbetur për pa u përfunduar siç është ajo në fshatin Kosaçë, mandej rruga për Malishevë të Epërme, por edhe disa rrugë të tjera në qytet. Trajtimi i ujërave të zeza po zgjidhet njëherë e mirë për Gjilanin, në bashkëpunim me qeverinë e Austrisë dhe Ministrinë e Financave të Republikës së Kosovës. Kurse, me Hidromoravën po rehabilitojmë ujësjellësin. Po ashtu në vitin e ardhshëm partnerin më të madh financiar do ta kemi qeverinë e Austrisë e cila me Ministrinë së Financave të Kosovës, pritet që ta nënshkruaj Marrëveshjen Teknike për marrjen e 12 milion €, dhe projektet që do t’i hartojmë këtë vit dhe negociatat që i kemi bërë me qeverinë e Austrisë, janë për fillimin dhe përfundimin e rrjetit të kanalizimit në Gjilan. Është projekti kryesor i largimit të baltës dhe mënjanimi të ujërave të zeza. Pro-

jekti do t' i përfshijë 54 km kanalizime, rregullimin e shtratit të Lumit Stanishorka dhe përfundimin e fundit të shtratit të Lumit Mirusha. Në këtë projekt nuk hyn vetëm pjesa urbane e qytetit, por këtu hyjnë të gjitha fshatrat e Komunës së Gjilanit dhe të gjitha fshatrat rreth Komunës së Gjilanit, e të cilat janë ndotës përmes kanalizimeve në Gjilan, por edhe të fshatrave të komunave tjera në partneritet me ato komuna. Kjo është faza e parë e përmbylljes së kanalizimeve për Komunën tonë. Ndërsa për fazën e dytë ne po punojmë me Qeverinë për ndërtimin e një impianti të ujërave të zeza dhe përfundimisht me këtë do të mbyllet procesi i ujërave të zeza. Lajmi më i madh për ne është se fillimi i këtyre punimeve i cili do të ndodhë në këtë vit, në mënyrë që projektet të realizohen brenda kalendarit të paraparë në afat prej një viti. Po ashtu presim që "Hidromorava" ta marrë dhe ta rehabilitojë rrjetin e ujësjellësit dhe po ashtu jemi pajtuar që Kompania ta marrë për obligim edhe mirëmbajtjen e këtij ujësjellësi. Ne kemi investuar më parë në disa fshatra, por nuk është kujdesur askush për mirëmbajtje dhe kanë mbetur fshatrat dhe vendbanimet pa ujë. Rrejtë ekziston, por nuk është mirëmbajtur, ndërsa tani duhet të investojmë me mjete shtesë për t' i rehabilituar të gjitha këto rrejte të ujësjellësit, ashtu që të furnizohet komuniteti me ujë, por në këtë rast duhet pasur parasysh edhe pagesën nga ana e komunitetit. Përfundimisht, Gjilanin po e nxjerrim nga balta dhe po e lidhim me autostradën ndërkombëtare: asfaltim të rrugëve në qytet dhe fshatra, si dhe fillim të punimeve në autostradën për Prishtinë. Në investime publike këtë vit do të përfundojmë pjesë të asfaltimit të rrugëve, të ndërtimit të trotuareve dhe të rehabilitimit të rrugëve. Rrugë kryesore që do të ndërtohet është rruga Gjilan- Prishtinë dhe atë aksi i parë prej tunelit deri te Penda e Livoqit, mandej prej Pendës deri te lagjja e Gllamës. Në të njëjtën kohë presim të fillojnë punimet prej Stacionit të Autobusëve në drejtim të Livoqit të Ulët dhe deri tek udhëkryqi i Cërrnicës, lot i I, kure lot i II deri në Klllokot. Ky projekt është paraparë në mes të Ministrisë së Infrastrukturës, Komunës dhe Bankës Evropiane për Zhvillim. Po ashtu pritet të fillojmë me ndërtimin e Autostradës, Dheu i Bardhë - Bunari i Përlepnicës - Gllamë dhe Prishtinë, i cili do të jetë korridori më i madh që do të lidhet me autostradat ndërkombëtare. Obligim i ynë ka mbetur meremetimi i rrugës Malishevë - Uglarë dhe Pogradjë i cili projekt është investim i Komunës dhe Ministrisë së Infrastrukturës. Kjo rrugë para luftës është ndërtuar me vet-kontribut të këtyre fshatrave, prandaj ka ardhur koha që të investohet në këtë rrugë dhe të hapet korridori deri te Dobrosini. Po ashtu, këtu na ndërlidhet edhe

hapja e vendkalimit kufitar në Stanqiç për ta lidhur Gjilanin me Kumanovën. Këto janë kryesisht projekte më të mëdha, kurse ne i kemi 1.2 milion € për rrugë në qytet, kryesisht rrugica dhe rrugë që kanë mbetur pa u realizuar. Mirëpo, po aq mjete janë ndarë edhe për asfaltimin e rrugëve në fshatrat e Komunës së Gjilanit, përveç në ato fshatra ku duhet të punojmë në kanalizim dhe ujësjellës, e që do të mbesin në fazën e dytë për asfaltim të rrugëve dhe trotuareve. Besoj se ky do të jetë vit i investimeve më të mëdha dhe do të vazhdojmë me disiplinë buxhetore dhe nuk do të ketë asnjë tolerancë të shpenzimit të buxhetit pa përmbyllje të kriterëve të rrepta. Nuk ka komunë të pasur me qytetarë të varfër: ulje tatimesh në pronë, rritje e inkasimit dhe falje borxhesh. Ne e kemi ulur vlerën e tatimit në pronë, prapë sipas kategorive, sepse duke kursyer qytetarin, Komuna fiton më shumë, sepse nuk mund të kemi komunë të pasur, kurse qytetarë të varfër. Për qytetarët e Komunës së Gjilanit është 7 milion € amnistia e borxheve, për të gjitha kategoritë që i parasheh ligji. Sa i përket komunës, ne nuk kemi obligime dhe këto dy vite nuk e kemi krijuar asnjë borxh ndaj askujt, por kemi borxhe të vjetra që po i servisojmë gradualisht. Në bujqësi kemi subvencionuar dhe do të vazhdojmë të subvencionojmë me mjete të punës dhe po punojmë shumë që me ligj bima e duhanit të trajtohet ashtu si rrushi i Rahovecit. Nëse fillon punën Fabrika e Duhanit, atëherë fabrika do të ndajë subvencion për kulturën e duhanit, sepse jemi shumë të interesuar për ta zhvilluar këtë degë të bujqësisë dhe bujqësinë në përgjithësi. Në fund më lejoni t' i falënderoj edhe mërgimtarët për solidaritet dhe mbështetje, sepse në rrafshin social, ne kemi ndërtuar një fond të qytetarëve dhe të komunës përmes së cilit janë ndërtuar 25 shtëpi, nga 11 që janë premtuar. Është rast i rrallë që premtohen 11 shtëpi dhe ndërtohen 25. Po ashtu, Komuna për 37 familje të tjera, për çdo muaj bënë pagesën e qirasë. Ne i kemi edhe 200 mijë € pa i harxhuar nga fondi, ndërsa këto shtëpi janë ndërtuar falë donacionit të donatorëve, qytetarëve, kurbetqarëve dhe biznesit të Komunës së Gjilanit. Ne po ashtu kemi ndarë bursa për studentë dhe të cilat bursa do të ndahen vetëm për studentë me kushte të vështira. Si gjithëherë, jemi të gatshëm për pyetjet tuaja. Pa dashur më shumë ta zgjas, unë jam i gatshëm të përgjigjem në pyetjet e juaja, por këtu janë edhe drejtorët dhe secili do të përgjigjet për sektorin e vet. Për t'u njohur më për së afërmi me të gjitha të arriturat që i përmenda shkurtimisht këtu, dhe për të iu informuar në mënyrë më të detajuar, i keni më poshtë raportet e drejtorive dhe zyrave veç e veç.



Marrëveshja me “HELP” sjell grante për bizneset dhe vende të reja pune

24
SHKURT

Në Gjilan sot është mbajtur sesioni informues për grantet që do të ndahen nga organizata “HELP”, organizatë kjo e cila ka të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Komunën, në mënyrë që bashkërisht të mbështesin sektorin e biznesit në Gjilan, mesatarisht me grante prej 2 mijë euro. Drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Agim Zuzaku, ka thënë se kjo është një skemë mbështetëse për qëndrueshmëri të bizneseve ekzistuese, nxitjen e krijimit të bizneseve të reja dhe krijim të vendeve të punës.

“HELP” po bënë prezantimin e formave të mbështetjes, respektivisht informatat themelore mbi ndarjen e granteve, por edhe përparësitë e mbështetjes së bizneseve. Vitin e kaluar kemi nënshkruar një Marrëveshje të Bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjilanit dhe organizatës “Help” në kuadër të projektit “Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të sektorit të mikro biznesit në Kosovë”, që financohet nga qeveria Gjermane dhe implementohet nga organizata “Help”. Në

kuadër të projektit të paktën 40 biznese do të mbështeten në synimet e tyre për të filluar ose zhvillimin e bizneseve. Vlera e përgjithshme e projektit për Gjilanin arrin në 121.055.00 euro. Komuna e Gjilanit kontribuon në shumën prej 16,000 Euro. Poashtu participues do të jenë edhe bizneset në një vlerë minimale. Sektori privat luan rol në rritje në çdo ekonomi kombëtare dhe kontribuon në punësim, rritje ekonomike dhe kultivim të sistemit të tregut. Andaj duke e ditur rëndësinë e madhe Komuna e Gjilanit është e angazhuar gjithnjë në mbështetje të këtij sektori dhe krijim të kushteve dhe klimës së mirë për biznes”, ka thënë drejtori Zuzaku, duke shtuar se bashkëpunimi me “HELP”, do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik është në shërbim të bizneseve dhe do të jetë e angazhuar drejtëpërdrejtë në mbështetje të bizneseve dhe zhvillimit të tyre, sepse me zhvillim ekonomik do të ketë edhe zhvillim të Komunës dhe punësimit, që është domosdoshmëri. Afati i fundit për aplikim për grante do të jetë data 31 mars 2016, ndërsa përfitues do të jenë minimumi 40 biznese.

Komuna e Gjilanit ndan nën-grante për 28 zejtarë



23
SHKURT

Komuna e Gjilanit ka ndarë sot nën-grante për 28 zejtarë, përmes projektit të financuar nga Komisioni Europian “Valorizimi i tregtisë/zejeve tradicionale dhe potencialeve të ekonomisë sociale në Komunitat Çair dhe Gjilan”, i cili implementohet në bashkëpunim me organizatën “Agro-Eko”. Shpërblimet ua kanë ndarë zejtarëve kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri dhe shefi i Operimeve në Zyrën e BE-së në Kosovë, Christof Stock. Rreth 40 për qind e përfituesve janë gra. Taksat komuale janë zero.

“Kur kemi konkurruar në Komisionin Europian, ne i kemi përzgjedhur zejet për arsye se e kemi parë se ato po shuhet dhe se zejtarët nuk po ripërtihen shkak i kushteve jo të mira. Pas nën-granteve që i kemi ndarë sot në projektin e Komisionit Europian, kjo veprimtari do të zhvillohet dhe lus që këto mjete të shfrytëzohen për zhvillim të zejeve tuaja”, u shpreh me këtë rast kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri. Ai theksoi se Komuna ka ulë të

gjitha llojet e tarifave në pikën zero për zejtarët, duke shtuar se po punohet shumë që ta gjendet një objekt për t’i vendosur të gjitha zejet në mënyrë që të mos paguhet qira. Ndërkaq, shefi i Operimeve të Zyrës së BE-së në Kosovë, Christof Stock, tha se sot zejtarët gjilanas po marrin një shpërblim të vogël, por shumë të rëndësishëm për zhvillimin e veprimtarive të tyre. “Është kënaqësi që jam sot këtu, jo vetëm që është përkrahje për zejet, por jam shumë i kënaqur që e kemi një bashkëpunim ndërkufitar shumë të rëndësishëm. Me këtë program, do t’i japim 28 shpërblime për zejtarët, të cilët e kanë marrë një nën-grant të vogël, por të rëndësishëm për ta. Me këtë projekt, do të bëjmë një ndryshim që të zhvillohet mikrobiznesi në të dyja anët e kufirit, pasi banorët e të dyja anëve kanë pasur kryesisht kërkesa të njëjta”, tha Stock. Stock tha se e gëzon fakti se rreth 40 për qind të përfituesve të nën-granteve janë gra, derisa ka falënderuar ekipin e projektit për, siç tha, punën e shkëlqyeshme që e kanë bërë.



Me mbështetjen për bizneset e vogla, KE është promotor i punësimit në Gjilan

23
SHKURT

Është inauguruar sot në Livoç të Gjilanit projekti për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla, i financuar nga Komisioni European dhe Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë, ku kompania “Tekom” ka përfutur një grant tejet të rëndësishëm për funksionimin e saj. Falë kësaj ndihme nga Komisioni Evropian, kompania “Tekom” e ka rritur numrin e punëtorëve edhe për dhjetë më shumë.

“Është një shembull se sa të suksesshëm mund të jenë grantet e vogla për bizneset, jo vetëm duke e rritur produktivitetin, por edhe kapacitetin e eksportit dhe punësimit. Zingjiri i produkteve është zgjeruar si rrejdhojë e këtij projekti, sikurse që është automatizuar prodhimi dhe është bërë me efikas. I uroj shumë suksese kësaj kompanie”, tha me këtë rast shefi i operimeve të Zyrës së BE-së në Kosovë, Christof Stock.

Kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka falënderuar Komisionin European për mbështetjen që po u jep bizneseve, duke

nënvizuar se KE është bërë njëri nga promotorët e punësimit në Gjilan. “E falënderoj për mbështetjen Zyrën e BE-së, ku përfutues është një nga bizneset e suksesshme në Gjilan. Gjilani ka nevojë për më shumë vende të punës dhe njëri nga promotorët e këtyre vendeve të punës është Komisioni European në mbështetje të sektorit privat. Uroj që edhe organizatat tjera dhe qeveria e Kosovës ta përcjellin shembullin e mbështetjes së KE-së. Gjilani po shkon drejt krijimit të mundësive, hapësirës dhe infrastrukturës dhe kushteve më të mira për zhvillim të biznesit”, ka deklaruar kryetari Haziri. Nga ana e tij, pronari i kompanisë “Tekom”, Bekuda, ka falënderuar KE-në dhe MTI-në për mbështetjen, duke shprehur se me këto pajisje të reja do ta rris kapacitetin dhe cilësinë e prodhimit, me prezencë në tregun regional. Ai tha se pas këtij granti e ka rritur numrin e punëtorëve për 10 më shumë se që ka pasur më herët.



Haziri: Sot po e bartim në duart e sportistëve stadiumin ndihmës

23
SHKURT

Në Gjilan është bërë sot përrurimi i stadiumit ndihmës, një projekt kapital që është financuar nga Bashkimi European, e i cili është një arenë shtesë për sportin dhe sportistët gjilanas. Në këtë event të pranishëm ishin kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, shefi i zyrës së BE-së në Kosovë, Christof Stock, përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale. Haziri ka falënderuar Komisionin European, për këtë investim të madh në Gjilan dhe për shumë programe të tjera, ku kjo Komunë është përfituese.

“Sot përruam një project madhor dhe capital për Gjilanin. Ky është një stadium ndihmës me të gjitha standartet dhe parametrat e Bashkimit European, në të cilin klubet sportive do të kryejn aktivitetet e veta me një kualitet të lartë. Sot po e bartim këtë project capital në duart e sportit e në veçanti në duart të sportistëve. Na mbetet që tani e tutje ta ruajme dhe mirëmbajmë këtë projekt. Edhe pas dy e më shumë vjetëve kjo fushë besojmë se do të jetë e të njëjtit standart sepse vepra të mëdha sikur kjo e sotmja nuk bëhen përditë, ato kërkojnë investime të mëdha dhe

angazhim të madh, andaj bashkërisht të bëjmë çmos që kjo vepër të jetë e të gjithë neve dh eta ruajmë të gjithë bashkërisht”, tha ndër të tjerash kryetari Haziri, duke potencuar që Gjilanit po i shtohet infrastruktura publike, sportive e rekreative. Ndërsa, shefi i zyrës së BE-së në Kosovë, Christof Stock, ka thënë se është kënaqësi e madhe që këtë stadium ta jep në dorë kryetarit të Komunës dhe Gjilanit në përgjithësi, andaj kujdesuni për të sepse është pasuri e juaja. “Është kënaqësi e madhe që të jem sot në Gjilan dhe të marr pjesë në hapjen e këtij projekti kapital për sportin e Gjilanit. Nga tash e tutje këtë terren sportiv, mund ta shfrytëzojnë ekipe të ndryshme të sportistëve si nga ekipet e meshkujve poashtu edhe femrave. Ky stadium mund të përdoret gjatë të gjithë vitit dhe në të gjitha kushtet atmosferike, sepse standartet e ndërtimit të tij janë moderne dhe janë të kualitetit të lartë, duke përfshirë edhe pjesët përcjellëse të këtij stadiumi siç janë zhveshoret dhe pjesët përcjellëse të tij”, duke thënë se sporti nuk është vetëm edukatë sportive, por edhe një ambasador i fuqishëm i Kosovës në botë.



Gjilani me donatorët nis projektet e mëdha

19

SHKURT

Në mbledhjen e bordit të drejtorëve, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se Gjilani në bashkëpunim me donatorët tashmë ka nisur vazhdimin e ndërtimit të bibliotekës së qytetit, sikurse edhe ndërtimin e shkollës së arteve dhe projektet në pastrimin e lumenjve, ndërkohë që pritet të fillojnë edhe investime tjera të mëdha. 2016-ta do të jetë viti i investimeve më të mëdha që ka njohur Gjilani në këto 16 vite liri.

Duke shprehur falënderim të madh për donatorët, të cilët i janë kthyer Gjilanit me investime, kreu i Gjilanit theksoi se shumë shpejt pritet të nisin edhe projektet e mëdha, siç është ndërtimi i shtratis të lumit “Stanishorka”, “Mirusha”, ndërtimi i rrjetit kanalizimeve fekale dhe atmosferike, sikurse edhe hapja dhe ndërtimi i rrugëve të reja në qytet e fshatra, hyrje-daljet etj. Në këtë takim, u

vlerësuan lart edhe organizimet e aktiviteteve në shënim të 8-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës, në të cilat pati pjesëmarrje masive të qytetarëve. Ndërkaq, u vlerësua, po ashtu, edhe ndarja e dekoratave në këtë 8-vjetor nga ana e presidentes Jahjaga me rekomadim të Shoqatës së Historianëve “Ali Hadri” në Gjilan dhe me mbështetje të kryetarit Lutfi Haziri për figurat e ndritura të Gjilanit: Zija Shemsiu, Xhavit Ahmeti, Jusuf Bahtjari dhe Halit Hasani. Kryetari Haziri ka falënderuar presidenten Jahjaga për dekoratat e sivjetme dhe të vitit të kaluar në 70-vjetorin e masakrës së Gjilanit për Hetem Hazirin, Ahmet Hazirin, Ymer Myqibabën, Bejtë Ali Pirevën dhe Shefki Desivojcën. Përndryshe, në vitin e kaluar, pikërisht në 70-vjetorin e masakrës së Gjilanit, presidenti shqiptar, Bujar Nishani, pati dekoruar me medalje Halim Oranën, Mulla Idriz Gjilanin, Esat Berishën, Hetem Hazirin, Ymer Myqybabën, dhe Rifat Bahtjarin.

Gjilani merr zotimin nga qeveria zvicerane për investime shtesë prej 2 milionë euro



18
SHKURT

Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, i shoqëruar nga drejtorët e drejtorive komunale dhe bashkëpunëtor të tjerë kanë pritur në një takim pune përfaqësuesit e zyrës zvicerane dhe të UNDP-së në Kosovë, me të cilët kanë folur lidhur me angazhimet konkrete që Komuna është duke i bërë në planin e integritetit, si dhe informatën për investime shtesë nga qeveria zvicerane prej rreth 2 milionë euro, që kanë të bëjnë kryesisht me investime në fushën e ujërave, zhvillimit ekonomik dhe punësimit.

Me këtë rast nënkryetari, Kadriu, ka thënë se angazhimi i Komunës së Gjilanit është shumë i madh në përmirësimin e jetës dhe shërbimeve për qytetarët, duke potencuar edhe planin për integritet, i cili qartëson dhe ka në vete edhe nevojën e madhe të përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe pjesëmarrësve të tjerë në këtë plan dhe zbatimin e tij. “Plani për Integritet është një material i qartë se çka duhet të bëhet saktësisht në fushën e bashkëpunimit me qytetarë si dhe përmirësimit të shërbimeve ndaj tyre. Falë angazhimit maksimal të kryetarit Haziri dhe përkushtimit të vazhdueshëm të tij, ne sot kemi një plan për integritet të cilin e kemi hartuar bashkërisht edhe me akter të tjerë nga niveli lokal dhe UNDP si partner në këtë përpilim. Konform këtij plani ne jemi duke punuar që shërbimet për qytetarë, por edhe investimet nga donatorët të kenë një mbështetje dhe udhëzim të qartë për nevojat e Komunës në fusha të ndryshme. Kjo ka qëllim informimin e qytetarëve për të gjitha ndodhitë nëpër drejtori dhe në përgjithësi në Komunë, hapje të prokurimit publik, përmirësimin e shërbimeve komunale ndaj qytetarëve, por edhe angazhimin konkret që të kemi vendimarr-

je bashkë me qytetarët”, tha në fjalën e tij nënkryetari Kadriu. Ai ka informuar delegacionin edhe për vendimin e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, për eliminim të korrupsionit apo rasteve të keqpërdorimit, që parasheh shpërblim në para të gatshme nga 500 deri në 2 mijë euro, për të gjithë ata që lajmërojnë rastin e korrupsionit ndaj zyrtarëve komunal. Ndërsa nga ana e tij, Patrick Etienne, drejtor i SDC-së në Kosovë, ka falënderuar Komunën e Gjilanit për angazhimin dhe përgatitjen e këtij plani për integritet, duke paralajmëruar se agjensionet e ndryshme ndërkombëtare, investimet dhe bashkëpunimin e tyre do ta bëjnë, vetëm me Komunitat që kanë një plan të tillë. “Çdo vit në Kosovë ndahen nga 25 milionë euro, për investime, zhvillim ekonomik dhe punësim, sikur që edhe këtë vit për Gjilanin si komunë janë të destinuara rreth 2 milionë euro. Sot problem për qytetarët dhe për donatorët në përgjithësi mbetet përvoja e madhe për korrupsionin, për çka ende nuk është duke u bërë një punë e vendosur që ky fenomen negativ të adresohet në organet e drejtësisë. Plani i integritetit është hap i madh dhe i mençur nga Komuna e Gjilanit. Agjensione të ndryshme ndërkombëtare, të cilat ndajnë fonde për Kosovën, do të bashkëpunojnë vetëm me komunitat të cilat tashmë kanë plan të qartë për integritet”, ka thënë ai ndër të tjerash. Drejtorët, ai i Arsimit dhe i Administratës së Përgjithshme, kanë informuar delegacionin lidhur me punët që janë bërë e që bëhen vazhdimisht në përmirësimin e shërbimeve si në efikasitet të shërbimeve, digjitalizim të tyre, hapje të institucioneve ndaj qytetarëve, por edhe aspekte të tjera e të shumta që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimeve dhe bashkëpunimin e hapur me qytetarët.



Haziri: Ky është një përvjetor i vogël, karshi sakrificës së dëshmorëve dhe heronjve tanë

17

SHKURT

Me aktivitete të shumëta, Komuna e Gjilanit po e shënon sot 8-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës. Fillimisht, kryetari i Komunës, Lutfi Haziri me bashkëpunëtorë, ka bërë homazhe tek varrezat e dëshmorëve dhe lapidarët në qytet, ndërkaq ka vlerësuar se ky 8-vjetor është përvjetor i vogël, karshi sakrificës së dëshmorëve dhe heronjve të Gjilanit e Kosovës.

“Uroj që festa e 8-vjetorit të shpalljes së Republikës të jetë festë për të gjithë qytetarët. Secili në mënyrën e tij le të festojë. Mbi të gjitha, festën e meritojnë njerëzit, të cilët, kanë sakrifikuar dhe kanë dhënë shumë për Kosovën. Ky 8-vjetor është përvjetor i vogël, karshi sakrificës së dëshmorëve dhe heronjve të Gjilanit dhe

Kosovës. Besoj shumë që Republika jonë shumë shpejt do t’i arrij objektivat e saj madhore që të jetë e integruar plotësisht në BE dhe NATO”, ka thënë kryetari Haziri. Haziri ka uruar që protesta e paralajmëruar për sot të mos e lëndoj Republikën. “Meqë janë paralajmëruar edhe protesta paqësore sot, uroj që Republika të mos lëndohet. Përkundrazi, t’i shtohet madhështia festës dhe të çojmë mesazh tek të gjithë qytetarët e Republikës që politikanët janë të përgjegjshëm”, ka porositur i pari i gjilanasve. Ndërkohë, Komuna e Gjilanit ka vazhduar me aktivitete të tjera festive, siç është koncerti për fëmijë, për të kulmuar në mbrëmje me performancën e grupeve gjilanasë në koncertin e muzikës rock para teatrit të qytetit, i cili, pritet të zgjas deri në orët e vona.



Haziri e Kosumi bisedojnë për zhvillimin e Universitetit “Kadri Zeka”

15
SHKURT

Kryetari i Komunës së Gjiçanit, Lutfi Haziri i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, ka pritur sot në takim rektorin e Universitetit “Kadri Zeka”, Bajram Kosumi, ku është biseduar për nevojat e zhvillimit të Universitetit, në veçanti për rolin e Komunës në ndërtimin e kampusit universitar dhe të gjitha programeve të tjera.

“Është kënaqësi dhe nderë i veçantë për Komunën që sot e kemi për vizitë rektorin e Universitetit “Kadri Zeka” dhe ish-kryeministrin e Kosovës, Bajram Kosumi. Biseduam lidhur me nevojat e zhvillimit të Universitetit, në veçanti për rolin e Komunës në ndërtimin e kampusit universitar dhe të gjitha programeve tjera që janë në interes të zhvillimit ndhe mundësive për të rinjtë dhe të rejtat e Komunës së Gjiçanit për të studiuar, niveli i studimeve dhe të gjitha kushtet që domosdoshmërisht duhet t’i organizojë edhe Komuna edhe Rectorati i Universitetit”, ka thënë pas takimit kreu i Gjiçanit, Lutfi Haziri.

Nga ana e tij, rektori i universitetit “Kadri Zeka”, Bajram Kosumi, pasi ka falënderuar kryetarin Haziri për

pritjen, ka thënë se në takim është biseduar si mund t’i shtyejnë përpara disa projekte të rëndësishme. “Ishte kënaqësi që të vazhdojmë bisedat me kryetarin Haziri për funksionimin e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiçan, i cili është një mundësi e madhe që duhet ta përdorim dhe ta shfrytëzojmë për të mirën e shoqërisë sonë. Biseduam së bashku se si mund t’i shtyejmë përpara disa prej projekteve siç është kampusi, programet të cilat mund të jenë të aplikueshme fillimisht për tregun rajonal dhe me gjerë”, ka thënë rektori Kosumi, duke shtuar se në Gjiçan ka hasur një kulturë akademike. “Në Gjiçan dhe rrethinë, në zyrat e kryetarëve të Komunave, unë kam hasur një kulturë akademike, një mirëkuptim për prosperitetin dhe zhvillimin e universitetit. Besoj se kjo frymë akademike këtu është garancia më e madhe se Universitetit do të ecë përpara dhe ne do të nxjerrim njerëz prej të cilëve do të përfitojmë shumë”, ka theksuar rektori Bajram Kosumi.



Haziri: Modeli austriak i banimit social, mundësi për t'u përdorur edhe në Gjilan

10

SHKURT

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në një takim pune delegacionin austriak të përbërë nga Gunther Fehlinger, Wolfgang Amann dhe Agron Beka, ku i pranishëm në këtë takim ishte edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Murat Hoxha, të cilët bashkërisht kanë bashkëbiseduar për modelin e Austrisë në fushën e banimit social, model që deri më tani është cilësuar i suksesshëm në shtetin mik të Kosovës.

Me këtë rast kryetari Haziri, ka thënë qëllim i takimit sot ishte banimi social, rezultatet e arritura dhe përvoja austriake. “Gjilani është njëra nga qytetet e Kosovës që po shikon mundësinë e përdorimit të modelit të Austrisë në

politikat e banimit social dhe angazhimin e përmirësimit të gjendjes së rëndë ekonomike dhe sociale të shumë familjeve që sot kanë problem kulmin mbi kokë. Jemi duke punuar vazhdimisht në përmirësim e gjendjes sa i përket banimit social, në këtë fazë po shohim mundësinë e përdorimit të modelit të Austrisë sa i përket kësaj fushe”, ka thënë ndër të tjerash kryetari Haziri. Ndryshe në këtë takim pos tjerash u tha që strehimi dhe kushtet për jetë, janë elementet bazë për jetën dhe zhvillimin e familjes dhe shoqërisë në përgjithësi dhe zgjidhja e problemit të banimit është hap përpara për të cilin jemi të vendosur të punojmë përherë.

Gjilani nis pastrimin e ambientit nga mbeturinat dhe deponitë e egra



10

SHKURT

Drejtoria e Shërbimeve Publike, në bashkëpunim me kompaninë “Eko-Higjiena”, kanë filluar pastrimin e mbeturinave në hapësirat e pendës së Livoçit, me qëllim të largimit të mbeturinave të shumta, të cilat janë grumbulluar në këtë liqe, nga pakujdesia e qytetarëve të pandërgjegjshëm, të cilët hudhin mbeturina vend e pa vend. Komuna e Gjilanit synon të krijojë ambient sa më të pastër jetësor.

Komuna e Gjilanit, respektivisht drejtoria, në kuadër të kontratës që ka me kompaninë “Ecohigjiena”, kanë nisur pastrimin e Pendës së Livoçit, duke bërë që në të

njëjtën kohë të bëhet pastrim dhe riciklim, kjo falë angazhimit edhe të kompanisë private “Riciklimi”, e cila mbeturinat e riciklueshme menjëherë i grumbullon dhe përgatit për tu ricikluar, ndërsa mbeturinat tjera deponohen në Deponinë e Mbeturinave. Zyrtarë të drejtorisë së Shërbimeve Publike, kanë njoftuar se me përmirësimin e kushteve atmosferike, në ditët në vijim do të punohet në pastrimin e ambienteve të hapura, largimin e deponive të egra për të krijuar ambienti të përshtatshëm dhe të pastër për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjilanit.



Haziri e Shala në Zhegër, gjithçka gati për fillimin e ndërtimit të palestrës sportive

10

SHKURT

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, së bashku me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Shala, kanë vizituar sot fshatin Zhegër, me qëllim të parapërgatitjeve për fillimin e palestrës së sporteve, ku do të investohen rreth 650 mijë euro. Palestra sportive ishte kërkesë e banorëve të këtij lokaliteti. Zhegrës iu premtua edhe rinovimi i Shtëpisë së Kulturës.

“Qëllimi i vizitës është përgatitja për fillimin e ndërtimit të palestrës së sporteve. Ne, poashtu, e vizituam edhe shtëpinë e kulturës, e cila është në gjendje jashtëzakonisht të rëndë për shkak të mosmirëmbajtjes. Do të punojmë bashkarisht me Ministrinë e Kulturës që në rishikim buxhetor ta sanojmë gjendjen. E falënderoj ministrin Shala për mbështjen që ia ka bërë Gjilanit, pasi ne jemi përfitues të mbi 1.3 milionë eurove në kornizë afatmesme të planifikimeve buxhetore, ku kryesisht merr kultura, rinia e sporti. Paralelisht me

këto projekte ne jemi në përfundim të Shtëpisë së Rinisë në Gjilan dhe fillimit të renovimit të stadiumit të qytetit”, tha me këtë rast kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri. Nga ana e tij, zëvendëskryeministri dhe ministri i Kulturës, Kujtim Shala, është zotuar se pas ndërtimit të palestrës së sporteve, po e shikojnë mundësinë që ta renovojnë edhe Shtëpinë e Kulturës së Zhegës. “Jam këtu që të planifikojmë bashkë me kryetarin fillimin e projekteve të reja, të cilat për ne dhe Komunën e Gjilanit janë shumë të rëndësishme. Në Zhegër do të fillojmë ndërtimin e palestrës, e cila ka vlerë rreth 650 mijë euro. Po ashtu, do të shikojmë mundësinë që brenda këtij viti të krijojmë një fond investiv për rinovimin dhe mirëmbajtjen e Shtëpisë së Kulturës”, tha zëvendëskryeministri Shala. Shala ka theksuar se do të vazhdojë të komunikoj me Komunën e Gjilanit për të parë nevojat tjera të fushës së kulturës, rinisë dhe sportit dhe me mundësitë e qeverisë, do të investojnë në tërësi në projektet që Komuna do t’i zgjedh me qytetarët.



Kryetari Haziri prezanton kalendarin e punës për vitin 2016

3

SHKURT

Në një konferencë për media, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka prezantuar para gazetarëve kalendarin vjetor të aktiviteteve për secilin muaj, ku për muajin janar kryefjala është “Flaka e Janarit”, shkurtin e ka cilësuar si Muaji i Solidaritetit, marsin – Muaji i Bujkut, prillin – Muaji i Ambientit, majin – Muaji i Librit, qershorin- Muaji i Shëndetit, korrikun – Muaji i Diasporës, gushtin – Muaji i Rinisë, shtatorin – Muaji i Sportit, tetorin – Muaji i Tolerancës Fetare, nëntorin – Muaji i Flamurit dhe Dhjetorin – Muaji i Festave.

Kreu i Gjilanit tha se tha se pos 25 shtëpive të ndërtuara në vitin e kaluar për familjet në nevojë, gjatë këtij muaji do të fillojnë së ndërtuari edhe 6 shtëpi të tjera, përderisa ka paralajmëruar se në muajin shkurt do të mbahet mbrëmja e dytë humanitare “Pak nga ne, shumë për ata”. Sa i përket sektorit të bujqësisë, Haziri tha se këtë vit do të rriten subencionet për bujqit, duke ua subvencionuar qind për qind farën dhe plehun artificial në mbjelljet pranverore, sikur që do të ketë subvencione edhe për kulturën e re – mjedren dhe kulturën e duhanit. Haziri tha se gjatë vitit 2016, prioritet janë investimet publike, ku me mbështetje të qeverisë së Austrisë do të ndërtohet rrejtja e kana-

lizimeve, ndërkaj me investimet e qeverisë zvicerane do të ndërtohet rrjeti i ujësjellësit në fshatra. “Ka adhur koha që përfundimisht të zgjidhet problemi i ujërave të zeza dhe ujit të pijshëm. Poashtu, do të ndërtohen rrugët brenda qytetit, ku do t’ju krijojmë qaje personave me nevoja të veçanta si dhe tri hyrje-daljet Gjilan-Prishtinë, Gjilan-Ferizaj dhe Gjilan-Bujanoc. Poashtu, Gjilanin do ta kthejmë në qytet të biçikletave”, tha kreu i Gjilanit. Ai ka paralajmëruar se sivjet do të ndërtohet edhe rruga e shumë kërkuar Malishevë-Uglarë-Pogragjë. Kryetari i Gjilanit ka theksuar 2016-ta është vit i grumbullimit të borxheve, ndërsa ka pohuar se Komuna ka paguar shumën më të madhe të borxheve ndaj operatorëve. “Ky është viti i grumbullimit të borxheve nga ata që i kanë obligime Komunës. Poashtu, ju informoj se si organizatë buxhetore, ne i kemi shlyer shumicën e obligimeve që Komuna ka pasur ndaj operatorëve privat. Borxhet kanë qenë guri në qafë për Gjilanin”, ka shtuar Haziri. I pari i gjilanasve ka apeluar qytetarët që ta shfrytëzojnë amnistinë dhe deri në shtator të hyjnë në marrëveshje me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave për të përfituar nga falja e borxheve. Krejt në fund, kryetari i Komunës së Gjilanit tha se gjatë këtij viti pret që të vendosjet traseja finale për autostradën, për të filluar menjëherë në vitin e ardhshëm.



Valentina Bunjaku-Rexhepi: Nuk do të toleroj gjuhë joparlamentare në Kuvend Komunal

2

SHKURT

Ciklin e konferencave me gazetarë të shefave të grupeve të këshilltarëve komunalë, që ka organizuar Zyra për Informim, e ka përmbyllur të martën kryesuesja e Kuvendit Komunal, Valentina Bunjaku-Rexhepi, e cila ka thënë se organi më i lartë vendim-marrës në pushtetin lokal, brenda kompetencave të veta, ka vazhduar të jetë plotësisht në shërbim të qytetarëve edhe gjatë vitit të kaluar. Një meritë të madhe për mbarëvajtjen e punëve në Kuvend Komunal, që gjatë vitit 2015 ka mbajtur 11 seanca, ajo ka adresuar edhe te Komitetet, si trupa ndihmës, të cilat kanë shqyrtuar e rekomaduar çështje që kanë qenë me rëndësi për qytetarët e komunës së Gjilanit.

Sa i përket hapësirës për debat, Bunjaku-Rexhepi ka thënë se në asamblenë komunale të Gjilanit respektohet fjala e lirë, por ndonjëherë edhe teprohet me marrjen e fjalës, nga 2-3 herë e më shumë, prandaj imponohet kërkesa për respektimin e rregullores së punës. Përndryshe, Bunjaku-Rexhepi u shpreh e kënaqur edhe me transparencën e organeve komunale kundrejt publikut, duke thënë se gjithçka është punuar në harmoni me ligjin dhe asnjë vendim nuk është kthyer nga MAPL-ja. Kryesuesja e Kuvendit Komunal ka vlerësuar angazhimet edhe të grupeve politike në vendim-marrje, duke thënë se këshilltarët e LDK-së e kanë dhënë maksimumin e tyre në detyrimet që kanë kundrejt qytet-

arëve. Kontributin e tyre e kanë dhënë edhe këshilltarët e AAK-së, si pjesë e koalicionit qeverisës. “LDK-ja nuk i ka problem numrat në Kuvend Komunal, por kryetari Lutfi Haziri ka treguar vullnet për të ndarë qeverisjen, për të respektuar vlerat edhe të partive tjera”, ka thënë Bunjaku-Rexhepi. Ajo ka falënderuar për bashkëpunim edhe opozitën, por ka kërkuar prej saj që të respektojë gjuhën parlamentare dhe të përmbahet nga fjalët denigruese ndaj anëtarëve tjerë, ndaj asaj si kryesuese dhe ndaj kryetarit të Komunës. “Nëse ofendimet përsëriten, do të jem e detyruar të marrë veprime sipas rregullores së punës”, ka thënë Bunjaku-Rexhepi. Roli i opozitës do të respektohet maksimalisht, edhe propozimet e saj gjithashtu, por ne nuk mund ta ndryshojmë vazhdimisht një rend pune që është përcaktuar më parë, vetëm pse insiston opozita. Ajo e ka komentuar edhe rastin e këshilltarit Srgjan Mitrovic, i cili njëkohësisht është emëruar edhe në krye të strukturave paralele, duke thënë se Kuvendi Komunal i ka ndjekur procedurat ligjore dhe tani, pas përgjigjes nga MAPL, është në pritje të vendimit të KQZ-së, për zëvendësimin e tij. Ndërkaq, duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve, Bunjaku-Rexhepi ka mohuar të ketë qenë ndonjëherë provokative ndaj opozitës, duke thënë se në Kuvend Komunal, për mua, të gjithë anëtarët janë të barabartë dhe të tillë do të jenë edhe në të ardhmen, sepse janë përfaqësues të qytetarëve.

Haziri: Vrima e zezë për shqiptarët po hiqet nga qendra e Gjilanit



2

SHKURT

Është bërë sot përrurimi i qendrës së paraburgimit në Gjilan, objekt me infrastrukturë të lartë modern, që ofron kushte të mira për të gjithë të burgosurit dhe stafin të cilët punojnë në këtë qendër, ku nga të pranishmit është thënë se është ambient i mirë dhe i domosdoshëm për rendin dhe ligjin.

Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, ministri i Administratës Publike, Mahir Yagcilar, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Me këtë rast ministri i drejtësisë Hajredin Kuçi ka thënë se institucioni që ai drejton po mundohet të krijojë ambient të domosdoshëm për rendin dhe ligjin. “Ligjet i kemi më mirat në Evropë, kurse objekti që po inaugurohet, është më modern në rajon. Suksesi më i madh yni është që në këtë qendër të ketë sa më pak të burgosur, por nëse do të ketë atëherë tretmani ndaj tyre duhet të jetë korrekt dhe vetëm në bazë të ligjit. Edhe të burgosurit duhet të ndihen mirë dhe duhet të respektohet ligji dhe të drejtat e njeriut”, ka thënë ministri i Drejtësisë Hajredin Kuçi. Ai me këtë rast poashtu ka falënderuar misionin e EULEX-it, Komunën e Gjilanit për angazhimin dhe gatishmërinë e treguar përherë dhe Ministrinë e Administrimit Publik që janë përkujdesur që kjo qendër të jetë vërtet e kompletuar sot. Kurse, nga ana

e tij Mahir Yagcilar, ministër i Administratës Publike, tha se suksesshëm e kemi përmbyllur infrastrukturën në këtë qendër, detyrë që e ka në kuadër të monitorimit dhe investimit të infrastrukturës publike në qeverinë e Republikës së Kosovës. Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, tha se qeveria e Kosovës ka bërë punë të shumta e të mëdha në infrastrukturë dhe kompletimin e saj për organet e shtetit, ndërsa publikisht ka marrë përsipër investimin e rrugës që shpie drejtë kësaj Qendre Korrektuese. “Rruga që ende është e parregulluar dhe e papërshtatshme, do t’i mbetet Komunës ta investoj dhe për këtë zotohem publikisht se do e kryej, sikur që jemi zotuar edhe për rregullimin e oborrit të gjykatës. Ministri Kuçi, në Gjilan ka përfunduar tashmë objektin e Gjykatës dhe Prokurorisë, tash po përrurojmë këtë objekt modern dhe mbetet edhe finalizimi i projektit tjetër, atij për Policinë e Kosovës, në mënyrë që organet e drejtësisë të dalin nga zemra e qytetit, në mënyrë që pastaj bashkërisht të bëjmë punë të mëdha pikërisht në qytet, në shërbim të qytetarëve tanë. Sot përfundimisht është bërë hap i madh për largimin e vrimës së zezë nga qendra e qytetit, e burgut famëkeq, që këtë epitet e ka marrë nga regjimi serb, nga i cili, numër shumë i madh i shqiptarëve janë torturuar deri në vdekje në atë objekt, për të cilin kam përvoja shumë të hidhura edhe personalisht me kolegë të mi që fatbardhësisht një pjesë e tyre jemi gjallë”, ka thënë kryetari Haziri. “Gjilani kishte burgun më famëkeq, aty shqiptarët kanë lënë shëndetin e shumë, e shumë të tjerë edhe jetën”, tha në fund të fjalës së tij kryetari Lutfi Haziri. Në fjalën e tij Pieter Bah, nga EULEX-I, u shpreh i kënaqur që projekti është finalizuar dhe tani të burgosurit do të ndihen më rehat. Kurse, Sokol Zogaj, nga shërbimi korrektues i Kosovës dhe Shefik Sylejmani nga shërbimi korrektues në Gjilan u zotuan se në këtë qendër shërbimi ndaj të burgosurve do të jetë profesional. Ndryshe, në këtë ceremoni merrnin pjesë edhe Behxhet Shala, Fatmir Rexhepi, Zenun Pajaziti, Bajrush Ymeri, Zyhdi Haziri, Jetish Maloku, Elmina Mahmuti, Remzi Azemi dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve lokale e qendrore.

Kronika e manifestimit “Flaka e Janarit 2016”



Haziri kërkon nga Prishtina e Tirana, ta mbështesin manifestimin mbarëkombëtar

1

SHKURT

Mbrëmë është bërë mbyllja e manifestimit shumkulturor “Flaka e Janarit 2016”, me “Fest Flakën”, që deri më tani tradicionalisht organizohet në nderim dhe përkulje për heronjtë dhe dëshmorët, që kanë rënë për liri.

Me këtë rast kryetari Haziri ka thënë se ka ardhur koha që dy Ministrinë e Kulturës, ajo e Kosovës dhe e Shqipërisë, të zgjohen nga gjumi dhe ta mbështesin këtë manifestim mbarëkombëtar, i cili është vlerë e madhe kulturore për dy shtetet shqiptare. “Qytetaria e Gjilanit këto ditë i dha epitetin qytetit tone, Kryeqytet kulturor i shqiptarëve.

Me “Festë Flakën”, sonte e përmbyllëm në mënyrën më të mirë manifestimin shumëkulturor, mbarëkombëtar “Flaka e Janarit 2016”. Ky është muaji i përkuljes së të gjallëve ndaj veprës dhe sakrificës së atyre, të cilët, dëshmuar se si duhet atdheu”, thanë fjalën e tij kryetari Haziri. Ai ka thënë se ishin heronjtë, dëshmorët dhe të gjithë të rënë na mësuar që të mos e pranojmë robërinë. Shpreh krenarinë dhe falënderimin tim për të gjithë ata që punuan dhe bënë që ky manifestim të marrë përmasa kaq madhështore. Ka ardhur koha që dy Ministrinë e Kulturës, ajo e Kosovës dhe e Shqipërisë, të zgjohen nga gjumi dhe ta mbështesin këtë manifestim mbarëkombëtar.

Çmimin “Pena e Flakës” e fitojnë poetët Halil Matoshi e Basri Çapriçi

31
JANAR

Poetët Basri Çapriçi dhe Halil Matoshi, e ndanë çmimin-poezia më e mirë e lexuar në Orën e Madhe Letrare “Pena e Flakës 2016”, në të cilën aktivitet letrar të manifestimit “Flaka e Janarit 2016”, punimet e tyre i kanë lexuar krijues nga pjesë të ndryshme të Kosovës, nga Shqipëria, Maqedonia e Lugina e Preshevës.

Arsim HALILI (Bujanoc), Odise PLAKU (Tiranë), Alisa VELAJ, (Vlorë), Selvete ABDULLAHU, (Gjilan), Alketë SPAHIU, (Gjilan), Nuhi SADIKU, (Shtime), Mehmetali REXHEPI (Gjilan), Sarë GJERGJI, (Viti), Myrvete OSMANI, (Vushtri), Azem DELIU, (Skenderaj), Nikollë SPATHARI, (Durrës), Sami VELÇANI, (Durrës), Ruzhdi META, (Durrës), Nehas SOPAJ, (Shkup), Sevdail DEMIRI, (Kumanovë), Zejnepe ALILI – REXHEPI, (Tetovë), Mexhid MEHMETI, (Fushë Kosovë - Preshevë), Ibrahim KADRIU (Prishtinë – Gjilan) Linditë DODA, (Burrel), Bardhyl MALIQI, (Sarandë), Pajtim ÇAUSHI, (Sarandë), Basri ÇAPRIQI (Prishtinë – Ulqin), Halil MATOSHI (Prishtinë – Kamenicë). Po ashtu i pranishëm ishte edhe poeti nga Danimarka, Michael Enevoldsen si mysafir poet ndërkombëtar që deklamoi një poezi të tijen. Përndryshe, “Pena e Flakës”, iu përkuштua shkrimtarit të shquar gjilanas, Beqir Musliut, në 20 vjetorin e shkuarjes së tij në amshim që, koincidiu edhe me 25 vjetorin e themelimit të këtij Manifestimi, pjesë e të cilit ishte edhe në aktin themelues e, edhe në pesë manifestime, radhazi (1992 - 1996). Për të foli studijuesi dhe kritiku Prend Buzhala. Ndërkohë, pas Orës së Madhe letrare u bë edhe shpallja e rezultateve të konkursit shpërblyes në poezi dhe prozë. Juria e konkursit letrar “Flaka e janarit” 2016 në përbërje: Sinan Sadiku, Albina Idrizi dhe Aziz Mustafa vlerësoi se konkursi letrar ishte tejet i suksesshëm. Me këtë rast njëri nga ta Sinan Sadiku tha se në konkurs kishin ardhur 81 poezi, rreth një e treta e të cilave me vlera të mirëfillta artistike, ndërsa gjysma e tyre janë veçuar në rrethin e ngushtë për shpërblime. “Jurja është e kënaqur me nivelin artistik të poezive dhe konsideron se ka prurje të reja edhe sa i përket gjuhës poetike, edhe sa i përket ritmit dhe ndërtimit të vargjeve e edhe sa u përket ideve, temave dhe shprehjes emocionale”, tha ai. Sipas tij, pas leximit, rileximit, dhe vlerësimit të poezive nga secili anëtar veç e veç, juria është

takuar dhe pas propozimeve, diskutimeve e arsyetimeve në mënyrë unanime ka vendos të shpërblehen poezitë:

1. Vendi i parë, “Rrena më e bukur...”, shifra “Ëndrra `16”
2. Vendi i dytë, “Gardhi”, shifra “Shuej”
3. Vendi i tretë, “N`amë të fjalve”, shifra “Blina”

Sadiku ka thënë po ashtu se në konkurs kishin konkurruar krijues me 35 tregime. “Vlerësojmë se është ruajtur niveli i viteve të kaluara edhe sa i përket sasisë e edhe sa i përket cilësisë”, tha ai.

Juria ka vendos të shpërblehen tregimet:

1. Vendi i parë, “Letër nga larg”, shifra, “Artemisa 2016”
2. Vendi i dytë e ndajnë tregimet: “Dhimbe e bardhë”, shifra “Pengu i jetës” dhe “Njeriu i marrë”, shifra “Sheshi pa lule”
3. Vendi i tretë, “Kokën tuaj do ta hani”, shifra “Lisi i ahut”

“Po ju njoftoj se janë eliminuar disa poezi dhe tregime për shkak se nuk u janë përmbajtur kriteret e konkursit. Konkretisht janë eliminuar pesë poezi, sepse e kanë tejkaluar dukshëm numrin e vargjeve të parapara në konkurs. Po ashtu janë eliminuar dy tregime, njëri për arsye se autorja në vend të shifrës e ka shënuar emrin dhe tjetri për arsye se e ka tejkaluar numrin e faqeve”, tha tutje Sadiku. Përndryshe, për botim në revistën letrare – kulturore “Agmia” propozohen poezitë: “Sagë për Doruntinën, shifra “Konstandini”; “Koha ime e arnuar”, shifra “Krizantema”; “Ara – mara”, shifra “Flaka e janarit – 2016”; “T`braktisunit”, shifra “Moza”; “Prishtina”, shifra “Makoti”; “Misteri”, shifra “Andy”; “I mbrojtur nga vetja, ju dhe të tjerët”, shifra “Monologu”; “Bisedë me një grua të palumtur”, shifra “Faqja 97 e ditarit” dhe “Ikonë flijimi”, shifra “Jeta”. Po ashtu për botim propozohen tregimet: “Ma kujto buzëqeshjen cicërimë”, shifra “Cicërima”, “Përtej lartësive”, shifra “Dardani” dhe “Të dashurosh ilirishte”, shifra “Fyelli ilirik”.



“Folk Flaka” mbrëmje që mblodhi artdashësit e folklorit në Gjilan

30
JANAR

Teatri i Gjilanit këtë muaj ka vluar nga aktivitete të ndryshme kulturore, gjë që ka ndikuar edhe në orientimin e qytetarëve pandërprer që ti mësojnë kësaj dere të artit dhe kulturës.

Gjatë natës së mbrëmshme në këtë institucion, në kuadër të manifestimit “Flaka e Janarit 2016”, ka kumbuar daullja, është hedhur valle e gëngë me çifteli, duke u prezantuar vlera folklorike që i kushtoj heronjëve dhe dëshmorëve të rënë për liri. Me këtë rast kryetari Haziri, në fjalën e tij ka i ka dhënë mbështetje folklorit dhe dhe vlerave të pasura që ka Gjilani në këtë fushë, duke garantuar që kjo do të jetë pasuri shtesë në manifestimin “Flaka e Janarit” edhe gjatë të ardhmes. “Folklori në Gjilan

është pjesë e pasur e kulturës muzikore, që është ruajtur e bartur brez pas brezi. Ky element është pasurim edhe më i madh i “Flakës së Janarit” e posaçërisht i pjesës muzikore. Mbështetja e Komunës së Gjilanit përherë do të jetë edhe më e fuqishme gjatë të ardhmes sepse gjithçka që është kulturë, dhe që ruan apo ndikon në pasurimin e kulturës gjilanase do të ketë mbështetjen e Komunës”, ka thënë ndër të tjerash kryetari Haziri. Ndryshe, në këtë mbrëmje kanë prezantuar ansamble të ndryshme nga Gjilani, dhe qytete të tjera të Kosovës, të cilët kanë sjellur para publikut valle të ndryshme burimore, sikur edhe këngë patriotike në kujtim të heronjëve dhe dëshmorëve të kombit.



Petrovci: O sa mirë me qenë në Gjilan!

29
JANAR

Mbrëmë ishte nata finale e ndarjes së çmimeve me rastin e mbylljes së festivalit të dramës shqipe “Talia e Flakës” në Gjilan, e ku për shtatë netë me radhë, në skenë janë prezantuar tetë shfaqje nga teatro të ndryshme nga Kosova dhe Shqipëria.

Sikur në asnjë vend shqiptarë, kryeqendra e kulturës shqiptare në Ballkan, Gjilani, duke nderuar e kujtuar heronjtë e kombit ka ngritur në këmbë gjithë artëdashësit që të jenë në përcjellje të manifestimit “Flaka e Janarit 2016”, e cila pos shumë risive dhe elementeve të fuqishme artistike kishte edhe publikun të cilët një orë para shfaqjeve mbushnin sallën përplot, duke bërë kështu që numër i madh i qytetarëve të kthehen prapa pa patur mundësinë të jenë në shfaqje. Juria profesionale e përbërë nga Drita Begolli - aktore dhe regjisore, Milto Kutali - regjisor dhe Bajrush Mjaku - aktor. Me këtë rast, në ndarjen e çmimeve ishte i pranishëm edhe aktori i madh shqiptar, Enver Petrovci, i cili ka thënë se Gjilani vërtetë është kryeqendra e kulturës, por publiku është ai që e mban dhe i jep madhësi dhe mbështetje të vërtetë teatrit. “Nuk kam “qare” pa e thënë një gjë, kur erdha sonte për të ndjekur shfaqjen e fundit, nga grumbulli shumë

i madh i njerëzve para teatrit nuk kisha dot shancin të hyjë brenda, prandaj përmes telefonatave nga bodrumi, a depo, apo tavani, mezi u futa në sallë. Gjatë hyrjes mora vesh se ‘kijamet’, mbrëmë nga turma e madhe është thyer dera e teatrit, por ai ishte gëzim shumë i madh për mua. Atë derë unë do ta riparoj. Ka kohë shumë të gjatë që nuk kam dëgjuar të jetë thyer dera në Kosovë apo Shqipëri për teatër. Kishim raste për tallava muzikë, mirëpo për Teatër jo. E këtë e bënë vetëm një qytetari sikur kjo në Gjilan. Kjo është lakmi për gjithë njerëzit që flasin shqip, që të kenë një publikë dhe kulturë sikur në Gjilan, të jeni të sigurt që as për së afërmi nuk ka kështu që nga Saranda e deri në Preshevë”, ka thënë ai. “Kjo energji që ka ky publik, nuk krijohet pse ke para. Kultura nuk krijohet pse ke para. Publiku nuk krijohet me para, ai krijohet dhe rritet vetëm me traditë. I nderuar kryetar, kjo energji dhe traditë në Gjilan është krenari dhe lakmi, mbaje të gjallë e të fuqishme kështu, sikur që dini ta mbani ju përherë. O sa mirë me qenë në Gjilan!”, ishte fjala e Petrovcit në adresimin para publikut gjilanas. Ndërsa në fjalën e tij, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka kujtuar 25-vjetorin e “Flakës...” me elaborimin e shumë vështirësive të filleve të saj, duke informuar të gjithë ar-

tistët dhe publikun për dyfishim të buxhetit për Kulturën, jashtë financimit të manifestimit “Flaka e Janarit”. “Kur kemi nisur me “Flakën...”, teatër e kishim shkollën e Përlepnices, Bresalcit dhe i shkollave tjera sepse teatrin nuk mund ta shfrytëzonim. Edhe në atë kohë, asnjëherë nuk e kemi ndalur besimin për teatrin shqip, për kulturën dhe vlerat kulturore në Gjilan. Për këto ditë kishim kënaqësinë që në Gjilan të kemi aktorë të mdhenjë, regjisorë, dramaturg dhe artdashës në përgjithësi nga të gjitha trojet shqiptare, por edhe regjisorin e njohur nga Teatrit Kombëtar të Stambollit, Orhan Kurtuldu”, ka thënë kryetari Haziri. “Ky qytet është i Beqir Musliut, i njeriut të madh të letrave shqipe dhe përkushtimit për letërsinë dhe teatrin, është qytet i Mirko Gashit, që ishte njeri i madh i letrave shqipe, i Rexhep Elmazit, që u privua nga jeta në lulen e rinisë, por edhe i shumë njerëzve të mirë të letrave që ky qytet i jep për gjithë shqiptarët. Ata që i dhanë shumë këtij teatri për së gjalli e vdekuri, janë Muharrem Shahiqi, Ibrahim Shabani e shumë të tjerë. Gjilanasit janë ata që e thejnë derën për të hyrë brenda në Teatër. Jo vetëm për shtatë ditë që janë dhënë tetë shfaqje, por për 70 ditë po të jepeshin 80 shfaqje, ky teatër do të ishte përplot, sepse janë njerëz të kulturës, të dramës dhe të artit në përgjithësi”, ka thënë kryetari Haziri. Kreu i Gjilanit ka dhënë lajmin se buxheti për Kulturën është 200 mijë euro dhe kështu për herë të parë pas luftës po ndodhë stabilizimi i teatrit në Gjilan, duke mos llogaritur këtu shpenzimet për “Flakën e Janarit”, që janë shpenzime shtesë këto, sikur që këtë vit bashkë me Ministrinë e Kulturës do të investohen mbi 120 mijë euro pikërisht në Teatër. Ai ka thënë se do të kërkoj nga dy Ministrinë e Kulturës, në Prishtinë dhe Tiranë, që këtë manifestim të “Flakës së Janarit”, ta vendosin përfundimisht në kalendarin kulturor të shqiptarëve, sepse e meriton pas 25 vjetësh të trajtohet në mënyrë institucionale dhe të mos mbetet vetëm në vullnetin e Komunes. Orhan Kurtullu, regjisor në Te-

atrin e Stambollit, ka thënë se ajo çka është në këtë teatër në Komunën e Gjilanit, nuk ka në asnjë vend shqiptarë, bile edhe në teatro të njohura nëpër botë. “Në Gjilan për këto ditë, unë kam parë shfaqje dhe aktore të mrekullueshëm, por publiku dhe interesimi i jashtëzakonshëm i tyre për të ndjerë emocionin i cili del nga shfaqjet dhe teatri, vërtetë është i paparë. Në një vend ku nuk ka interesim të publikut për teatër, ai vend ka vdekur”, ka thënë Kurtullu, në fjalën e tij. Përndryshe, çmimi për aktorin më të mirë iu nda Ismet Azemit, me shfaqjen “Karramel”, kurse aktorja më e mirë në rolin kryesor i është dhënë aktore Aurita Agushi, në rolin e saj në shfaqjen “Luftë në kohën e Dashurisë”. Çmimi për rolin dytësor i është ndarë aktorit Bujar Lako me shfaqja “Kush e solli Doruntinën”, ndërsa për aktoren më të mirë në rol dytësor u shpërblye Driada Matoshi. Ndërsa teksti më i mirë iu nda Doruntina Basha, shfaqja “Gishti”. Ndryshe, në Festivalin e Dramës Shqipe janë shfaqur tetë drama, duke nisur me shfaqjen “Jetë me qera”, Teatri i Gjilanit, me tekst të Rafet Abazit dhe regji të Ekrem Sopit, “Kush e solli Doruntinën”, Teatri “Aleksandër Moisiu”- Durrës, me tekst Ismail Kadare dhe regji të Leart Vasili, shfaqja “Mendje e Djallëzuar”, Teatri “Istref Begolli” – Pejë, autor Blerim Haxhiaj, në regji të Elmaze Nurës, shfaqja “Lufta në kohë të Dashurisë”, Teatri “Multimedia” – Prishtinë, autor Jeton Neziraj dhe regji të Blerta Nezirajt, shfaqja “Ushtari i dy luftërave”, Teatri “Dodona” – Prishtinë, autore Ibadete Abazi dhe regji Elhame Kutllovci, shfaqja “Karramel”, Teatri “Adriana”-Ferizaj dhe “Kllapa” Prishtinë me autor dhe regji Naser Shatrolli, shfaqja “Gishti”, nga Teatro Kombëtar i Kosovës, me autor Doruntina Basha dhe regji Erson Zymberi, dhe shfaqja që e mbylli këtë festival të dramës, ishte “Kandilli i Argjandët”, Teatri “Migjeni”- Shkodër, me autor Martin Camaj dhe regji të Fatbardh Smaja.

Kuvendarët e Gjilanit diskutojnë me tone mospajtuese për gjendjen në arsim

29
JANAR

Kuvendi Komunal i Gjilanit, në seancën e parë për këtë vit, të cilën e ka kryesuar Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka miratuar vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim për interesa publike, raportin e suksesit të nxënësve në gjysmëvjetorin e parë, planin operativ emergjent për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, iniciativën e kryetarit të Komunës për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, vendimin për formimin e Komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit, raportin e Zyrës së Prokurimit si dhe raportet e punës së Komiteteve.

Kuvendi ka miratuar iniciativën e kryetarit të Komunës për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera dhe e ka autozuar atë të angazhohet në këtë drejtim. Bashkëpunimi ndërkomunal në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, bazohet në ofrimin dhe pranimin e shërbimeve, koordinimin e planeve të reagimit emergjent, operacioneve tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë me komunat fqinjë. Edhe plani operativ emergjent, të cilin në pika të shkurta e ka paraqitur Ensar Kadriu, drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka marrë mbështetjen e anëtarëve të Kuvendit. Isa Agushi (LDK), kryesues i Komitetit për Shërbime Publike, tha se plani është i mirë, detal, por kësaj drejtorie duhet t'i rritet buxheti, që të ketë mundësi reagimi në situata emergjente. Kuvendi ka miratuar edhe vendimin për Komisionin e Mbikëqyrjes së zbatimit të planit të integritetit, i cili përbëhet nga pesë anëtarë të asamblesë komunale: Refik Shala e Rina Ahmeti (LDK), Leonora Bunjaku (PDK), Ibish Ibishi (AAK) dhe Krenare Latifi (VV). Arsyetimin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim e ka paraqitur Sadudin Berisha, drejtor i Kadastrës, i cili ka thënë se KEDS-i ka kërkuar tri parcela në Velekincë, Livoç i Poshtëm dhe zonën "Qarku", me sipërfaqe të përgjithshëm prej 48 metra katrorë, për ndërtimin e tri trafave, si nevojë për stabilizimin e tensionit të energjisë elektrike. Sa i përket suksesit të nxënësve në gjysmëvjetorin e parë, drejtori i Arsimit, Namzi Musa ka thënë se ai është më i mirë për 0.5 për qind në krahasim me gjysmëvjetorin e njëjtë të vitit të kaluar. Nota mesatare në nivel komunal, është 3.70, ka thënë Musa. Kjo pikë ka nxitur debat te anëtarët e Kuvendit Komunal, ku pozita, nëpërmjet Arben Mehmetit (LDK), që njëherësh është edhe kryesues i Komitetit të Arsimit dhe të tjerëve, e ka mbështetur dhe lavdëruar punën e Drejtorisë së Arsimit, ndërkaq opozita, nëpërmjet Izmi Zekës, Riad Rashitit,

Leonora Bunjakut, Shukrije Rapucës (PDK), Nevzad Isufit, Fehmi Sylejmanit (VV) dhe të tjerëve, është shprehur e pakënaqur me gjendjen në arsim, duke kërkuar që sukseset të maten përmes krahasimeve. Duke iu përgjigjur akuzave të opozitës, Musa ka thënë se ai nuk bën krahasime ndërmjet kësaj dhe asaj qeverisje, por u shpreh i bindur se sot në arsimin e Gjilanit, gjendja është dukshëm më e mirë se dje, ndërsa nesër duhet të jetë larg më mirë se sot, pavarësisht se kush vjen në qeverisje, ka thënë ai. Debati është karakterizuar nga gjuha e ashpër në disa momente, sidomos ndërmjet drejtorit të Arsimit, Nazmi Musa dhe këshilltares së PDK-së, Leonora Bunjaku, aq sa kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku-Rexhepi, është detyruar të ndërhyjë dhe të kërkojë prej anëtarëve të Kuvendit që të ruajnë kulturën e komunikimit parlamentar dhe të mos ofendojnë njëri-tjetrin. Meqë drejtori i Arsimit ka refuzuar t'i kërkojë falje Leonora Bunjakut, me të cilën u solidarizuan pastaj edhe anëtarë të tjera të Kuvendit, për ta lëshuar seancën, këtë e ka bërë vetë kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku-Rexhepi, e cila ka arritur ta normalizojë gjendjen dhe Kuvendi ka vazhduar punën me pikat tjera. Po ashtu, Kuvendi miratoi edhe raportet e punës së Komiteteve. Kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku-Rexhepi tha se këto trupa ndihmëse, përmes punës së tyre profesionale e kanë ndihmuar shumë funksionimin e asamblesë komunale. Një raport për çështjet e prokurimit e ka paraqitur Salih Kqiku nga Departamenti i Prokurimit, i cili ka thënë se gjatë vitit 2015, janë zhvilluar 124 aktivitete të prokurimit. Ai ka dhënë përgjigje dhe në akuzat e opozitës për mos transparencë, duke thënë se ligji i prokurimit nuk lejon publikimin e planit. Sa i përket punës së këtij Departamenti, Kqiku tha se organizatat e pavarura kanë dhënë vlerësime pozitive. Me debate mospajtuese është karakterizuar edhe ky raport. Jakup Bajrami (LDK) tha se nga raporti shihet se në Gjilan është bërë punë e madhe dhe i ka dhënë mbështetje punës së Departamentit të Prokurimit. Riad Rashiti (PDK), ka thënë se në prokurim ka shkelje të shumta procedurale dhe ligjore. Nevzad Isufi (VV) tha se organizatat e pavarura kanë konstatuar parregullsi në prokurim. Isa Agushi (LDK) kërkoi nga opozita që akuzat për prokurimin, nëse ka fakte, t'i dërgojë në prokurori, përndryshe, tha ai, mos ia futni kot. Ndërkaq, Avdyl Aliu (LDK) tha se opozita i ka dërguar akuzat në prokurori, por janë hedhur poshtë për mungesë të fakteve. Në fund, nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu si dhe drejtorët Nazmi Musa, Ramiz Ramadani e Naser Korça janë përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit.



Raportimi i policisë para qytetarëve, standard i ri në Kosovë dhe rajon

29
JANAR

Stacioni Policor në Gjilan, për herë të parë që nga themelimi, ka bërë sot publik raportin e punës për vitin 2015, në sallën e teatrit të qytetit, ku ka marrë pjesë komandanti i stacionit policer në Gjilan, Remzi Azemi, drejtoresha rajonale e policisë, Elmina Mahmuti, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, përfaqësues të institucioneve lokale e qendrore dhe qytetarë të interesuar.

Komandanti i Stacionit Policor në Gjilan, Remzi Azemi, në adresimin para të pranishmëve tha se këtë hap e ka marrë për të qenë sa më transparent për publikun, ndërkaq ka falënderuar kryetarin Haziri për bashkëpunimin e mirë që e ka pasur në të mirë të sigurisë në Gjilan, sikurse edhe prokurorinë, gjykatën dhe qytetarët. “Publikimin e raportit të punës po e bëjmë për herë të parë për të qenë sa më transparent ndaj publikut. Viti 2015, punën e stacionit policor në Gjilan e karakterizon me një përkushtim, profesionalizëm dhe sukses të jashtëzakonshëm, pasi 77 për qind e rasteve janë zbuluar ose 13 për qind më shumë se në vitin 2014. Marrë në përgjithësi, mund të them se kemi arritur t’i përmbushin me përpikmëri objektivat e përcaktuara”, ka thënë Azemi, duke shtuar se asnjë incident nuk është shënuar me motive ndërfetare dhe ndëretnike. Drejtoresha Rajonale e Policisë në Gjilan, Elmina Mahmuti, theksoi se ndihet mirë me rezultatet e mira të

stacionit policor, duke thënë se raportimi sikur i sotshëm duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen. “Gjilanin, ky janar i vitit 2016 e bënë unik dhe e veçon edhe për prezantimin e raportit vjetor të policisë për herë të parë para publikut, sikur që e veçon Gjilanin edhe me manifestimet kulturore. Këto ditë kemi thënë se jemi bërë kryeqytet kulturor i shqiptarëve në Ballkan, por sot duhet ta vendosim në kalendar këtë të premte të shenjtë si ditë kur Policia e Gjilanit ka vendosur një standard në policinë e shtetit dhe atë në rajon mbi raportimin dhe komunikimin drejtpërdrejt me qytetarët”. “Ky standard i ri e veçon Gjilanin për shkak të kushteve të sigurisë dhe punës së palodhshme të policisë, të cilët veprojnë, ballafaqohen dhe ndërhyjnë edhe me mjete të fundit në parandalimin dhe ruajtjen e jetës, pronës dhe pasurisë së qytetarëve. Gjilani është qyteti i vetëm, i cili për nuk ka vrasje fatale dhe krimi si i tillë nuk njihet në këtë komunë që 2 vite. E falënderoj publikisht policinë, prokurorët dhe gjyqtarët për punën e madhe. Nëse ishim matë në parametra të standardeve të BE-së, Gjilani do ta merrte liberalizimin dhe do të ishte afër BE-së para shumë kohësh”, u shpreh Haziri. Krejt në fund, kryetari Haziri tha se propozimet e eprorëve të policisë për përmirësimin e kushteve në infrastrukturë-komunikacion, do të merren parasysht dhe do të bëjë investime të drejtpërdrejta.



Vitin e ardhshëm “Foto Flaka” do të mbahet në Galerinë e re të Qytetit

29
JANAR

Në kuadër të Flakës së Janarit sonte është bërë përzgjedhja e fotografisë më të mirë të festivalit “Foto Flaka”, si risi e kësaj kategorie në kuadër të manifestimit “Flaka e Janarit 2016”, me çrast kishte mbledhur fotograf të shumtë nga qytete të ndryshme të trojeve shqiptare nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Lugina e Preshevës.

Me këtë rast kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, i cili edhe ka bërë hapjen e “Foto Flakës”, ka thënë se këtë vit “Flaka e Janarit 2016” është e pasuruar edhe me kategori të reja artistike, që kanë sjellur edhe artist e artdashës të shumtë në Gjilan. “Gjilani e me këtë rast edhe “Flaka e Janarit 2016”, në vitin jubilar të saj, është pasurua edhe me kategori të reja artistike, që janë vlera kulturore për manifestimin “Flaka e Janarit”, por edhe për Gjilanin që është tashmë kryeqendra kulturore e shqiptarisë. Menjëherë do të nisim me organizimin e “Flakës së Janarit”, për vitin 2016. do të vazhdojmë edhe me tutje ruajtjen e origjinalitetit të këtij manifestimi, por përherë duke e zgjeruar me aktivitete kulturore dhe artis-

tike, sepse ky është manifestim që përmes kulturës dhe artit në përgjithësi të kujtohen heronjtë dhe dëshmorët e rënë për liri”, ka thënë kryetari Haziri. Haziri, poashtu ka konfirmuar pikërisht në këtë event të fotografisë, se Foto Flaka e vitit të ardhshëm do të mbahet në objektin e Galerisë së Qytetit dhe jo në këso ambiente që më së paku i ngjajnë një galerie, ndërsa në Gjilan në vitet në vijim do të kemi pos Galerisë së Qytetit edhe Kinemanë dhe institucione të tjera që janë të domosdoshme për zhvillimin e artit. “Këtë vit interesimi për “Flakën e Janarit” e veçanërisht për teatrin mua më ka kujtuar vrapimin e publikut pas Teatrit të Shek Spirit dhe nga këtu e them se mbështetja e Komunës do të jetë përherë shumë e fuqishme si në organizim ashtu edhe në financim të infrastrukturës për objekteve”, ka thënë në fund kryetari Haziri. Haziri poashtu ka ndarë çmimin për fotografinë më të mirë të festivalit Flaka e Janarit, të cilin e ka marrë fotografi, Haris Alija, nga Prizreni. Ndërsa përzgjedhja është bërë nga juria profesionale e përbërë nga Faredin Spahiu, Vlora Ymeri dhe Din Azizi, të cilët kanë bërë vlerësimin për fotot e 16 fotografëve pjesëmarrës.



Klubi i volejbollit “Drita” – nderi i qytetit

27
JANAR

Kryetari i Komunës së Gjiçanit, Lutfi Haziri, ka pritur në një takim Klubin e Volejbollit të Femrave “Drita”, që siç ka thënë ai, ky klub dhe lojtarët e gjeneratës së re, janë nderi dhe krenaria e qytetit sepse në vitin 2015 kanë marrë tri kupa dhe medalje të shumta nëpër gara në vend.

Ai ka thënë se mbështetja e Komunës së Gjiçanit do të jetë e vazhdueshme edhe për këtë vit, ndërsa ka informuar se ky klub do të nominohet edhe për çmimin e radhës të cilin e ndanë Komuna në qershor kur edhe është data e çlirimit të Gjiçanit. “Klubi i volejbollit të femrave “Drita”, është klub që është krenaria dhe nderi i të gjithë neve e në veçanti i qytetit të Gjiçanit, për sukseset e arritura në vitin 2015. Mbështetja e Komunës së Gjiçanit do të jetë 100%. Ne do të jemi prapa jush gjatë gjithë kohës, edhe në garat jashtë vendit, dhe së bashku me ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të gjejmë format që mbështetja të jetë kur keni angazhime jashtë vendit. Sa i përket infrastrukturës sportive – palestrës, ajo do të jetë në shërbimin tuaj, sepse ekipet elitare dhe të suksesshme meritojnë mbështetjen në të gjitha format. Po ashtu ju informoj se nga sot ky ekip do të jetë i nominuar për çmimin e qytetit që ndanë Komuna në ditën e çlirimit më 15 qershor, ndërsa vajzave suksese edhe më tutje në sport por edhe në mësimet e studimeve”, përfundoj kryetari Haziri. Nga ana e tij, Lorik Ilazi, trajner i klubit, ka falënderuar Komunën e Gjiçanit për mbështetjen, duke potencuar se mbështetja financiare që ka ardhur nga qeverisja komunale, ka bërë që sukseset të jenë këto që janë duke mbajtur kampionin e Kosovës. “Kryetar sot jemi këtu që t’u falënderojmë për mbështetjen që na keni dhënë gjatë vitit 2015. Falë asaj mbështetjeje, ne jemi sot këtu para jush me tri kupa dhe me shumë medalje që kemi marrë në gara të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Sot ju informojmë se me mbështetjen që na konfirmuat, ne në vitin 2016, do të jemi edhe më të fuqishëm dhe më të angazhuar. Tashmë si ekip kemi marrë tri kupa, fillimisht Kupën e Republikës së Kosovës, pastaj Kupën e Federatës së Volejbollit, e më pas edhe Super Kupën e Kosovës. Jemi të vendosur të marrim pjesë edhe në gara ndërkombëtare dhe në gara të tjera jashtë vendit, me qëllim që Gjiçanit fillimisht, por edhe Kosovës ti japim fitore sa më të mëdha”, ka thënë ndër të tjerash Ilazi.

BB ka miratuar aplikimin e Gjilanit për komponentën e llogaridhënies sociale



27
JANAR

Komuna e Gjilanit edhe zyrtarisht sot është informuar nga Banka Botërore, për miratimin e aplikimit të Gjilanit për komponentën e llogaridhënies sociale, që ka qëllim angazhimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje lokale dhe qëndrueshmërinë sociale në praktikën e komunës, për të përmirësuar integritetin, transparencën e organizatës dhe llogaridhënies, si dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike dhe aseteve publike të menaxhimit.

Me këtë rast, nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, ka thënë se kjo marrëveshje është një mbështetje për Gjilanin në kuadër të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies. “Aplikimi i Komunës së Gjilanit për komponentën e llogaridhënies sociale, sot jemi informuar se është miratuar nga Banka Botërore. Përmes këtij memorandum synohet që të pajisen dhe përgatiten zyrtarët lokal

të zgjedhur, zyrtarët dhe stafi teknik, për të menaxhuar efektivisht zhvillimin urban, për rritjen gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve qeverisë në programe të reformës. Aktivitetet e parapara që do të ndërmerren në Komunën e Gjilanit do të mbulojnë dy hapa kryesorë, atë për kryerjen e përgjegjshmërisë sociale dhe Vlerësimin e Përfshirjes Qytetare në fazën e parë të projektit dhe e dyta është aktivitetet për të hartuar Planin e Veprimit për strategjitë prioritare të miratuara”, ka thënë nënkryetari Kadriu. Ai po ashtu ka potencuar se mbështetje të fuqishme në këto dy shtulla do të kemi nga Banka Botërore, por angazhimi do të jetë edhe i Komunës njëkohësisht në përmbushjen dhe zbatimin e këtij memorandum, sepse e gjithë kjo po bëhet në interes të qytetarëve, por edhe transparencës duke qenë komponenta e llogaridhënies përherë e më e avancuar në Komunën e Gjilanit në përgjithësi.



“Luftë në kohë të dashurisë” shfaqet para publikut Gjilanas


26
JANAR

26 janar 2016 / Në Teatrin e qytetit në Gjilan, mbrëmë është bërë shfaqja e dramës “Luftë në Kohë të dashurisë”, nga Teatri “Multimedia” – Prishtinë, e cila në skenë ka sjellur në mënyrë modern apo posmoderne dramën e luftës për dashuri, që prezantimi kryesor i saj ishte vendosur në një salon ondulimi si vend ku më lirshëm femrat shprehin hallet, brengat, por edhe dashurinë që kanë për intimitetin dhe investimin që bëjnë të duken më bukur dhe më tërheqëse.

Sikur edhe në shumë shfaqje të tjera, edhe në këtë mbrëmje, numri i publikut ishte ai që vëndet që ofron Teatri janë shumë minimale në krahasim me kërkesën për të parë shfaqjet. Me këtë rast dyshja Jeton Neziraj dhe regjisorja Blerta Neziraj, kanë thënë se kjo shfaqje është

pikërisht për të sjellur verzionin e dashurisë nga këndi i një salloni, ku shprehjet dhe intimitetet për dashurinë janë më lirshëm të rrëfyera mes femrave që frekuentojnë aty, për investimet që bëjnë në bukurinë e tyre. Edhe publiku, ka pritur mjaftë mirë shfaqjen që ishte me skena të shumta provokimesh, e fjalëve intime të cilat prezantoheshin mjaftë lirshëm në këtë sallon, përkundër që kishte edhe nga debatues të shumtë pas shfaqjes që këtë e radhisnin në një shfaqje me shumë skena banale të panevojshme. Ndryshe, temat “tabu”, përherë janë shoqëritë avangardiste që i tejkalojnë edhe kur ato janë me elemente banaliteti, intimiteti, apo tejkalim nga një në gjeneratë tjetër të shoqërisë, e cila është aktualiteti iI evaluimit të shoqërisë në përgjithësi.

Kryetari Haziri emëron grupet për impementimin e projekteve milionëshe në Gjilan



25
JANAR

Çështje tejet të rëndësishme janë diskutuar sot në mbledhjen e bordit të drejtorëve të Komunës së Gjilanit të drejtuar nga kryetari Lutfi Haziri, në të cilën kanë marrë pjesë edhe drejtorët e ndërmarrjeve publike, sikurse edhe zyrat vartëse të kryetarit. Javën e ardhshme nisin procedurat për zgjerimin e rrugës Gjilan-Ferizaj (hyrje-dalje). Nga drejtimi i Kamenicës, tashmë ka filluar ndërtimi i rrugës me katër korsi.

Kreu i Gjilanit ka theksuar se shuma e investimeve në këtë Komunë për këtë vit për herë të parë tejkalon shumën e buxhetit komunal, duke përmendur projektin për trajtimin e ujërave të zeza, investime nga qeveria e Austrisë dhe ajo e Kosovës, projekti për rrjet të ujësjellësit me financim të qeverisë së Zvicrës, projekti për renovimin e stadiumit të qytetit, ndërtimin e palestrës së sporteve në Zhegër me investime nga qeveria gjermane, atë të efijencës së energjisë elektrike, ku përfshihet renovimi i të gjitha objektet publike, renovimi i teatrit të qytetit, Sa-

hat Kullës, vazhdimi i implementimit të banimit social, ku do të ndërtohen edhe shtatë shtëpia të reja për familjet në nevojë etj. Po ashtu, në takimin e sotëm është bërë e ditur se së shpejti do të dalë në ankand publik rregullimi i “Tregut të Gjellbër”, sikur që edhe gjatë javës do të nisin procedurat e projektit për ndërtimin e rrugës me katër korsi (hyrje-dalje) Gjilan-Ferizaj. Bordi ka konfirmuar se Gjilani ka nisur procedurat për subvencionimin e mjedresës, që është hera e parë në Gjilan, ndërkaq, që nga ana tjetër, pritet të nis së projekti i varrezave të reja. Komuna e Gjilanit tashmë e ka të gatshëm edhe projektin për menaxhimin e mbeturinave, i cili do të nis së implementuari gjatë javës, përderisa është e përgatitur për menaxhimin e vërshimeve eventuale si pasojë e shkrirjes së borës. Kryetari Haziri ka emëruar grupet për implementimin e këtyre projekteve milionëshe, i cili i vlerësoi si më të rëndësishmet që nga paslutfja, duke ua përmirësuar kualitetin e jetesës qytetarëve të Gjilanit.

Pejanët vijnë me “Mendje Djallëzore” në Gjilan



25
JANAR

Teatri “Istref Begolli” nga Peja, në kuadër të manifestimit “Flaka e Janarit 2016”, ka shfaqur mbrëmë dramën “Mendje Djallëzore”, me tekst të Blerim Haxhiajt dhe me regji të Elmaze Nura, ku të pranishmit e shumtë kishin rastin të shohin edhe nga afër një shfaqje, e cila prezantonte aktualitetin në vend, problemet me drejtësinë, problemet shoqërore por edhe ndikimet e jashtme në maskimin e të vërtetës.

Regjisorja Elmaze Nura, në fjalën e saj ndër të tjerash ka thënë se kjo shfaqje qëllim ka të sjell aktualitetin e përgjithshëm në skenën e një shfaqjeje, duke spikatur kryesisht, jetën e dy të burgosurve, nga të cilit pafajësia detyrohet të vuaj dënimin për krimin e pakryer asnjëherë,

kundrejt kriminelit i cili paraqitet figurë me ndrikim edhe nga burgu. Të pranishmit, kanë dhënë vlerësime pozitive për shfaqjen e cila sipas shumë kritikëve të cilët kanë dhënë vlerësimet për shfaqjen, kanë thënë se “ky është realiteti i deritanishëm, ku kriminelët shpeshherë përmes ndikimit dhe lidhjeve të fuqishme që ka, shfrytëzon çdo gjë, për të shpëtuar nga vepra penale, duke mëveshur të tjerëve fajësinë në mënyrë që vet kriminelin të lirohet”, thanë ata ndër të tjerash. Ndërsa, gjatë natës së sontme publiku i Gjilanit kanë mundësinë që nga afër të ndjekin shfaqjen “Lutfa në kohën e Dashurisë”, nga Teatri “Multimedia” Prishtë, me tekst të Jeton Nezirajt dhe me regji të Blerta Nezirajt”.



Talia e Flakës vazhdon me “Kush e solli Doruntinën”

24
JANAR

Shfaqja “Kush e solli Doruntinën”, është prezantuar nga aktorët e Teatrit “Aleksandër Moisiu” nga Durrësi, me tekst të shkrimtarit të madh shqiptarë Ismail Kadare dhe me regji të regjisorit Leart Vasili, ku sipas kritikëve të shfaqjes, ishte një vepër e përgatitur mjaftë mirë në aspektin skenik.

Me këtë rast regjisor Vasili, ka thënë se veprat e përgatitura nga shkrimtari i madh Kadare, janë përherë të vështira për tu inskenuar në Teatër. “Veprat e të madhit Kadare, janë përherë të vështira për ti paraqitur në skenën e Teatrit, por me lejen e autorit dhe me elemente moderne ne kemi bërë këtë vepër edhe në skenë. Elementet bazë të novelës

së Kadaresë, i kemi kryesoret, pasi pa to është e mangët shfaqja. Mitologjia për Besën, personazhi Konstandini, roli dhe ndikimi i Kishës dhe personazhe të shumta janë të njëjtë me atë të Kadaresë. Thjeshtë kemi dashur që të mbajmë gjallë interesimin e publikut për shfaqjen”, tha ai ndër të tjerash. Edhe juria profesionale, ka dhënë vlerësim pozitiv për këtë shfaqje, duke vënë theksin në elementet moderne të prezantuara, në bazën dhe mitologjinë e ruajtur, por edhe në lirinë që kishin aktorët gjatë roleve të tyre. Ndryshe, informojmë artëdashësit që sonte do të mund të ndjekin shfaqjen “Mendje Djallëzore” nga teatri “Istref Begolli” të Komunës së Pejës, me tekst të Blerim Haxhiajt dhe me regji të Elmaze Nurës.



Interesim i jashtëzakonshëm i qytetarëve për festivalin “Talia e Flakës”

23
JANAR

Mbrëmë në Gjilan është hapur Festivali i Dramës Shqiptare “Talia e Flakës”, si pjesë përbërëse e manifestimit shumëkulturore “Flaka e Janarit” që mbahet në nderim të heronjve, dëshmorëve dhe martirëve shqiptarë, të rënë nëpër janarët dhe muajt tjerë të historisë së vështirë shqiptare për liri e identitet kombëtar, që këtë vit shënon vitin jubilar të 25 me radhë.

Festivalin e ka shpallur të hapur aktori i madh shqiptarë, Enver Petrovci, i cili në skenë u ngjiti me kërkesën e kryesueses së Kuvendit të Komunës, Valentina Bunjaku – Rexhepi. Me këtë rast Petrovci shkurtimisht ka thënë se nuk mbanë mend ndonjëherë që ndonjë Teatër shqiptarë të kishte numër kaqë të madhë të të interesuarve për shfaqjen. “Nuk mbaj mend dhe nuk ka ndodhur ndonjëherë, që kaq shumë qytetarë të jenë të pranishëm në një shfaqje. Dhe poashtu nuk mbahet mend asnjëherë që ky numër kaq i madh të ketë qenë ndonjëherë edhe në Teatrin e Gjilanit edhe pse Gjilani njihet për interesimin e madh që ka për Teatrin. Mund të them vetëm një gjë, që Gjilani ka vlerë, kulturë dhe traditë në Teatër, prandaj është kështu e mbushur salla edhe sonte dhe jam i bindur që kështu do të jetë deri në fund”, ka thënë ai duke shpallur të hapur festivalin e dramës në Gjilan. Ndërsa kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, Valentina Bunjaku – Rexhepi, në fjalën e saj, ka falënderuar të gjitha teatrot pjesëmarrëse në këtë manifestim, sikur që një falënderim ka dhënë edhe për artistët mbarë-shqiptarë që janë në Gjilan gjatë kësaj jave. “Falënderim i

veçantë për gjithë teatrot, artistët dhe artdashësit që janë për këtë javë në Gjilan. Është nderë dhe krenari për Gjilanin që në hapje të festivalit kemi artist, regjisor, dramaturg, veteranë të teatrit, udhëheqës të tjerë kulturor nga gjitha trevat shqiptare dhe më gjerë. Komuna e Gjilanit është mbështetëse financiare dhe organizatore e këtij manifestimi, falë përkushtimit të madh e të vendosur të kryetarit të Gjilanit, Lutfi Haziri, nën përkujdesjen e të cilit edhe mbahet “Flaka e Janarit 2016”. Përcaktimi i kryetarit që të mbështesë artin dhe aktivitetin kulturor të Gjilanit në përgjithësi, dëshmon se është veprimi më i duhur, kur kemi parasysh interesimin e jashtëzakonshëm të pjesëmarrësve nëpër aktivitete të ndryshme”, ka thënë Bunjaku – Rexhepi, në fjalën e saj. Ndërsa të pranishmit kanë përcjellur shfaqjen “Jetë me Qera” e cila ishte edhe shfaqja hapëse e festivalit “Talia e Flakës”, që është përgatitur nga Teatri i Gjilanit, me regji të regjisorit Ekrem Sopit dhe performim të aktorëve gjilanas. Kjo shfaqje është pritur jashtëzakonisht mirë nga publiku, ku herë pas here duartrokitjet ishin ato që ndikonin në pauza të shkurta skenike. Regjisorin Sopi, i cili që nga paslufta, ka përgatitur disa shfaqje, ka thënë se pritja nga publiku, është vlerësim i jashtëzakonshëm për shfaqjen. “Ne kemi paraqitur përmes kësaj shfaqje jetën reale që ndodhë në teatër, skenë politike dhe në shoqëri në përgjithësi. Ndje hem mirë që aktorët kanë dhënë gjithçka nga vetja që kjo të jetë shfaqje që e mbanë të ndezur interesimin e publikut për shfaqjen”, ka thënë ai ndër të tjerash.



Grantet e BE-së për biznese të vogëla dhe të mesme, mundësi për punësim

21
JANAR

Në organizim të AZHR-Lindje, sot është mbajtur sesioni i parë informues në Gjilan, lidhur me ftesën për propozime për zhvillimin e sektorit privat. Deri më tani rreth 100 aplikantë potencialë ishin të pranishëm në këtë takim dhe kishin mundësinë që të informohen rreth detajeve mbi të gjitha aspektet e procesit deri në aplikim për këtë thirrje për projekt-propozime (grante).

Në këtë takim ishte i pranishëm edhe nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, i cili ka shprehur mirënjohjen e tij për rrjetin ARDA dhe në veçanti AZHR-Lindje, për mbështetjen e vazhdueshme për zhvillimin e sektorit privat në komunën e Gjilanit, duke theksuar se kjo është një mundësi e mirë dhe e madhe që u ofrohet bizneseve të vogla dhe të mesme. “Është një mundësi e madhe që po u ofrohet bizneseve të vogla dhe të mesme. Shpresojmë që të kemi sa më shumë përfitues të këtyre granteve, që ndikojnë drejtpërdrejtë edhe në gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillim ekonomik njëkohësisht. AZHR dhe mekanizmat e saj mbështetës, janë meritoret e drejtpërdrejtë për këto takime, me qëllim të përgatitjes paraprake të aplikuesve të mundshëm që të kenë sukses. Në mbështetje të kryetarit Haziri, jemi të vendosur që biznesit në Gjilan ti krijohen kushte dhe lehtësira edhe më të mëdha në ush-

trim të veprimtarive të tyre, sepse interesi i përbashkët është zhvillimi dhe punësimi”, ka thënë, ndër të tjerash, në fjalën e tij, nënkryetari Kadriu. Edhe drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Agim Zuzaku, ka thënë se kjo është një mbështetje për sektorin privat, që mundësohet nga zyra e BE-së në Kosovë dhe fondet e qytetarëve të BE-së. “Është fat i madh që kemi një mbështetje të zyrës së BE-së, përmes projekteve me shumë rëndësi në zhvillim ekonomik në Kosovë. Urojmë që sa më shumë biznese nga komuna e Gjilanit të jenë përfitues. Si drejtori, jemi të gatshëm në asistim dhe mbështetje të bizneseve që të jenë përfitues nga këto grante, por një rol ky ka këtu ARDA-ja, me stafin e saj, të cilët tashmë kanë dëshmuar për mbështetjen konkrete të bizneseve të këtij regjioni dhe të Gjilanit në veçanti”, tha drejtori Zuzaku, duke ftuar të gjitha bizneset e vogla dhe të mesme, që të jenë pjesë e këtij programi, në mënyrë që përfitues të jenë sa më shumë qytetarë, përmes punësimeve të reja. Ndryshe, skema e granteve për zhvillimin e sektorit privat, financohet nga zyra e BE-së në Kosovë, në kuadër të projektit “Mbështetje e Zhvillimit Ekonomik Rajonal në Kosovë” i implementuar nga rrjeti ARDA. Kurse, udhëzimi dhe dosjet e plota të aplikimit mund të shkarkohen në linkun e mëposhtëm dhe afati i fundit për aplikim është: [www.arda-kosovo.eu/grant-scheme](http://arda-kosovo.eu/grant-scheme)



Haziri: Presidenti Rugova e trasoi rrugën për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës

21
JANAR

Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është mbajtur në akademi përkujtimore në shënim të 10-vjetorit të ndarjes nga jeta të presidentit historik të Kosovës, Ibrahim Rugova, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve lokale e qendrore dhe qytetarë të shumtë.

Në fjalën e rastit, kryetari I Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se Kosova po kalon pa njeriun e vet, po krijuesin e saj, pa shkrimtarin dhe themeluesin e shtetit më të ri në botë, Ibrahim Rugova. Ai tha se presidenti Rugova, në momentet më të rënda për Kosovën e ngriti zërin e tij të butë, por të pandryshueshëm për dekada të tëra karshi regjimit, totalitarizmit të një shteti, i cili te shqiptarët gjithmonë është perceptuar si okupator i madh. “Në vitin e parë të ndarjes së tij nga jeta, kur Kosova po mendohej ta përmbyllë njohjen formale të pavarësisë, siç thoshte presidenti Rugova, me unitetin e ndërtuar me vështirësi jashtëzakonisht të madh në atë kohë, por duke qenë president dhe njeri i unitetit, ai arriti ti bashkoi të gjitha forcat politike relevante rreth një tryeze për t’u përballur me njohjen ndërkombëtare të Kosovës, që është hapi i fundit i realizimit të ëndrrës së tij dhe gjithë shqiptarëve. Ai arriti ti bashkonte dhe ta trasonte atë rrugë që siguroi de jure dhe de fakto shpalljen e Pavarësisë së Kosovës”, është shprehur Haziri. Ai ka përmendur një vlerësim të

presidentit amerikan, Bill Clinton, i cili ka thënë ajo që e dallon Rugovën nga të tjerët është se ‘ai na ka treguar se si ta realizojmë kërkesën e shqiptarëve për Liri e Pavarësi’.

“Presidenti amerikan, Bill Clinton, në një sesion të mbyllur ka thënë se ‘ajo që dallon Rugovën nga gjithë ata që në Ballkan dhe Europën Juglindore cilësohen si liderë, është se Rugova shqiptarëve në Kosovë dhe ne miqve tuaj, iu ka ofruar vision i cili ka qenë i përshkruar, vizion i cili ka qenë i ndërtuar dhe vizion i cili na ka treguar se si ta realizojmë kërkesën e shqiptarëve për Liri e Pavarësi’, ka shtuar kryetari Haziri. Kreu i Gjilanit pohoi se sot Kosovës i duhet një vizion i cili besohet, një vizion i cili ndërtohet dhe një vizion i cili bëhet i besueshëm edhe për miqtë tanë. Ai tha se të gjithë e thonë se janë të nderuar që kanë jetuar në epokën e Rugovës, duke shtuar se “nuk kam besuar kurrë që edhe 10 vite pas ndarjes nga jeta ka grupime politike në Kosovë që edhe për së vdekuri iu pengon”. Haziri theksoi se kërkesa e presidentit Rugova ka qenë që të punojmë të bashkuar, që dallimet tona t’i shohim si vlera, që të ndërtojmë liri për çdo individ dhe çdo familje, që të besojmë në vete, familje e Zot. “Kjo është ajo që Lirinë, Pavarësinë dhe Demokracinë në Kosovë e garanton përjetësisht sepse është testament i cili nuk mund të thyhet”, tha Haziri.

Gjilani përfiton 1.3 milionë euro investime nga Ministria e Kulturës



18
JANAR

Një milion e 300 mijë euro investime ka përfituar sot Komuna e Gjilanit nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të kryetarit Lutfi Haziri dhe ministrit Kujtim Shala. Mjetet do të shfrytëzohen për renovimin e stadiumit, teatrit dhe projekte tjera të infrastrukturës kulturore e sportive.

Nga ky memorandum, 598 mijë euro shkojnë për “Renovimin e Stadiumit të Qytetit të Gjilanit”, 625 mijë euro për “Ndërtimin e Palestrës së Sporteve në Zhegër”, derisa edhe rreth 100 mijë euro janë ndarë për renovimin e Teatrit të Gjilanit, rreth 20 mijë euro për Sahat Kullën. Kreu i Gjilanit Lutfi Haziri, pasi ka falënderuar ministrin Shala për mbështetjen, theksoi se me këto projekte kapitale për Gjilanin, ndikohet dukshëm në përmirë-

simin e infrastrukturës në sport dhe gjithashtu krijohen kushte më të volitshme për zhvillimin e sportit në këtë komunë. Ai tha se që nga marrja e mandatit të kryetarit, e ka vënë në prioritet kulturën, rininë dhe sportin, duke përmendur edhe ndërtimin e shtëpisë së rinisë, ndërtimin e stadiumit ndihmës, dhënien e zyrës së tij për muzeun e qytetit, si dhe projektin për galerinë e qytetit. Nga ana e tij, ministri Shala u shpreh se MKRS-ja është e përkushtuar që të bashkëpunojë me komunat e Kosovës dhe t’i ndihmojë ato në përmirësimin e infrastrukturës në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Shala theksoi se investime kapitale në Gjilan, do të krijojnë kushte më të mira dhe në përkim me standardet moderne për zhvillimin dhe avancimin e mëtejshëm të sportit, sidomos në kohën kur sporti i Kosovës po ndërkombëtarizohet gjithnjë e më shumë.

Haziri: Janari u bë muaji më i rëndësishëm për shqiptarët, pas nëntorit

17
JANAR

Nën organizimin e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është mbajtur sot “Akademia e Flakës”, në kuadër të manifestimit “Flaka e Janarit 2016” për të nderuar sakrificën e dëshmorëve për lirinë e shqiptarëve, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues nga jeta institucionale e kulturore, familjarë të dëshmorëve e qytetarë të shumtë.

Në fjalën e rastit, kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri tha se heronjtë, dëshmorët e martirët u bënë shembulli më i mirë i sakrificës, jo në familje e lagje e qytet, po kudo që jetojnë shqiptarët në trevat ektike. “Gjilani për 25 vjet rresht në mënyrën e vet më të veçantë të mundshme nderon të gjithë ata që sakrifkuan për lirinë, për Republikën, për shqiptarët kudo që janë. Ata nuk luftuan për Gjilan e Anamoravë. Ata u kryengritën për të drejtat e shqiptarëve kudo që jetojnë. Ata unë bënë shembulli më i mirë i sakrificës, jo në familje e lagje e qytet, por kudo që jetojnë shqiptarët në trevat ektike, gjithë ai mal i madh i mërgimtarëve anë e kënd botës që ishin pjesë e pandashme e përpjekjeve për liri dhe pavarësi. Më lejoni t’i kujtoj me këtë rast me përulje heronjtë e dëshmorët e Gjilanit e Anamoravës që nga Idriz Seferi, Mulla Idriz Gjilani, Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Kadri Zeka, Zija Shemsiu, Reshat Ymeri, Halim Orana, Agim Ramadani dhe të gjithë dëshmorët tjerë”, tha Haziri. Haziri ka kërkuar drejtësi për Kadri Zekën e vëllezërit Gërvalla sepse, siç tha, duke qenë heronjë dhe



emblemë, ata e meritojnë dhe ne e meritojmë që të dihet saktësisht kush qëndroi prapa këtyre vrasjeve mizore. “Ky 17 janar i ftohtë i shënon me ngjyra të kuqe, ngjyrën e gjakut, rënien heroike të Kadri Zekës. Ju familje të dëshmorëve, mbi të gjitha sot jeni krenarë, jeni të fortë dhe jeni përballë kësaj situatë që vendi ynë kërkon edhe më tutje të luftojë për lirinë e plotë. Sot, mbi tri dekada ne presim drejtësi e cila akoma nuk ka folur. Ne kërkojmë drejtësi për Kadri Zekën e vëllezërit Gërvalla sepse duke qenë heronjë dhe emblemë, ata e meritojnë dhe ne e meritojmë që të dihet saktë kush qëndroi prapa këtyre vrasjeve mizore. Janari i madh e i përgjakshëm u bë muaji më i rëndësishëm pas nëntorit, i cili lidhet me lirinë e shqiptarëve”, ka shtuar kryetari i Gjilanit. Ai theksoi se dëshmorët na mësuam të mos e pranojmë padrejtësinë, të mos frikohemi të rezistojmë e të luftojmë për të drejta, liri e unitet. “Ne shqiptarët ende nuk e kemi lirinë e plotë. Ne shqiptarët ende nuk jemi bashkë në Ballkan dhe në Europë duhet të hyjnë të bashkuar në një komb i cili është amaneti më i madh i dëshmorëve”, u shpreh Haziri. Një fjalë rasti pati edhe doajeni i veprimtarisë kulturore dhe gazetarisë, Hasan Bunjaku, i cili vlerësoi se pas rënies së dëshmorëve lindi ideja e manifestimit kulturor “Flaka e Janarit”, duke shtuar se në kohën e paraluftës janë përballur me shumë sakrifica e probleme për të organizuar këtë manifestim, i cili po vazhdon edhe pas 25 vjetëve me krenari.

“Peneli i Flakës” mbledh artistë të shumtë në ekspozitën kolektive

17

JANAR

Në Galerinë e Arteve në Gjiilan është hapur ekspozita e arteve pamore “Peneli i Flakës”, si njëra ndër katër shtyllat themelore të manifestimit “Flaka e Janarit”, ku janë ekspozuar punime të krijuesve të ndryshëm, në pikturë, sculpture dhe grafikë, ndërsa është ndarë edhe çmimi blerës i galerisë që është tashmë tradicional.

Tematikat e punimeve trajtonin tema të ndryshme me dominimin të elementeve të fuqishme kombëtare shqiptare. Me këtë rast kryetari i Komunës së Gjiilanit, Lutfi Haziri, në hapjen e kësaj ekspozite ka thënë se Gjiilani dhe artistët e kësaj ane, sot, kanë nderin që në qytetin e kulturës të presin kolegët e tyre nga të gjitha trojet shqiptare. “Gjiilani ka traditë në organizimin e “Penelit të Flakës”, respektivisht ekspozitat e mëdha dhe me përmbajtje në nderim të të rënëve për lirinë e vendit. Kjo praktikë e mirë kulturore do të vazhdojë edhe më tutje me kultivimin e mirëfillt dhe original të artit pamor. Kjo shtyllë e ka ruajtur origjinalitetin e saj që nga themelimi i flakës para 25 vjetëve. Është një rrugë e gjatë dhe shumë e vështirë që është kaluar për këto 25 vjetë të “Flakës...”, e posaqërisht shumë e rëndë është periudha e organizimit të saj gjatë viteve të ’90-ta. Komuna e Gjiilanit do të jetë edhe në të ardhmen një mbështetje e fuqishme e artistëve të kësaj fushe

në përgjithësi, sepse arti i bashkon të gjithë përmes vlerave të mëdha që ka”, ka thënë ndër të tjerash në fjalën e tij kryetari i Gjiilanit Lutfi Haziri. Ndërsa, përgjegjësi i Njësisë për Kulturë, Kujtim Shahiqi, ka falënderuar kryetarin e Komunës së Gjiilanit për mbështetjen e këtij organizimi në kuadër të “Flakës...”, duke potencuar se sot në Gjiilan, janë vepra të ndryshme të autorëve gjithkombëtar, duke qenë pjesë e ekspozitës punime të ndryshme nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Lugina e Preshevës etj, gjë që e ka bërë edhe më madhështore këtë organizim. Përgjegjësi për artin pamor, në kuadër të “Flakës së Janarit 2016”, skulptori Avni Behluli, tha se qëllimi i manifestimit padyshim është që ekspozita ta përfitojë karakterin gjithëkombëtar dhe të bëhet njëra nga shtyllat kryesore të tërë këtij spektri kulturor të emërtuar me emrin “Flaka e Janarit”. Gjithashtu ai ka thënë se interesimi i artistëve të rinjë është shumë i madh dhe i mirëseardhur për vlerat e artit në përgjithësi, duke e zbukuruar këtë manifestim edhe më shumë. Ndryshe çmimi blerës i galërisë i është dhënë piktorit, Rasim Vllasaliu, ndërsa tri çmime të tjera janë ndarë për Agim Bujupit, Eshtref Berisha dhe Mervan Mustafa në pikturë. Manifestimi kulturor tradicional “Flaka e Janarit 2016”, përveç pjesës së artit pamor, mbështetet edhe në shtyllat tjera themelore siç është, arti letrar, arti skenik dhe arti muzikor.

Lutfi Haziri mori certifikatë për 30 sekonda përmes shërbimit “e-kiosqet”



15
JANAR

Lutfi Haziri ia bëri sot sefte projektin më të ri të Komunës së Gjilanit “e-kiosqet”, duke marrë certifikatën e lindjes për 30 sekonda. “E-kioska” është vendosur para objektit të administratës dhe kryetari Haziri tha se ky është test-program dhe do të zgjerohet në të gjitha lagjet dhe fshatrat e mëdha, në mënyrë që secili qytetar t’i ketë shërbimet sa më afër.

“Sot Gjilani shënon hapin e pestë të modernizimit të administratës së saj të shërbimeve civile. “E-kiosqet” janë në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj që dëshirojnë të kenë shërbime 24 orë. Falë këtij aplikimit edhe të këtij shërbimi, qytetarët nuk kanë nevojë as të presion e as të kontaktojnë sportelet tona. Ky është test-program dhe do të zgjerohet në të të gjitha lagjet dhe fshatrat e mëdha të komunës së Gjilanit, në mënyrë që secili t’i ketë shërbimet sa më afër”, ka deklaruar kryetari Haziri, pasi e mori certifikatën. Ai tha se në Gjilan do të vendosen dhe dy kiosqe informative për nevojat e qytetarëve, sikurse edhe një kiosk që do të jetë një formë e kartelës shëndetësore që pacienti të lidhet me mjekun drejtpërdrejt. “Janë programe që po i avancojmë e po i realizojmë me shumë sukses dhe besojmë shumë që Gjilani edhe këtë vit do të shënoj hartën e suksesit dhe efikasitetit të realizimit të pro-

grameve në shërbim më të mirë ndaj qytetarëve”, ka shtuar Haziri.

Ndërsa, drejtori i Administratës së Përgjithshme, Nazim Gagica, tha se pas këtij dhe projekteve të tjera, Komuna e Gjilanit prin me inovacion, shërbime më të mira dhe kreativitet në nivel vendi. “Ne sot po e realizojmë edhe këtë projekt të fundit, me të cilin po i përmbushim të gjitha kriteret për të krijuar një administratë moderne, krahas shumë projekteve tjera që janë realizuara në Gjilan, duke filluar prej aplikimeve online, “Telework”, “One Stop Shop” dhe regjistrimit online të procedurave administrative. Sot po i fusim në përdorim këtë “E-Kiosk”, të cilat do të jenë 24 orë në dispozicion të qytetarëve, duke rritur cilësinë e shërbimeve për dokumentet e gjendjes civile. Gjilani prin me inovacion dhe kreativitet në nivel vendi”, u shpreh Gagica. Menjëherë pas kryetarit Haziri, certifikatën e lindjes në këtë “E-kiosk” e mori edhe qytetari Riad Asllani, i cili tha se iu deshën rreth 30 sekonda për këtë shërbim dhe ky është një lehtësim i madh për të. Dy e-kiosqet tjera janë vendosur në lagjen “Arbëria” dhe “Dardania”, ndërsa do të futen në funksion gjatë javës së ardhshme. Duhet theksuar se këto “E-Kiosqe” garantojnë siguri të lartë të të dhënave personale.



Gjilani përruron shtëpinë e 25-të për familjet në nevojë

15
JANAR

Është përruruar shtëpia e 25-të në Gjilan, ku në të do vendoset familja pesë anëtarësh e Ekrem Biqukut, i cili deri më tani ka jetuar në kushte shumë të vështira dhe më e keqja ishte si i kishte humbur të gjitha shpresat për të ardhmen. Komuna e Gjilanit, përmes fondit të solidaritetit, i ndërtoi shtëpi kësaj familje.

Në përrurimin e shtëpisë ka marrë pjesë kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, i shoqëruar nga nënkryetari, Rexhep Kadriu dhe donatorë të shumtë. “Familja Biquku, për shumë kohë ka jetuar në kushte shumë të vështira. Sot është përruruar shtëpia e 25-të në kuadër të programit për zgjidhjen e problemit të banimit social. Kjo është shtëpia e 25-të e ndërtuar deri më tani. Do të vazhdohet edhe me ndërtimin e 5 shtëpive të reja, ku dy ndërtohen nga donatorët dhe të tjerat nga fondi i grumbulluar. Sikur që do të vazhdohet edhe me renovimin e mbi 35 shtëpive dhe zgjidhjen e problemeve sociale. Gjithashtu, do të organizohet edhe një mbrëmje e tillë që të bëhet e mundur zgjidhja e rasteve që kanë prob-

lem banimin si elementin bazë të zhvillimit të familjes”, ka thënë kryetari Haziri, duke i uruar familjes Biquku shtëpinë e re. Ai gjithashtu ka thënë se me angazhimin që do të bëhet, problemi i banimit social do të zgjidhet këtë vit. “Komuna e Gjilanit ka edhe një numër të banesave në dispozicion dhe ato do t’ua ndajë familjeve pa kulm mbi kokë. Në të njëjtën kohë do të vazhdohet edhe me rritjen e fondit të banimit social, në mënyrë që të mbyllet lista e banimit social njëherë e përgjithmonë”, ka thënë Haziri. Ekrem Biquku ka thënë se shtëpia ishte brenga më e madh e jetës së tij. “Unë edhe pse në këtë gjendje, ndjehem shumë mirë që shoqëria nuk më paska harruar”, ka thënë ai, duke falënderuar kryetarin për këtë mbështetje të fuqishme dhe zgjidhje të këtij problemi shumë të madh, duke i garantuar fëmijëve të tij kushte për jetë më të mirë në të ardhmen. Ndryshe, në këtë shtëpi kanë dhënë kontributin e tyre, në inventarizim dhe mobilim edhe mobileria “Besë”, mobileria “Dritë” që ka siguruar kuzhinën dhe donatorë të tjerë që bënë të mundur kompletimin e shtëpisë për Enver Biqukun.

Haziri: Gjilani, kryeqytet kulturore i shqiptarëve në Ballkan

14
JANAR

Në kuadër të “Flakës së Janarit 2016”, mbrëmë është bërë hapja e “Film-Flakës”, ku për tri ditë rresht do të jenë para qytetarëve filma të metrazhit të shkurtër, prodhim nga kinematografia shqiptare. Me këtë rast, në fjalën e hapjes të festivalit, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se Gjilani është kryeqyteti kulturor i shqiptarëve në Ballkan.

“Për shkak të ngjarjeve të shumta kulturore që mbahen në janar që nga fillimi deri në mbyllje të manifestimit me Fest Flakën, në kujtim të dëshmorëve të rënë për liri, ardhjes së shumë artistëve e artdashësve për të qenë pjesë e manifestimit, bënë tërheqjen e vëmendjes dhe përqëndrimit në kulturë e art dhe në nderim për ata që janë krenari kombëtare e historike. Gjilani është kryeqytet kulturor i shqiptarëve në Ballkan, pikërisht për këtë organizim dhe shumë aktivitete të tjera kulturore”, ka thënë kryetari Haziri. “Isha pjesë e themelimit të Flakës, si i ri në vitet e ’90-ta, përmes aktiviteteve kulturore kemi arritur që mjaftë mirë të kujtojmë e nderojmë heronjtë e rënë për liri. “Flaka e Janarit” për herë të parë pas luftës ka brend tjetër dhe zgjerim në kuadër të pasurimit të manifestimit edhe me kategori të reja, siç është film flaka, foto flaka, etj, por gjithnjë duke ruajtur themelin dhe bazën e saj të vërtetë”, ka thënë më tej i pari i Gjilanit, Lutfi Haziri duke shpallur të hapur Film Flakën. Haziri ka thënë se Gjilani përmes aktiviteteve të shumta e të ndryshme kulturore që organizon, ka për qëllim kryesor, respektin, nderimin dhe gjunjëzimin për gjithë dëshmorët që dhanë jetën, që shqiptarët në Ballkan sot të jetojnë të lirë. “Po punojmë bashkërisht, që Gjilanit i cili është qytet pa kinema për shumë vite, t’ia kthejmë filmin. Gjithashtu jemi të përqëndruar dhe po punojmë në këtë drejtim që ky manifestim të profilizohet edhe me aktivitete shitesë në fushën e kulturës, në mënyrë që të futet në kalendarin kulturor jo vetëm kombëtar, ndër shqiptarë në Ballkan, por edhe në kalendarin kulturor të artit Evropian”, tha Haziri. Ndryshe, sonte mbëmë shfaqur pesë filma të metrazhit të shkurtër, “Ballkoni”, “Heshtja”, “My City Screams”, “Tre” dhe filmi “Sonate”. Poashtu, do të vazhdohet edhe me filma të tjerë në dy netët e ardhshme për qytetarët të cilët mbushën Teatrin Qytetit në Gjilan, si asnjëherë më parë.



Në Gjilan nis manifestimi mbarëkombëtar “Flaka e Janarit 2016”

11
JANAR

Me vizitën në kazermën e Forcave të Sigurisë së Kosovës, homazhe në varrezat e dëshmorëve, te lapidarët në qytet dhe me pritje për familjet e dëshmorëve, sot ka nisur manifestimi kulturor mbarëkombëtar “Flaka e Janarit 2016”, i cili organizohet nën përkujdesjen e kryetarit Lutfi Haziri, ku për një muaj do të ketë aktivitete të shumta e të ndryshme, në kujtim dhe nderim të dëshmorëve dhe të gjithë të rënëve nëpër vite për lirinë e Kosovës.

Me këtë rast në fjalën e tij në emër të kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri, nënkryetari Rexhep Kadriu, ka thënë se Komuna e Gjilanit ka bërë të gjitha përgatitjet që ky aktivitet shumëkulturor me karakter mbarëkombëtar, pikërisht këtë vit shënon 25 vjetorin e themelimit, duke qenë vazhdimësi e aktiviteteve kulturore në nderim dhe kujtim të dëshmorëve dhe të rënëve në janarët e përgjakshëm për lirinë e vendit. “Është janari ai që me vete mori djemtë dhe vajzat e Kosovës si kurban për lirinë që ne sot gëzojmë. Që nga Mulla Idriz Gjilani, Idriz Seferi, e deri tek rënia e Rexhep Malës, Nuhi Berishës, vëllezërve Gërvalla, Kadri Zekës, Agim Ramdanit, Pajazit Ahmetit, Alban Ajetit dhe vargut të gjithë dëshmorëve të tjerë që Gjilani në janar i kujton me epitete të lartë, si figurat që dhanë jetën dhe gjaku i tyre është dhe mbetet histori e lavdishme e Gjilanit dhe Kosovës. Ky manifestim që nisi sot, është rrugëtim i vuajtjeve, persekuti-

mit, dhunës dhe barbarisë serbe ndaj popullit më të vjetër në Ballkan - shqiptarëve. Ne të gjallët, do të jemi përherë borxhlinj të heronjëve tanë, sepse ata dhanë jetën që ne sot të frymojmë lirshëm”, ka thënë ai ndër të tjerash. Kurse në fjalën e saj, gjatë pritjes së familjeve të dëshmorëve, kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku – Rexhepi, ka thënë se janari është i shenjtë për të gjithë shqiptarët, sepse pikërisht me rëniet heroike në janar, ka nisur rruga e gjatë dhe e mundimshme e lirisë së Kosovës. “Flaka e Janarit” është sinonim i respektit dhe i nderit për familjet e dëshmorëve dhe për veprat e mëdha të dëshmorëve. Prandaj, me iniciativë të kryetarit Haziri, në fund të vitit të kaluar u nderuan me titullin “Qytetar Nderi” të Komunës së Gjilanit, zonja Hanife Mala, bashkëshortja e dëshmorit Rexhep Mala si dhe baba Rexhep Berisha, babai i dëshmorit Nuhi Berisha. Kjo është më e pakta që Gjilani ka bërë, krahasuar me qëndresën dhe sakrificën e tyre në shërbim të ardueut. Para këtyre familjeve të mëdha unë sot ndjehem e vogël të flas. Ose më mirë të them, sot nuk është ditë për të thënë fjalë të tjera, pos t’ju falënderojmë. Gjilani dhe Kosova janë bërë bashkë për të bërë nderim deri në përkulje”, tha ajo në fjalën e saj. Bashkërisht sonte është bërë ndezja e flakadanit të “Flakës së Janarit 2016”, flakë e cila do të jetë e ndezur deri në përfundim të manifestimit, në shënim të flakës që iu dha lirisë së Kosovës.

Viti 2016, vit i investimeve dhe zhvillimit të Gjilanit



1
JANAR

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga familja e tij, kryesuesja e Kuvendit, Valentina Bunjaku Rexhepi, nënkryetari Rexhep Kadriu dhe drejtorët e drejtorive komunale, në natën e ndërrimit të moteve ka vizituar Policinë e Kosovës, Zjarrëfikësit, Spitalin Regjionale dhe Ndhimën e Shpejtë në Shëndetësinë Primare e më pas ka festuar në mesin e qindra qytetarëve të Gjilanit, të cilët ishin mbledhur para Teatrit të Qytetit, në ndezjen e fishekzjarreve nën atmosferën e krijuar të koncertit të madh festiv.

Kryetari Haziri me këtë rast ka thënë se viti 2016 do të jetë vit i Gjilanit dhe i qytetarëve të kësaj Komune të harruar prej kohësh nga investimet. “Ndaj lajmin e mirë me të gjithë juve qytetarë të nderuar të Gjilanit, bashkëatdhetarë

nga diaspora se viti 2016 do të jetë vit i zhvillimeve më të rëndësishme të pasluftës. Ky do të jetë vit i gjilanasve. Së bashku me miqtë e shumtë, donatorët e ndryshëm nga qeveritë botërore, së bashku me juve bashkatdhetarë dhe me qytetarët e Gjilanit, 2016-ën, do ta kemi vit të investimeve, sukseseve, punës dhe solidaritetit të përgjithshëm, për një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët”, ka thënë ai ndër të tjerash në fjalën e tij para qytetarëve të shumtë të mbledhur në qendër të Gjilanit. Haziri gjithashtu ka apeluar tek të gjithë qytetarët që kjo natë dhe këto ditë feste të kalohen në gëzim dhe mature gjatë festimit duke shtuar kujdesin në përdorimin e mjeteve piroteknike. Për ndryshe, natë e mbrëmshme ka kaluar e qetë sipas institucioneve të sigurisë dhe shëndetit public, me disa raste të cilat kanë marrë ndihmën e mjekut në kohë të shpejtë.



Haziri Gjilani, kryeqytet kulturor i shqiptarëve në Ballkan

14

JANAR

Në kuadër të “Flakës së Janarit 2016”, mbrëmë është bërë hapja e “Film-Flakës”, ku për tri ditë rresht do të jenë para qytetarëve filma të metrazhit të shkurtër, prodhim nga kinematografia shqiptare. Me këtë rast, në fjalën e hapjes të festivalit, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se Gjilani është kryeqyteti kulturor i shqiptarëve në Ballkan.

“Për shkak të ngjarjeve të shumta kulturore që mbahen në janar që nga fillimi deri në mbyllje të

manifestimit me Fest Flakën, në kujtim të dëshmorëve të rënë për liri, ardhjes së shumë artistëve e artdashësve për të qenë pjesë e manifestimit, bënë tërheqjen e vëmendjes dhe përqëndrimit në kulturë e art dhe në nderim për ata që janë krenari kombëtare e historike. Gjilani është kryeqytet kulturor i shqiptarëve në Ballkan, pikërisht për këtë organizim dhe shumë aktivitete të tjera kulturore”, ka thënë kryetari Haziri.